



**UNIVERSITETI MESDHETAR I SHQIPËRISË
FAKULTETI I SHKENCAVE EKONOMIKE
DEPARTAMENTI I EKONOMISË DHE ZHVILLIMIT**

DISERTACION

(Në kërkim të gradës shkencore Doktor i Shkencave)

Fusha e studimit: Doktoratë në Shkenca Ekonomike

VLERËSIMI I PERCEPTIMIT PUBLIK MBI ANGAZHIMIN E SIPËRMARRJEVE NË FUSHËN E PËRGJEGJËSISË SOCIALE DHE ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM: RASTI I SHQIPËRISË

Doktorant:

MSc. Ina BALUKJA

Drejtues shkencor:

Prof. Dr. Adrian CIVICI

Tiranë, Shkurt 2026

“Falënderoj udhëheqësin tim, Prof. Dr. Adrian Civici, për mbështetjen e vazhdueshme gjatë këtij rrugëtimi tre-vjeçar në fushën e kërkimit shkencor të pasur me sfida dhe risi”

“Finalizimin e punimit doktorat ia dedikoj dy femijëve të mi të shtrenjtë,
Louis & Vivien”

ABSTRAKT

Angazhimi i sipërmarrjeve shqiptare në fushën e përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm është thelbësor për promovimin e praktikave të biznesit që janë etike, përgjegjëse ndaj mjedisit dhe ekonomikisht të qëndrueshme. Megjithatë janë arritur përparime të rëndësishme në rritjen e ndërgjegjësimit dhe promovimin e iniciativave të qëndrueshmërisë, zbatimi efektiv mbetet i kufizuar për shkak të mungesës së planeve strategjike, njohurisë publike të pamjaftueshme dhe integritetit jo të barabartë të praktikave të qëndrueshmërisë në sektorët e sipërmarrjeve. Ky studim kryen një analizë të thelluar të praktikave të sipërmarrjeve të përzgjedhura në Shqipëri, duke kombinuar kornizat teorike, sondazhet empirike, fokus-grupet dhe vlerësimin e harmonizimit ligjor me acquis-n e Bashkimit Evropian 2024-2025 në fushat e qëndrueshmërisë, ekonomisë qarkulluese dhe kujdesit të detyrueshëm të sipërmarrjeve. Hulumtimi identifikon sfidat kryesore në integrimin e përgjegjësisë sociale në dimensionet ekonomike, sociale dhe mjedisore, vlerëson efektivitetin e indikatorëve të qëndrueshmërisë së sipërmarrjeve dhe thekson rolin e teknologjive të reja në përmirësimin e transparencës, raportimit dhe përputhshmërisë. Gjetjet theksojnë rëndësinë e kuadrit ligjor mbështetës, koordinimit institucional, stimujve fiskalë dhe rregullatorë, si dhe bashkëpunimeve të ndërsjellta për të forcuar angazhimin e sipërmarrjeve drejt zhvillimit të qëndrueshëm. Duke adresuar këto aspekte, sipërmarrjet shqiptare mund të përmirësojnë përafrimin strategjik me standardet e Bashkimit Evropian, të rrisin besimin publik dhe të kontribuojnë në një ambient biznesi funksional, përgjegjës dhe të qëndrueshëm, duke avancuar në këtë mënyrë objektivat kombëtare të zhvillimit dhe integritetit në Bashkimin Evropian.

Fjalë kyçe: përgjegjësi sociale e korporatave, zhvillim i qëndrueshëm, ekonomi qarkulluese, harmonizim ligjor me Bashkimin Evropian, indikatorë të qëndrueshmërisë sipërmarrëse.

ABSTRACT

The engagement of Albanian enterprises in social responsibility and sustainable development is essential for fostering ethical, environmentally responsible, and economically resilient business practices. While significant progress has been made in raising awareness and promoting sustainability initiatives, effective implementation remains limited due to gaps in strategic planning, limited public knowledge, and uneven integration of sustainability practices across corporate sectors. This study conducts a comprehensive analysis of enterprises practices in Albania, combining theoretical frameworks, empirical surveys, focus groups, and the evaluation of legal alignment with European Union acquis 2024-2025 on sustainability, circular economy, and corporate due diligence. The research identifies key challenges in integrating social responsibility across economic, social, and environmental dimensions, evaluates the effectiveness of enterprises sustainability indicators, and highlights the role of emerging technologies in enhancing transparency, reporting, and compliance. Findings emphasize the importance of supportive legal frameworks, institutional coordination, fiscal and regulatory incentives, and multi-stakeholder collaborations to strengthen enterprise commitment to sustainable development. By addressing these areas, Albanian enterprises can improve strategic alignment with European Union standards, enhance public trust, and contribute to a functional, socially responsible, and sustainable business environment, ultimately advancing national development goals and European Union integration.

Keywords: enterprise social responsibility, sustainable development, circular economy, European Union legal alignment, enterprise sustainability indicators.

PËRMBAJTJA

ABSTRAKT	iii
ABSTRACT	iv
KAPITULLI I: HYRJE DHE KUADRI STRATEGJIK I STUDIMIT	1
1. Objektivat e Studimit.....	7
2. Pyetjet Kërkimore të Studimit.....	8
3. Hipotezat e Studimit.....	9
4. Metodologjia e Studimit.....	9
5. Rezultatet e Pritshme dhe Lidhja me Objektivat e Studimit.....	10
6. Struktura e Përgjithshme e Studimit.....	11
 KAPITULLI II: INDIKATORËT PËR VLERËSIMIN E ANGAZHIMIT TË SIPËRMARRJEVE NDAJ PËRGJEGJËSISË SOCIALE DHE ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM: NJË ANALIZË TEORIKE	15
1. Hyrje.....	16
2. Sipërmarrja dhe Përgjegjësia e saj në Shoqëri.....	16
2.1. Sipërmarrja si aktor ekonomik dhe shoqëror: kuadri konceptual.....	16
2.2. Evolucion i rolit të sipërmarrjes: nga orientimi drejt fitimit të qasja e palëve të interesuara.....	16
2.4. Evolucion i përgjegjësisë sociale të sipërmarrjeve.....	18
2.5. Sipërmarrjet si aktorë kyç në zhvillimin e qëndrueshëm.....	20
2.3. Përgjegjësia sociale e sipërmarrjeve: kuptimi, definicionet dhe dimensionet.....	17
3. Indikatorët për Vlerësimin e Angazhimit të Sipërmarrjeve ndaj Përgjegjësisë Sociale dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.....	21
3.1. Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm si kornizë indikatorësh për vlerësimin e angazhimit të sipërmarrjeve.....	22
3.1.1. Indikator i praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe roli i tij në zhvillimin e sipërmarrjeve.....	24
3.1.1.1. Efikasiteti i burimeve dhe ekonomia qarkulluese: nën-indikatorë të indikatorit të praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm.....	26
3.1.1.2. Investimet me ndikim social si nën-indikator i praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm.....	26
3.1.1.3. Financat e gjelbra dhe përgjegjësia sociale si nën-indikatorë të indikatorit të praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm.....	29
3.1.1.4. Qytetaria ekonomike globale si nën-indikator i praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm.....	30
3.1.1.5. Strategjitë për qëndrueshmëri dhe rezistenca e sipërmarrjeve si nën-indikator i praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm.....	32
3.1.1.6. Angazhimi i palëve të interesuara si nën-indikator i praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm.....	33
3.2. Indikator i Reduktimit të Karbonit.....	35
3.3. Indikator i Menaxhimit të Zinxhirit të Furnizimit.....	37

3.4. Indikatori i Gjithëpërfshirjes.....	39
3.5. Indikatori i Angazhimit në Komunitet.....	40
3.6. Indikatori i Angazhimit me Palët e Interesuara.....	42
3.7. Indikatori i Investimeve Sociale.....	43
3.8. Indikatori i Pajtueshmërisë me të Drejtat e Njeriut.....	44
3.9. Indikatori i Transparencës dhe Raportimit.....	46
4. Konkluzione.....	48

KAPITULLI III: INDIKATORËT E DIMENSIONEVE EKONOMIKE PËR VLERËSIMIN E LIDHJES MIDIS PËRGJEGJËSISË SOCIALE DHE ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM TË SIPËRMARRJES: NJË ANALIZË TEORIKE.....

1. Hyrje.....	52
2. Indikatori i Rritjes së të Ardhurave.....	53
3. Indikatori i Kursimeve në Kosto.....	55
4. Indikatori i Zgjerimit të Tregut.....	56
5. Indikatori i Avantazhit Konkurses.....	59
6. Indikatori i Efikasitetit të Burimeve.....	60
7. Indikatori i Inovacionit.....	62
8. Indikatori i Qasjes në Kapital.....	63
9. Indikatori i Produktivitetit të Punonjësve.....	66
10. Indikatori i Zbutjes së Riskut.....	69
11. Indikatori i Vlerës së Markës.....	70
12. Konkluzione.....	72

KAPITULLI IV: KORNIZA METODOLOGJIKE DHE MODELI EMPIRIK PËR STUDIMIN E PERCEPTIMIT PUBLIK MBI ANGAZHIMIN E SIPËRMARRJEVE TË PËRZGJEDHURA NË SHQIPËRI NË FUSHËN E PËRGJEGJËSISË SOCIALE DHE ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM.....

1. Hyrje.....	75
2. Korniza Metodologjike e Studimit.....	77
2.1. Modeli empirik dhe struktura e variablave.....	77
2.2. Operacionalizimi i modelit analitik dhe instrumenti i mbledhjes së të dhënave.....	77
2.3. Strategjia e analizës statistikore.....	81
2.4. Hipoteza e studimit.....	81
3. Popullata e Studimit dhe Korniza e Kampionimit.....	84
3.1. Mbledhja e të dhënave të studimit dhe karakteristikat e kampionit.....	86
3.2. Analiza e të dhënave.....	86
3.3. Arsyetimi metodologjik për përzgjedhjen e regresionit rendor dhe regresionit logjistik rendor të përgjithshëm.....	88
4. Konkluzione.....	89

KAPITULLI V. REZULTATET E STUDIMIT PËR VLERËSIMIN E PERCEPTIMIT PUBLIK MBI ANGAZHIMIN E SIPËRMARRJEVE TË PËRZGJEDHURA NË SHQIPËRI NË FUSHËN E PËRGJEGJËSISË SOCIALE DHE ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM	91
1. Hyrje.....	91
2. Rezultatet kërkimore dhe diskutime.....	92
2.1 Rezultate të përgjithshme të studimit	92
2.2. Paraqitja Statistiskore e të Dhënave.....	92
2.3. Analiza e Ndërlidhjeve përmes Regresionit Rendor.....	93
2.4. Analiza e Perceptimit Publik dhe Interpretimi i Rezultateve.....	94
2.5. Analiza e Madhësisë së Efektit sipas Fokus Grupeve.....	94
2.6. Vlerësimi i Perceptimit Publik të Përgjithshëm ndaj Hipotezës së Studimit.....	97
2.7. Vlerësimi i Perceptimit për Fokus Grupet.....	101
2.7.1. Fokus grupi: Drejtues.....	101
2.7.2. Fokus grupi: Partnerë.....	104
2.7.3. Fokus grupi: Furnitorë.....	108
2.7.4. Fokus grupi: Klientë.....	112
2.7.5. Fokus grupi: Punonjës.....	116
3. Konkluzione.....	120
 KAPITULLI VI: KONKLUZIONE DHE PERSPEKTIVA PËR ZHVILLIMIN E ANGAZHIMIT TË SIPËRMARRJEVE NË DREJTIM TË PËRGJEGJËSISË SOCIALE DHE ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM TË BIZNESIT NË SHQIPËRI	125
1.Hyrje.....	125
2.Gjetjet e Studimit.....	126
3.Rekomandimet.....	128
4. Kufizimet e Studimit.....	133
5. Premisa për Kërkime të Mëtejshme.....	135
 BIBLIOGRAFIA	136
ANEKS A: Anketa.....	154
ANEKS B: Sipërmarrjet e vlerësuara në anketim.....	158
ANEKS C: Vlerësimet e elementëve të anketimit.....	161
 LISTA E FIGURAVE	
Figura I: Diagramë e Analizës së Efektit Vlerësues midis Fokus-Grupeve.....	83
Figura II: Diagramë e Qasjes Statistiskore të Studimit që përfshin Fokus Grupet.....	83
Figura III: Diagramë e Shpërndarjes së Pjesëmarrësve sipas Moshës dhe Nivelit të Arsimit.....	85
Figura IV: Diagramë grafike e krahasimit të vlerësimeve të elementeve studimore sipas fokus grupeve.....	96

Figura V: Diagramë grafike e Testit të shpërndarjes normale për variablat e regresionit rendor.....	97
Figura VI: Diagramë grafike e Modelit të regresionit rendor e atij logjistik rendor për perceptimin publik.....	99
Figura VII: Diagramë grafike për Korrelacionet e Spearman-it.....	100
Figura VIII: Diagramë grafike për Testin e shpërndarjes normale për variablat e regresionit rendor (Fokus grupi: Drejtues).....	101
Figura IX: Diagramë grafike për modelin e regresionit rendor e atij logjistik rendor (Fokus grupi: Drejtues).....	103
Figura X: Diagramë grafike për Korrelacionet e Spearman-it (Fokus grupi: Drejtues).....	104
Figura XI: Testi i shpërndarjes normale për variablat e regresionit rendor (Fokus grupi: Partnerë).....	105
Figura XII: Testi Omnibus (Fokus grupi: Partnerë).....	106
Figura XIII: Modeli i regresionit rendor e atij logjistik rendor (Fokus grupi: Partnerë)...	107
Figura XIV: Korrelacionet e Spearman-it (Fokus grupi: Partnerë).....	108
Figura XV: Testi i shpërndarjes normale për variablat e regresionit rendor (Fokus grupi: Furnitorë).....	109
Figura XVI: Testi i linjave paralele (Fokus grupi: Furnitorë).....	109
Figura XVII: Testi Omnibus (Fokus grupi: Furnitorë).....	110
Figura XVIII: Testi Omnibus (Fokus grupi: Furnitorë).....	111
Figura XIX: Korrelacionet e Spearman-it (Fokus grupi: Furnitorë).....	112
Figura XX: Testi i shpërndarjes normale për variablat e regresionit rendor (Fokus grupi: Klientë).....	112
Figura XXI: Testi i linjave paralele (Fokus grupi: Klientë).....	113
Figura XXII: Testi Omnibus (Fokus grupi: Klientë).....	114
Figura XXIII: Modeli i regresionit rendor e atij logjistik rendor (Fokus grupi: Klientë).....	114
Figura XXIV: Korrelacionet e Spearman-it (Fokus grupi: Klientë).....	115
Figura XXV: Testi i shpërndarjes normale për variablat e regresionit rendor (Fokus grupi: Punonjës).....	116
Figura XXVI: Testi i linjave paralele (Fokus grupi: Punonjës).....	117
Figura XXVII: Testi Omnibus (Fokus grupi: Punonjës).....	117
Figura XXVIII: Modeli i regresionit rendor e atij logjistik rendor (Fokus grupi: Punonjës).....	118
Figura XXIX: Korrelacionet e Spearman-it (Fokus grupi: Punonjës).....	119

LISTA E TABELAVE

Tabela I: Elementët Matës të Nën-Indikatorëve “Efikasiteti i Burimeve dhe Ekonomia Qarkulluese”.....	26
Tabela II: Elementët Matës të Nën-Indikatorit “Investimet me Ndikim Social”.....	28
Tabela III: Elementët Matës të Nën-Indikatorit “Financat e Gjelbra - Përgjegjësia Sociale”.....	30

Tabela IV: Komponentët Matës të Nën-Indikatorit “Strategjitë e Qëndrueshmërisë dhe Rezistencës”	33
Tabela V: Komponentët Matës të Nën-Indikatorit “Angazhimi i Palëve të Interesuara”	34
Tabela VI: Komponentët Matës të Indikatorit “Reduktimi i Karbonit”	36
Tabela VII: Komponentët Matës të Indikatorit “Menaxhimi i Zinxhirit të Furnizimit” ...	38
Tabela VIII: Komponentët Matës të Indikatorit “Gjithëpërfshirja”	40
Tabela IX: Komponentët Matës të Indikatorit “Angazhimi në Komunitet”	42
Tabela X “Matrica e Indikatorëve dhe Nën-Indikatorëve në Kornizën Teorike të Angazhimit të Korporatave.....	50
Tabela XI: “Indikatori i Rritjes së të Ardhurave”	55
Tabela XII: “Indikatori i Kursimeve në Kosto”	56
Tabela XIII: “Indikatori i Zgjerimit të Tregut”	58
Tabela XIV: “Indikatori i Avantazhit Konkurses”	60
Tabela XV: “Indikatori i Efikasitetit të Burimeve”	62
Tabela XVI: “Indikatori i Inovacionit”	63
Tabela XVIII: “Indikatori i Qasjes në Kapital”	66
Tabela XIX: “Indikatori i Produktivitetit të Punonjësve”	68
Tabela XX: “Indikatori i Zbutjes së Riskut”	70
Tabela XXI: “Indikatori i Vlerës së Markës”	71
Tabela XXII: “Matrica e Indikatorëve Ekonomikë në Kornizën Teorike të Angazhimit të Korporatave”	73
Tabela XXIII: Analiza e madhësisë Krahasese sipas Grup Moshave.....	93
Tabela XXIV:Krahësimi i vlerësimeve të elementeve studimore sipas fokus grupeve.....	95
Tabela XXV: Testi i shpërndarjes normale për variablat e regresionit rendor.....	97
Tabela XXVI: Testi i linjave paralele.....	98
Tabela XXVII: Testi Omnibus.....	98
Tabela XXVIII: Modeli i regresionit rendor e atij logjistik rendor për perceptimin publik.....	99
Tabela XIX: Korrelacionet e Spearman-it.....	100
Tabela XX: Testi i shpërndarjes normale për variablat e regresionit rendor.....	101
Tabela XXI. Testi i linjave paralele (Fokus grupi: Drejtues).....	102
Tabela XXII: Testi Omnibus (Fokus grupi: Drejtues).....	102
Tabela XXIII: Modeli i regresionit rendor e atij logjistik rendor (Fokus grupi: Drejtues).....	102
Tabela XXIV: Korrelacionet e Spearman-it (Fokus grupi: Drejtues).....	103
Tabela XXV: Testi i shpërndarjes normale për variablat e regresionit rendor (Fokus grupi: Partnerë).....	104
Tabela XXVI: Testi i linjave paralele (Fokus grupi: Partnerë).....	105
Tabela XXVII: Testi Omnibus (Fokus grupi: Partnerë).....	105
Tabela XXVIII: Modeli i regresionit rendor e atij logjistik rendor (Fokus grupi: Partnerë).....	106

Tabela XXIX: Korrelacionet e Spearman-it (Fokus grupi: Partnerë).....	107
Tabela XXX: Testi i shpërndarjes normale për variablat e regresionit rendor (Fokus grupi: Furnitorë).....	108
Tabela XXXI: Testi i linjave paralele (Fokus grupi: Furnitorë).....	109
Table XXXII: Testi Omnibus (Fokus grupi: Furnitorë).....	110
Tabela XXXIII. Modeli i regresionit rendor e atij logjistik rendor (Fokus grupi: Furnitorë).....	110
Tabela XXXIV: Korrelacionet e Spearman-it (Fokus grupi: Furnitorë).....	111
Tabela XXXV: Testi i shpërndarjes normale për variablat e regresionit rendor (Fokus grupi: Klientë).....	112
Tabela XXXVI: Testi i linjave paralele (Fokus grupi: Klientë).....	113
Tabela XXXVII: Testi Omnibus (Fokus grupi: Klientë).....	113
Tabela XXXVIII: Modeli i regresionit rendor e atij logjistik rendor (Fokus grupi: Klientë).....	114
Tabela XXXIX: Korrelacionet e Spearman-it (Fokus grupi: Klientë).....	115
Tabela XXXX: Testi i shpërndarjes normale për variablat e regresionit rendor (Fokus grupi: Punonjës).....	116
Tabela XXXXI. Testi i linjave paralele (Fokus grupi: Punonjës).....	116
Tabela XXXXII: Testi Omnibus (Fokus grupi: Punonjës).....	117
Tabela XXXXIII: Modeli i regresionit rendor e atij logjistik rendor (Fokus grupi: Punonjës).....	118
Tabela XXXXIV: Korrelacionet e Spearman-it (Fokus grupi: Punonjës).....	119

KAPITULLI I

HYRJE DHE KUADRI STRATEGJIK I STUDIMIT

Ky punim doktoral, i karakterizuar nga kompleksiteti i objektit të studimit dhe nga ndërthurja e dimensioneve teorike dhe empirike, synon të kontribuojë në debatin bashkëkohor mbi rolin e sipërmarrjeve në shoqërinë moderne, duke u fokusuar në vlerësimin e perceptimit publik mbi angazhimin e sipërmarrjeve të përzgjedhura në Shqipëri në fushën e përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Studimi pozicionohet në ndërthurjen e analizës ekonomike, juridike dhe sociale, duke reflektuar natyrën shumëdimensionale të veprimtarisë së sipërmarrjeve në kushtet e globalizimit dhe të ndërvlerësimit në rritje ndërmjet tregjeve, shoqërisë dhe mjedisit.

Në një ekonomi globale në transformim të vazhdueshëm, në të cilën konkurrenca intensifikohet dhe tregjet bëhen gjithnjë e më të ndërlidhura, roli i subjekteve ekonomike nuk mund të reduktohet vetëm në funksionin prodhues apo në gjenerimin e fitimit. Në literaturën dhe praktikën ndërkombëtare këto subjekte përshkruhen kryesisht me termin “Sipërmarrje” (*Enterprise*) dhe/ose “Korporatë” (*Corporation*), ndërsa në legjislacionin shqiptar përdoret nocioni “Shoqëri Tregtare”, sipas Ligjit nr. 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”¹.

Në kuadër të këtij studimi, termat “Sipërmarrje” dhe/ose “Korporatë” përdoren në kuptimin e tyre teorik dhe funksional, si ekuivalent konceptual i shoqërive tregtare, në përputhje me terminologjinë ndërkombëtare dhe literaturën shkencore përkatëse, pa pretenduar një ekuivalencë formale juridike, duke reflektuar rolin e tyre të njëjtë substancial në ekonomi dhe shoqëri. Ky rol, në kushtet e ekonomisë bashkëkohore, ka pësuar një zgjerim të ndjeshëm përtej qëllimit tradicional fitimprurës, duke përfshirë dimensione sociale, mjedisore dhe institucionale. Për rrjedhojë, sipërmarrjet përballen sot me pritshmëri të reja nga shoqëria, institucionet si dhe tregjet, të cilat i shtojnë ato të rimendojnë qëllimin, përgjegjësinë dhe ndikimin e veprimtarisë së tyre.

Në këtë kontekst, qasja tradicionale që e mat suksesin e sipërmarrjeve, kryesisht, përmes treguesve financiarë rezulton e pamjaftueshme për të shpjeguar kompleksitetin e rolit që ato luajnë në shoqërinë moderne. Kjo ide reflektohet qartë edhe në mendimin e industrialistit amerikan Henry Ford, sipas të cilit “*një biznes që bën vetëm para është një biznes i varfër*”, cituar nga Lunov & Lepskiy (2021), duke theksuar se qëndrueshmëria afatgjatë e sipërmarrjeve lidhet jo vetëm me performancën ekonomike, por edhe me përgjegjësinë ndaj shoqërisë dhe mjedisit ku ato veprojnë.

Në këtë kuadër, studimi fokusohet në analizën e përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm të sipërmarrjeve, si dhe në modelet e zbatimit dhe politikave që ndjekin korporatat. Analiza mbështetet në literaturën ndërkombëtare (Carroll, 1991; Porter & Kramer, 2006) dhe në reflektimet e autorëve shqiptarë (Tahiraj et al, 2025, Tahiraj et al., 2026; Sinanaj & Krypa Tapija, 2023; Çelo, Dumi, Çelo, 2015), duke integruar perspektiva

¹ Fletore Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, nr. 60, datë 06.05.2008.
<https://qbz.gov.al/eli/ligj/2008/04/14/9901>

të ndryshme për të ndërtuar një kuadër analitik të përshtatshëm për kontekstin shqiptar. Për shkak të rolit dhe ndikimit të gjerë të sipërmarrjeve, lind nevoja për rregullimin e veprimtarisë së tyre përtej kornizës strikte ligjore, duke përfshirë edhe standarde etike dhe morale, përgjegjësinë ndaj palëve të interesuara, konsumatorëve, mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Në këtë kuptim, përgjegjësia sociale e sipërmarrjeve nuk duhet të kuptohet thjesht si një detyrim etik i izoluar, por si një komponent thelbësor i strategjisë (Crowther, 2019) dhe i legjitimitetit shoqëror të tyre, duke marrë parasysh ndikimin e drejtëpërdrejtë në mjedisin e jashtëm, i cili konsiderohet nga kontabiliteti modern si një nga funksionet kryesore të tij. Kjo evidenton nevojën për të përcaktuar qartë rolin dhe strukturën e sipërmarrjeve si një aktor substancial në treg, duke e konsideruar atë si një formë të avancuar të organizimit të biznesit dhe një aktor kompleks ekonomik dhe social. Ky kuptim i përgjegjësisë sociale përbën bazën teorike për analizën empirike të këtij studimi.

Duke u bazuar në këtë kuadër teorik, në tablonë dinamike dhe gjithnjë në zhvillim të biznesit modern, qeverisja e sipërmarrjeve shërben si një instrument kyç për të zbatuar përgjegjësinë sociale dhe praktikën e qëndrueshme. Evolucioni i qeverisjes së sipërmarrjeve ka përshtatur pritshmëritë e shoqërisë për transparencë, etikë dhe llogaridhënie, duke nxitur sipërmarrjet të adoptojnë iniciativë strategjike me ndikim pozitiv në shoqëri dhe mjedis, pa lënë mënjanë objektivat financiare. Këto objektiva zakonisht përfshijnë filantropi, mbështetje për komunitetin, promovimin e praktikave etike të punës, diversitetin dhe sigurinë e punonjësve, si dhe investime në zhvillimin e komunitetit, veçanërisht në arsim, shëndetësi dhe rritje ekonomike, duke forcuar mirëbesimin dhe reputacionin e sipërmarrjeve (Boulouta & Pitelis, 2014; Carroll & Shabana, 2010; Aguilera et al., 2007).

Shembuj ndërkombëtarë të sipërmarrjeve si Unilever, Patagonia dhe Microsoft dëshmojnë integrimin e suksesshëm tek sipërmarrjet të përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm në strategjitë e tyre kryesore, duke adresuar pritshmëritë e palëve të interesuara, si dhe duke u përballur aktivisht me sfidat rregullatore, mjedisore dhe sociale. Krahasimisht, përpjekjet për zhvillim të qëndrueshëm dhe përgjegjësi sociale të sipërmarrjeve synojnë minimizimin e ndikimeve mjedisore, promovimin e bilancit ekologjik afatgjatë dhe integrimin e praktikave etike dhe shoqërore në strategjitë e biznesit.

Sipërmarrjet përdorin teknologji ekologjike, reduktojnë emetimet e karbonit, përmirësojnë efikasitetin e energjisë dhe investojnë në projekte të energjisë së rinovueshme. Qëndrueshmëria e zinxhirëve të furnizimit është gjithashtu një prioritet, duke u fokusuar në burimet etike të materialeve dhe reduktimin e mbetjeve (Wadhwa et al., 2023). Shumë sipërmarrje po sjellin risi përmes zhvillimit të produkteve dhe shërbimeve miqësore me mjedisin dhe modelevë të ekonomisë qarkulluese, si iniciativat për riciklimin dhe ripërdorimin (Awuah et al., 2024; Weiland et al., 2021). Këto masa ilustrojnë mënyrën sesi sipërmarrjet integrojnë përgjegjësinë sociale dhe qëndrueshmërinë në veprimtarinë e tyre operative, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm dhe në përmirësimin e performancës së kornizës së tre faktorëve jo

financiarë “Mjedis, Shoqëri dhe Qeverisje”², e cila shërben si një set indikatorësh për të vlerësuar përputhshmërinë e sipërmarrjeve me praktikën e qëndrueshme dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Këto përpjekje ndjekin jo vetëm kornizën globale të udhëhequr nga Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara³, por edhe përcaktuar në “Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike” ratifikuar nga Shqipëria më 3 tetor 1994, por edhe kornizën globale të faktorëve jo financiarë “Mjedis, Shoqëri dhe Qeverisje”, të njohura përmes udhëzimeve të standardit ndërkombëtar ISO 26000:2010 të Organizatës Ndërkombëtare për Standardizim⁴ si dhe praktikave të Bashkimit Evropian (Tsang et al., 2023; Carlsen & Bruggemann, 2022).

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm variojnë nga zbutja e varfërisë deri te ndryshimet klimatike, duke ofruar një udhërrëfyes gjithëpërfshirës për bizneset që të kontribuojnë pozitivisht në mirëqenien shoqërore dhe mjedisore. Nga ana tjetër, korniza e tre faktorëve jo financiarë “Mjedis, Shoqëri dhe Qeverisje” përfshin elementë kryesorë lidhur me praktikën e përgjegjësisë sociale të korporatave. Ndërsa, standardi si “ISO 14001:2015 ‘Për menaxhimin mjedisor’”⁵ dhe çertifikata “Certified B Corporation”⁶ shërbejnë si tregues për matjen e progresit në këto aspekte (Fonseca et al., 2022).

² Korniza e tre faktorëve jo-financiarë “Mjedis, Shoqëri, Qeverisje”, e njohur gjerësisht në literaturën ndërkombëtare si “ESG - Environmental, Social, Governance”, përkufizohet nga Organizata Ndërkombëtare për Standardizim (ISO – International Organization for Standardization) si një grup praktikash dhe treguesish jo-financiarë që kontribuojnë drejtpërdrejt në profilin e menaxhimit të rrezikut, zhvillimin e qëndrueshëm dhe përgjegjësinë sociale të një organizate. Në këtë kuadër, standardi “IWA 48:2024”, i publikuar nga Organizata Ndërkombëtare për Standardizim, përbën një dokument udhëzues jo-çertifikues që përcakton parimet e zbatimit të kornizës së tre faktorëve jo-financiarë “Mjedis, Shoqëri, Qeverisje”, duke ofruar një kornizë të nivelit të lartë për integrimin e praktikave mjedisore, sociale dhe të qeverisjes në strategjinë, kulturën dhe veprimtarinë organizative, si dhe për menaxhimin, matjen dhe raportimin e performancës “Mjedis, Shoqëri, Qeverisje” në mënyrë të qëndrueshme, të krahasueshme dhe të besueshme. Raportimi mbi këta tregues synon të rrisë transparencën ndaj investitorëve dhe palëve të interesuara mbi aktivitetet dhe ndikimet mjedisore, shoqërore dhe të qeverisjes, si dhe të nxisë harmonizimin e tyre në nivel ndërkombëtar. Për më shumë: <https://www.iso.org/standard/89240.html>

³ Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, të njohura në literaturën ndërkombëtare si “Sustainable Development Goals – SDGs”, janë një thirrje globale për veprim të adoptuar nga Shtetet Anëtare të Kombeve të Bashkuara në kuadër të Agjendës 2030, me synimin për t’i dhënë fund varfërisë, për të mbrojtur planetin dhe për të siguruar paqe e mirëqenie për të gjithë njerëzit deri në vitin 2030. Këto objektiva përfshijnë 17 qëllime të lidhura me çështje sociale, ekonomike dhe mjedisore si barazia, arsimi, klima, energjia e pastër, zhvillimi i qëndrueshëm urban dhe partneritetet ndërkombëtare. Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm synojnë të rrisin transparencën, kohezionin politik dhe bashkëpunimin ndërkombëtar për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm në të gjitha vendet. Për më shumë: <https://albania.un.org/sq/sdgs>

⁴ Standardi ndërkombëtar ISO 26000:2010 është publikuar nga Organizata Ndërkombëtare për Standardizim në vitin 2010, i cili ofron udhëzime jo-çertifikuese për përgjegjësinë sociale të organizatave, duke u fokusuar në integrimin e parimeve etike, sociale dhe mjedisore në vendimmarrje dhe veprimtari në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm. Për më shumë: <https://www.iso.org/iso-26000-social-responsibility.html>

⁵ ISO 14001:2015 është një standard ndërkombëtar për sistemet e menaxhimit mjedisor (Environment Management Systems - EMS), i cili ofron një kornizë për organizatat që të krijojnë, zbatojnë dhe përmirësojnë vazhdimisht sistemet e tyre për të menaxhuar ndikimet mjedisore, për të përmbushur kërkesat ligjore dhe për të rritur performancën mjedisore në mënyrë të qëndrueshme. Standardi është pjesë e familjes ISO 14000 dhe mund të çojë edhe në çertifikim të palëve të treta për organizatat që plotësojnë kërkesat e tij. Për më shumë: <https://www.iso.org/standard/60857.html>

⁶ “Certified B Corporation” është një çertifikim ndërkombëtar i lëshuar nga organizata jo-fitimprurëse “B Lab”, që vlerëson kompanitë mbi standarde të larta të performancës sociale dhe mjedisore, transparencës dhe

Integrimi i këtyre kornizave i ndihmon sipërmarrjet të harmonizojnë iniciativat e tyre të qëndrueshme me standardet ndërkombëtare dhe të rrisin transparencën ndaj investitorëve dhe palëve të interesuara. Ndaj, përafrimi i qeverisjes së sipërmarrjeve me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe përgjegjësisë sociale përfaqëson një hap kyç në evolucionin e praktikave bashkëkohore të biznesit. Kjo qasje simbiotike merr parasysh marrëdhënien e ndërlikuar midis komunitetit global dhe veprimtarisë së sipërmarrjeve, duke reflektuar sfidat komplekse që lidhen me ndryshimet klimatike, pabarazinë sociale dhe teknologjitë e reja.

Në këtë kontekst, sipërmarrjet nuk mund të fokusohen më vetëm tek fitimi afatshkurtër, por duhet të adoptojnë një vizion gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm, duke integruar sjelljen e përgjegjshme, kujdesin ndaj mjedisit dhe angazhimin social në strategjitë e tyre kryesore. Angazhimi i sipërmarrjeve ndaj këtyre dimensioneve reflekton jo vetëm përpjekjet për të përmbushur Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe kornizën e tre faktorëve jo financiarë “Mjedis, Shoqëri dhe Qeverisje”, por edhe një qasje strategjike që lidh performancën ekonomike me ndikimin social dhe mjedisor në një mënyrë të harmonizuar dhe të qëndrueshme.

Statistikat ndërkombëtare evidentojnë rritjen e jashtëzakonshme të këtyre praktikave. Konkreisht, “Projekti i Shkëmbimit të Karbonit”, një mekanizëm që synon të reduktojë emetimet e gazrave serrë duke krijuar një treg ku organizatat dhe shtetet mund të blejnë dhe shesin kredite karboni, në vitin 2024 raportoi se 24,800 kompani evidentuan ndikimet e tyre mjedisore⁷. Ndërsa, indeksi FTSE4Good All-World, një indeks global i zhvilluar nga FTSE Russell që përfshin kompani të listuara në tregjet kryesore botërore që plotësojnë kriteret e performancës së qëndrueshmërisë “Mjedis, Shoqëri dhe Qeverisje”, në vitin 2024 përfshiu 1,713 kompani nga 47 vende, duke ilustruar adoptimin e gjerë të praktikave të qëndrueshme nga bizneset globale⁸. Gjithashtu, raportet e politikave të sipërmarrjeve tregojnë se 76% e kompanive e konsiderojnë përgjegjësinë sociale të korporatave si thelbësore për uljen e rrezikut të reputacionit, si dhe 81% prej tyre i bëjnë publike politikat e brendshme për transparencën dhe përfshirjen e palëve të interesuara (KPMG, 2024; Sepetis, 2024).

Vlen të përmendet se, në një perspektivë krahasuese rajonale, Australia shihet si lider ku bizneset, duke filluar nga viti 2025, po miratojnë strategji proaktive për qëndrueshmërinë në përgjigje të rregulloreve të reja përgatitore që kërkojnë raportime vjetore mbi performancën mjedisore përfshirë edhe të dhënat mbi emetimet (KPMG, 2024). Në të njëjtën kohë, qasja e Bashkimit Evropian thekson rëndësinë e një zhvillimi gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm, në të cilin askush nuk mbetet pas, duke i dhënë prioritet qëndrueshmërisë lokale. Zhvillimi i qëndrueshëm në nivel lokal kërkon një menaxhim gjithëpërfshirës që i shërben të gjitha palëve të interesuara, duke u fokusuar në

përgjegjësisë dhe u jep të drejtën të përdorin markën “B Corporation” pas përmbushjes së kriteve të auditimit. Për më shumë: <https://www.bcorporation.net/en-us/certification/>

⁷ Për më shumë: <https://www.cdp.net/en/press-releases/worlds-biggest-companies-eye-usd5-trillion-in-climate-opportunities-doubling>

⁸ Për më shumë: <https://research.ftserussell.com/Analytics/FactSheets/Home/Downloads>

përfitim të komuniteteve, rajoneve dhe sektorëve të ndryshëm (Sepetis, 2024; Todri & Papajorgji, 2024).

Ndërkohë, në rajonin e Evropës Juglindore, praktikat e përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm të sipërmarrjeve kanë shfaqur nivele të ndryshme zbatimi dhe perceptimi (Levkov & Palamidovska-Sterjadovska, 2019). Studimet tregojnë se, lidhur me përgjegjësinë sociale të sipërmarrjeve, angazhimi në komunitet dhe iniciativat mjedisore janë aktivitetet që raportohen më shpesh. Ndërsa, procesi i integritetit në Bashkimin Evropian luan një rol kyç në krijimin dhe nxitjen e këtyre strategjive (UNDP, 2008; Habili, 2021). Megjithatë, perceptimet e punonjësve shpesh evidentojnë se përgjegjësia sociale e sipërmarrjeve konsiderohet si një praktikë vullnetare dhe jo si një angazhim strategjik i mirëfilltë. Në këtë kontekst, vetëm një pjesë e kufizuar e bizneseve të mesme dhe të mëdha i japin përparësi përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm, pavarësisht rëndësisë së tyre strategjike për legjitimitetin dhe reputacionin.

Evidencat rajonale (Giving Balkans) tregojnë se në Serbi sektori i biznesit ishte dhuruesi i dytë më i madh në vitin 2021, duke marrë një rol të rëndësishëm në filantropi dhe iniciativat sociale (Raporti i Dhurimeve në Serbi, 2021). Po ashtu, “Strategjia e Zhvillimit Ekonomik dhe Politik në Ballkanin Perëndimor për vitin 2022-2025” thekson se adoptimi i praktikave të qëndrueshme dhe përgjegjësisë sociale nga sipërmarrjet është në korrelacion me nivelin e afërsisë së vendeve ndaj integritetit në Bashkimin Evropian. Shtetet që janë më pranë procesit të integritetit tregojnë progres më të madh në harmonizimin e politikave dhe implementimin e standardeve që lidhen me përgjegjësinë sociale, transparencën dhe praktikat mjedisore të sipërmarrjeve. Ky informacion është i mbështetur nga raporti zyrtar i OECD “Economic Convergence Scoreboard for the Western Balkans 2025”⁹, i cili monitoron përparimin e reformave ekonomike, politike dhe sociale të vendeve të rajonit drejt përputhshmërisë me standardet e BE-së. Megjithatë, raporti evidenton se efektiviteti dhe koherenca e iniciativave të përgjegjësisë sociale të sipërmarrjeve mbeten të paqëndrueshme, duke theksuar nevojën për korniza më të strukturuar dhe të detyrueshme për të siguruar ndikim real dhe të qëndrueshëm.

Në këtë drejtim vlen të theksohet se, ndonëse adoptimi i praktikave të përgjegjësisë sociale të sipërmarrjeve dhe zhvillimit të qëndrueshëm përbëjnë tashmë një tendencë në rritje në nivel ndërkombëtar, edhe në Shqipëri vërehet një rritje graduale e interesit për këto praktika, ndonëse ato mbeten ende të kufizuara në shtrirje dhe pamjaftueshmërisht të konsoliduara në nivelin e sipërmarrjeve. Evidenca nga studime dhe raportime në Shqipëri tregojnë se, aktualisht, vetëm një pjesë e kufizuar e bizneseve të mesme dhe të mëdha angazhohen në iniciativat të përgjegjësisë sociale të sipërmarrjeve dhe zhvillimit të qëndrueshëm në mënyrë strategjike. Shumë biznese zhvillojnë nisma të përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm si veprime të rastësishme ose vullnetare dhe shpesh këto praktika nuk janë pjesë e integruar e strategjive të qeverisjes së sipërmarrjeve, duke u përqendruar kryesisht te projektet individuale apo mjedisore në vend që të përfaqësojnë

⁹ Për më shumë: https://www.oecd.org/en/publications/economic-convergence-scoreboard-for-the-western-balkans-2025_bc0babf3-en.html

një qasje gjithëpërfshirëse të qëndrueshmërisë (Levkov & Palamidovska-Sterjadovska, 2019; UNDP, 2008; Jupe & Bejko, 2020; Habili, 2021).

Për të orientuar këto përpjekje dhe për të rritur integrimin e faktorëve mjedisorë, shoqërorë dhe të qeverisjes në strategjitë dhe proceset vendimarrëse, ky studim e konsideron standardin ndërkombëtar “ISO IWA 48:2024” si një kornizë udhëzuese jo çertifikuese për parimet e zbatimit të kornizës së tre faktorëve jo financiarë “Mjedis, Shoqëri dhe Qeverisje”. Ky standard ofron udhëzime të nivelit të lartë për integrimin e këtyre faktorëve brenda kulturës dhe operacioneve organizative, duke mundësuar standardizim, krahasueshmëri dhe besueshmëri në praktikën dhe raportimin “Mjedis, Shoqëri dhe Qeverisje” pa qenë një çertifikim i detyrueshëm¹⁰.

Duke njohur rëndësinë e praktikave mjedisore, sociale dhe qeverisëse, qeveria shqiptare, në bashkëpunim me Programin e Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara, ka ndërmarrë zbatimin e një “Plani Kombëtar të Veprimit për Përgjegjësinë Sociale të Sipërmarrjeve në Shqipëri”, me qëllim nxitjen e praktikave të biznesit përgjegjës dhe të qëndrueshëm (UNDP, 2008). Ky plan synon forcimin e harmonizimit me standardet evropiane dhe kuadrin ligjor të Bashkimit Evropian, duke përmirësuar përputhshmërinë e politikave dhe praktikave kombëtare me kërkesat e integritetit evropian në fushën e përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm¹¹.

Vlerësimi i perceptimit të sipërmarrjeve të mesme dhe të mëdha të përzgjedhura në Shqipëri mbi angazhimin e tyre në fushën e përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm është gjithashtu një faktor kyç për zbatimin e praktikave të përgjegjësisë sociale të sipërmarrjeve. Një studim tregon se 45% e qytetarëve shqiptarë e konsiderojnë sigurinë dhe cilësinë e produkteve si fusha thelbësore të përgjegjësisë së sipërmarrjeve (Habili, 2021). Paralelisht, përafrimi i Shqipërisë me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm evidenton nevojën për përparim në fusha si shëndetësi, energji e pastër, rritje ekonomike dhe infrastrukturë, ndërsa ende mbeten hapësira për zhvillim në sektorë të tjerë, si ruajtja e ekosistemeve detare (Agjencia Evropiane e Mjedisit, 2020). Si rezultat, përgjegjësia sociale e sipërmarrjeve dhe zhvillimi i qëndrueshëm përbëjnë dy dimensione themelore që sipërmarrjet duhet të zhvillojnë për të vepruar me sukses në Shqipëri.

Integrimi i këtyre praktikave kontribuon në ndërtimin e besimit publik, përmirësimin e mjedisit dhe shëndetit publik, si dhe në zhvillimin ekonomik lokal. Për më tepër, praktikën e përgjegjësisë sociale ndihmojnë në krijimin e një reputacioni të fortë, përmbushin kërkesat ligjore dhe standardet ndërkombëtare, rrisin angazhimin e

¹⁰ Standardi ndërkombëtar ISO IWA 48:2024 i cili përcakton parimet e zbatimit për faktorët mjedisorë, shoqërorë dhe të qeverisjes (*Implementation principles for environmental, social and governance - ESG factors*) është një udhëzues jo-çertifikues i Organizatës Ndërkombëtare për Standardizim (ISO) që ofron kornizë të nivelit të lartë për integrimin e praktikave “Mjedis, Shoqëri dhe Qeverisje” në strategji, kulturë dhe operacione organizative, duke mbështetur standardizimin dhe krahasueshmërinë në raportimin “Mjedis, Shoqëri dhe Qeverisje”. Për më shumë: <https://www.iso.org/standard/89240.html>

¹¹ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) ka mbështetur zhvillimin e një Plani Kombëtar të Veprimit për Përgjegjësinë Sociale të Sipërmarrjeve në Shqipëri, duke kontribuar në krijimin e një mjedisi politikash që promovon praktikën e përgjegjësisë sociale dhe qëndrueshmërisë si dhe harmonizimin e tyre me standardet ndërkombëtare dhe evropiane. Për më shumë: <https://www.undp.org/albania/publications/national-csr-report-2013>

punonjësve dhe ofrojnë një avantazh konkurrues, duke promovuar një kulturë pozitive dhe të qëndrueshme në shoqëri. Prandaj, në Shqipëri, është thelbësore që korporatat të integrojnë përgjegjësinë sociale dhe zhvillimin e qëndrueshëm në strategjitë e tyre për të garantuar një të ardhme më të qëndrueshme dhe të sigurt për të gjitha palët e interesuara.

Në këtë drejtim, iniciativat ndërkombëtare si çertifikata “Certified B Corporation” ofrojnë modele konkrete për zbatimin e praktikave të qëndrueshme. Kjo çertifikatë u jepet bizneseve që përmbushin kritere të caktuara në pesë fusha kryesore si punonjësit, komuniteti, klientët, ndikimi mjedisor dhe modeli i qeverisjes, konsideruar se studimet ndërkombëtare (Fonseca et al., 2022) tregojnë se kjo çertifikatë mund të nxisë një sukses më të madh të korporatave duke kontribuar edhe në rritjen e të ardhurave.

Integrimi i praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe të përgjegjësisë sociale nga sipërmarrjet e përzgjedhura në Shqipëri, së bashku me perceptimin e publikut mbi nivelin dhe cilësinë e këtij angazhimi, përbëjnë një komponent thelbësor në ndërtimin e kuadrit empiriko-teorik të këtij studimi. Analiza e këtyre elementëve krijon bazën konceptuale dhe metodologjike mbi të cilën mbështeten objektivat e studimit, pyetjet kërkimore, hipotezat, metodologjia dhe rezultatet e pritshme, si dhe struktura e punimit.

1. Objektivat e Studimit

Objektivi kryesor i studimit është:

✓ *Analizimi i nivelit të angazhimit të sipërmarrjeve të përzgjedhura në Shqipëri në fushën e përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke vlerësuar shkallën e përafrimit të praktikave me standardet ndërkombëtare bashkëkohore, identifikuar sfidat dhe mundësitë për përmirësim, si dhe vlerësuar këtë angazhim nga këndvështrimi i perceptimit publik.*

Në mënyrë të veçantë, studimi synon:

✓ *Identifikimin e faktorëve dhe elementëve që nxisin ose pengojnë angazhimin e sipërmarrjeve të përzgjedhura në Shqipëri në fushën e përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm.*

✓ *Vlerësimin e ndikimit të këtyre faktorëve dhe elementëve në përafrimin e praktikave të sipërmarrjeve të përzgjedhura në Shqipëri me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.*

Objektivat specifike të studimit janë:

✓ *Identifikimi i elementëve kryesorë të angazhimit të sipërmarrjeve të përzgjedhura në Shqipëri në fushat mjedisore, sociale, institucionale dhe ekonomike.*

✓ *Analiza e perceptimeve të publikut mbi angazhimin e sipërmarrjeve të përzgjedhura në Shqipëri në këto fusha.*

✓ *Vlerësimi i ndikimit të pesë shtyllave studimore në përafrimin e praktikave të sipërmarrjeve të përzgjedhura në Shqipëri me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm:*

- ❑ Reduktimi i Emetimeve të Karbonit dhe Menaxhimi i Zinxhirit të Furnizimit - një variabël i pavarur.
- ❑ Gjithëpërfshirja dhe Angazhimi në Komunitet - një variabël i pavarur.
- ❑ Investimet Sociale dhe Palët e Interesuara - një variabël i pavarur.
- ❑ Transparenca, Raportimi dhe Pajtueshmëria me të Drejtat e Njeriut - një variabël i pavarur.
- ❑ Niveli i perceptuar i përafrimit të praktikave të sipërmarrjeve të përzgjedhura në Shqipëri me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm përmes integritetit të praktikave të qëndrueshmërisë – një variabël i varur.
- ✓ Dhënia e rekomandimeve praktike për sipërmarrjet dhe aktorët politikë për të përmirësuar politikat dhe praktikën e përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm në Shqipëri.

2. Pyetjet Kërkimore të Studimit

Në funksion të realizimit të objektivit kryesor, studimi udhëhiqet nga **pyetja kërkimore qendrore**:

✓ Cilat janë aspektet kryesore që, sipas perceptimit publik, ndikojnë në rritjen e angazhimit të sipërmarrjeve të përzgjedhura në Shqipëri në fushën e përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm?

Për të adresuar këtë pyetje qendrore, studimi përfshin edhe **pyetjet kërkimore ndihmëse**, të lidhura me dimensionet mjedisore, shoqërore, institucionale dhe ekonomike të angazhimit të sipërmarrjeve:

▪ Dimensioni mjedisor:

✓ Në çfarë mase praktikën e reduktimit të emetimeve të karbonit dhe menaxhimit të zinxhirit të furnizimit ndikojnë në perceptimin publik të angazhimit të sipërmarrjeve ndaj objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm?

▪ Dimensioni shoqëror:

✓ Si perceptohet nga publiku angazhimi i sipërmarrjeve në komunitet, në politikat e gjithëpërfshirjes dhe në investimet sociale?

▪ Dimensioni institucional:

✓ Në çfarë mase transparenca, raportimi dhe respektimi i të drejtave të njeriut ndikojnë në përafrimin e praktikave të sipërmarrjeve me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm?

▪ **Dimensioni ekonomik:**

✓ Si lidhen praktikat ekonomike të sipërmarrjeve me përafrimin e tyre me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe me përfitimet e tyre konkurruese, sipas perceptimit publik?

3. Hipotezat e Studimit

Në përputhje me objektivat e studimit, pyetjen kërkimore qendrore dhe pyetjet kërkimore ndihmëse, janë formuluar edhe **hipotezat** e mëposhtme të studimit:

✓ **H0:** Në modelin e regresionit rendor, koeficientët e variablave të pavarur që përfaqësojnë dimensionin mjedisor, shoqëror, institucional dhe ekonomik nuk janë statistikisht të rëndësishëm ($\beta_1 = \beta_2 = \beta_3 = \beta_4 = 0$), çka nënkupton se këto dimensione nuk ushtrojnë ndikim domethënës në perceptimin mbi përafrimin e sipërmarrjeve të përzgjedhura në Shqipëri me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

✓ **H1:** Koeficienti i variablit (β_1), që përfaqëson angazhimin e sipërmarrjeve në reduktimin e emetimeve të karbonit dhe në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit, është pozitiv dhe statistikisht i rëndësishëm në modelin e regresionit rendor, duke treguar ndikim domethënës në perceptimin publik mbi përafrimin e sipërmarrjeve me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

✓ **H2:** Koeficienti i variablit (β_2), që përfaqëson gjithëpërfshirjen dhe angazhimin e sipërmarrjeve në komunitet, është pozitiv dhe statistikisht i rëndësishëm në modelin e regresionit rendor, duke treguar ndikim domethënës në perceptimin publik mbi përafrimin e sipërmarrjeve me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

✓ **H3:** Koeficienti i variablit (β_3), që përfaqëson investimet sociale dhe angazhimin e sipërmarrjeve me palët e interesuara, është pozitiv dhe statistikisht i rëndësishëm në modelin e regresionit rendor, duke treguar ndikim domethënës në perceptimin publik mbi përafrimin e sipërmarrjeve me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

✓ **H4:** Koeficienti i variablit (β_4), që përfaqëson transparencën, raportimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut është pozitiv dhe statistikisht i rëndësishëm në modelin e regresionit rendor, duke treguar ndikim domethënës në perceptimin publik mbi përafrimin e sipërmarrjeve me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

4. Metodologjia e Studimit

Studimi adopton një **metodologji mikse** që mbështetet në:

✓ *Integrimin e metodave sasiore dhe cilësore, me qëllim sigurimin e një analize gjithëpërfshirëse të angazhimit të sipërmarrjeve ndaj përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm.*

✓ *Mbledhjen e të dhënave empirike përmes një ankete online dhe **fokus-grupeve**, të përdorura për të matur perceptimin **publik** mbi angazhimin e sipërmarrjeve*

të përzgjedhura, shqiptare dhe atyre me origjinë të huaj, që veprojnë në Shqipëri dhe që kanë ekspozim real ndaj praktikave të përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Duke qenë se struktura e ekonomisë shqiptare dominohet nga biznesi i vogël dhe i mesëm, *kampioni përbëhet nga shoqëri tregtare që kualifikohen si sipërmarrje të mëdha dhe të mesme, të cilat përfaqësojnë pjesën më të rëndësishme të fokus grupit të synuar për qëllimet analitike të këtij studimi.*

✓ *Analiza fokusohet në 10 indikatorë të angazhimit të sipërmarrjeve, të ndarë në pesë shtylla kryesore studimore, të cilat përfaqësojnë variablat e pavarur që matin dimensionet ekonomike, sociale, mjedisore dhe të qeverisjes së përgjegjshme, ndërsa variabli i varur mat nivelin e perceptuar të përafrimit të sipërmarrjeve me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, duke u bazuar në integrimin e praktikave të qëndrueshmërisë. Secili indikator operacionalizohet përmes treguesve kyç tematikë, të cilët mund të përfshijnë nën-indikatorë specifikë, të cilët më tej zbërthehen në elementë konkretë matës. Kjo strukturë lejon lidhjen e drejtëpërdrejtë midis kornizës teorike dhe pjesës zbatuese të studimit, si dhe përshtatjen e tyre me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe integrimin e praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm.*

✓ *Përdorimin e metodave statistikore përshkruese, analizës së madhësisë së efektit, si dhe analizës së regresionit rendor dhe logjistik rendor. Këto metoda përdoren për të evidentuar ndikimin relativ të secilës shtyllë në përafrimin e praktikave të sipërmarrjeve të përzgjedhura në Shqipëri me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, si dhe për të analizuar ndryshimet midis grupeve të interesit.*

5. Rezultatet e Pritshme dhe Lidhja me Objektivat e Studimit

Në përputhje me objektivat e studimit, pyetjet kërkimore dhe hipotezat e formuluar, pritet që ky punim doktoral të sjellë një sërë rezultatesh dhe kontributesh të rëndësishme teorike, metodologjike dhe praktike në fushën e përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm të sipërmarrjeve në Shqipëri:

✓ *Vlerësim gjithëpërfshirës dhe i strukturuar i nivelit të angazhimit të sipërmarrjeve të përzgjedhura në Shqipëri në lidhje me përgjegjësinë sociale dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Ky vlerësim do të evidentojë shkallën e përafrimit të praktikave të sipërmarrjeve të përzgjedhura në Shqipëri me standardet bashkëkohore ndërkombëtare referuar objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, duke reflektuar perceptimin publik.*

✓ *Identifikimi i faktorëve kryesorë mjedisorë, shoqërorë, institucionalë dhe ekonomikë që ndikojnë në mënyrë domethënëse në përafrimin e praktikave të sipërmarrjeve me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm. Analiza e këtyre faktorëve, bazuar në perceptimin publik, do të kontribuojë në fokusimin më efektiv të përpjekjeve strategjike dhe operative të sipërmarrjeve, si dhe në hartimin e politikave mbështetëse nga aktorët institucionalë.*

✓ *Kontribut origjinal dhe risi në literaturën shkencore përmes një qasje të integruar teorike, metodologjike dhe empirike. Një nga kontributet kryesore konsiston në rishikimin metodologjik të zgjeruar dhe të strukturuar të indikatorëve që përdoren për të*

matur angazhimin e sipërmarrjeve ndaj përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Ky rishikim përfshin jo vetëm indikatorët tradicionalë mjedisorë, shoqërorë dhe institucionalë, por shtrihet edhe në dimensionin ekonomik të këtyre angazhimeve, duke integruar indikatorë si: (i) rritja e të ardhurave; (ii) kursimet në kosto; (iii) zgjerimi i tregut; (iv) avantazhi konkurrues; (v) efikasiteti i burimeve; (vi) inovacioni; (vii) qasja në kapital; (viii) produktiviteti i punonjësve; (ix) zbutja e riskut dhe vlera e markës. Ky integrim përbën një risi metodologjike, pasi lidh në mënyrë sistematike përgjegjësinë sociale dhe zhvillimin e qëndrueshëm me performancën ekonomike dhe konkurruese të sipërmarrjeve. Në vijim, studimi pritet të ofrojë një kontribut metodologjik empirik, përmes aplikimit të një metodologjie mikse që integron të dhënat sasiore dhe cilësore. Vlerësimet mbi angazhimin e shoqërive tregtare me ortakë/aksionarë shqiptarë dhe ato me ortakë/aksionarë të huaj, të përzgjedhura në Shqipëri, të cilat realizohen përmes një ankete online, që mbledh perceptimet e grupeve të ndryshme të interesit. Këto grupe përfshijnë fokus-grupet brenda strukturave organizative të shoqërive tregtare, si dhe aktorët e tregut me të cilët ndërveprojnë këto biznese. Integrimi i disa analizave statistikore në mënyrë të kombinuar përbën një tjetër element që është risi i këtij studimi.

✓ *Studimi synon të kontribuojë në orientimin praktik të sipërmarrjeve që veprojnë në Shqipëri.* Bazuar në rezultatet përshkruese dhe empirike të marra nga kampioni i plotë dhe nga secili fokus-grup, studimi ofron evidenca të bazuara shkencërisht për rritjen e angazhimit të tyre në fushën e përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe duke krijuar një bazë të qëndrueshme për hulumtime të ardhshme në këtë fushë.

✓ *Qasje e integruar dhe inovative në realitetin shqiptar.* Ky studim doktorale është një nga përpjekjet e para gjithëpërfshirëse për të analizuar angazhimin e sipërmarrjeve ndaj përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm nga këndvështrimi i perceptimit publik.

✓ *Orientime praktike dhe rekomandime konkrete për sipërmarrjet, politikëbërësit dhe aktorët institucionalë.* Rezultatet e studimit do të shërbejnë për përmirësimin e politikave dhe praktikave të përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm në Shqipëri, si dhe krijimin e një baze të qëndrueshme për hulumtime të ardhshme në këtë fushë.

6. Struktura e Përgjithshme e Studimit

Për të siguruar një qasje të qartë dhe të strukturuar ndaj objektivave të studimit, punimi organizohet në **6 (gjashtë)** kapituj kryesorë, secili me një fokus specifik dhe lidhje të drejtëpërdrejtë me pyetjet kërkimore dhe hipotezat e ngritura në këtë studim.

1. Kapitulli i parë ofron kuadrin konceptual për këtë temë doktorale duke analizuar rolin e sipërmarrjeve në promovimin e përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm në Shqipëri, si dhe perceptimin publik mbi këtë angazhim. Ai shqyrton rëndësinë e dimensioneve mjedisore, sociale, institucionale dhe ekonomike si elementë kyç të

strategji të biznesit, veçanërisht, në një kontekst të integritetit evropian dhe rritjes së kërkesave për transparencë dhe llogaridhënie. Ky kapitull përmban qëllimin dhe objektivat e studimit, pyetjet kërkimore dhe hipotezat, metodologjinë e studimit dhe rezultatet e pritshme si dhe lidhjen e tyre me objektivat e studimit, duke krijuar lidhjen midis kuadrit teorik dhe analizës empirike. Metodologjia e përdorur është mikse, duke integruar të dhëna sasiore dhe cilësore përmes anketave dhe fokus-grupeve, me qëllim të vlerësimit të perceptimit publik dhe të angazhimit real të sipërmarrjeve. Ai gjithashtu përshkruan shtyllat kryesore të angazhimit dhe indikatorët që përdoren për të matur dimensionet e ndryshme të përgjegjësisë sociale. Gjithashtu, ky kapitull lidh literaturën dhe teorinë me praktikën aktuale në Shqipëri, duke evidentuar boshllëkun midis angazhimeve formale dhe implementimit të tyre. Përveç kësaj, identifikon faktorët nxitës dhe pengues të integritetit të qëndrueshmërisë, duke ofruar një kornizë për analizën empirike të mëtejshme, si dhe siguron një orientim të qartë për zhvillimin e pjesëve të tjera të temës dhe paraqet kontributet dhe rezultatet e pritshme të studimit.

2. Kapitulli i dytë ndërton kuadrin teorik dhe konceptual të studimit, duke analizuar evolucionin e rolit të sipërmarrjeve nga një qasje tradicionale e orientuar nga fitimi drejt integritetit të përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm si pjesë e strategjisë së tyre afatgjatë. Në këtë kontekst shqyrtohen konceptet themelore të përgjegjësisë sociale të sipërmarrjeve dhe zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe ndërthurja e dimensioneve ekonomike, sociale, mjedisore dhe institucionale në veprimtarinë e sipërmarrjeve. Kapitulli i dytë, gjithashtu, analizon rolin e indikatorëve të matshëm si instrumente për vlerësimin e nivelit të angazhimit të sipërmarrjeve dhe përputhshmërisë së praktikave të tyre me standardet ndërkombëtare dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Një vëmendje e veçantë i kushtohet rëndësisë së perceptimit publik dhe të palëve të interesuara si element kyç në legjitimimin dhe efektivitetin e përgjegjësisë sociale. Në përfundim, ky kapitull vendos themelet teorike mbi të cilat mbështetet analiza empirike e studimit, duke krijuar bazën për operacionalizimin e indikatorëve dhe testimin e hipotezave në kapitujt vijues.

3. Kapitulli i tretë analizon në planin teorik indikatorët e dimensionit ekonomik si instrumente për vlerësimin e lidhjes midis përgjegjësisë sociale të sipërmarrjeve dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Duke u mbështetur në literaturën shkencore bashkëkohore, ndërtohet një kornizë konceptuale që evidenton ndërthurjen midis performancës ekonomike dhe ndikimit shoqëror të aktiviteteve të sipërmarrjeve. Theksi vihet në rolin e menaxhimit të përgjegjshëm të burimeve, zinxhirit të furnizimit, investimeve të qëndrueshme dhe kontributit në zhvillimin e komunitetit. Në këtë mënyrë, kapitulli i tretë thekson se suksesi ekonomik nuk përbën vetëm një objektiv financiar, por një komponent të rëndësishëm të qëndrueshmërisë afatgjatë. Analiza e indikatorëve ekonomikë krijon bazën teorike për matjen empirike të angazhimit të sipërmarrjeve dhe për vlerësimin e ndikimit të tij në arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm.

4. Kapitulli i katërt paraqet arkitekturën metodologjike të studimit, duke operacionalizuar objektivat, pyetjet kërkimore dhe hipotezat në një model empirik të strukturuar. Në këtë fazë, analiza zhvendoset nga niveli teorik në verifikimin empirik, përmes ndërtimit të variablave të matshëm dhe aplikimit të teknikave statistikore të përshtatshme për testimin e marrëdhënieve ndërmjet dimensioneve të përgjegjësisë

sociale dhe perceptimit publik. Korniza metodologjike mbështetet në paradigmen pozitiviste dhe post-pozitiviste, duke kombinuar qasjen kuantitative me analiza statistikore të avancuara. Modeli analitik përfshin pesë shtyllat kryesore të angazhimit të sipërmarrjeve: dimensionin mjedisor, dimensionin social, dimensionin institucional/qeverisës, investimet dhe përafrimin me zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm (variabla të pavarur), që analizohen në raport me perceptimin publik si variabël i varur. Përmes ndërtimit të një instrumenti të strukturuar matjeje dhe aplikimit të metodave si regresioni rendor dhe regresioni logjistik rendor, ky kapitull siguron rigorozitet metodologjik dhe besueshmëri analitike. Në tërësi, ai krijon bazën empirike për testimin e hipotezave dhe për vlerësimin e ndikimit të dimensioneve të përgjegjësisë sociale në legjitimitetin dhe qëndrueshmërinë e sipërmarrjeve në kontekstin shqiptar.

5. Kapitulli i pestë paraqet rezultatet e studimit për vlerësimin e perceptimit publik mbi angazhimin e sipërmarrjeve të përzgjedhura në Shqipëri në fushën e përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Rezultatet përshkruhen në mënyrë inferenciale përmes modeleve statistikore të përshtatura duke integruar interpretimin numerik me kontekstin konceptual. Analiza fokusohet në pesë shtyllat kryesore të modelit, duke evidentuar në cilat dimensione perceptimi publik është më i konsoliduar dhe ku ekzistojnë pasiguri ose nevojë për përmirësim institucional. Trajtimi i të dhënave nuk i konsideron rezultatet si tregues të izoluar, por si pjesë të një strukture analitike që reflekton kompleksitetin e ndërveprimit ndërmjet dimensioneve mjedisore, sociale dhe të qeverisjes së sipërmarrjeve. Përveç përshkrimit të përgjithshëm, ky kapitull analizon ndikimet e ndryshme të secilit dimension mbi përafrimin me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe evidenton tendencat kryesore në qasjen e sipërmarrjeve të përzgjedhura në Shqipëri. Rezultatet diferencohen gjithashtu sipas grupeve të interesit, duke përfshirë drejtuesit, punonjësit, klientët dhe partnerët, për të identifikuar dallime në perceptim dhe për të rritur thellësinë analitike. Kjo qasje shumë-dimensionale mundëson lidhjen e modelit teorik me evidencën empirike dhe testimin e hipotezave të studimit. Në këtë mënyrë, kapitulli jo vetëm raporton gjetjet empirike, por ofron edhe udhëzime të vlefshme për praktikën e sipërmarrjeve dhe politikëbërjen në Shqipëri, duke nxjerrë në pah dimensionet ku angazhimi i sipërmarrjeve është më efektiv dhe ato ku kërkohet përmirësim strategjik.

6. Kapitulli i gjashtë prezanton konkluzionet dhe perspektivat për zhvillimin e angazhimit të sipërmarrjeve në drejtim të përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm të biznesit në Shqipëri. Ky kapitull përmbledh gjetjet më të rëndësishme të studimit mbi angazhimin e sipërmarrjeve shqiptare në fushën e përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke integruar rezultatet e analizës teorike dhe empirike. Ai shërben si urë lidhëse ndërmjet kuadrit konceptual, modelit metodologjik dhe rezultateve të analizës së të dhënave, duke krijuar një bazë të qëndrueshme për formulimin e rekomandimeve dhe për evidentimin e kufizimeve dhe drejtimeve të ardhshme të kërkimit.

▪ **Në përfundim:**

✓ Konkludohet se, duke marrë parasysh kontekstin dhe rezultatin e studimit, zhvillimi i qëndrueshëm po konsolidohet gjithnjë e më shumë si nje parim themelor me karakter universal, i cili orienton veprimtarinë e aktorëve publikë dhe privatë, duke shndërruar sipërmarrjet në një faktor kyç për realizimin e tij, edhe ne kontekstin shqiptar. Studimi synon të shqyrtojë rolin, sfidat dhe mundësitë e angazhimit të sipërmarrjeve shqiptare në fushën e përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke ofruar një bazë për rekomandime praktike dhe politika që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm në nivel kombëtar në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe me legjislacionin evropian.

KAPITULLI II

INDIKATORËT PËR VLERËSIMIN E ANGAZHIMIT TË SIPËRMARRJEVE NDAJ PËRGJEGJËSISË SOCIALE DHE ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM: NJË ANALIZË TEORIKE

1. Hyrje

Objekti i këtij studimi doktoral është analizimi i nivelit të angazhimit të sipërmarrjeve të përzgjedhura në Shqipëri, në fushën e përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Studimi vlerëson shkallën e përafrimit të praktikave të tyre me standardet ndërkombëtare bashkëkohore, identifikon sfidat dhe mundësitë për përmirësim, si dhe shqyrton perceptimin publik dhe të palëve të interesuara mbi këtë angazhim. Qëllimi është të identifikohen faktorët dhe elementët që nxisin ose pengojnë angazhimin e sipërmarrjeve në fushën e përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm në kontekstin shqiptar, si dhe të vlerësohet ndikimi i tyre në përafrimin e bizneseve me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik.

Kjo analizë realizohet duke u fokusuar në identifikimin dhe vlerësimin e indikatorëve kryesorë të matshëm që pasqyrojnë angazhimin e sipërmarrjeve në dimensionet mjedisore, shoqërore, institucionale dhe ekonomike. Studimi e shqyrton këtë angazhim nga këndvështrimi i perceptimit publik dhe i palëve të interesuara, duke e konsideruar këtë perspektivë si një element thelbësor në vlerësimin e legjitimitetit dhe efektivitetit të praktikave të sipërmarrjeve.

Në këtë kuptim, kapitulli i dytë synon të ndërtojë boshtin teorik dhe konceptual të studimit, përmes një eksplorimi sistematik të literaturës shkencore mbi sipërmarrjet si aktorë ekonomikë dhe shoqërorë, evolucionin e rolit dhe përgjegjësisë të tyre në shoqëri, si dhe kalimin gradual nga një qasje e orientuar kryesisht nga fitimi drejt përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm si komponentë strategjikë të veprimtarisë të sipërmarrjeve. Gjithashtu, ky kapitull vendos themelet teorike mbi të cilat mbështetet analiza empirike e zhvilluar në kapitujt vijues, duke ofruar një kuptim të strukturuar të koncepteve, qasjeve dhe indikatorëve të matshëm që përdoren për të vlerësuar angazhimin e sipërmarrjeve ndaj përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Në mënyrë më specifike, kapitulli i dytë trajton fillimisht konceptin e sipërmarrjeve dhe përgjegjësitë e tyre në kontekstin e zhvillimeve ekonomike, shoqërore dhe mjedisore bashkëkohore, duke ndjekur evolucionin historik dhe teorik të përgjegjësisë së sipërmarrjeve drejt përgjegjësisë sociale. Më pas, analizohet kuptimi dhe përkufizimi i përgjegjësisë sociale të sipërmarrjeve dhe zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe format kryesore të shfaqjes së tyre në praktikë. Në vijim, ky kapitull analizon në planin teorik rolin e indikatorëve si instrumente analitike për matjen dhe vlerësimin e këtyre

angazhimeve, duke theksuar rëndësinë e integritetit të dimensioneve mjedisore, shoqërore, institucionale dhe ekonomike.

Kapitulli i dytë përmbyllet me një sintezë të çështjeve kryesore të trajtuara, duke nxjerrë në pah lidhjet midis koncepteve teorike, praktikave të sipërmarrjeve dhe indikatorëve që masin angazhimin e sipërmarrjeve në fushën e përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm, që shërben si lidhje konceptuale me kapitullin e dytë, ku këto elementë operacionalizohen më tej në kuadrin metodologjik të studimit.

2. Sipërmarrja dhe Përgjegjësia e saj në Shoqëri

Analiza teorike për indikatorët e përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm kërkon fillimisht një qartësim konceptual mbi rolin e sipërmarrjes në shoqëri dhe evolucionin e përgjegjësisë së saj (Freeman, 1984; Carrol 1991; Pojani, 2025).

Në këtë drejtim, analiza e sipërmarrjes si aktor ekonomik dhe shoqëror përbën bazën teorike mbi të cilën ndërtohet kuptimi bashkëkohor i përgjegjësisë sociale të sipërmarrjeve (Jensen, 2001; Friedman, 1970; Jupe & Bejko, 2020).

2.1. Sipërmarrja si aktor ekonomik dhe shoqëror: kuadri konceptual

Në literaturën klasike ekonomike, sipërmarrja është konceptuar kryesisht si një subjekt ekonomik, qëllimi parësor i të cilit është maksimizimi i fitimit për aksionarët e saj (Friedman, 2007; Jensen 2001; Pojani, 2025). Kjo qasje, e njohur gjerësisht si modeli “i orientuar nga aksionarët”, mbështetet në idenë se përgjegjësia kryesore e biznesit është gjenerimi i vlerës ekonomike brenda formës juridike të tij ekzistuese, ndërsa çështjet sociale dhe mjedisore konsiderohen jashtë fushës së përgjegjësisë së drejtpërdrejtë të tij.

Për një periudhë të gjatë, kjo perspektivë dominoi doktrinën ekonomike dhe praktikën menaxheriale, duke e kufizuar rolin e sipërmarrjes, kryesisht, në funksionin e saj financiar (Freeman, 1984, Todri, Sejdini & Balukja, 2025). Megjithatë, ky model tradicional ka rezultuar gjithnjë e më i pamjaftueshëm për të shpjeguar kompleksitetin e marrëdhënieve midis sipërmarrjeve dhe shoqërisë në kontesktin bashkëkohor. Transformimet ekonomike, sociale dhe institucionale të dekadave të fundit kanë nxitur një rikonceptualizim të rolit të sipërmarrjes, duke e pozicionuar atë jo vetëm si krijuese të vlerës ekonomike, por edhe si aktor me ndikim të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë në mirëqenien shoqërore dhe mjedisore (Porter & Kramer, 2006; Todri, Sejdini & Balukja, 2025). Kjo qasje hap rrugën për analizën e rolit të sipërmarrjes drejt përgjegjësisë të zgjeruara shoqërore, e cila trajtohet në nënçështjen vijuese.

2.2. Evolucionin e rolit të sipërmarrjes: nga orientimi drejt fitimit te qasja e palëve të interesuara

Globalizimi i tregjeve, rritja e ndërvarësisë ekonomike, shfaqja e sfidave globale lidhur me ndryshimet klimatike, pabarazitë sociale dhe degradimi mjedisor, sikurse dhe

rritja e ndjeshmërisë publike kundrejt sjelljes së sipërmarrjeve, kanë vënë në pikëpyetje modelin tradicional të qeverisjes së sipërmarrjeve i orientuar ekskluzivisht drejt aksionarëve (Sachs, 2015; WEF, 2020; Gjerazi & Skana, 2023).

Në këtë kontekst ka marrë formë qasja e bazuar tek palët e interesuara, e cila zgjeron fushën e përgjegjësisë së sipërmarrjeve përtej aksionarëve, duke përfshirë punonjësit, klientët, furnitorët, komunitetet lokale, institucionet publike dhe shoqërinë në tërësi (Freeman, 1984; Donaldson & Preston, 1995; Pojani, 2025). Sipas kësaj perspektive, performanca e sipërmarrjes vlerësohet jo vetëm në terma financiarë, por edhe në funksion të mënyrës se si ajo menaxhon marrëdhëniet me aktorët e ndryshëm dhe adreson ndikimet sociale dhe mjedisore të veprimtarisë së saj (Carroll, 1991; Matten & Moon, 2008; Jupe & Bejko, 2020).

Ky zgjerim i fushës së përgjegjësisë kërkon një ndryshim thelbësor në filozofinë e menaxhimit të sipërmarrjes, duke integruar qëllimet sociale dhe mjedisore në vendimarrje. Kalimi nga orientimi ekskluziv ndaj fitimit drejt një qasjeje gjithëpërfshirëse ka kontribuar drejtëpërdrejt në zhvillimin e konceptit të përgjegjësisë sociale (Porter & Kramer, 2006; Gjerazi & Skana, 2023), duke e pozicionuar atë si një komponent strategjik të veprimtarisë së sipërmarrjeve (Carroll, 1991; Matten & Moon, 2008; Todri, Sejdiu & Balukja, 2025).

Në përfundim, evolucioni i rolit të sipërmarrjeve nga një aktor i orientuar kryesisht nga fitimi drejt një subjekti ekonomik me përgjegjësi të zgjeruara shoqërore dhe mjedisore përbën bazën konceptuale të përgjegjësisë sociale për këto subjekte. Ky transformim teorik krijon premisat për analizën e formave konkrete të shfaqjes së përgjegjësisë sociale të sipërmarrjeve dhe për operacionalizimin e saj përmes indikatorëve të matshëm, çështje që trajtohen në seksionet vijuese të këtij kapitulli (Carroll, 1991; Freeman, 1984; Pojani, 2025; Jupe & Bejko, 2020).

2.3. Përgjegjësia sociale e sipërmarrjeve: kuptimi, definicionet dhe dimensionet

Përgjegjësia sociale e sipërmarrjeve përfaqëson një kornizë përmes së cilës sipërmarrjet integrojnë shqetësimet sociale, mjedisore dhe etike në strategjitë dhe operacionet e tyre, duke shkuar përtej përmbushjes formale të detyrimeve ligjore (Porter & Kramer, 2006; Sachs, 2015). Ajo përfshin menaxhimin e marrëdhënieve me palët e interesuara si punonjës, klientë, komunitete lokale, institucione publike dhe angazhimin proaktiv ndaj sfidave mjedisore (Carroll, 1991; Matten & Moon, 2008; Jupe & Bejko, 2020).

Në praktikë, performanca e përgjegjësisë sociale të sipërmarrjeve matet gjithnjë e më shpesh përmes kornizës së tre faktorëve apo indikatorëve jo financiarë “Mjedis, Shoqëri dhe Qeverisje”: (i) Dimensioni mjedisor, i cili përfshin ndikimin e veprimtarisë së sipërmarrjeve në përdorimin e burimeve natyrore, menaxhimin e mbetjeve dhe emetimet e karbonit; (ii) Dimensioni social, i cili trajton marrëdhëniet me punonjësit, diversitetin, gjithëpërfshirjen dhe ndikimin në komunitetet lokale; (iii) Dimensioni ekonomik që lidhet me qëndrueshmërinë financiare, efikasitetin e investimeve dhe kthimin e vlerës së tyre

(Kocmanová & Dočekalová, 2011; Hristov & Chirico, 2019). Këta faktorë lehtësojnë vendimmarrjen strategjike dhe raportimin transparent, duke treguar përkushtimin e sipërmarrjeve ndaj qëndrueshmërisë dhe përgjegjësisë sociale (Diez-Cañamero et al., 2020).

Gjithashtu, studimi i Hristov dhe Chirico (2019) dëshmon se në dinamikën gjithnjë në zhvillim të qëndrueshmërisë së sipërmarrjeve, navigimi në një numër të madh faktorësh/indikatorësh mjedisor, social dhe ekonomik bëhet parësor për sipërmarrjet që kërkojnë të kenë ndikim pozitiv duke siguruar performancë dhe sukses afatgjatë. Në planin mjedisor ato mund të përdorin metrika të tilla si: (i) shkalla e emetimeve të gazrave serë; (ii) përdorimi i energjisë së rinovueshme; (iii) menaxhimi i mbetjeve dhe ruajtja e burimeve natyrore. Përsa i përket aspekteve sociale, sipërmarrjet analizojnë faktorë si: (i) trajtimi i punonjësve; (ii) diversiteti; (iii) gjithëpërfshirja në vendin e punës; (iv) ndikimi në komunitetet lokale. Në aspektin ekonomik, ato shqyrtojnë të dhëna lidhur me: (i) rritjen e të ardhurave; (ii) sigurimin e vendeve të punës; (iii) qëndrueshmërinë financiare. Këto të dhëna shpesh grumbullohen dhe raportohen në dokumente të tilla si raportet e qëndrueshmërisë, të cilat ndihmojnë në transparencën e veprimtarive dhe rezultateve të sipërmarrjeve ndaj aksionarëve dhe publikut. Shqyrtimi i këtyre indikatorëve në mënyrë kolektive mundëson që palët e interesuara të fitojnë një kuptim gjithëpërfshirës të angazhimit të një sipërmarrje ndaj praktikave të qëndrueshme dhe kontributit të saj në qëllimet më të gjera shoqërore dhe mjedisore.

Duke i shqyrtuar këta indikatorë në mënyrë të integruar, palët e interesuara fitojnë një kuptim gjithëpërfshirës të nivelit të angazhimit të sipërmarrjeve ndaj praktikave të qëndrueshme dhe kontributit të saj në qëllimet më të gjera shoqërore dhe mjedisore. Indikatorët shërbejnë, gjithashtu, si mjete kyçe për vendimmarrjen strategjike, planifikimin afatgjatë dhe shpërndarjen e burimeve. Siç evidentohet edhe nga punimi i Diez-Cañamero et al. (2020), monitorimi dhe vlerësimi sistematik i indikatorëve kryesorë, i mundëson sipërmarrjeve të identifikojnë fushat për përmirësim, të vendosin objektiva të matshëm dhe të ndjekin progresin drejt qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm, duke lehtësuar njëkohësisht komunikimin transparent me palët e interesuara.

Integrimi i këtyre dimensioneve në strategjinë e sipërmarrjeve kontribuon në përmirësimin e reputacionit, rritjen e transparencës dhe forcimin e qëndrueshmërisë ekonomike dhe shoqërore, duke e bërë përgjegjësinë sociale një element thelbësor të qeverisjes së sipërmarrjeve (Kocmanová & Dočekalová, 2011).

Si rezultat, analiza e mëtejshme fokusohet në evolucionin e përgjegjësisë sociale të sipërmarrjeve, me qëllim evidentimin e dinamikës historike dhe teorike që ka institucionalizuar përgjegjësinë sociale në praktikën bashkëkohore të qeverisjes së sipërmarrjeve.

2.4. Evolucionin e përgjegjësisë sociale të sipërmarrjeve

Iniciativat ndërkombëtare për reduktimin e emetimeve të karbonit tregojnë një angazhim të palëkundur për të përmirësuar bashkëpunimin midis shteteve dhe për të

intensifikuar përpjekjet për të reduktuar ndjeshëm emetimet e karbonit në sektorë të ndryshëm. Dialogu dhe veprimet bashkëpunuese, të iniciuara përmes këtyre marrëveshjeve, janë dëshmi e njohjes nga ana e komunitetit ndërkombëtar se ndryshimet klimatike përbëjnë një kërcënim të gjithanshëm, që kërkon përpjekje urgjente, të koordinuara dhe të qëndrueshme në një shkallë globale.

Ky zhvillim ndërkombëtar përkon me ndërgjegjësimin e sipërmarrjeve për ndikimin e tyre mjedisor, duke nxitur kalimin nga përpunimi reaktiv me ligjet drejt strategjive proaktive për reduktimin e emetimeve të karbonit dhe menaxhimin e burimeve natyrore. Me rritjen e ndërgjegjësit global mbi pasojat e ndryshimeve klimatike ka një thirrje urgjente për të gjithë sektorët, veçanërisht për sipërmarrjet, që të marrin përgjegjësitë e tyre ndaj mjedisit.

Këto iniciativa reflektojnë një fokus strategjik në forcimin e bashkëpunimit shumëpalësh midis qeverive, organizatave dhe bizneseve për të adresuar këto çështje mjedisore urgjente. Shtetet duhet të punojnë së bashku për të harmonizuar politikat e tyre, për të bashkëndarë praktikën më të mira dhe për të koordinuar veprimet që synojnë reduktimin e emetimeve të karbonit. Duke qenë se sipërmarrjet e mëdha janë kontribues të rëndësishëm në ngrohjen globale për shkak të konsumit të madh të energjisë, proceseve industriale dhe aktiviteteve të zinxhirit të furnizimit - palët e interesit si qeveritë, organizatat jo fitimprurëse dhe publiku - kërkojnë gjithnjë e më shumë që këto sipërmarrje të bëhen përgjegjëse për ndikimin e tyre mjedisor. Si rezultat, pritet që sipërmarrjet jo vetëm të respektojnë rregulloret ekzistuese, por të ndjekin me përkushtim praktika inovative që kontribuojnë në objektivat globale për reduktimin e karbonit.

Studimet më të fundit (Wright & Nybery, 2024) mbështesin idenë se sipërmarrjet mund të jenë një katalizator në promovimin e ndryshimeve mjedisore. Duke adoptuar praktika të qëndrueshme, investuar në teknologji të gjelbërta dhe duke zbatuar sisteme rigorozë të menaxhimit mjedisor, sipërmarrjet mund të reduktojnë ndjeshëm gjurmët e tyre të karbonit. Theksi në angazhimin proaktiv tregon kalimin nga përpunimi reaktiv në strategji përparimtare që mbështesin objektiva më të gjera mjedisore, duke zgjeruar rolet e sipërmarrjeve për të përfshirë menaxhimin e burimeve natyrore. Ky kontekst kërkon një përgjegjësi kolektive midis aktorëve të ndryshëm: qeverive, bizneseve dhe shoqërisë civile për të adresuar sfidat mjedisore përmes bashkëpunimit, angazhimit dhe veprimeve me ndikim.

Në këtë mënyrë, qëllimet për zhvillim të qëndrueshëm mbrojnë tezën se ulja e varfërisë dhe mungesave të tjera duhet të shoqërohet me strategji për të përmirësuar shëndetin dhe arsimimin, reduktuar paparazitë dhe nxitjen e rritjes ekonomike, duke u dhënë një vëmendje të veçantë ndryshimeve klimatike dhe mbrojtjes së ekosistemit natyror (Kombet e Bashkuara/ UN, 2018).

Në këtë kuadër, përgjegjësia për realizimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm nuk i takon vetëm institucioneve publike, por kërkon një rol aktiv dhe strategjik të sipërmarrjeve, të cilat, përmes politikave dhe praktikave të tyre, ndikojnë drejtpërdrejt në trajektoren e zhvillimit të qëndrueshëm.

2.5. Sipërmarrjet si aktorë kyç në zhvillimin e qëndrueshëm

Roli i sipërmarrjeve si aktorë kyç në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror lidhet ngushtë me kapacitetin e tyre për të mobilizuar burime financiare, teknologjike dhe njerëzore në një shkallë të gjerë (Sachs, 2015; WEF, 2020; Jupe & Bejko, 2020). Përmes investimeve, inovacionit, krijimit të vendeve të punës dhe ndikimit në zinxhirët globalë të furnizimit, sipërmarrjet kanë potencialin të kontribuojnë ndjeshëm në arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.

Ky rol është bërë veçanërisht i dukshëm në kontekstin e sfidave globale si ndryshimet klimatike. Marrëveshjet ndërkombëtare, nga Konventa e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimin Klimatik¹² (Bodansky, 1993), Protokoli i Kiotos¹³ (Protocol, 1997), Marrëveshja e Parisit¹⁴ (Bodansky et al., 2021), Konferenca e Glasgos¹⁵ (Cohen et al., 2022), si dhe Deklarata Kinë-SHBA mbi Rritjen e Veprimit për Klimën¹⁶ (Cohen et al., 2022), kanë nxitur një ndërgjegjësim të shtuar të sipërmarrjeve për ndikimin e tyre mjedisor dhe përgjegjësitë përkatëse.

Në këtë konteskt, disa sipërmarrje kanë filluar të zbatojnë praktika inovative që integrojnë përgjegjësinë sociale dhe mjedisore në projektet e tyre. Një shembull i qartë janë qytetet inteligjente, të cilat balancojnë zhvillimin ekonomik, social dhe mjedisor, duke përdorur teknologjitë e informacionit për të përmirësuar përfshirjen qytetare, efikasitetin e qeverisjes dhe zhvillimin urban (Yeh, 2017; Buuse & Kolk, 2019). Kompanitë që kontribuojnë në transformimin e këtyre qyteteve përdorin teknologji të reja dhe krijojnë mundësi për inovacion, duke integruar kështu në strategjitë e tyre përgjegjësinë sociale të sipërmarrjeve dhe duke gjeneruar të dhëna që mbështesin vendimarrjen dhe objektivat e qëndrueshmërisë (Paroutis et al., 2014; Sharma & Chrisman, 1999; Hoskinsson et al., 2011).

¹² Konventa e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimin Klimatik, e cila hyri në fuqi në mars të vitit 1994, është një traktat i rëndësishëm, pasi kishte për qëllim angazhimin e vendeve dhe bashkëpunimin mes tyre ndaj një objekti të përbashkët: parandalimin e ndërhijrjeve të dëmshme të njerëzve në sistemin klimatik, duke shënuar një qasje globale për të adresuar urgjentisht problemin e ndryshimeve klimatike. Për më shumë: <https://unfccc.int/process-and-meetings/united-nations-framework-convention-on-climate-change>

¹³ Protokoli i Kiotos, i cili hyri në fuqi në dhjetor të vitit 1997, vendosi detyrime ligjore për vendet e zhvilluara për të reduktuar emetimet e gazrave serë. Për më shumë: <https://eur-lex.europa.eu/IT/legal-content/summary/kyoto-protocol-on-climate-change.html>

¹⁴ Marrëveshja e Parisit, e cila hyri në fuqi në dhjetor të vitit 2015, mundësoi angazhimin e 200 shteteve për të kufizuar rritjen globale të temperaturave nën 2 gradë Celsius, me synimin për ta mbajtur atë deri në 1.5 gradë Celsius mbi nivelet para-industriale. Për më shumë: <https://unfccc.int/process-and-meetings/the-paris-agreement#:~:text=The%20Paris%20Agreement%20is%20a,Parties%20to%20the%20Paris%20Agreement>

¹⁵ Konferenca e Kombeve të Bashkuara për ndryshimin klimatik e mbajtur në Glasgo në nëntor të vitit 2021 shërbeu si një platformë e rëndësishme për forcimin e angazhimeve globale për klimën. Për më shumë: <https://unfccc.int/conference/glasgow-climate-change-conference-october-november-2021>

¹⁶ Deklarata Kinë-SHBA për ndryshimin klimatik simbolizon një përpjekje të rëndësishme bashkëpunimi midis dy ekonomive më të mëdha në botë, duke theksuar angazhimin e tyre për të forcuar bashkëpunimin bilateral në fushën e parandalimit të ndryshimeve klimatike. Për më shumë: <https://www.ispionline.it/it/pubblicazione/usa-cina-intesa-sul-clima-32319>

Studiuesit (Senatore, 2020; Dameri, R.P. & Bruzzone, M., 2023) theksojnë se qytetet inteligjente mund të realizojnë njëherazi shumë nga Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Një qytet konsiderohet inteligjent nëse balancohen zhvillimin ekonomik, social dhe mjedisor dhe ndërvepron me procese demokratike përmes një qeverisjeje pjesëmarrëse. Këto qytete menaxhohen nga ekspertë, konsulentë, sipërmarrje dhe funksionarë të qytetit të cilët përcaktojnë mënyrën se si qyteti konceptualizohet, planifikohet dhe zhvillohet (Yeh, 2017). Shembuj të qyteteve inteligjente janë Busan (Koreja e Jugut), Londra (Mbretëria e Bashkuar) dhe Santander (Spanjë).

Parashikohet që zhvillimi i qyteteve inteligjente të arrijë një shpenzim financiar prej 115.33 miliardë dollarë amerikanë deri në vitin 2029 (Statista, 2025). Ky kontekst krijon mundësi për sipërmarrje shumëkombëshe për të sjellë risitë teknologjike dhe zhvilluar strategji të qëndrueshme (Buuse & Kolk, 2019). Literatura kryesore tregon se shumica e teknologjive të nevojshme për transformimin e qyteteve inteligjente është zhvilluar dhe promovuar nga kompanitë teknologjike si pjesë e strategjisë së tyre për të integruar përgjegjësinë sociale të sipërmarrjeve dhe për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm (Buuse & Kolk, 2019; Paroutis et al., 2014).

Si rezultat, roli i sipërmarrjeve shtrihet përtej filantropisë tradicionale, pasi ai përfshin angazhimin proaktiv në inovacion, menaxhimin e burimeve natyrore dhe bashkëpunimin me aktorë të ndryshëm për të adresuar sfidat mjedisore dhe sociale, duke kontribuar drejtpërdrejt në Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Kjo qasje kërkon operacionalizimin e konceptit përmes një sistemi indikatorësh, të cilët sigurojnë një kornizë të strukturuar për vlerësimin e angazhimit të sipërmarrjeve ndaj përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

3. Indikatorët për Vlerësimin e Angazhimit të Sipërmarrjeve ndaj Përgjegjësisë Sociale dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm

Në mjedisin dinamik dhe vazhdimisht në transformim të biznesit bashkëkohor, angazhimi i sipërmarrjeve ndaj përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm është shndërruar në një fokus qendror të kërkimit shkencor. Analiza e ndërlidhjes midis këtyre dy qasjeve është thelbësore për suksesin e sipërmarrjeve dhe për krijimin e kushteve për një të ardhme më të qëndrueshme dhe më të përgjegjshme.

Ky seksion fokusohet në indikatorët që mund të përdoren për të vlerësuar angazhimin e sipërmarrjeve ndaj përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Theksi vihet në një analizë të përpiktë të një grupi indikatorësh të përzgjedhur me kujdes nga literatura shkencore, të cilët shërbejnë si sistem referimi për vlerësimet sasiore dhe cilësore të ndikimit të iniciativave të sipërmarrjeve lidhur me përgjegjësinë sociale dhe qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm. Këta indikatorë funksionojnë si instrumenta thelbësorë për të vlerësuar efektivitetin e strategjive të sipërmarrjeve në arritjen e ndryshimeve pozitive gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.

Gjithashtu, ky seksion shqyrton marrëdhëniet e ndërlikuara midis faktorëve ekonomikë, socialë dhe mjedisorë, duke theksuar nevojën që korporatat të integrojnë praktikën e përgjegjshme në modelet e tyre të biznesit. Analiza e rasteve kur sipërmarrjet kanë harmonizuar me sukses iniciativat e përgjegjësisë sociale me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm ndihmon për të kapërcyer boshllëkun midis teorisë dhe praktikës, duke ofruar udhëzime të vlefshme për menaxhimin efektiv të përgjegjësisë sociale të sipërmarrjeve dhe strategjive të qëndrueshmërisë.

3.1. Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm si kornizë indikatorësh për vlerësimin e angazhimit të sipërmarrjeve

Një nga debatet qendrore në literaturën bashkëkohore mbi përgjegjësinë sociale të sipërmarrjeve dhe zhvillimin e qëndrueshëm lidhet me raportin kompleks midis objektivave tradicionale të maksimizimit të fitimit dhe kërkesave në rritje për përgjegjësi sociale dhe mjedisore. Këto dy dimensionë shpesh perceptohen si të vështira për tu harmonizuar, pasi orientimi eskuziv drejt uljes së kostove dhe rritjes së fitimit, në disa raste, mund të shoqërohet me praktika që çenojnë mjedisin, shëndetin e punonjësve apo mirëqënien sociale.

Ky realitet përbën një nga arsyt kryesore pse disa sipërmarrje shfaqin rezerva ndaj integritetit të plotë të indikatorëve “Mjedis, Shoqëri dhe Qeverisje”, veçanërisht, në raport me përputhshmërinë e veprimtarisë së tyre me praktikën e qëndrueshme dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (Fallah Shayan et al., 2022). Për këtë arsye është e rëndësishme të theksohet se rezistenca ndaj indikatorëve “Mjedis, Shoqëri dhe Qeverisje” shpesh buron nga sfida për harmonizimin e objektivave të fitimit me kërkesat e qëndrueshmërisë dhe përgjegjësisë sociale.

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara ofrojnë një kornizë të qartë për sipërmarrjet, duke i ndihmuar të integrojnë konsiderata etike, sociale dhe mjedisore në operacionet e tyre. Këto synime shërbejnë si një busull udhëzimi, duke treguar fushat ku sipërmarrjet mund të japin kontribute domethënëse, nga ulja e varfërisë dhe promovimi i barazisë gjinore deri te siguri e qëndrueshmërisë mjedisore. Iniciativat strategjike dhe partneritetet publike-private, përfshirë ndarjen e burimeve dhe zhvillimin e projekteve të përbashkëta, si dhe promovimin e praktikave inovative, mundësojnë krijimin e ekosistemeve të qëndrueshme, ku sipërmarrjet kontribuojnë me ekspertizën e tyre, ndërsa qeveritë dhe organizatat jo fitimprurëse sigurojnë kornizat rregullatore dhe mbështetjen komunitare (Leena et al., 2013).

Sipërmarrjet luajnë rol kyç në rritjen e ndërgjegjësimin për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, përmes trajnimeve për punonjësit, fushatave informative, seminareve dhe ndarjes së praktikave të sukseshme. Partneritetet me organizatat jo fitimprurëse dhe institucionet akademike promovojnë projekte të qëndrueshmërisë dhe angazhimin e komunitetit, ndërsa mediat sociale mundësojnë rritjen e ndikimit dhe frymëzimin e të tjerëve (Montiel et al., 2021). Një kategorizim i 17 Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në gjashtë grupe sipas potencialit për të krijuar eksternalitete pozitive si

përmirësimi i njohurive dhe promovimi i shëndetit dhe për të parandaluar eksternalitete negative si përdorimi i tepruar i burimeve natyrore dhe dëmtimi i kohezionit social, ndihmon sipërmarrjet të integrojnë këto objektiva në mënyrë strategjike dhe të japin një kontribut të strukturuar dhe me ndikim.

Përveç këtyre iniciativave, sipërmarrjet mund të krijojnë projekte që lidhen njëkohësisht me përfitime globale dhe lokale duke ndërtuar lidhje të qëndrueshme midis nivelit global dhe komunitetit lokal (Vargas & Cooper, 2024). Strategjitë gjithëpërfshirëse për barazinë gjinore kërkojnë bashkëpunim midis shumë palëve të interesit, duke integruar perspektiva të dobishmërisë dhe të drejtësisë sociale. Politikat që promovojnë avancimin e grave në pozita udhëheqëse, trajnime për ndryshimin e stereotipeve dhe përmirësimin e kushteve të punës kontribuojnë në krijimin e një ambjenti pune më të barabartë dhe produktiv duke përmirësuar edhe imazhin e sipërmarrjes (Gartzia, 2021; Velasco-Balmaseda et al., 2024).

Sipërmarrjet përdorin gjithashtu auditime të jashtme, sisteme vlerësimi dhe teknologji inovative për të monitoruar ndikimet dhe për të siguruar transparencë, llogaridhënie dhe reputacion (Brunila et al., 2023). Procesi i vlerësimit të përputhshmërisë së veprimeve me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm është i shumëanshëm, duke analizuar ndikimin real të iniciativave dhe duke identifikuar kontributet ose pengesat e mundshme në arritjen e objektivave globale. Në këtë mënyrë, pranimi dhe përballimi i sfidave i pozicionon sipërmarrjet si subjekte globale të përgjegjshme dhe mundëson krijimin e vlerave afatgjata përmes integritit të praktikave të qëndrueshme në strategjitë dhe operacionet e tyre.

Mbi këtë bazë evidencat tregojnë se, sipërmarrjet që angazhohen në zhvillimin social, mjedisor dhe ekonomik shpesh vendosin prioritetet të qarta për ndikim pozitiv në shoqëri dhe mjedis (Blackburn, 2012). Në aspektin social, ato mbështesin programe arsimore, shëndetësore dhe zhvillimin e kapaciteteve. Në aspektin mjedisor, ato reduktojnë gjurmën karbonike dhe mbrojnë burimet natyrore. Ndërsa, në aspektin ekonomik, ato krijojnë vende pune dhe mbështesin bizneset lokale. Kjo qasje integron filozofinë e zhvillimit të qëndrueshëm dhe përgjegjësisë sociale në strategjitë dhe operacionet e përditshme të sipërmarrjeve, duke forcuar ndikimin e tyre afatgjatë dhe qëndrueshmërinë e biznesit (Le et al., 2024).

Angazhimi ndaj barazisë gjinore dhe partneritetet strategjike mbeten elementë kyç për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Trajnime për punonjësit, fushata informative, seminare dhe bashkëpunime me organizatat jo fitimprurëse dhe institucionet akademike kontribuojnë në ndërgjegjësimin për qëndrueshmërinë dhe angazhimin e komunitetit (Montiel et al., 2021). Integrimi i prioritetit global “reduktimi i emetimeve dhe biodiversiteti” dhe iniciativave lokale “varfëria dhe edukimi” siguron ndikim pozitiv në të dy nivelet (Vargas & Cooper, 2024).

3.1.1. Indikatori i praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe roli i tij në zhvillimin e sipërmarrjeve

Zbatimi i praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm përbën një indikator thelbësor për vlerësimin e angazhimit të sipërmarrjeve në harmonizimin e objektivave ekonomike me përgjegjësinë sociale dhe qëndrueshmërinë mjedisore. Ky indikator shkon përtej matjeve tradicionale financiare duke synuar të vlerësojë mënyrën se si praktikatat e sipërmarrjeve kontribuojnë në arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe në krijimin e qëndrueshmërisë ekonomike afatgjatë (Alshehhi et al., 2018).

Megjithatë, literatura empirike vë në dukje se marrëdhënia midis praktikave ekonomike të zhvillimit të qëndrueshëm dhe performancës financiare mbetet e paqëndrueshme dhe shpesh e paqartë. Kjo paqartësi lidhet kryesisht me ndryshimet metodologjike, me fokusin selektiv në dimensione të caktuara të qëndrueshmërisë dhe me mënyrën e matjes së variablave ekonomike, sociale dhe mjedisore¹⁷. Si pasojë, është rritur nevoja për instrumente vlerësuese më gjithëpërfshirëse dhe më të strukturuar të afta për të identifikuar kompleksitetin e ndërveprimit midis këtyre dimensioneve.

Në këtë kuptim, indikatori i praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm i zhvilluar në këtë studim synon të masë nivelin e integritetit të strategjive ekonomike, sociale dhe mjedisore në veprimtarinë e sipërmarrjeve, si dhe ndikimin e tyre të kombinuar në suksesin financiar dhe në përfitimet për shoqërinë dhe mjedisin. Ky indikator mbështetet në qasje teorike që synojnë të kapërcejnë ndarjen tradicionale midis performancës ekonomike dhe përgjegjësisë sociale.

Një nga këto qasje është koncepti i “Rezultatit të Trefishtë”, i njohur si “*Triple Bottom Line*” (Elkington, 1997), i cili artikulon ndërthurjen e tre dimensioneve të performancës së sipërmarrjeve: ekonomike, sociale dhe mjedisore. Ky koncept ka shërbyer si pikënisje për zhvillimin e modeleve më gjithëpërfshirëse të vlerësimit të qëndrueshmërisë, duke theksuar se suksesi afatgjatë i sipërmarrjeve nuk mund të vlerësohet vetëm përmes treguesve financiarë. Megjithatë, operacionalizimi i “*Triple Bottom Line*” në instrumente konkrete matëse ka rezultuar kompleks çka ka nxitur një interes në rritje për krijimin dhe përmirësimin e sistemeve të matjes së performancës së qëndrueshmërisë së sipërmarrjeve.

Mbështetja empirike për këtë qasje është reflektuar në studime që analizojnë ndikimin konkret të iniciativave mjedisore dhe sociale në performancën e sipërmarrjeve. Sipërmarrjet që kanë zbatuar programe mjedisore si dizajni për riciklim, analiza e ciklit të jetës apo çertifikimi mjedisor, si dhe praktika sociale të orientuara drejt përmirësimit të kushteve të punës dhe mbështetjes së komunitetit, përfaqësojnë raste tipike të zbatimit të “*Triple Bottom Line*”.

¹⁷ Analiza e studimit të Alshehhi et al. (2018), që i referohet më shumë se 132 dokumentave nga revista të nivelit të lartë, tregon se 78% e botimeve raportojnë një marrëdhënie pozitive midis zhvillimit të qëndrueshëm të sipërmarrjeve dhe performancës financiare, edhe pse variacionet metodologjike ndikojnë në interpretimin e rezultateve. Gjithashtu, literatura po e zëvendëson gradualisht zhvillimin e qëndrueshëm me përgjegjësinë sociale të sipërmarrjeve, duke i përfshirë pak dimensionet mjedisore dhe ekonomike; ndërkohë, studimet nga vendet në zhvillim mbeten të pakta, duke evidentuar nevojën për hulumtime të mëtejshme.

Në këtë drejtim, studimi i Gimenez et al. (2012) ofron evidencë të rëndësishme empirike duke treguar se programet mjedisore të brendshme kontribuojnë pozitivisht në të tre komponentët e qasjes “*Triple Bottom Linne*” (ekonomik, social dhe mjedisor); ndërsa, iniciativat sociale të brendshme ndikojnë kryesisht në dimensionin social dhe atë mjedisor, çka sugjeron se përfitimet financiare nga këto programe mbeten më të vështira për t’u realizuar në një afat të shkurtër. Po ashtu, gjetjet sugjerojnë se bashkëpunimi brenda zinxhirit të furnizimit luan një rol më të rëndësishëm sesa vlerësimi formal i tij, duke përforcuar nevojën për qasje bashkëpunuese në realizimin e qëndrueshmërisë.

Në vijim të kësaj analize, dimensionin ekonomik i praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm nuk kufizohet vetëm në qëndrueshmërinë financiare të sipërmarrjes, por shtrihet edhe në nxitjen e rritjes ekonomike gjithëpërfshirëse. Në këtë kuptim, indikatorin e praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm eksploron mënyrën se si aktivitetet ekonomike të sipërmarrjeve kontribuojnë në krijimin e mundësive dhe në reduktimin e pabarazive brenda komuniteteve ku ato operojnë. Ai vlerëson iniciativat të tilla si krijimi i vendeve të punës, mbështetja e bizneseve lokale, investimet në arsim dhe zhvillimin e aftësive, duke analizuar nëse suksesi ekonomik i sipërmarrjes shndërrohet në përfitime të prekshme për një grup të gjerë palësh të interesuara.

Kjo qasje merr rëndësi të veçantë në kushtet kur rritja e pabarazisë sociale dhe ekonomike paraqitet si një nga sfidat më të mëdha bashkëkohore, jo vetëm për shoqërinë, por edhe për vetë bizneset. Pabarazia krijon rreziqe materiale për performancën e sipërmarrjeve, duke përfshirë prodhimin jo të efektshëm, reduktimin e inovacionit, tkurrjen e kapitalit njerëzor, ngushtimin e tregjeve dhe rritjen e paqëndrueshmërisë financiare. Në këtë kuptim, rritja e pabarazisë rrezikon të bëjë të pamjaftueshme strategjitë ekzistuese të zhvillimit të qëndrueshëm dhe të përgjegjësisë sociale të sipërmarrjeve.

Sikurse evidentohet nga studimi i Cort et al. (2025), infrastruktura aktuale e transparencës së sipërmarrjeve rezulton e pamjaftueshme për të ofruar të dhëna të besueshme mbi rreziqet e biznesit që burojnë nga pabarazia dhe ndikimi real i sjelljes së sipërmarrjeve në adresimin e saj. Duke u mbështetur në analogjinë me zhvillimet e fundit në raportimin mbi rreziqet klimatike, autorët sugjerojnë nevojën për qasje më të avancuara raportimi dhe vlerësimi, të cilat do t’u mundësonin kompanive, investitorëve dhe palëve të tjera të interesuara të kuptojnë më mirë lidhjen midis pabarazisë sociale dhe ekonomike si dhe performancës afatgjatë të biznesit.

Si pasojë, literatura bashkëkohore ka theksuar se, pavarësisht progresit të bërë në integrimin e qëndrueshmërisë në strategjitë e sipërmarrjeve, mbeten ende sfida të rëndësishme që lidhen me dizajnin, zbatimin, përdorimin dhe evolucionin e këtyre sistemeve matëse. Rishikimi i literaturës kryer nga Searcy (2012), i fokusuar në punimet e publikuara ndërmjet viteve 2000–2010, përfaqëson një kontribut të rëndësishëm analitik në këtë drejtim, duke identifikuar boshllëqet ekzistuese dhe duke strukturuar një set prej 65 pyetjesh kyçe kërkimore për të udhëhequr zhvillimet e mëtejshme në matjen e performancës së qëndrueshmërisë së sipërmarrjeve. Këto reflektime theksojnë nevojën

për sisteme vlerësimi që të jenë njëkohësisht teorikisht të qëndrueshme dhe praktikisht të zbatueshme.

3.1.1.1. Efikasiteti i burimeve dhe ekonomia qarkulluese: nën-indikatorë të indikatorit të praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm

Efikasiteti i burimeve dhe ekonomia qarkulluese, nën-indikatorë të indikatorit të praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm, shqyrtojnë mënyrën se si sipërmarrjet optimizojnë përdorimin e burimeve dhe adoptojnë parimet e ekonomisë qarkulluese, duke kontribuar në një ekonomi më elastike dhe të qëndrueshme në kuadër të qasjes “*Triple Bottom Line*” (Sanches et al., 2022). Praktikrat përfshijnë dizajne produktesh për qëndrueshmëri dhe riciklim, reduktimin e mbetjeve dhe përfshirjen e materialeve të ricikluara në proceset e prodhimit.

Për ta përmbledhur në mënyrë të qartë, më poshtë, paraqitet Tabela I “Elementë Matës të Nën-Indikatorit ‘Efikasiteti i Burimeve dhe Ekonomia Qarkulluese’”, e cila ilustron se si efikasiteti i burimeve dhe ekonomia qarkulluese ndikon në performancën ekonomike, sociale dhe mjedisore të sipërmarrjeve. Tabela evidenton gjithashtu elementët matës të këtyre nën-indikatorëve, si dhe mënyrën se si secili prej tyre kontribuon në arritjen e Objektive të Zhvillimit të Qëndrueshëm, duke krijuar një lidhje të drejtëpërdrejtë midis analizës teorike dhe pjesës zbatuese të studimit.

Tabela I: Elementët Matës të Nën-Indikatorëve “Efikasiteti i Burimeve dhe Ekonomia Qarkulluese”

Komponenti Matës	Përshkrimi	Lidhja me Objektivat e Qëndrueshmërisë
Menaxhimi i burimeve	Reduktimi i konsumit të energjisë dhe materialeve në proceset prodhuese dhe operative	Minimizon ndikimin mjedisor dhe përmirëson efikasitetin ekonomik
Reduktimi i mbetjeve	Zvogëlimi i mbetjeve të gjeneruara nga proceset prodhuese	Redukton kostot operative dhe ndikon pozitivisht në mjedis
Dizajni për riciklim dhe qëndrueshmëri	Përdorimi i materialeve të riciklueshme dhe projektimi i produkteve që mund të ripërdoren ose riciklohen	Siguron integrimin e parimeve të ekonomisë qarkulluese dhe përfitime mjedisore e sociale
Strategjitë e përfshirjes së materialeve të ricikluara	Përdorimi i mbetjeve industriale dhe materialeve të rikthyera në ciklin e prodhimit	Promovon qarkullimin e burimeve dhe zvogëlon ndikimin negativ në mjedis

3.1.1.2. Investimet me ndikim social si nën-indikator i praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm

Një komponent thelbësor i praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm janë edhe investimet me ndikim social, të cilat ndikojnë në gjenerimin e rezultateve pozitive shoqërore paralelisht me krijimin e kthimeve financiare. Në këtë kuadër, nën-indikator i

investimeve me ndikim social vlerëson mënyrën se si sipërmarrjet përdorin kapitalin e tyre për të kontribuar në zhvillimin e komuniteteve dhe në adresimin e nevojave sociale, duke shkuar përtej logjikës tradicionale të maksimizimit të fitimit.

Ky nën-indikator përfshin iniciativa të tilla si projektet e zhvillimit komunitar, mbështetjen e sipërmarrjes sociale, investimet në arsim, kujdes shëndetësor dhe zhvillimin e aftësive njerëzore. Në këtë mënyrë, ai mat angazhimin e sipërmarrjeve për të shndërruar performancën ekonomike në përfitime të prekshme sociale, duke kontribuar drejtëpërdrejt në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Megjithatë, literatura empirike tregon se efektet e investimeve me ndikim social varen ndjeshëm nga struktura e tregut, stimujt institucionalë dhe kornizat rregullatore. Në këtë drejtim, studimi i Arias Fogliano de Souza Cunha dhe Samanez (2013), i fokusuar në Indeksin e Qëndrueshmërisë së Korporatave (ISE) të Bursës së Brazilit (BM&FBOVESPA), ofron evidencë të rëndësishme mbi performancën e investimeve të qëndrueshme në tregun brazilian të aksioneve përgjatë periudhës kohore dhjetor 2005 – dhjetor 2010. Duke krahasuar portofolin e Indeksit të Qëndrueshmërisë së Korporatave (ISE) me portofolin e tregut (IBOVESPA) dhe indekse të tjerë sektorialë, si dhe duke përdorur indikatorët e likuiditetit, kthimit dhe rrezikut, autorët konstatojnë se: megjithëse investimet e qëndrueshme shfaqin karakteristika pozitive si likuiditet më të lartë dhe nivel më të ulët rreziku, ato nuk arrijnë performancë financiare të kënaqshme përgjatë periudhës së analizuar. Kjo sugjeron se kufizimet e imponuara nga ky lloj investimi në ndarjen e kapitalit në Brazil mund të ndikojnë negativisht në atraktivitetin e tyre në raportin risk-kthim.

Për ta përmbledhur në mënyrë të strukturuar, Tabela II “Elementët Matës të Nën-Indikatorit ‘Investimet me Ndikim Social’” paraqet nën-indikatorin e investimeve me ndikim social, duke evidentuar komponentët kryesorë matës, dimensionet e qëndrueshmërisë që preken dhe lidhjen e tyre me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Kjo qasje lejon operacionalizimin e konceptit dhe lidhjen e analizës teorike me pjesën empirike të studimit.

Tabela II: Elementët Matës të Nën-Indikatorit “Investimet me Ndikim Social”

Dimensioni i Qëndrueshmërisë	Komponentët Matës	Përshkrimi	Lidhja me Qëndrueshmërinë
Ekonomik	Kthimi financiar i investimeve me ndikim social	Vlerëson aftësinë e investimeve për të gjeneruar kthime financiare së bashku me ndikimin social	Siguron zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, duke kombinuar fitimin me përfitime sociale (lidhet me Objektivin e Zhvillimit të Qëndrueshëm 8: Punë dinjitoze dhe rritje gjithëpërfshirëse ¹⁸)
Ekonomik	Menaxhimi i riskut të investimeve të qëndrueshme	Analizon nivelin e rrezikut dhe stabilitetin financiar të investimeve me ndikim social	Forcon qëndrueshmërinë e kapitalit dhe ul mundësinë e humbjeve financiare, duke mbështetur rritjen ekonomike afatgjatë (lidhet me Objektivin e Zhvillimit të Qëndrueshëm 9: Ndërtim infrastrukturë të qëndrueshme, promovon industrializim të qëndrueshëm dhe nxit inovacionin ¹⁹)
Social	Investime në zhvillimin e komunitetit	Mbështetje për projekte që synojnë përmirësimin e kushteve sociale dhe ekonomike të komuniteteve lokale	Nxit zhvillimin social dhe përmirëson mirëqenien e komuniteteve, duke kontribuar në Objektivin e Zhvillimit të Qëndrueshëm 11: Qytete dhe komunitete të qëndrueshme ²⁰ dhe Objektivin e Zhvillimit të Qëndrueshëm 10: Reduktim i pabarazive ²¹
Social	Mbështetje e sipërmarrjeve sociale	Investime në sipërmarrje që kombinojnë misionin social me aktivitetin ekonomik	Promovon punësim dhe përfshirje sociale, duke lidhur zhvillimin ekonomik me përfitime sociale (lidhet me Objektivin e Zhvillimit të Qëndrueshëm 8 dhe Objektivin e Zhvillimit të Qëndrueshëm)
Social	Investime në arsim dhe shëndetësi	Kontribut në përmirësimin e aksesit dhe cilësisë së shërbimeve sociale bazë	Përmirëson kapitalin njerëzor dhe qasjen në shërbime jetësore, duke kontribuar në Objektivin e Zhvillimit të Qëndrueshëm 3: Shëndetësi e mirë ²² dhe Objektivin e Zhvillimit të Qëndrueshëm 4: Arsim cilësor ²³
Qeverisje	Strategji dhe politika për investime me ndikim social	Ekzistenca e politikave të formalizuara dhe transparencës në investime	Siguron qeverisje të qëndrueshme të sipërmarrjeve dhe përdorim transparent të kapitalit, duke mbështetur integritetin dhe qëndrueshmërinë e investimeve (lidhet me Objektivin e Zhvillimit të Qëndrueshëm 16: Paqe, drejtësi dhe institucione të forta ²⁴)

¹⁸ Për më shumë: <https://www.un.org/sustainabledevelopment/economic-growth/>

¹⁹ Për më shumë: <https://www.un.org/sustainabledevelopment/infrastructure-industrialization/>

²⁰ Për më shumë: <https://www.un.org/sustainabledevelopment/cities/>

²¹ Për më shumë: <https://www.un.org/sustainabledevelopment/inequality/>

²² Për më shumë: <https://www.un.org/sustainabledevelopment/health/>

²³ Për më shumë: <https://www.un.org/sustainabledevelopment/education/>

²⁴ Për më shumë: <https://www.un.org/sustainabledevelopment/peace-justice/>

3.1.1.3. Financat e gjelbra dhe përgjegjësia sociale si nën-indikatorë të indikatorit të praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm

Një aspekt kyç i praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm është krijimi i mekanizmave financiare që mbështesin investime të qëndrueshme dhe miratimi i parimeve të financave të gjelbra. Indikator i praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm shqyrton mënyrën se si një sipërmarrje integron kriteret mjedisore, sociale dhe të qeverisjes në vendimet financiare dhe investimet e saj. Ai vlerëson praktika të tilla si emetimi i bonove të gjelbra, shpërndarja e fondeve për projekte të qëndrueshme dhe orientimi i flukseve financiare drejt nismave që promovojnë ruajtjen e mjedisit, mirëqenien sociale dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Evidencat empirike tregojnë ndërveprimin pozitiv midis praktikave të përgjegjësisë sociale të sipërmarrjeve dhe financave të gjelbra, si dhe ndikimin e tyre të përbashkët në zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm në Bangladesh. Studimi i Rahman et al. (2024) bazohet në një metodë konceptuale dhe përdor të dhëna nga botime, artikuj hulumtues si dhe interneti. Industria e turizmit, e pasur me burime natyrore, kulturore dhe historike ka krijuar mundësi punësimi, ka lehtësuar varfërinë dhe ka kontribuar në rritjen ekonomike dhe arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Rezultatet tregojnë se bizneset që kombinojnë praktikën e përgjegjësisë sociale të sipërmarrjeve me financat e gjelbra mund të stimulojnë zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm. Për të rritur këtë ndikim, studimi sugjeron forcimin e bashkëpunimit me palët përkatëse, implementimin e programeve edukative dhe ndërgjegjësuere për bizneset, si dhe nxitjen e investimeve të gjelbra përmes lehtësirave fiskale dhe subvencioneve.

Për ta përmbledhur në mënyrë të strukturuar, Tabela III “Elementët Matës të Nën-Indikatorit ‘Financat e Gjelbra – Përgjegjësia Sociale’” evidenton komponentët kryesorë matës dhe lidhjen e tyre me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Tabela III: Elementët Matës të Nën-Indikatorit “Financat e Gjelbra - Përgjegjësia Sociale”

Dimensioni i Qëndrueshmërisë	Komponentët Matës	Përshkrimi	Lidhja me Qëndrueshmërinë
Ekonomik	Integrimi i kriterëve “Mjedis, Shoqëri dhe Qeverisje” në vendimet financiare	Vlerëson nëse investimet e sipërmarrjes përfshijnë kriteret mjedisore, sociale dhe të qeverisjes (Mjedis, Shoqëri dhe Qeverisje)	Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm 8: Punë të denjë dhe rritje ekonomike gjithëpërfshirëse; Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm 9: Infrastruktura e qëndrueshme dhe inovacion
Mjedisor	Emetimi i bonove të gjelbra dhe shpërndarja e fondeve për projekte të qëndrueshme	Analizon financimin e projekteve që promovojnë zhvillim të qëndrueshëm dhe ruajtje mjedisore	Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm 7: Energjia e pastër dhe e aksesueshme ²⁵ ; Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm 13: Veprime për klimën ²⁶)
Social	Investime me ndikim social	Analizon projektet që gjenerojnë përfitime sociale (arsim, shëndetësi, zhvillim komuniteti) duke bashkuar kthimet financiare me ndikim shoqëror	Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm 3: Shëndetësi e mirë; Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm 4: Arsimi cilësor; Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm 10: Reduktim i pabarazisë
Qeverisje	Politikat dhe transparenca për financa të gjelbra	Vlerëson ekzistencën e politikave formale dhe transparencës në investime të qëndrueshme	Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm 16: Qeverisje efektive, llogaridhënëse dhe transparente ²⁷

3.1.1.4. Qytetaria ekonomike globale si nën-indikator i praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm

Praktikat e qëndrueshme ekonomike nuk kufizohen vetëm në nivelin e komuniteteve lokale, por shtrihen në një dimension më të gjerë, duke përfshirë përgjegjësitë globale të sipërmarrjeve. me qëllim përfshirjen e përgjegjësisë globale. Në këtë kuptim, indikatori i praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm shqyrton mënyrën se si sipërmarrjet e pranojnë dhe e zbatojnë konceptin e qytetarisë ekonomike globale, duke marrë në konsideratë ndikimet e aktiviteteve të tyre ekonomike në nivel ndërkombëtar. Ky indikator adreson iniciativa konkrete si praktikat e tregtisë së ndershme, burimet e përgjegjshme të lëndëve të para dhe përpjekjet për t’iu përgjigjur sfidave globale, përfshirë ndryshimet klimatike dhe pabarazitë ekonomike. Në këtë mënyrë, vlerësohet angazhimi i korporatave për të

²⁵ Për më shumë: <https://www.un.org/sustainabledevelopment/energy/>

²⁶ Për më shumë: <https://www.un.org/sustainabledevelopment/climate-change/>

²⁷ Për më shumë: <https://www.un.org/sustainabledevelopment/peace-justice/>

vepruar si aktorë ekonomikë të përgjegjshëm në nivel global, në funksion të avancimit të qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm.

Në këtë këndvështrim, studimi i Fernando Ravit në vitin (2012) ofron një kuadër konceptual të rëndësishëm, duke identifikuar një sërë kushtesh paraprake dhe ndërhyrjesh përmes të cilave shtetet dhe bizneset mund të inkorporojnë qëndrueshmërinë në strategjinë e tyre kombëtare dhe të sipërmarrjeve. Këto kushte, të cilat përshpejtojnë “*motivin*” për orientimin drejt qëndrueshmërisë, si dhe sfera e ndikimit të liderëve shtetërorë dhe atyre të biznesit, përbëjnë elementë me vlerë analitike për modelin e studimit, pasi ndihmojnë në kuptimin e mekanizmave përmes të cilëve globalizimi i qëndrueshëm mund të ndikohet dhe drejtohet në praktikë. Gjithashtu, studimi thekson se sfida të tilla si varfëria dhe ndryshimi klimatik përfaqësojnë rreziqe strategjike reale, të cilat, nëse nuk adresohen, mund të kenë pasoja të dëmshme afatgjata për planetin, biznesin dhe politikat shtetërore. Analiza e zhvillimeve që nga miratimi i Axhendës 21 në vitin 1982, si dhe progresi relativisht i kufizuar i realizuar deri më sot forcojnë argumentin për nevojën e zbatimit të hapave më të vendosur në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme.

Në këtë kontekst, një element qendror për tu theksuar është inkorporimi i strategjisë së qëndrueshmërisë si strategji diferencuese e sipërmarrjeve. Qasja e qëndrueshmërisë strategjike e sipërmarrjeve, e konceptuar si një proces në dy hapa, kërkon fillimisht angazhimin e liderëve shtetërorë dhe atyre të sipërmarrjeve ndaj nevojës për qëndrueshmëri, dhe më pas integrimin e kësaj strategjie si një faktor dallues që pozicionon shtetet dhe bizneset ndryshe nga ata aktorë që nuk e kanë pranuar këtë paradigëm. Ky aspekt përbën një element analitik kyç për modelin e studimit, pasi lidh drejtëpërdrejt qytetarinë globale me strategjinë, konkurrueshmërinë dhe orientimin afatgjatë të aktorëve ekonomikë.

Shembujt e korporatave si General Electric dhe Unilever ilustrojnë mënyrën se si një mentalitet i orientuar drejt qëndrueshmërisë dhe qytetarisë globale mund të reflektohet në praktika konkrete të biznesit. Paralelisht, roli i shteteve në përfshirjen e politikave të qëndrueshmërisë paraqitet si një faktor mbështetës, i cili ndihmon në motivimin e biznesit drejt modeleve të prodhimit dhe konsumit të qëndrueshëm.

Së fundmi, rezistenca ekonomike përbën një dimension thelbësor të qytetarisë ekonomike globale. Indikator i praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm eksploron kapacitetin e sipërmarrjeve për të adoptuar modele ekonomike elastike, të afta për tu përballur me goditje të tilla si ndryshimet klimatike, paqëndrueshmëria ekonomike dhe ndërprerjet në zinxhirët socialë dhe ekonomikë.

Strategji si diversifikimi, planifikimi i skenarëve dhe modelet fleksibël të biznesit vlerësohen si elementë që kontribuojnë në ndërtimin e një ekonomie globale më të qëndrueshme dhe më të adaptueshme, duke forcuar rolin e sipërmarrjeve si subjekte ekonomike globale të përgjegjshëm.

3.1.1.5. Strategjitë për qëndrueshmëri dhe rezistenca e sipërmarrjeve si nën-indikator i praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm

Promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm në nivel mikro kërkon që sipërmarrjet, veçanërisht, ato industriale të ndërtojnë dhe zbatojnë strategji të integruara të qëndrueshmërisë dhe rezistencës. Këto strategji përbëjnë një nën-indikator thelbësor të indikatorit të praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm, pasi reflektojnë kapacitetin e sipërmarrjeve për të menaxhuar në mënyrë afatgjatë rreziqet mjedisore, sociale dhe ekonomike, duke garantuar njëkohësisht vazhdimësinë e aktivitetit të tyre dhe kontributin në zhvillimin e qëndrueshëm.

Në literaturën ekonomike dhe menaxheriale mungon ende një përkufizim universal i qëndrueshmërisë së sipërmarrjeve, çka e bën të domosdoshëm trajtimin e saj përmes qasjeve të ndryshme konceptuale dhe praktike. Në këtë kontekst, studimi i Sanches et al. (2022) ofron një kontribut të rëndësishëm duke analizuar themelet konceptuale të qëndrueshmërisë së sipërmarrjeve, karakteristikat e saj dhe klasifikimin e qasjeve kryesore për përcaktimin e këtij koncepti, si dhe marrëdhënien ndërmjet qëndrueshmërisë së sipërmarrjeve, zhvillimit të qëndrueshëm në nivel mikro dhe ekonomisë qarkulluese.

Veçanërisht në sektorin e minierave, strategjitë e qëndrueshmërisë dhe rezistencës së sipërmarrjeve marrin një rëndësi të shtuar, për shkak të varësisë së lartë nga kapitali natyror dhe asetet minerale, si dhe ndikimeve të konsiderueshme mjedisore dhe sociale. Analiza e kryer mbi rastin e industrisë minerare në Rusi tregon se performanca e kompanive në këtë sektor ka një ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin mjedisor, ekonomik dhe social, si në nivel kombëtar ashtu edhe rajonal. Në këtë kuadër, strategjitë e sipërmarrjeve të orientuara drejt qëndrueshmërisë shërbejnë si mekanizma rezistence ndaj rreziqeve strukturore, ekonomike dhe mjedisore që karakterizojnë ekonominë e bazuar në burime natyrore.

Menaxhimi efektiv i faktorëve kyç të qëndrueshmërisë, përfshirë përdorimin racional të burimeve, përgjegjësinë sociale të sipërmarrjeve dhe integrimin e dimensionit mjedisor në vendimarrjen strategjike, krijon një ndikim pozitiv të matshëm që është në përputhje me kërkesat e zhvillimit të qëndrueshëm. Si rrjedhojë, strategjitë e qëndrueshmërisë dhe rezistencës së sipërmarrjeve shndërrohen në një tregues praktik të angazhimit real të sipërmarrjeve ndaj parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm, duke tejkaluar qasjet formale ose deklarative.

Në këtë kuptim, integrimi i elementeve të ekonomisë qarkulluese në strategjitë e sipërmarrjeve përbën një komponent kyç të këtij nën-indikator. Përfshirja e modeleve të biznesit qarkullues në strategjitë e kompanive industriale, dhe veçanërisht atyre minerare, kontribuon në rritjen e rezistencës së tyre ndaj krizave, uljen e presionit mbi burimet natyrore dhe përmirësimin e performancës mjedisore dhe sociale. Këto praktika forcojnë qëndrueshmërinë afatgjatë të sipërmarrjeve dhe mbështesin arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, duke e konsoliduar rolin e strategjive të qëndrueshmërisë dhe rezistencës si një nën-indikator thelbësor i praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm.

Më poshtë jepet Tabela IV “Komponentët Matës të Nën-Indikatorit ‘Strategjitë e Qëndrueshmërisë dhe Rezistencës’”, e cila përmbledh në mënyrë sintetike praktikatat dhe elementët që sipërmarrjet industriale, veçanërisht, ato minerare, duhet të zbatojnë për të menaxhuar rreziqet mjedisore, sociale dhe ekonomike.

Tabela IV: Komponentët Matës të Nën-Indikatorit “Strategjitë e Qëndrueshmërisë dhe Rezistencës”

Komponenti Matës	Përshkrimi	Praktika/Shembuj
Përdorimi racional i burimeve	Përdorimi racional i burimeve	Përdorimi racional i burimeve
Integrimi i dimensionit mjedisor	Integrimi i dimensionit mjedisor	Integrimi i dimensionit mjedisor
Përgjegjësia sociale e sipërmarrjeve	Përgjegjësia sociale e sipërmarrjeve	Përgjegjësia sociale e sipërmarrjeve
Rezistenca dhe elasticiteti ekonomik	Rezistenca dhe elasticiteti ekonomik	Rezistenca dhe elasticiteti ekonomik
Inkorporimi i ekonomisë qarkulluese	Inkorporimi i ekonomisë qarkulluese	Inkorporimi i ekonomisë qarkulluese

3.1.1.6. Angazhimi i palëve të interesuara si nën-indikator i praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm

Një element thelbësor i praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm është edhe angazhimi i palëve të interesuara, interesat dhe pritshmëritë e të cilave duhet të merren në konsideratë në proceset vendimarrëse të sipërmarrjeve. Në këtë kuptim, angazhimi i palëve të interesuara përfaqëson një nën-indikator kyç i praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm, pasi reflekton nivelin e përfshirjes, transparencës dhe llogaridhënies së sipërmarrjeve në raport me subjektet e prekuara nga aktiviteti i tyre ekonomik.

Indikator i praktikave ekonomike të zhvillimit të qëndrueshëm vlerëson nëse dhe në çfarë mase sipërmarrjet përfshijnë palët e interesuara në vendimarrjen ekonomike, duke nxitur forma të strukturuar dialogu dhe mekanizma pjesëmarrës. Këta mekanizma përfshijnë konsultimet periodike me palët e interesuara, dialogun me komunitetin lokal, si dhe krijimin e strukturave pjesëmarrëse të vendimarrjes, të cilat synojnë të sigurojnë një qasje gjithëpërfshirëse dhe të përgjegjshme ndaj zhvillimit të qëndrueshëm.

Në veçanti, pjesëmarrja e komunitetit në aktivitetet e sipërmarrjeve shpesh konsiderohet si një instrument zhvillimi, sidomos në vendet në zhvillim, ku ndërhyrjet e sektorit privat mund të luajnë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e kushteve sociale dhe ekonomike lokale. Megjithatë, praktikatat e angazhimit të komunitetit janë shpesh objekt kritikash, për shkak të tendencave drejt patronazhit, mungesës së ndjeshmërisë ndaj kontekstit lokal dhe mosreflektimit real të prioritetëve të komunitetit në vendimmarrjen e sipërmarrjeve. Në këtë kuadër, shqetësim qendror mbetet niveli real i pjesëmarrjes së komunitetit në vendimmarrjen sociale dhe ekonomike të sipërmarrjeve.

Pjesëmarrja e komunitetit në vendimmarrje ofron një mundësi për të adresuar këto kritika, duke kaluar nga forma formale ose simbolike të konsultimit drejt modeleve më të thelluara të bashkëvendimmarrjes. Studimi i Muthuri et al. (2009), i fokusuar në rastin e Magadi Soda Company në Kenia, analizon pjesëmarrjen e komunitetit në qeverisjen e sipërmarrjeve përmes lenteve të teorive të qeverisjes sociale - politike dhe të ndërveprimit. Autorët tregojnë se institucionalizimi i vendimmarrjes pjesëmarrëse ndikon në transformimin gradual të roleve qeverisëse të sipërmarrjeve dhe në mënyrën e veprimit social të saj, duke krijuar marrëdhënie më të qëndrueshme dhe më të balancuara me komunitetin lokal.

Në këtë kontekst, angazhimi i palëve të interesuara si nën-indikator i praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm shërben si një tregues i rëndësishëm i cilësisë së qeverisjes së sipërmarrjes dhe i orientimit të saj drejt zhvillimit gjithëpërfshirës. Ai mat jo vetëm ekzistencën e mekanizmave të angazhimit, por edhe efektivitetin e tyre në ndikimin real mbi vendimmarrjen ekonomike dhe sociale të sipërmarrjes, duke kontribuar në ndërtimin e besimit, legjitimitetit dhe qëndrueshmërisë afatgjatë.

Më poshtë, Tabela V “Komponentët Matës të Nën-Indikatorit ‘Angazhimi i Palëve të Interesuara’”, e cila përmbledh në mënyrë sintetike mënyrat se si sipërmarrjet integrojnë përfshirjen, transparencën dhe llogaridhënien në vendimmarrjen e tyre ekonomike dhe sociale.

Tabela V: Komponentët Matës të Nën-Indikatorit “Angazhimi i Palëve të Interesuara”

Komponenti Matës	Përshkrimi	Praktika/Shembuj
Përfshirja e palëve të interesuara	Masat dhe mënyrat se si sipërmarrjet përfshijnë aktorët e prekur nga aktiviteti i tyre ekonomik	Konsultime periodike, dialog me komunitetin, forum vendimarrës
Transparenca	Niveli i hapjes së sipërmarrjes ndaj informacionit dhe vendimmarrje	Raportim publik, qasje në informacion mbi vendimet ekonomike dhe sociale
Llogaridhënia	Shprehja e përgjegjësisë së sipërmarrjes ndaj palëve të interesuara	Strukturat pjesëmarrëse, mekanizma monitorimi, vlerësimi i ndikimit të vendimeve
Pjesëmarrja e komunitetit	Gradualiteti dhe efektiviteti i integritetit të komunitetit në vendimmarrje	Bashkëvendimmarrje, projekte zhvillimi lokal, qeverisje sociale-partneritet

3.2. Indikatori i Reduktimit të Karbonit

Ngrohja globale përbën një nga sfidat më serioze të zhvillimit bashkëkohor, duke ndikuar drejtpërdrejt jo vetëm biodiversitetin, por edhe shëndetin dhe mirëqenien e njerëzimit. Në këtë drejtim, sipërmarrjet, si burimi kryesor i emetimit të gazrave serrë mbajnë një përgjegjësi të veçantë në reduktimin e emetimeve të karbonit. Për rrjedhojë, indikatori i reduktimit të karbonit përfaqëson një komponent thelbësor të praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm, pasi mat angazhimin real të sipërmarrjeve për të kufizuar ndikimin e tyre mjedisor dhe për tu përafëruar me objektivat afatgjate klimatike.

Megjithatë, evidenca empirike tregon se vetëm një numër relativisht i kufizuar sipërmarrjesh kanë zhvilluar dhe bërë publike strategji të strukturuar për kalimin drejt ekonomisë me karbon të ulët, shpesh të referuara si *“harta e kalimit në karbon të ulët”*. Një nga arsyt kryesore lidhet me mungesën e përfitimeve të menjëhershme ekonomike nga investimet mjedisore, çka e bën tranzicionin drejt objektivave *“neto zero”* sfidues nga këndvështrimi i vendimmarrjes afatshkurtër.

Në këtë drejtim, analiza e praktikave të menaxhimit të karbonit në kontekste të ndryshme kombëtare ofron njohuri të vlefshme për identifikimin e masave efektive të reduktimit të emetimeve. Studimi i Wang et al. (2023) kontribuon në këtë debat duke propozuar një kornizë multidimensionale të reduktimit të karbonit në nivelin e sipërmarrjeve. Autorët sugjerojnë se strategjitë efektive të reduktimit të emetimeve duhet të bazohen në: (i) Angazhimin në mekanizma rregullatorë të karbonit, si sistemet e tregtisë së emetimeve; (ii) Adoptimin e teknologjive të gjelbra; (iii) Forcimin e strukturave të qeverisjes së sipërmarrjeve; (iv) Sigurimin e burimeve financiare të mjaftueshme për mbështetjen e tranzicionit drejt karbonit të ulët. Kjo qasje shërben si një urë lidhëse ndërmjet objektivave mjedisore dhe krijimit të vlerës afatgjatë për sipërmarrjet.

Një dimension tjetër i rëndësishëm i indikatorit të reduktimit të karbonit lidhet me perceptimet dhe pritshmëritë shoqërore ndaj praktikave të sipërmarrjeve. Studimi i Loia dhe Adinolfi (2021), përmes analizës së të dhënave nga mediat sociale, tregon se strategji të tilla si puna në distancë nuk perceptohen gjerësisht nga publiku si instrumente për reduktimin e emetimit të karbonit, edhe në periudha me ndjeshmëri të lartë mjedisore. Këto gjetje nënvizojnë rëndësinë e komunikimit dhe transparencës së sipërmarrjeve si elementë plotësues të strategjive të reduktimit të karbonit.

Nga perspektiva e qeverisjes së sipërmarrjeve, roli i investitorëve institucionalë në nxitjen e reduktimit të emetimeve është gjithashtu i dokumentuar. Studimi i Azar (2021) tregon se angazhimi aktiv i investitorëve të mëdhenj institucionalë shoqërohet me nivele më të ulëta të emetimeve të karbonit në sipërmarrjet ku ata kanë pjesëmarrje të konsiderueshme, duke theksuar rëndësinë e presioneve të jashtme në hartimin e strategjive mjedisore.

Në literaturë, reduktimi i emetimit të karbonit trajtohet gjithnjë e më shumë si rezultat i ndërveprimit ndërmjet presioneve të palëve të interesuara dhe strategjive të brendshme të sipërmarrjeve. Studimi i Sprengel dhe Busch (2011) tregon se strategjitë mjedisore nuk

përcaktohen domosdoshmërisht nga një grup specifik palësh të interesuara, por nga niveli i ndotjes dhe ekspozimi i sipërmarrjes ndaj rreziqeve klimatike, duke e bërë intensitetin e emetimeve një faktor përcaktues në zgjedhjen e strategjisë së reduktimit të karbonit.

Për vlerësimin empirik të këtij indikator, literatura thekson nevojën për një qasje shumëplanëshe. Sipas Le Guenedal et al. (2022), objektivat e reduktimit të karbonit duhet të jenë specifike, të matshme, të arritshme, të rëndësishme dhe të kufizuara në kohë, duke ofruar një bazë të qartë për monitorimin e progresit. Për rrjedhojë, indikator i reduktimit të karbonit nuk kufizohet vetëm në matjen numerike të uljes së emetimeve, por përfshin edhe analizën e strategjive, politikave dhe mekanizmave të zbatimit të tyre.

Në këtë kuadër, reduktimi i emetimit të karbonit paraqitet si një tregues i integruar i përkushtimit mjedisor të sipërmarrjes dhe i aftësisë së saj për të përballuar sfidat e tranzicionit klimatik. Ai reflekton jo vetëm performancën mjedisore, por edhe elasticitetin, kapacitetin inovativ dhe orientimin strategjik të sipërmarrjeve drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe përgjegjësisë sociale.

Më poshtë, Tabela VI “Komponentët Matës të Indikatorit “Reduktimi i Karbonit”, e cila sintetizon dimensionet kryesore përmes të cilave matet indikator i reduktimit të karbonit, duke e paraqitur atë si një tregues të integruar të performancës mjedisore, qeverisjes së sipërmarrjeve dhe orientimit strategjik drejt zhvillimit të qëndrueshëm.

Tabela VI: Komponentët Matës të Indikatorit “Reduktimi i Karbonit”

Komponenti Matës	Përshkrimi	Praktika/Shembuj
Strategjia e karbonit të ulët	Ekzistenca e një plani të strukturuar për tranzicionin drejt “neto zero”	Harta e kalimit në karbon të ulët, objektiva afatgjata klimatike
Pjesëmarrja në mekanizma rregullatorë	Angazhimi në instrumente të politikave klimatike	Sistemet e tregtisë së emetimeve, taksë karboni
Adoptimi i teknologjive të gjelbra	Investime në inovacion dhe procese me emetime të ulëta	Energjia e rinovueshme, efienca energjetike
Qeverisja dhe mbikëqyrja	Integrimi i objektivave klimatike në strukturat drejtuese	Komitete për “Mjedis, Shoqëri dhe Qeverisje”, mbikëqyrje nga bordi, presioni i investitorëve institucionalë
Burimet financiare	Kapaciteti financiar për mbështetjen e tranzicionit	Investime kapitale të gjelbra, financim i qëndrueshëm
Matja dhe monitorimi i progresit	Përcaktimi i objektivave të matshme dhe raportimi i performancës	Objektiva SMART, raportim i emetimeve
Transparenca dhe komunikimi	Informimi i palëve të interesuara mbi performancën klimatike	Raporte qëndrueshmërie, komunikim publik

3.3. Indikatori i Menaxhimit të Zinxhirit të Furnizimit

Përgjegjësia në zinxhirin e furnizimit përbën një indikator thelbësor në vlerësimin e përkushtimit të një sipërmarrje ndaj praktikave etike të biznesit dhe qëndrueshmërisë. Në një epokë ku përgjegjësia e sipërmarrjeve ndërthuret gjithnjë e më shumë me nismat globale dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, menaxhimi i zinxhirit të furnizimit shfaqet si një sistem kyç referimi për përafrimin e veprimtarisë së sipërmarrjes me synimet mjedisore, sociale dhe ekonomike afatgjata. Ky indikator vlerëson masat e marra për të siguruar praktika të përgjegjshme dhe të qëndrueshme përgjatë gjithë ciklit të zinxhirit të furnizimit, që nga siguri i lëndëve të para deri te dorëzimi i produktit përfundimtar.

Natyra e globalizuar e operacioneve të biznesit ka ndërlidhur korporatat me furnitorë, prodhues dhe shpërndarës në nivel global, duke e shtrirë përgjegjësinë për praktikën etike dhe të qëndrueshme përtej operacioneve të drejtëpërdrejta të sipërmarrjes. Në këtë kuptim, indikatori i menaxhimit të zinxhirit të furnizimit vlerëson mënyrën se si sipërmarrjet adresojnë çështje të tilla si praktikën e drejtë të punës, burimet etike dhe qëndrueshmëria mjedisore, duke kaluar përtej llogjikës tradicionale të efikasitetit dhe kostos drejt parimeve të përgjegjësisë, transparencës, llogaridhënies dhe përgjegjësisë së zgjeruar.

Një dimension qendror i këtij indikatori lidhet me reduktimin e ndikimit klimatik përmes zinxhirit të furnizimit, duke e trajtuar atë jo si një element të izoluar, por si pjesë përbërëse të strategjisë së përgjithshme të qëndrueshmërisë së sipërmarrjes. Në këtë kontekst, menaxhimi i zinxhirit të furnizimit shërben si mekanizëm operacional për identifikimin, matjen dhe reduktimin e emetimeve të gazeve serrë, veçanërisht atyre që lidhen me aktivitetet e furnitorëve, transportin, logjistikën dhe ciklin e jetës së produkteve. Përmes bashkëpunimit me partnerët përgjatë zinxhirit të furnizimit, korporatat synojnë të përafrojnë praktikën e tyre me objektivat globale për klimën, duke kontribuar në zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe në tranzicionin drejt modeleve më të qëndrueshme të prodhimit dhe konsumit.

Debati mbi metrikat e vlerësimit të performancës në këtë fushë mbetet i gjerë. Studimi i Ahi dhe Searcy (2015), i cili analizon 445 artikuj shkencorë dhe identifikon 2,555 metrika unike, evidenton mungesën e konsensusit mbi mënyrën e matjes së menaxhimit të qëndrueshëm të zinxhirit të furnizimit. Megjithatë, emetimet nga ajri dhe emetimet e gazrave serrë shfaqen ndër metrikat më të përdorura, duke konfirmuar rëndësinë e dimensionit klimatik brenda këtij indikatori. Kjo qasje thekson nevojën për korniza konceptuale që integrojnë shqetësimet mjedisore, sociale dhe ekonomike në mënyrë të ndërthurur.

Në vijim, indikatori fokusohet në burimin etik të materialeve dhe praktikën e drejtë të punës, duke shqyrtuar mënyrën se si sipërmarrjet sigurojnë që lëndët e para të përfitohen në përputhje me standardet mjedisore dhe të të drejtave të njeriut. Eliminimi i praktikave joetike, garantimi i kushteve të sigurta të punës dhe respektimi i pagave të drejta janë elementë thelbësorë të këtij vlerësimi.

Qëndrueshmëria mjedisore mbetet një shtyllë tjetër kyçe e indikatorit, ku përpjekjet për reduktimin e karbonit, uljen e përdorimit të energjisë dhe burimeve natyrore, si dhe zbatimin e parimeve të ekonomisë qarkulluese, konsiderohen tregues të pjekurisë së menaxhimit të zinxhirit të furnizimit. Këto iniciativa reflektojnë rolin transformues që ky indikator mund të ketë jo vetëm për sipërmarrjen, por edhe për komunitetin global (Centobelli et al., 2018).

Në të njëjtën kohë, transparenca dhe gjurmueshmëria janë komponentë thelbësorë për sigurimin e besueshmërisë dhe llogaridhënies. Përmes teknologjisë, certifikimeve dhe partneriteteve bashkëpunuese, sipërmarrjet rrisin aftësinë për të monitoruar ndikimin mjedisor dhe social të zinxhirit të furnizimit (Brun et al., 2020).

Së fundmi, menaxhimi i përgjegjshëm i zinxhirit të furnizimit përfshin identifikimin dhe zbutjen e rreziqeve sociale, mjedisore dhe gjeopolitike, duke e forcuar qëndrueshmërinë e sipërmarrjes përballë krizave dhe pasigurive (Giannakis & Papadopoulos, 2016). Në këtë mënyrë, indikator shfaqet si një instrument gjithëpërfshirës që lidh objektivat e reduktimit të karbonit me përgjegjësinë sociale dhe performancën afatgjatë të biznesit.

Më poshtë, Tabela VII “Komponentët Matës të Indikatorit ‘Menaxhimi i Zinxhirit të Furnizimit’”, e cila sintetizon dimensionet kryesore përmes të cilave matet indikator i përgjegjësisë në zinxhirin e furnizimit, duke e paraqitur atë si një instrument të integruar që lidh reduktimin e karbonit, përgjegjësinë sociale dhe performancën afatgjatë të sipërmarrjes në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm.

Tabela VII: Komponentët Matës të Indikatorit “Menaxhimi i Zinxhirit të Furnizimit”

Komponenti Matës	Përshkrimi	Praktika/Shembuj
Burimi etik i materialeve	Sigurimi i lëndëve të para në përputhje me standardet mjedisore dhe të të drejtave të njeriut	Çertifikime, kode etike për furnitorët
Praktikat e drejta të punës	Respektimi i kushteve të sigurta të punës dhe pagave të drejta përgjatë zinxhirit	Auditime sociale, standarde ndërkombëtare të punës
Reduktimi i ndikimit klimatik	Matja dhe ulja e emetimeve nga furnitorët, transporti dhe logjistika	Monitorim, bashkëpunim për dekarbonizim
Qëndrueshmëria mjedisore	Ulja e përdorimit të energjisë dhe burimeve natyrore	Eficiencë energjetike, ekonomi qarkulluese
Transparenca dhe gjurmueshmëria	Monitorimi dhe raportimi i ndikimeve mjedisore dhe sociale	Raportim “Mjedis, Shoqëri, Qeverisje”, teknologji gjurmimi, certifikime
Menaxhimi i rreziqeve	Identifikimi dhe zbutja e rreziqeve sociale, mjedisore dhe gjeopolitike	Analiza risku, diversifikim furnitorësh

3.4. Indikatori i Gjithëpërfshirjes

Diversiteti përfshin një gamë të gjerë dallimesh midis individëve, përfshirë, por pa u kufizuar në racën, gjininë, përkatësinë etnike, moshën, orientimin seksual dhe aftësitë njohëse. Gjatë gjithë këtij spektri, gjithëpërfshirja i referohet krijimit të një mjedisi ku të gjithë ndihen të vlerësuar, të respektuar dhe të përfshirë, pavarësisht nga dallimet e tyre. Së bashku, diversiteti dhe gjithëpërfshirja formojnë bazën e një kulture pune që promovon bashkëpunimin, kreativitetin dhe ndjenjën e përkatësisë (Likoko & Kini, 2017). Ky indikator vlerëson nivelin në të cilin një sipërmarrje kultivon aktivisht diversitetin dhe siguron përfshirjen e të gjithë punonjësve.

Studimi i D'Netto et al. (2014) mbi perceptimet e punonjësve në sektorin e prodhimit në Australi zbuloi se, megjithëse diskriminimi i hapur është i kufizuar, punëdhënësit shpesh adoptuan një *“qasje minimale ligjore”* ndaj diversitetit, duke mos e trajtuar atë si një avantazh strategjik. Mungesa e praktikave efektive të menaxhimit të diversitetit në burimet njerëzore ka çuar në paaftësinë për të shfrytëzuar përfitimet e diversitetit. Sfidat të identifikuara përfshijnë njohjen e pamjaftueshme të aftësive të jashtme, komunikimin joefektiv, kostot e trajnimeve dhe izolimin social; ndërsa, përfitimet përfshijnë përmirësimin e etikës së punës, mundësi për të mësuar nga kultura të ndryshme, uljen e mungesave dhe reduktimin e qarkullimit të punonjësve. Gjetjet tregojnë gjithashtu se punëtorët emigrantë përballen me disavantazhe të ndryshme në këtë sektor.

Nga perspektiva e gjithëpërfshirjes, studimi i Singha (2024) analizon rolin kritik të menaxhimit dhe kulturës organizative në promovimin e barazisë gjinore në sipërmarrje, sidomos në kontekstin e përparimeve të shpejta teknologjike. Ai thekson rëndësinë e menaxhimit gjithëpërfshirës gjatë transformimit digjital, duke treguar se si teknologjia mund të përmirësojë praktikën përfshirëse dhe të ndihmojë në krijimin e ambienteve të barabarta të punës. Duke kuptuar dhe menaxhuar në mënyrë efektive kulturën e sipërmarrjes të epokës digjitale, liderët mund të kultivojnë mjedise përfshirëse që vlerësojnë perspektiva të ndryshme dhe promovojnë drejtësinë sociale, një element kyç për inovacion dhe sukses organizativ.

Studiuesi Muñoz (Muñoz, 2019) propozon integrimin e metodës së *“Rekrutimit të Anonimizuar”* në procesin e rekrutimit të sektorit publik në Filipine, duke zbatuar një proces rekrutimi dhe zgjedhjeje të bazuar në kompetenca anonime. Ky proces synon të reduktojë paragjykimet e pavetëdijshme dhe vlerësimet subjektive, duke përdorur teknologjinë për të anonimizuar informacionin demografik si emrat dhe sfondi i kandidatëve, duke u fokusuar vetëm te aftësitë dhe përvojat e rëndësishme. Rezultatet tregojnë një gadishmëri të fortë për të adoptuar këtë qasje inovative, e cila synon të rrisë diversitetin, barazinë dhe përvetësimin e talenteve në sektorin publik.

Në përfundim, indikatori i gjithëpërfshirjes ka një rëndësi të madhe për sipërmarrjet që përballen me sfidat e përgjegjësisë sociale. Ai vlerëson angazhimin e kompanive ndaj praktikave që promovojnë diversitetin, barazinë dhe përfshirjen e grupeve të ndryshme shoqërore. Përveç ndërtimit të një reputacioni pozitiv, ky indikator ndihmon në përmirësimin e klimës organizative dhe rritjen e produktivitetit. Metrikat kryesore

përfshijnë: (i) Përqindjen e individëve nga grupe të ndryshme në pozita të ndryshme pune; (ii) Nivelin e angazhimit të punonjësve dhe monitorimin e përfshirjes në vendimarrje dhe politikat sipërmarrëse. Vlerësimi i këtyre metrikave lejon identifikimin e fushave për përmirësim, duke garantuar një ambient pune më të drejtë, gjithëpërfshirës dhe të barabartë për të gjithë punonjësit.

Më poshtë, Tabela VIII “Komponentët Matës të Indikatorit ‘Gjithëpërfshirja’”, e cila sintetizon elementët kryesorë përmes të cilëve matet indikatori i gjithëpërfshirjes, duke e paraqitur atë si një tregues të cilësisë së kulturës organizative, drejtësisë sociale dhe kapacitetit inovativ të sipërmarrjes në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm.

Tabela VIII: Komponentët Matës të Indikatorit “Gjithëpërfshirja”

Komponenti Matës	Përshkrimi	Praktika/Shembuj
Përfaqësimi i diversitetit	Përqindja e individëve nga grupe të ndryshme në nivele dhe funksione të ndryshme organizative	Balanca gjinore, përfaqësimi etnik, i moshës dhe i personave me aftësi të kufizuara
Barazia në mundësi	Garantimi i proceseve të drejta në rekrutim, promovim dhe shpërblim	Rekrutim i anonimizuar, politika kundër diskriminimit
Kultura gjithëpërfshirëse	Krijimi i një mjedisi ku të gjithë ndihen të vlerësuar dhe të respektuar	Trajnime për diversitetin, politika për barazi gjinore
Angazhimi dhe pjesëmarrja	Niveli i përfshirjes së punonjësve në vendimarrje dhe politika sipërmarrëse	Anketa të angazhimit, mekanizma feedback-u
Monitorimi dhe raportimi	Matja sistematike e treguesve të diversitetit dhe gjithëpërfshirjes	Raportim “Mjedis, Shoqëri, Qeverisje”, indikatorë të qarkullimit dhe mungesave

3.5. Indikator i Angazhimit në Komunitet

Ndërkohë që sipërmarrjet bëjnë përparim në avancimin e diversitetit dhe gjithëpërfshirjes, ato vazhdojnë të përballen me sfida në krijimin e mjediseve gjithëpërfshirëse dhe në adresimin e nevojave të ndryshme të komuniteteve ku veprojnë. Kuptimi i sfidave dhe mundësive u mundëson sipërmarrjeve dhe palëve të interesuara të marrin një qëndrim të paanshëm dhe të zhvillojnë strategji për një angazhim efektiv në komunitet, duke nxitur një të ardhme më të barabartë, inovative dhe elastike.

Angazhimi në komunitet përbën një indikator kyç të vlerësimit të përgjegjësisë sociale të sipërmarrjeve dhe ndikimit të tyre përtej operacioneve të përditshme. Ky indikator fokuson strategjitë dhe iniciativat që korporatat ndërmarrin për të kontribuar në mirëqenien e komuniteteve dhe për të ndërtuar marrëdhënie të qëndrueshme me aktorët lokalë. Angazhimi kapërcen filantropinë e thjeshtë, përfshirë partneritete, bashkëpunime

dhe nisma të qëndrueshme që adresojnë nevojat lokale dhe përmirësojnë strukturën shoqërore, duke e bërë sipërmarrjen pjesë integrale të ekosistemit social.

Qëndrueshmëria e angazhimit në komunitet është gjithashtu thelbësore. Metrikat e përdorura për vlerësim përfshijnë treguesit kryesorë të performancës, mekanizmat e reagimit dhe vlerësimet bashkëpunuese për të kuptuar efektivitetin e veprimeve dhe fushat që kërkojnë përmirësim. Sfidat e zakonshme për sipërmarrjet përfshijnë dallimet kulturore, barrierat e komunikimit dhe rezistencën ndaj ndryshimit, por ato mund të shndërrohen në mundësi për inovacion, ndërtim partneritetesh dhe rritje reciproke.

Studiuesit Hickey dhe Cui (2024) evidentojnë rëndësinë e mentorimit dhe mbështetjes në rrugët e karrierës, duke treguar se iniciativat që ndihmojnë individët në komunitet, përfshirë gratë në sektorë jo të përfaqësuar, mund të krijojnë një impakt pozitiv dhe të zgjeruar social. Studimi i Michelon (2013) tregon se kompanitë që përshtatin iniciativat e tyre të përgjegjësisë sociale me nevojat e palëve të interesit arrijnë rezultate më të mira performancash dhe ndikimi strategjik është më i qëndrueshëm.

Hulumtimet mbi komunitetet lokale të marginalizuara, si ai i Eikelenboom dhe Long (2023), tregojnë se pjesëmarrja efektive kërkon balancim të interesave dhe përdorim të qasjes së ndjeshme për të arritur konsensus. Kjo evidencë vë në dukje se angazhimi i suksesshëm në komunitet kërkon qasje të menduar dhe të koordinuar, duke integruar komunitetin në zgjidhje praktike dhe të qëndrueshme.

Përfshirja e punonjësve të korporatës në projektet komunitare është një tjetër dimension i rëndësishëm. Studimi i Barakat et al. (2016) tregon se nismat e përgjegjësisë sociale rrisin kënaqësinë e punonjësve dhe përforcojnë imazhin organizativ, duke kontribuar në angazhimin e tyre ndaj qëllimeve organizative. Kjo lidhet ngushtë me përfitimin reciprok midis komunitetit dhe punonjësve, duke përmirësuar lidhjet dhe motivimin brenda korporatës.

Angazhimi i qëndrueshëm në komunitet kërkon bashkëpunim me organizata të ndryshme, shkolla profesionale dhe universitete për të nxitur përfshirjen dhe zhvillimin e talenteve. Kjo qasje ndihmon në ndërtimin e kapaciteteve lokale, promovon inovacionin dhe forcon marrëdhëniet me komunitetin.

Në përfundim, indikatori i angazhimit në komunitet shërben si një udhërrëfyes për korporatat, duke u mundësuar të ndërtojnë marrëdhënie që shtrihen përtej shkëmbimeve financiare. Ai eksploron aspektet e shumëanshme të bashkëpunimit, duke nxitur praktika të qëndrueshme dhe duke rritur prosperitetin e përbashkët midis sipërmarrjeve dhe komunitetit.

Më poshtë, Tabela IX “Komponentët Matës të Indikatorit “Angazhimi në Komunitet”, e cila paraqet në mënyrë sintetike komponentët matës të indikatorit të angazhimit në komunitet, duke evidentuar dimensionet kryesore të kontributit dhe bashkëpunimit të sipërmarrjeve. Ajo përmbledh treguesit kyç që përdoren për të vlerësuar efektivitetin, qëndrueshmërinë dhe ndikimin e iniciativave komunitare në kuadër të përgjegjësisë sociale.

Tabela IX: Komponentët Matës të Indikatorit “Angazhimi në Komunitet”

Komponenti Matës	Përshkrimi	Metrika/ Treguesi Kryesor
Investimet dhe iniciativat komunitare	Programe dhe projekte që adresojnë nevojat lokale organizative	Nr./vlera e projekteve dhe investimeve
Partneritetet lokale	Bashkëpunime me OJF, institucione arsimore dhe aktorë lokalë	Nr. partneriteteve aktive
Mekanizmat e reagimit	Kanale për konsultim dhe vlerësim të komunitetit	Ekzistenca e mekanizmave & frekuenca e feedback-ut
Pjesëmarrja e punonjësve	Përfshirja e stafit në projekte komunitare	% e punonjësve të angazhuar
Vlerësimi i ndikimit	Matja e efektivitetit dhe qëndrueshmërisë së iniciativave	Tregues kyç i performancës sociale dhe raporte vlerësimi
Qëndrueshmëria e angazhimit	Vazhdimësia dhe integrimi strategjik i iniciativave	Plane afatgjata & integrim në strategji

3.6. Indikator i Angazhimit me Palët e Interesuara

Angazhimi i palëve të interesuara është një indikator kyç për vlerësimin e angazhimit të një sipërmarrje ndaj transparencës, llogaridhënies dhe praktikave të qëndrueshme. Ai mat shkallën në të cilën korporata ndërvepron në mënyrë efektive dhe gjithëpërfshirëse me palët e saj të interesit, duke marrë parasysh interesat dhe shqetësimet e tyre të ndryshme. Termi "*palë të interesuara*" përfshin një gamë të gjerë aktorësh: punonjësit, klientët, furnitorët, organizatat joqeveritare, komunitetet lokale dhe investitorët.

Angazhimi efektiv i palëve të interesuara kërkon dialog të vazhdueshëm dhe kuptimplotë, ku korporata jo vetëm komunikon vendimet dhe iniciativat e saj, por gjithashtu mbledh dhe analizon reagime dhe të dhëna nga palët e interesuara. Ky komunikim i dyanshëm është jetik për të kuptuar pritshmëritë, nevojat dhe shqetësimet e tyre. Indikator i angazhimit përfshin metodat që korporatat përdorin për të identifikuar palët e interesuara, për t'u dhënë përparësi dhe për t'u angazhuar me to në mënyrë të qëndrueshme.

Sipas Thomas Maak (2007), liderët përgjegjës krijojnë kapital social duke ndërvepruar me palët e interesuara dhe duke ndërtuar marrëdhënie të qëndrueshme dhe të dobishme reciprokisht. Kjo përfshin krijimin e rrjeteve të marrëdhënieve dhe rrjeteve të vlerave që përmirësojnë bashkëpunimin dhe kontribuojnë në një biznes të qëndrueshëm dhe në të mirën e përbashkët (Maak & Pless, 2006; Lord & Brown, 2001; Bourdieu & Nice, 1980).

Studime empirike, si ai i Camilleri tregojnë një lidhje midis përgjegjësisë sociale të korporatave dhe performancës financiare (Camilleri, 2017), ndërsa Agudo-Valiente evidenton rëndësinë e kanaleve të komunikimit me palët e interesuara: moskrijimi i tyre mund të reduktojë efektivitetin e përgjegjësisë sociale (Agudo-Valiente, 2015). Për këtë, mund të përdoren metrika të matshme, për shembull: (i) Numri dhe frekuenca e konsultimeve me palët e interesuara; (ii) Shkalla e përgjigjeve të marra nga palët e

interesuara ndaj iniciativave të korporatës; (iii) Ndikimi i këtyre reagimeve në vendimarrjen dhe programet e përgjegjësisë sociale të korporatave; (iv) Cilësia e raportimit dhe transparencës së veprimeve sociale. Këto tregues e bëjnë të mundur vlerësimin e nivelit të bashkëpunimit dhe ndikimit të angazhimit të palëve të interesuara.

Në studimin e Rudyanto dhe Siregar evidentohet se presioni nga palët e interesuara dhe struktura e qeverisjes së korporatave ndikon në cilësinë e raporteve të qëndrueshmërisë (Rudyanto & Siregar, 2018). Kompanitë që angazhohen aktivisht me palët e interesuara janë më të afta për të identifikuar rreziqet dhe mundësitë, duke harmonizuar praktikatat e biznesit me pritshmëritë shoqërore. Në këtë kuptim, angazhimi i palëve të interesuara nuk është vetëm një kërkesë përputhshmërie, por një imperativ strategjik për korporatat.

Në përfundim, angazhimi i palëve të interesuara është një indikator shumë dimensional që shtrihet përtej komunikimit të thjeshtë, duke përfshirë bashkëpunimin, transparencën, reagimin dhe integrimin në vendimarrje. Ky indikator reflekton përkushtimin e korporatës ndaj praktikave të qëndrueshme dhe të përgjegjshme, duke përafruar operacionet e saj me pritshmëritë dhe shqetësimet e palëve të ndryshme të interesuara.

3.7. Indikatori i Investimeve Sociale

Indikatori i investimeve me ndikim social është një instrument thelbësor për vlerësimin e angazhimit të një sipërmarrje për të kontribuar në mënyrë pozitive në shoqëri. Ai shkon përtej filantropisë tradicionale, duke fokusuar vlerësimin tek investimet strategjike sociale që synojnë rezultate të matshme dhe ndikim të qëndrueshëm. Ky indikator vlerëson potencialin transformues të aktiviteteve financiare të korporatave, duke marrë parasysh rëndësinë, sfidat dhe implikimet e tyre sociale dhe ekonomike.

Investimet me ndikim social përfshijnë projekte dhe sipërmarrje që adresojnë sfida si varfëria, pabarazia, arsimi dhe kujdesi shëndetësor, ndërkohë që gjenerojnë kthime financiare. Indikatori mat shkallën e përputhjes së portofolit të investimeve me objektivat sociale, integrimin e tyre në strategjinë e përgjithshme dhe aftësinë për të monitoruar dhe raportuar efektet e tyre.

Studiues të rinj në menaxhimin strategjik (Eccles, Ioannou & Serafeim, 2014; Friede, Busch & Bassen, 2015) sugjerojnë se investimet me ndikim social kontribuojnë pozitivisht në performancën financiare dhe sociale të korporatave, duke evidentuar se angazhimi strategjik në dimensionin social është i lidhur me qëndrueshmërinë afatgjatë dhe reputacionin e korporatës.

Këto studime ofrojnë edhe metrika të matshme për investimet sociale, si: (i) Shuma e investimeve të dedikuara për projekte sociale; (ii) Numri i iniciativave sociale të implementuara dhe vlerësimi i impaktit të tyre (p.sh., numri i përfituesve, reduktimi i varfërisë, përmirësimi i arsimit); (iii) Raportimi i ndikimit social sipas standardeve ndërkombëtare (p.sh., GRI, IRIS+); (iv) Integrimi i objektivave sociale në vendimarrjen

e investimeve dhe monitorimi i performancës për secilën iniciativë. Këto tregues mundësojnë një vlerësim më të objektivizuar të efektivitetit të investimeve me ndikim social dhe përputhshmërisë së tyre me qëllimet strategjike të korporatës

Pavarësisht mundësive të mëdha, korporatat përballen me sfida të ndryshme në zbatimin e investimeve sociale. Studimet e fundit (Ganesh & Venugopal, 2024; Nguyen, 2025) identifikojnë çështje të tilla si: transparencë, mungesa e konsensusit brenda organizatës, mungesa e burimeve financiare, angazhimi i komunitetit dhe vlerësimi i ndikimit. Për t'i kapërcyer këto sfida, korporatat duhet të zhvillojnë metodologji matjeje të standardizuara, të monitorojnë efektivitetin dhe të përafrojnë investimet me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Shembuj nga literatura tregojnë rëndësinë e matjes dhe raportimit të efektit: Studiuesi Nguyen përdor metodën e vlerësimit sintetik “fuzzy” për të matur efektivitetin e projekteve sociale në industrinë ndërtimore, duke renditur kategoritë më të rëndësishme të ndikimit social (Nguyen 2025). Studiuesi Yusif evidenton se investimet sociale në arsimin dhe trajnimin e popullsisë rrisin potencialin ekonomik dhe intelektual të vendit (Yusif, 2020). Studiuesi Tanaka thekson rolin e investimeve të qëndrueshme në shëndetësi për përballimin e sfidave globale, si pandemia nga COVID-19 dhe ndryshimi klimatik (Tanaka, 2024).

Në konkluzion, indikatori i investimeve me ndikim social mat aftësinë e korporatave për të krijuar vlerë sociale dhe financiare në mënyrë të koordinuar dhe të qëndrueshme. Ai bazohet në tregues të matshëm, përfshirë: (i) Shuma totale e investimeve sociale dhe përqindja e tyre ndaj buxhetit total të investimeve; (ii) Numri dhe natyra e projekteve sociale të zbatuara; (iii) Ndikimi i matshëm në komunitet (p.sh., përfitues, përmirësime në arsim, shëndetësi, mjedis); (iv) Integrimi strategjik dhe raportimi sipas standardeve ndërkombëtare; (v) Përmirësimi i vazhdueshëm dhe adaptimi i projekteve bazuar në reagimet e palëve të interesuara.

Në përfundim, konkludohet se ky indikator lejon korporatat të monitorojnë progresin dhe të bëjnë vendime më të informuara mbi investimet sociale, duke lidhur financat me qëllimet sociale dhe duke siguruar transparencë dhe llogaridhënie për palët e interesuara. Pra, investimet me ndikim social janë një proces gjithëpërfshirës që synon krijimin e vlerës sociale dhe financiare, përputhshmërinë me objektivat strategjike, angazhimin me komunitetin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

3.8. Indikatori i Pajtueshmërisë me të Drejtat e Njeriut

Indikatori i pajtueshmërisë me të drejtat e njeriut është një mjet kyç për vlerësimin e angazhimit të sipërmarrjeve për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të individëve brenda sferës së tyre të ndikimit. Ai shkon përtej përmbushjes së detyrimeve ligjore, duke përfshirë parimet etike dhe përgjegjësinë sociale, si dhe vlerëson mënyrën se si korporatat integrojnë praktikatat e tyre me standardet ndërkombëtare, përfshirë Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe konventat themelore të Organizatës Ndërkombëtare të Punës.

Në vitet e fundit, indikatorët, vlerësimet dhe indekset që lidhen me biznesin dhe të drejtat e njeriut kanë njohur një zhvillim të konsiderueshëm. Megjithatë, matja e respektimit të të drejtave të njeriut nga korporatat mbetet një sfidë komplekse. Studiuesi De Felice ofron një analizë të iniciativave më të njohura në këtë fushë dhe evidenton pengesat normative, metodologjike, praktike dhe politike që shoqërojnë ndërtimin e masave efektive dhe emancipuese (De Felice, 2015). Sipas tij, debati duhet të zhvendoset nga pyetja nëse indikatorët duhen përdorur, drejt një qasjeje më konstruktive që fokusohet në mënyrën se si ato mund të konceptohen dhe zbatohen në mënyrë më të besueshme dhe më efektive. Ky reflektim teorik forcon bazën metodologjike të indikatorit dhe justifikon përdorimin e tij si instrument analitik.

Në nivel normativ dhe institucional, studiuesit Fasterling dhe Demuijnck argumentojnë se: Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut ofrojnë një kornizë të rëndësishme për integrimin e parimit të “kontrollit të duhur” në praktikën e zakonshme të menaxhimit (Fasterling & Demuijnck, 2013). Megjithatë, ata theksojnë se efektiviteti i këtij mekanizmi varet nga angazhimi real moral i korporatave dhe nga shmangia e një zbatimi thjesht instrumental.

Nga perspektiva krahasimore, Gebreegziabher evidenton ekzistencën e kornizave ligjore dhe politike që mund të mbështesin përgjegjësinë sociale të korporatave në vendet në zhvillim, por njëkohësisht thekson boshllëkun ndërmjet vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim në orientimin dhe zbatimin praktik të këtyre standardeve (Gebreegziabher, 2023).

Në kontekstin e sektorëve me risk të lartë, në studimin e tij me bashkëautorë, Massarani propozon përdorimin e vlerësimeve të ndikimit të të drejtave të njeriut si një instrument më i strukturuar për të adresuar kufizimet e mekanizmave vullnetarë ekzistues (Massarani et al., 2007). Kjo qasje synon të lidhë analizën ligjore me dimensionin operacional të biznesit.

Në këndvështrimin e sigurisë së të drejtave në nivel ndërkombëtar, studiuesit Knuckey & Jenkin evidentojnë vështirësitë praktike të sigurisë së të drejtave, duke treguar se mekanizmat ekzistues shpesh janë të pamjaftueshme për të garantuar drejtësi për komunitetet e prekura (Knuckey & Jenkin, 2018).

Indikator i përfshin gjithashtu mbrojtjen e të drejtave të punonjësve si brenda korporatës ashtu edhe përgjatë zinxhirit të furnizimit, duke shqyrtuar praktikën e punës, mosdiskriminimin, kushtet e sigurta të punës dhe parandalimin e punës së detyruar apo të fëmijëve. Në këtë drejtim, studiuesit Binaku dhe Ismajli theksojnë se respektimi i të drejtave të punonjësve kontribuon drejtpërdrejt në zhvillimin e një shoqërie të drejtë dhe në qëndrueshmërinë ekonomike (Binaku dhe Ismajli, 2024).

Në dimensionin e jashtëm, indikator i analizon marrëdhëniet e korporatës me komunitetet lokale dhe grupet vulnerabël, duke vlerësuar ndikimin mbi të drejtat e tokës, ruajtjen kulturore dhe pjesëmarrjen e komuniteteve në proceset vendimarrëse. Studimet e Calvano dhe Welford theksojnë rëndësinë e dialogut dhe menaxhimit të tensioneve mes korporatave dhe palëve të interesuara në zbatim të parimit të transparencës (Calvano, 2008; Welford et al., 2008).

Në tërësi, indikator i pajtueshmërisë me të drejtat e njeriut ofron një kuadër analitik që kombinon: (i) dimensionin normativ ndërkombëtar; (ii) mekanizmat e kontrollit të duhur dhe vlerësimit të ndikimit; (iii) mbrojtjen e të drejtave të punonjësve; (iv) marrëdhëniet me komunitetet dhe grupet vulnerabël; (v) transparencën dhe llogaridhënien. Në këtë mënyrë, ai shndërrohet nga një instrument formal verifikimi në një mjet substancial për vlerësimin e përgjegjësisë reale të korporatave ndaj të drejtave të njeriut.

Pra, respektimi i të drejtave të njeriut nuk është thjesht një çështje raportimi, por një proces gjithëpërfshirës që lidhet me angazhimin me palët e interesuara, përmirësimin e performancës sociale dhe etike dhe mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm.

3.9. Indikator i Transparencës dhe Raportimit

Transparenca dhe raportimi përbëjnë një komponent thelbësor të praktikave ekonomike të zhvillimit të qëndrueshëm, pasi ato ndikojnë drejtpërdrejt në llogaridhënien, besueshmërinë dhe performancën afatgjatë të sipërmarrjeve. Në kuadër të këtij studimi, transparenca kuptohet si zbulimi i qartë, i plotë dhe i verifikueshëm i informacionit mbi ndikimet ekonomike, sociale dhe mjedisore të aktivitetit të sipërmarrjeve, ndërsa raportimi përfaqëson mekanizmin formal për komunikimin e këtij informacioni ndaj palëve të interesuara.

Në një epokë ku palët e interesuara kërkojnë rritje të shikueshmërisë në praktikat e sipërmarrjeve, transparenca shfaqet si një element thelbësor i sjelljes së përgjegjshme të biznesit. Ky tregues analizon metodologjitë dhe praktikat e përdorura nga korporatat për të shpalosur informacionin mbi performancën e tyre financiare, sociale dhe mjedisore. Qëllimi nuk është vetëm përmbushja e kërkesave rregullatore, por nxitja e besimit midis palëve të interesuara, përfshirë investitorët, klientët, punonjësit dhe komunitetin.

Literatura empirike thekson lidhjen midis transparencës dhe performancës së qëndrueshme. Studimi i Yelnikova dhe Barhaq hedh dritë mbi matjen e transparencës së mjedisit të investimeve për investimet përgjegjëse, duke vlerësuar tregun ukrainas dhe duke e përmirësuar përmes mjeteve të vlerësimit në zhvillimin e qëndrueshëm (Yelnikova & Barhaq, 2020). Vlerësimet, renditjet, indekset dhe standardet e zhvillimit të qëndrueshëm ofrojnë tregues të qartë për seleksionimin e kompanive në bazë të përgjegjësisë sociale dhe qëndrueshmërisë. Ky indikator minimizon ashpërsinë informative në nivelet mikro dhe makro, duke siguruar një mjedis transparent për vendimet e investimeve dhe sigurinë e klimës së favorshme të investimit. Për më tepër, standardizimi i produkteve dhe teknikave të investimeve përgjegjëse mbetet prioritet për politikat shtetërore.

Studiuesi Frynas vlerëson potencialin e axhendës aktuale për përgjegjësinë sociale të korporatave në adresimin e sfidave të menaxhimit social, veçanërisht, në sektorin e naftës dhe gazit (Frynas, 2010). Ai sugjeron se përballja me sfidat e menaxhimit është thelbësore për të adresuar ndikimin e aktiviteteve të korporatave dhe se iniciativat aktuale të

përgjegjësisë sociale të korporatave shpesh janë të pamjaftueshme, ndërkohë që aktivitetet e korporatave mund të kontribuojnë në dëshimet e menaxhimit.

Studiuesit Jackson dhe Jackson analizojnë sektorin e burimeve natyrore në Sierra Leone dhe tregojnë se aktivitetet e korporatave mund të kontribuojnë në angazhimin e qëndrueshëm me komunitetet përmes transparencës dhe investimeve në fuqinë punëtore (Jackson & Jackson, 2017). Rekomandohet që korporatat të jenë transparente në ndërtimin e marrëdhënieve me komunitetet dhe të mbështeten nga mekanizma institucionale për përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Reformat institucionale sipas Cooper dhe Owen kanë rritur publikimin e raporteve të përgjegjësisë sociale të korporatave, por ato jo gjithmonë i fuqizojnë palët e interesuara ose krijojnë veprime konkrete, duke vënë në pah se transparenca duhet të matet jo vetëm sipas ekzistencës së raporteve, por edhe nga ndikimi real i tyre (Cooper & Owen, 2007).

Studiuesi Schaltegger vë në dukje se inovacioni në kontabilitetin për qëndrueshmëri, në përputhje me gjashtë atributet e propozuara nga studiuesi Baregheh mund të kontribuojë në përmirësimin e menaxhimit të qëndrueshmërisë (Schaltegger et al., 2017; Baregheh et al., 2009). Megjithatë, ata pranojnë se, pavarësisht përpjekjeve të bëra, ende nevojitet rimodulim dhe hulumtime të mëtejshme për të zhvilluar qasje kontabiliteti që përgjigjen më efektivisht ndaj sfidave mjedisore dhe sociale.

Studiuesit Roca dhe Searcy analizojnë 94 raporte të qëndrueshmërisë në Kanada dhe evidentojnë përdorimin e 585 indikatorëve të ndryshëm, duke treguar diversitetin dhe mungesën e standardizimit midis sektorëve (Roca dhe Searcy, 2012). Kjo vë në dukje sfidën metodologjike të raportimit dhe rëndësinë e zhvillimit të treguesve të besueshëm dhe krahasueshëm.

Studiuesi Lodhia, Larsson dhe Heintz (2020) theksojnë rëndësinë e përdorimit të teknologjisë dhe Web-it për raportimin ambienta dhe social, duke krijuar mundësi për akses të lehtë, besueshmëri dhe ndërtim të etikës dhe transparencës në produktet dhe shërbimet e korporatave (Lodhia, 2004; Larsson & Heintz, 2020). Këto praktika ndihmojnë në ndërtimin e besimit të konsumatorët dhe palët e interesuara, sidomos në sisteme kritike që kërkojnë siguri dhe integritet.

Në thelb, transparenca përfshin zbulimin e qartë dhe të paqartë të informacionit, duke përfshirë pasqyrat financiare, strukturat e qeverisjes, ndikimet mjedisore dhe iniciativat sociale. Indikator i vlerëson shkallën në të cilën një korporatë ofron informacion gjithëpërfshirës dhe të aksesueshëm, për të mundësuar vendime të informuara dhe për të forcuar llogaridhënien. Raportimi transparent ndërton besueshmëri, zvogëlon rreziqet dhe përforcon angazhimin e korporatës ndaj praktikave etike, të qëndrueshme dhe shoqërore.

Megjithatë, matja e transparencës dhe e respektimit të standardeve të qëndrueshmërisë mbetet sfidë metodologjike. Siç argumenton studiuesi De Felice, iniciativat e matjes përballen me pengesa normative dhe praktike, duke theksuar nevojën për kalimin nga debati “nëse” duhet të përdoren indikatorë drejt pyetjes “si” mund të ndërtohen mekanizma më efektivë dhe emancipues (De Felice, 2015),.

Në këtë mënyrë, transparenca nuk shihet thjesht si publikim informacioni, por si një mekanizëm kompleks për ndërtimin e besimit, përmirësimin e menaxhimit të

qëndrueshmërisë dhe nxitjen e një mjedisi të korporatës të përgjegjshëm dhe në këndvështrimin shoqëror të qëndrueshëm.

Pra, transparenca nuk është vetëm një çështje raportimi, por një proces gjithëpërfshirës që lidhet me besueshmërinë, ndërtimin e marrëdhënieve me palët e interesuara dhe përmirësimin e praktikave të qëndrueshme të korporatave.

4. Konkluzione

Kapitulli i dytë, duke analizuar në mënyrë kritike evolucionin e përgjegjësisë sociale të korporatave dhe integrimin e saj në paradigmen e zhvillimit të qëndrueshëm, përbën bazën konceptuale dhe metodologjike të këtij studimi. Shqyrtimi i literaturës shkencore në këtë kapitull evidentoi se konceptimi tradicional i korporatës si një strukturë e orientuar ekskluzivisht drejt maksimizimit të fitimit për aksionarët është sfiduar nga qasje bashkëkohore që theksojnë ndërvarësinë midis performancës ekonomike, ndikimit social dhe përgjegjësisë mjedisore. Ky transformim nuk përfaqëson thjesht një zgjerim tematik, por një riformulim të rolit institucional të korporatës në raport me shoqërinë dhe sistemin ekonomik global. Në këtë kuptim, zhvillimi i qëndrueshëm nuk është trajtuar si një koncept normativ abstrakt, por si një kornizë referimi që strukturon mënyrën e vlerësimit të performancës së korporatave. Integrimi i dimensioneve ekonomike, sociale dhe mjedisore krijon një logjikë analitike që tejkalon matjen lineare të rezultateve financiare dhe kërkon vlerësim të ndikimit afatgjatë, të shpërndarë në nivele të ndryshme të ndërveprimit institucional dhe shoqëror. Kjo qasje kërkon kalimin nga një model raportimi formal drejt një modeli të integruar të qeverisjes ku qëndrueshmëria përfshihet në proceset vendimarrëse dhe në kulturën organizative.

Për të shmangur një trajtim të fragmentuar të përgjegjësisë sociale, kapitulli i parë mundësoi strukturimin e një qasje të operacionalizuar përmes sistemit të indikatorëve të vlerësimit të angazhimit të korporatave. Këta indikatorë nuk janë konceptuar si elementë të izoluar matjeje, por si komponentë të një arkitekture analitike të ndërlidhur, ku secili dimension kontribuon në kuptimin e përgjithshëm të qëndrueshmërisë organizative. Në këtë mënyrë, studimi kalon nga niveli deklarativ i përgjegjësisë sociale në një nivel të matshëm dhe të krahasueshëm analize, duke mundësuar identifikimin e shkallës së integritetit të parimeve të qëndrueshmërisë në praktikën e korporatave.

Një nga përfundimet kryesore që del nga analiza teorike është se efektiviteti i indikatorëve kushtëzohet nga koherenca ndërmjet orientimit strategjik të korporatës, strukturave të saj të qeverisjes dhe praktikave konkrete të zbatimit. Mospërputhja midis deklarimeve publike dhe veprimeve reale krijon rrezikun e formalizmit dhe të përdorimit të përgjegjësisë sociale si instrument reputacioni, duke dobësuar legjitimitetin institucional të korporatës. Për këtë arsye, indikatorët duhet të kuptohen jo vetëm si mjete teknike matjeje, por si mekanizma që evidentojnë integrimin real të qëndrueshmërisë në modelin e biznesit.

Gjithashtu, kjo analizë teorike evidentoi qartë tensionin mes nevojës për standardizim dhe kërkesës për kontekstualizim. Standardet ndërkombëtare dhe praktikat e

harmonizuar të raportimit mundësojnë krahasueshmëri dhe transparencë, por zbatimi i tyre kërkon përshtatje me realitetet institucionale, ekonomike dhe kulturore ku operojnë korporatat. Kjo sfidë metodologjike thekson rëndësinë e ndërtimit të një modeli fleksibël analitik, i cili ruan rigorozitetin shkencor pa neglizhuar specifikat kontekstuale.

Një tjetër element që rezulton qartë nga literatura shkencore është roli i transparencës dhe llogaridhënies si parakushte për funksionimin efektiv të sistemit të indikatorëve. Matja e angazhimit të korporatave humbet kuptimin në mungesë të informacionit të aksesueshëm, të verifikueshëm dhe të kuptueshëm për palët e interesit. Prandaj, indikatorët nuk janë të shkëputur nga struktura e qeverisjes, por pjesë integrale e saj, duke ndikuar në ndërtimin e besueshmërisë dhe në konsolidimin e marrëdhënieve me aktorët institucionalë dhe shoqërorë.

Në nivel konceptual, kapitulli i dytë konfirmon se përgjegjësia sociale dhe zhvillimi i qëndrueshëm përbëjnë një sistem të ndërlidhur ku dimensionet ekonomike, sociale dhe mjedisore nuk funksionojnë në mënyrë të pavarur, por ndikojnë reciprokisht njëra-tjetrën. Kjo ndërvarësi kërkon një qasje integruese në analizë dhe shmang reduktimin e angazhimit të korporatave në tregues të veçuar ose në interpretime të njëanshme. Për rrjedhojë, modeli i ndërtuar në këtë kapitull synon të vendos qartazi në pah kompleksitetin e këtij ndërveprimi dhe të ofrojë një instrument analitik të qëndrueshëm për fazën empirike të studimit. Si rezultat i këtij eksplorimi teorik është ndërtuar një kornizë analitike e strukturuar që do të shërbejë si bazë për operacionalizimin e variablave dhe për analizën e të dhënave në kapitujt vijues. Indikatorët e përzgjedhur do të përdoren si instrumente për matjen dhe krahasimin e nivelit të angazhimit të korporatave, duke mundësuar testimin e hipotezave dhe vlerësimin e marrëdhënieve ndërmjet dimensioneve të ndryshme të qëndrueshmërisë.

Në këtë mënyrë, kapitulli i dytë nuk përfaqëson një përmbledhje të thjeshtë të literaturës shkencore ekzistuese, por një strukturë konceptuale që strukturon të gjithë logjikën e studimit. Ai vendos themelet teorike dhe metodologjike mbi të cilat mbështetet analiza empirike, duke përcaktuar qartë parametrat e vlerësimit, marrëdhëniet ndërmjet dimensioneve të qëndrueshmërisë dhe kornizën brenda së cilës do të interpretohen rezultatet. Në këtë funksion, kapitulli i dytë shërben si urë lidhëse ndërmjet debatit teorik dhe verifikimit empirik, duke garantuar koherencë, rigorozitet shkencor dhe integritet analitik në vijimësinë e studimit.

Së fundmi, bazuar në analizën dhe konkluzionet e nxjerra, vlerësohet e nevojshme që të ofrohet nëpërmjet një tablele edhe një përmbledhje e indikatorëve kryesorë të angazhimit të korporatave, të cilët operacionalizojnë konceptet e përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Tabela e mëposhtme sintetizon këta indikatorë sipas dimensioneve të tyre – ekonomik, social dhe mjedisor – duke shërbyer si një pikë reference analitike për fazën empirike të studimit. Kjo përmbledhje jo vetëm që strukturon informacionin e prezantuar, por gjithashtu lidh kuadrin konceptual me instrumentet konkrete të matjes dhe krahasimit që do të përdoren në kapitujt vijues. Sikurse tregohet në Tabelën X “Matrica e Indikatorëve dhe Nën-Indikatorëve në Kornizën Teorike të

Angazhimit të Korporatave”, çdo indikator është i lidhur me dimensionin përkatës të qëndrueshmërisë.

Tabela X “Matrica e Indikatorëve dhe Nën-Indikatorëve në Kornizën Teorike të Angazhimit të Korporatave

Indikator Kryesor	Nën-Indikator	Përshkrimi/Fokusi
Praktikat e Zhvillimit të Qëndrueshëm	Efikasiteti i burimeve dhe ekonomia qarkulluese	Optimizimi i burimeve, riciklimi, reduktimi i mbetjeve, dizajni i produktit për qëndrueshmëri
	Financat e gjelbra dhe përgjegjësia sociale	Integrimi i kriterëve “Mjedis, Shoqëri dhe Qeverisje” në vendimet financiare, emetimi i bonove të gjelbra, orientimi i fondeve për projekte të qëndrueshme
	Investimet me ndikim social	Investime që krijojnë përfitime sociale dhe financiare, mbështetje për arsim, shëndetësi, zhvillim komunitar
	Qytetaria ekonomike globale	Përgjegjësia e korporatave ndaj ndikimeve globale, tregtia e ndershme, burimet e përgjegjshme, sfidat globale; strategjia diferencuese e qëndrueshmërisë
	Strategjitë për qëndrueshmëri dhe rezistenca e korporatave	Strategjitë e integruara për menaxhimin e rreziqeve mjedisore, sociale dhe ekonomike; modelet fleksibël të biznesit
	Angazhimi i palëve të interesuara	Përfshirja e komunitetit dhe palëve të interesuara në vendimmarrje, dialog i strukturuar, transparencë dhe llogaridhënie
Reduktimi i Karbonit		Masat dhe strategjitë për reduktimin e emetimeve të gazrave serrë, monitorimi i gjurmës karbonike, përmirësimi i performancës mjedisore
Menaxhimi i Zinxhirit të Furnizimit		Integrimi i praktikave të qëndrueshme në zinxhirin e furnizimit, kontrolli i burimeve, etikë dhe përputhshmëri me standardet mjedisore dhe sociale
Gjithëpërfshirja		Integrimi i barazisë gjinore, përfshirja e grupeve të marginalizuara dhe pjesëmarrja e palëve të interesuara në vendimmarrje
Angazhimi në Komunitet		Pjesëmarrja aktive e komunitetit në vendimmarrje; projekte që kontribuojnë në zhvillimin social dhe ekonomik lokal; dialog i strukturuar dhe gjithëpërfshirës me palët e interesuara
Angazhimi me Palët e Interesuara		Nivel i përfshirjes së palëve të interesuara në vendimmarrje; përdorimi i dialogut të strukturuar, konsultimeve periodike dhe mekanizmave pjesëmarrës për të siguruar vendimmarrje gjithëpërfshirëse dhe të përgjegjshme

Investimet Sociale		Përdorimi i kapitalit të korporatave për të kontribuar në zhvillimin e komuniteteve dhe adresimin e nevojave sociale; përfshin projekte komunitare, mbështetje për sipërmarrjen sociale, arsim, shëndetësi dhe zhvillimin e aftësive njerëzore
Pajtueshmëria me të Drejtat e Njeriut		Integrimi i parimeve të të drejtave të njeriut në strategjitë dhe operacionet e korporatave; respektimi i standardeve ndërkombëtare mbi të drejtat e punonjësve dhe komunitetit; adresimi i diskriminimit dhe mbrojtja e grupeve të marginalizuara
Transparenca dhe Raportimi		Publikimi i informacionit mbi aktivitetet, ndikimet dhe performancën e korporatave; siguri i llogaridhënies; përdorimi i standardeve ndërkombëtare për raportim “Mjedis, Shoqëri dhe Qeverisje” dhe qëndrueshmërinë

Në përfundim, Tabela X “Matrica e Indikatorëve dhe Nën-Indikatorëve në Kornizën Teorike të Angazhimit të Korporatave” përbën themelin konceptual mbi të cilin ndërtohet analiza teorike e kapitullit të dytë, ku trajtohen në mënyrë të thelluar indikatorët e dimensioneve ekonomike dhe roli i tyre në vlerësimin e marrëdhënies midis përgjegjësisë sociale të korporatës dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

KAPITULLI III

INDIKATORËT E DIMENSIONEVE EKONOMIKE PËR VLERËSIMIN E LIDHJES MIDIS PËRGJEGJËSISË SOCIALE DHE ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM TË SIPËRMARRJES: NJË ANALIZË TEORIKE

1. Hyrje

Në dinamikën e angazhimit të sipërmarrjeve me shoqërinë, kuptimi gjithëpërfshirës i indikatorëve është thelbësor për të vlerësuar ndikimin e tyre ekonomik dhe shoqëror. Kapitulli i tretë synon të ofrojë një analizë teorike të indikatorëve që fokusohen në dimensionet ekonomike, me qëllim vlerësimin e lidhjes midis përgjegjësisë sociale të korporatës dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Kjo analizë e indikatorëve të dimensioneve ekonomike buron nga një shqyrtim sistematik i literaturës shkencore mbi përgjegjësinë sociale të sipërmarrjeve dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Ajo sintetizon kontributet e autorëve kyç, si Carroll për piramidën e përgjegjësisë sociale (Carroll, 1999), Eccles për performancën ekonomike dhe sociale (Eccles et al., 2014), si dhe Schaltegger për ndërveprimin midis kontabilitetit për qëndrueshmëri dhe ndikimit shoqëror (Schaltegger et al., 2017). Analiza funksionon si një kornizë konceptuale, duke evidentuar mënyrat se si aktivitetet ekonomike të sipërmarrjeve lidhen me rezultatet shoqërore dhe shërben si bazë për shqyrtimin e mëtejshëm të indikatorëve që vlerësojnë lidhjen midis përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Duke u mbështetur në këtë kornizë konceptuale, e ndërtuar në literaturën shkencore ekzistuese, vlerësohet e nevojshme që të shqyrtohet se si aktivitetet konkrete të sipërmarrjeve ndikojnë në marrëdhëniet me aktorë të ndryshëm shoqërorë dhe në arritjen e qëndrueshmërisë sociale dhe ekonomike, konsideruar se korporatat luajnë një rol të rëndësishëm brenda ekosistemeve shoqërore, ku aktivitetet e tyre shtrihen përtej transaksioneve financiare. Ndërveprimet me aktorë të ndryshëm, si punonjës, klientë, komunitete dhe publikun më të gjerë janë komplekse dhe ndikojnë në rezultatet sociale dhe ekonomike. Pra, kapitulli i tretë analizon indikatorët që evidentojnë mënyrat se si aktivitetet ekonomike të sipërmarrjeve kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe lidhjen e tyre me përgjegjësinë sociale.

Ndërsa ndikimi i sipërmarrjeve në shoqëri është i gjerë, kapitulli i tretë ruan fokus të qartë në pasojat ekonomike. Aktivitetet e korporatave, nga prodhimi dhe punësimi deri te vendimet e zinxhirit të furnizimit, ndikojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe të tërthortë në strukturat ekonomike. Duke shqyrtuar indikatorët që lidhen me këto aktivitete, analizohen mënyrat se si konsideratat ekonomike ndërthuren me ndikimin shoqëror, duke ofruar një perspektivë të plotë mbi rolin e suksesit ekonomik në arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm. Duke u mbështetur në analizën e ndërveprimit midis aktiviteteve

ekonomike të korporatave dhe ndikimit të tyre shoqëror, indikatorët e shqyrtuar në këtë kapitull shërbejnë si instrumentë matës për të eksploruar marrëdhëniet komplekse midis aktiviteteve të korporatave dhe rezultateve shoqërore. Ata përfshijnë dimensione të ndryshme, duke nisur nga menaxhimi i përgjegjshëm i zinxhirit të furnizimit dhe praktikat e investimeve të qëndrueshme, deri te ndikimi në komunitet dhe trajtimi i sfidave globale. Qëllimi kryesor është të ofrojë njohuri të mbështetura në literaturë që mund të udhëheqin praktika më të përgjegjshme, më të qëndrueshme dhe me ndikim ekonomik në nivelin e korporatave.

2. Indikator i Rritjes së të Ardhurave

Indikator i rritjes së të ardhurave shërben si një tregues i zhvillimit financiar që synon të përcaktojë sasinë e rritjes së të ardhurave të një korporate nga zbatimi i praktikave të qëndrueshme në një kontekst global që evoluon me shpejtësi. Në një epokë ku biznesi global po kalon drejt një paradigme të orientuar nga ndërgjegjësimi mjedisor, ky indikator është themelor, pasi evidenton ndikimet financiare të angazhimit të një korporate ndaj strategjive të qëndrueshme dhe miqësore me mjedisin.

Në një kontekst ku qëndrueshmëria mjedisore po bëhet gjithnjë e më shumë sinonim i përgjegjësisë së korporatës, indikator i rritjes së të ardhurave përmes praktikave të qëndrueshme shërben si një instrument gjithëpërfshirës për të evidentuar mënyrën se si korporatat pozicionohen strategjikisht brenda tregjeve të ekonomisë së gjelbër. Studiuesi Zhyvko shqyrtoi konceptin e përgjegjësisë sociale të korporatave përmes lentes së ekonomisë së gjelbër, duke theksuar nevojën për të integruar praktika të qëndrueshme mjedisore të qëndrueshme në strategjitë e korporatave (Zhyvko, 2024). Studimi analizon modelet e përgjegjësisë sociale të korporatave që fokusohen në reduktimin e ndikimit mjedisor dhe promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe mënyrat se si korporatat mund të përdorin burimet e tyre për të gjeneruar ndikim pozitiv në mjedis dhe shoqëri. Gjithashtu, studimi evidenton edhe qasjet inovative për menaxhimin e mbetjeve, përdorimi i energjisë alternative, teknologjitë e gjelbra, si dhe shembujt e kompanive udhëheqëse që i implementojnë me efikasitet këto strategji. Një fokus i veçantë i është dhënë edhe rëndësisë së transparencës së korporatës, etikës dhe përfshirjes së palëve të treta në krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm. Qëllimi është vlerësimi i rasteve të bizneseve të mëdha ndërkombëtare që integrojnë përgjegjësinë sociale në modelet e tyre të biznesit brenda ekonomisë së gjelbër. Gjithashtu, studimi shqyrton edhe strategjitë si dhe qasjet për menaxhimin e mbetjeve, përdorimin e burimeve të rinovueshme dhe iniciativat për ruajtjen e biodiversitetit. Metodologjia e përdorur kombinon një qasje ndërdisiplinore që përfshin elemente të ekologjisë, ekonomisë dhe sociologjisë, me qëllim të analizës së ndikimit të përgjegjësisë sociale të korporatave në zhvillimin e qëndrueshëm dhe ekonominë e gjelbër. Rezultatet tregojnë se kompanitë që e zbatojnë aktivisht përgjegjësinë sociale në strategjitë e tyre zakonisht arrijnë performancë më të lartë, përfshirë uljen e emetimeve të dioksidit të karbonit, optimizimin e përdorimit të burimeve dhe rritjen e riciklimit. Shembujt nga industri të ndryshme tregojnë se integrimi i

teknologjive dhe proceseve të gjelbra gjithashtu mund të përmirësojë konkurrueshmërinë e kompanive.

Përsa analizuar më sipër konfirmohet se indikator i rritjes së të ardhurave analizon të ardhurat e gjeneruara nga prezantimi i produkteve dhe shërbimeve të qëndrueshme, duke evidentuar qëndrueshmërinë financiare të iniciativave të biznesit miqësore ndaj mjedisit. Përtej zgjerimit në tregjet e gjelbra, ai vlerëson aftësinë e korporatës për të tërhequr konsumatorë të ndërgjegjshëm për çështjet mjedisore. Ndërsa, konsumatorët bëhen më kërkuar dhe orientohen drejt produkteve e shërbimeve në përputhje me vlerat e tyre, korporatat që integrojnë qëndrueshmërinë në strategjitë e tyre mund të përjetojnë rritje të të ardhurave (Arora & Mishra, 2023). Në këtë kuadër, indikator i rritjes së të ardhurave vlerëson lidhjen midis praktikave të qëndrueshme të korporatës dhe reagimit të tregut, duke evidentuar përfitimet ekonomike të përgjegjësisë mjedisore.

Duke analizuar rritjen e të ardhurave si rezultat i drejtpërdrejtë i praktikave të qëndrueshme, studimi i Atz në përputhje me gjetjet e mëparshme të Shrivastava, thekson se ky indikator pasqyron ndikimin pozitiv të iniciativave të korporatave si në performancën financiare ashtu edhe në mjedisin ekologjik (Atz et al., 2020; Shrivastava, 2018). Përmes zhvillimit të inovacioneve miqësore me mjedisin, proceseve me efikasitet energjetik dhe përdorimit të burimeve të përgjegjshme, rritja e të ardhurave reflekton përfitimet financiare që burojnë nga operacionet e orientuara drejt qëndrueshmërisë (Zheng & Tu, 2024).

Në përfundim, konkludohet se indikator i rritjes së të ardhurave përmes praktikave të qëndrueshme përfaqëson një instrument të rëndësishëm për korporatat që synojnë të harmonizojnë performancën ekonomike me përgjegjësinë mjedisore. Ai ofron një pasqyrë të arritjeve financiare, sikurse evidenton rolin integruar të praktikave të qëndrueshme në nxitjen e rritjes ekonomike afatgjatë. Në këtë kuptim, rritja e të ardhurave shndërrohet në një tregues të aftësisë së korporatës për të arritur njëkohësisht prosperitet ekonomik dhe kujdes mjedisor.

Më poshtë, Tabela XI “Indikator i Rritjes së të Ardhurave” paraqet në mënyrë sintetike komponentët matës të indikatorit të rritjes së të ardhurave nga praktikat e qëndrueshme, duke evidentuar lidhjen midis performancës financiare dhe angazhimit mjedisor të korporatës. Ajo përmbledh treguesit kryesorë që matin kontributin e produkteve dhe inovacioneve të gjelbra në rritjen ekonomike, konkurrueshmërinë dhe pozicionimin strategjik në tregjet e qëndrueshme.

Tabela XI: “Indikatori i Rritjes së të Ardhurave”

Komponenti Matës	Përshkrimi	Treguesi Kryesor Matës
Rritja e të ardhurave nga produktet e qëndrueshme	Të ardhurat e gjeneruara nga produkte/shërbime “të gjelbra”	% e rritjes vjetore të të ardhurave të gjelbra
Pesha e të ardhurave të gjelbra	Kontributi i produkteve të qëndrueshme në totalin e të ardhurave	% ndaj të ardhurave totale
Zgjerimi në tregjet e gjelbra	Depërtimi në segmente të reja të qëndrueshme	Nr. tregjeve/segmenteve të reja
Investimet në inovacion të gjelbër	Shpenzimet për teknologji dhe procese të qëndrueshme	% e buxhetit për kërkim & zhvillim të gjelbër
Efikasiteti operacional	Ulja e kostove përmes praktikave të qëndrueshme	% ulje kostosh/kursime energjie
Reagimi i tregut	Tërheqja e konsumatorëve të ndërgjegjshëm	Rritja e kërkesës/pjesës së tregut

3. Indikatori i Kursimeve në Kosto

Indikatori i kursimeve në kosto është një instrument i krijuar për të vlerësuar reduktimet e prekshme të kostove operative që i atribuohen iniciativave të qëndrueshmërisë së një korporate (Epstein & Roy, 2001). Ky indikator përdor metrika sasiore për të matur ndikimin financiar të këtyre iniciativave, duke analizuar të dhënat mbi konsumin e energjisë, shpenzimet e menaxhimit të mbetjeve dhe aspekte të tjera të rëndësishme operationale, çka përfshin një ekzaminim të përpiktë të pasqyrave financiare, raporteve operationale dhe treguesve të tjerë kyç të performancës për të përcaktuar kursimet aktuale të kostos së arritur (Roca & Searcy, 2012).

Ky indikator shërben si një matës i drejtpërdrejtë i efikasitetit financiar që derivon nga integrimi i praktikave të qëndrueshme, duke dëshmuar se përgjegjësia mjedisore dhe sociale mund të përkthehet në avantazhe të matshme ekonomike. Një aspekt i rëndësishëm i këtij indikatori lidhet me zbatimin e teknologjive me efikasitet energjetik në operationet e korporatës. Miratimi i burimeve të rinovueshme të energjisë, përdorimi i pajisjeve me konsum të reduktuar dhe implementimi i teknologjive që optimizojnë përdorimin e burimeve ndikojnë drejtpërdrejt në uljen e kostove operative. Në këtë kuptim, indikatori përcakton sasinë e kursimeve të realizuara përmes integritit strategjik të praktikave të qëndrueshme energjetike. Në këtë linjë, studimi i Schaltegger dhe Wagner e pozicionon sipërmarrjen e qëndrueshme në ndërthurje me inovacionin për qëndrueshmëri (Schaltegger & Wagner, 2011). Kuadri i tyre konceptual zhvillon një tipologji të sipërmarrjes së qëndrueshme, duke përfshirë dimensionin social dhe institucional dhe e lidh atë me inovacionin që synon transformimin e tregut. Metodologjikisht, autorët propozojnë një qasje për vlerësimin cilësor të pozicionit të korporatës në një matricë klasifikimi bazuar në orientimin e saj ndaj çështjeve mjedisore dhe sociale si dhe në ndikimin e saj në treg. Kjo qasje ndihmon në identifikimin e kushteve nën të cilat

inovacioni për qëndrueshmëri gjeneron jo vetëm vlerë sociale, por edhe përfitime ekonomike të qëndrueshme.

Një dimension tjetër kritik i indikatorit të kursimeve në kosto lidhet me ndikimin e programeve të reduktimit të mbetjeve në shpenzimet operationale (Warshawsky, 2016). Strategjitë gjithëpërfshirëse të menaxhimit të mbetjeve – të bazuara në riciklim, ripërdorim dhe në parimet e ekonomisë qarkulluese – mund të reduktojnë ndjeshëm kostot që lidhen me trajtimin dhe asgjësimin e tyre. Në këtë mënyrë, përmirësimi i performancës mjedisore shoqërohet me racionalizim të shpenzimeve operative.

Përtej dimensionit financiar, indikator i kursimeve në kosto shërben edhe si demonstrim i përgjegjësisë së korporatave. Ai dëshmon se iniciativat e qëndrueshmërisë, të orientuara nga kujdesi ndaj mjedisit dhe shoqërisë, mund të harmonizohen me menaxhimin racional të burimeve financiare (Velea & Ellenbecker, 2001). Në këtë këndvështrim, indikator i kursimeve në kosto përmes iniciativave të qëndrueshmërisë pasqyron një marrëdhënie të ndërvarur midis performancës financiare të korporatës dhe përgjegjësisë së saj mjedisore. Ai i pozicionon masat e reduktimit të kostove si një instrument strategjik për bizneset që synojnë njëkohësisht përmirësimin e performancës financiare dhe kontributin aktiv në objektivat globale të qëndrueshmërisë.

Më poshtë, Tabela XII “Indikator i Kursimeve në Kosto”, e cila paraqet në mënyrë të përmblëdhur komponentët matës të indikatorit të kursimeve në kosto, duke evidentuar burimet kryesore të reduktimit të shpenzimeve përmes praktikave të qëndrueshme. Kjo tabelë pasqyron lidhjen e drejtpërdrejtë midis efikasitetit operacional, inovacionit mjedisor dhe përmirësimit të performancës financiare të korporatës.

Tabela XII: “Indikator i Kursimeve në Kosto”

Komponenti Matës	Përshkrimi	Treguesi Kryesor Matës
Kursimet nga efikasiteti energjetik	Ulja e kostove përmes reduktimit të konsumit të energjisë	% e uljes së kostove të energjisë
Përdorimi i burimeve të rinovueshme	Zëvendësimi i burimeve tradicionale me energji të gjelbër	% e energjisë nga burime të rinovueshme
Reduktimi i mbetjeve	Ulja e kostove nga riciklimi dhe ekonomia qarkulluese	% e uljes së kostove të menaxhimit të mbetjeve
Optimizimi i burimeve	Përmirësimi i përdorimit të lëndëve të para dhe ujit	% e reduktimit të konsumit të burimeve
Inovacioni për qëndrueshmëri	Zbatimi i teknologjive me kosto-efektivitet	Vlera e kursimeve nga teknologjitë e reja
Analiza financiare e kursimeve	Matja e kursimeve përmes pasqyrave financiare dhe Treguesi Kyç i Performancës	Vlera totale e kursimeve vjetore

4. Indikator i Zgjerimit të Tregut

Indikator i zgjerimit të tregut është një metrikë thelbësore që synon të vlerësojë shkallën në të cilën shtrirja e tregut të një korporate është zgjeruar përmes ofrimit të produkteve ose shërbimeve të qëndrueshme (Schaltegger et al. 2016). Ky tregues evidenton se praktikatat e qëndrueshme të biznesit jo vetëm që kontribuojnë në objektivat

mjedisore dhe sociale, por gjithashtu luajnë një rol kryesor në kapjen e segmenteve të reja të tregut dhe tërheqjen e konsumatorëve të ndërgjegjshëm.

Në një mjedis biznesi dinamik dhe në zhvillim, zgjerimi i tregut është një imperativ strategjik për korporatat që kërkojnë rritje dhe pozicionim të qëndrueshëm konkurrues (Attah et al. 2024). Megjithatë, fokusi në qëndrueshmëri si një nxitës për zgjerimin e tregut përfaqëson një qasje më komplekse dhe strategjike të ndërthurur. Kjo përfshin ofrimin e produkteve ose shërbimeve që përputhen me qëllimet e qëndrueshmërisë dhe në përshtatje me një bazë konsumatore gjithnjë e më të ndërgjegjshme për mjedisin. Prandaj, zgjerimi i qëndrueshëm i tregut tejkalon matjet konvencionale të rritjes, duke përfshirë një angazhim ndaj praktikave të përgjegjshme.

Studiuesi Brondon në studimin e tij e trajtoi si në një fazë të katërt globalizimin që prodhoi një ndryshim strukturor në konkurrencën e rrjeteve (Brondon, 2014). Si rezultat, korporatat rezultojnë të jenë ekspozuar ndaj forcave sociale - mjedisore në një shkallë të gjerë, duke u përballur me motorët e rinj të kapitalizmit global që lidhen veçanërisht me: (i) Shëndetin; (ii) Energjinë; (iii) Ushqimin; (iv) Komunikimin. Kjo qasje kërkon një kod modern të përgjegjësisë sociale të sipërmarrjeve që tregon qartë përgjegjësinë globale të kompanisë në kuadrin e përgjithshëm të rritjes së qëndrueshme.

Një aspekt i këtij treguesi lidhet me identifikimin dhe depërtimin në segmente të reja të klientëve. Korporatat që zgjerojnë me sukses praninë e tyre në treg përmes iniciativave të qëndrueshmërisë synojnë grupe specifike demografike dhe zhvillojnë produkte apo shërbime me karakteristika të theksuara mjedisore dhe sociale. Duke ofruar alternativa të qëndrueshme, bizneset adresojnë një segment në rritje të konsumatorëve që kërkojnë zgjedhje etike dhe të ndërgjegjshme ndaj mjedisit. Kjo nënkupton përshtatjen e strategjive të marketingut, dizajnit të produktit dhe komunikimit të korporatave në përputhje me vlerat dhe pritshmëritë e këtyre segmenteve.

Në këtë drejtim, studiuesi White argumenton se ndryshimi i sjelljes së konsumatorit drejt modeleve më të qëndrueshme kërkon strategji të strukturuar që integrojnë faktorë socialë, psikologjikë dhe kontekstualë (White et al., 2019). Korniza e tyre thekson rëndësinë e orientimit drejt motivimeve të konsumatorit, normave sociale dhe perceptimit të ndikimit individual në mjedis. Kjo qasje e zhvendos fokusin nga produkti si atribut “i gjelbër” drejt ndërtimit të një marrëdhënie vlerash midis markës dhe konsumatorit, duke e bërë qëndrueshmërinë një element të integruar të strategjisë së tregut dhe jo thjesht një instrument reputacioni. Për të materializuar këtë qasje përdoren tregues konkretë që vlerësojnë përfshirjen e ofertave të qëndrueshme brenda portofolit të produkteve ose shërbimeve të korporatës. Kjo shtrihet përtej gjesteve simbolike, duke kërkuar një integrim të vërtetë të praktikave të qëndrueshme në modelin kryesor të biznesit. Nëpërmjet proceseve të prodhimit miqësor ndaj mjedisit, materialeve me burim etik ose teknologjive inovative të gjelbra, korporatat shfaqin një përkushtim ndaj qëndrueshmërisë që përshtatet me konsumatorët që kërkojnë zgjedhje të përgjegjshme (Tseng et al., 2021). Pasi këto oferta të qëndrueshme të jenë integruar në portofolin e produkteve dhe strategjinë e korporatës, hapi i mëtejshëm është matja e ndikimit të tyre në treg. Ndërsa, matja e suksesit të zgjerimit të tregut përmes ofertave të qëndrueshme përfshin analizën

sasiore të rritjes së pjesës së tregut, blerjen e klientëve në segmente të reja dhe të ardhurat e krijuara nga produktet ose shërbimet e qëndrueshme (Székely & Knirsch, 2005). Kjo qasje e drejtuar nga të dhënat ofron një pamje gjithëpërfshirëse se si iniciativat e qëndrueshmërisë përkthehen në zgjerim të prekshëm të tregut. Për më tepër, vlerësimet cilësore, duke përfshirë sondazhet e konsumatorëve dhe reagimet, ofrojnë njohuri mbi perceptimin dhe pranimin e ofertave të qëndrueshme të korporatës në treg.

Përtej matjeve sasiore, indikator i zgjerimit të tregut reflekton edhe pozicionimin strategjik dhe imazhin e markës së kultivuar përmes praktikave të qëndrueshme të tregut (Baumgartner & Ebner, 2010). Korporatat e sukseshme në këtë fushë jo vetëm që kapin tregje të reja, por gjithashtu vendosen si lider në qëndrueshmëri. Kjo arritje e dyfishtë kontribuon jo vetëm në suksesin financiar, por edhe në qëndrueshmërinë dhe rëndësinë afatgjatë të korporatës në një treg gjithnjë e më shumë të orientuar nga konsideratat mjedisore dhe sociale (Dhanda & Shrotryia, 2021).

Në përfundim, indikator i zgjerimit të tregut përmes ofertave të qëndrueshme thekson potencialin transformues të qëndrueshmërisë në rindërtimin e dinamikës së tregut. Ai pozicionon zgjerimin e tregut jo vetëm si një metrikë sasiore, por si një imperativ strategjik në përputhje me vlerat e një baze konsumatore të ndërgjegjshme për mjedisin dhe me përgjegjësi shoqërore.

Më poshtë, Tabela XIII “Indikatori i Zgjerimit të Tregut” paraqet në mënyrë të strukturuar komponentët matës të indikatorit të kursimeve në kosto, duke evidentuar burimet kryesore të reduktimit të shpenzimeve përmes praktikave të qëndrueshme. Ajo thekson se efikasiteti energjetik, menaxhimi i mbetjeve, optimizimi i burimeve dhe inovacioni teknologjik përkthehen në përfitime të matshme financiare, duke dëshmuar ndërvlerësinë midis performancës ekonomike dhe përgjegjësisë mjedisore të korporatës.

Tabela XIII: “Indikatori i Zgjerimit të Tregut”

Komponenti Matës	Përshkrimi	Treguesi Kryesor Matës
Rritja e pjesës së tregut	Zgjerimi i pranisë në treg përmes produkteve të qëndrueshme	% e rritjes së pjesës së tregut
Depërtimi në segmente të reja	Hyrja në grupe të reja klientësh të ndërgjegjshëm	Nr. segmenteve të reja / % e klientëve të rinj
Të ardhurat nga ofertat e qëndrueshme	Kontributi financiar i produkteve/shërbimeve të gjelbra	% e të ardhurave nga oferta të qëndrueshme
Diversifikimi i portofolit	Integrimi i produkteve të qëndrueshme në linjat ekzistuese	% e produkteve të qëndrueshme në portofol
Pozicionimi i markës	Perceptimi i kompanisë si lider në qëndrueshmëri	Rezultate sondazhesh / indeksi i reputacionit
Angazhimi i konsumatorëve	Pranimi dhe reagimi ndaj ofertave të qëndrueshme	Norma e besnikërisë / niveli i kënaqësisë

5. Indikator i Avantazhit Konkurrues

Indikator i avantazhit konkurrues është krijuar për të vlerësuar nëse një korporatë arrin një pozicion unik dhe të qëndrueshëm në treg përmes praktikave të qëndrueshme. Studiuesi López tregon se përgjegjësia sociale dhe mjedisore kur integrohet strategjikisht mund të kontribuojë në diferencimin e korporatës, rritjen e saj në treg dhe vendosjen e çmimeve premium për produktet ose shërbimet (López et al., 2007). Për ta vlerësuar, autorët krahasojnë performancën e kompanive evropiane që e kishin pranuar përgjegjësinë sociale me ato që nuk e kishin bërë, duke përdorur tregues kontabël dhe të dhëna nga Indeksi i Qëndrueshmërisë Dow Jones dhe Indeksi Global Dow Jones për periudhën 1998-2004. Rezultatet empirike evidentuan dallime të rëndësishme në performancë të lidhura me praktikën e përgjegjësisë sociale, edhe pse u shfaq një ndikim negativ afatshkurtër në performancë.

Sipas studiuesve McWilliams dhe Siegel, qëndrueshmëria mund të shërbejë si një burim fuqie, duke i mundësuar vendosjen e çmimeve premium, rritjen e pjesës së tregut dhe përforcimin e pozicionit konkurrues (McWilliams & Siegel, 2011). Ky kuadër teorik lidh përgjegjësinë sociale të sipërmarrjeve me teorinë e bazuar në burime (RVB) dhe konceptet ekonomike të sigurimit privat të mallrave publike, duke treguar se burimet dhe kapacitetet unike të kompanive mund të përdoren për të krijuar vlera strategjike që i shërbejnë edhe shoqërisë (Barney, 1991; Wernerfelt, 1984). Kjo lidhje e teorisë me praktikën reale tregon se përgjegjësia sociale mund të kontribuojë në krijimin e një avantazhi konkurrues të qëndrueshëm.

Në vijim, studimet mbi marketingun e gjelbër tregojnë një aplikim praktik të këtij avantazhi. Në studimin e Purwanti et al. evidentohet se marketingu i gjelbër mund të forcojë pozicionin konkurrues të një kompanie duke e diferencuar në treg dhe duke nxitur njohjen e vlerës së saj mjedisore (Purwanti et al., 2019). Kjo tregon se implementimi i praktikave të qëndrueshme nuk është vetëm përgjegjësi sociale, por edhe një mënyrë për të ndërtuar avantazh konkurrues.

Fokusi kryesor i indikatorit qëndron në të kuptuarit se si iniciativat e qëndrueshmërisë kontribuojnë në diferencimin strategjik të korporatës (Mitroulis & Kitsios, 2016). Orientimi në treg dhe njohja e nevojave të konsumatorëve lejon kompanitë të zhvillojnë kapacitete dinamike për inovacion dhe të dallohen nga konkurrentët, duke arritur performancë më të mirë organizative dhe duke integruar qëndrueshmërinë në strategjinë e tyre.

Adoptimi i proceseve miqësore me mjedisin, përdorimi i materialeve etike dhe praktikën e ekonomisë qarkulluese pozicionojnë korporatat si liderë në sjelljen e përgjegjshme të biznesit. Fitimi i avantazhit konkurrues përmes qëndrueshmërisë përfshin gjithashtu mundësinë për të vendosur çmime premium për produktet ose shërbimet (MacAskill, 2021), pasi konsumatorët janë të gatshëm të paguajnë më shumë për produkte që përputhen me vlerat e tyre etike dhe mjedisore. Kjo strategji lidhet edhe me tregjet

financiare: fenomeni i “greenium²⁸” në obligacionet e gjelbra tregon se angazhimi ndaj qëndrueshmërisë mund të sjellë avantazh financiar dhe reputacion për kompanitë që emetojnë obligacione të besueshme (Berdiev, 2025; MacAskill, 2021).

Korporatat që diferencohen me sukses përmes praktikave të qëndrueshme mund të tërheqin një bazë më të gjerë klientësh, duke përfshirë konsumatorë të ndërgjegjshëm për mjedisin (Fosu et al. 2024). Vlerësimi i avantazhit konkurrues përmes indikatorit përfshin matje sasiore, si rritja e pjesës së tregut dhe strategjitë e çmimeve dhe matje cilësore, si perceptimi i konsumatorëve dhe besnikëria e markës (Ginsberg & Bloom, 2004). Ky kombinim ofron një pamje gjithëpërfshirëse të përfitimeve që rrjedhin nga praktikatat e qëndrueshme.

Në përfundim, indikatori i avantazhit konkurrues nxjerr në pah potencialin transformues të qëndrueshmërisë në rritjen e pozicionimit konkurrues të një korporate. Duke zbatuar praktikatat e qëndrueshme në mënyrë strategjike, sipërmarrjet jo vetëm që dallohen, por e pozicionojnë qëndrueshmërinë si një nxitës thelbësor të suksesit në treg.

Më poshtë, Tabela XIV “Indikatori i Avantazhit Konkurrues” paraqet indikatorin e avantazhit konkurrues përmes praktikave të qëndrueshme, duke përmbledhur komponentët kryesorë të matjes, përshkrimin e tyre dhe treguesit që përdoren për të vlerësuar ndikimin. Ajo evidenton se si korporatat mund të diferencohen në treg, të rrisin pjesën e tregut dhe të gjenerojnë të ardhura të shtuara, duke përdorur qëndrueshmërinë si një mjet strategjik për të fituar avantazh konkurrues dhe për të përforcuar besnikërinë e klientëve.

Tabela XIV: “Indikatori i Avantazhit Konkurrues”

Komponenti Matës	Përshkrimi	Treguesi Kryesor Matës
Avantazhi konkurrues përmes qëndrueshmërisë	Vlerëson nëse korporata arrin një pozicion unik dhe të qëndrueshëm në treg përmes praktikave të qëndrueshme	Pjesa e tregut, të ardhurat nga produktet/shërbimet e qëndrueshme, perceptimi i konsumatorëve, besnikëria ndaj markës, çmimet premium të vendosura

6. Indikatori i Efikasitetit të Burimeve

Indikatori i efikasitetit të burimeve shërben si një mjet kryesor për të vlerësuar angazhimin e sipërmarrjeve ndaj praktikave të qëndrueshme. Ai mat nëse burimet përdoren në mënyrë efikase, duke reduktuar konsumin dhe humbjet, si dhe përcakton

²⁸ Termi “greenium” i referohet një “premiumi të gjelbër”, pra një diferencë në çmim ose në norma të fitimit midis obligacioneve të gjelbra dhe atyre standarde ku investitorët mund të pranojnë një fitim pak më të ulët për një obligacion të emetuar me qëllime mjedisore në krahasim me një obligacion konvencional me karakteristika të ngjashme. Edhe pse evidenca empirike është e ndarë dhe metodologjitë ndryshojnë, shumë studime tregojnë se një “greenium” është vërejtur në disa tregje kryesore globale, veçanërisht kur obligacionet përmbajnë çertifikime të qarta dhe transparencë të lartë mjedisore - duke kuptuar interes të fortë të investitorëve për instrumente të financuara me qëndrueshmëri

shkallën në të cilën korporatat optimizojnë përdorimin e tyre, duke gjeneruar kursime konkrete të kostove dhe duke minimizuar ndikimin mjedisor.

Studime të shumta kanë propozuar qasje të ndryshme për matjen e efikasitetit të burimeve. Koh et al. (2016) prezantojnë perspektivën e integruar të efikasitetit të burimeve (IREV) dhe indeksin IRE, të cilët vlerësojnë efikasitetin mjedisor, ekonomik dhe social të ekonomive të prodhimit. Indeksi IRE përdor të dhëna multinationale input-output, duke përdorur elementë si indeksi i zhvillimit njerëzor (HDI) dhe të dhënat për rritjen e gjelbër të OECD-së, si dhe përfshin aspekte të efikasitetit të burimeve mjedisore, energjisë dhe produktivitetit të materialeve. Pra, indeksi IRE përdor metodologji gjithëpërfshirëse për vlerësimin e efikasitetit të burimeve dhe qëndrueshmërisë, duke ndikuar në zinxhirët globalë të furnizimit dhe promovuar përparimet në menaxhimin e zinxhirëve të furnizimit të gjelbër. Analizat e regresionit të shumëfishtë në 40 shtete, përfshirë 34 vende anëtare të OECD-së, tregojnë se produktiviteti i materialeve dhe menaxhimi i burimeve ndihmojnë në përmirësimin e efikasitetit të integruar me kalimin e kohës.

Në nivelin e korporatave, studiuesi Bartolacci propozon një indikator të efikasitetit ekonomik për kompanitë që menaxhojnë mbeturinat urbane, duke kombinuar perspektivat ekonomike dhe mjedisore (Bartolacci et al., 2019). Ky indikator ndihmon në identifikimin e kursimeve të mundshme dhe optimizimin e përdorimit të lëndëve të para sekondare. Po kështu, studiuesi Di Maio argumenton se vlerësimi i efikasitetit të burimeve në terma të ekonomisë qarkulluese dhe vlerës së tregut të burimeve të stresuara mund të përmirësojë politikën mjedisore dhe të drejtojë praktikën e sipërmarrjeve në mënyrë efektive (Di Maio et al., 2017).

Përdorimi i efikas i burimeve nuk ka vetëm ndikime mjedisore, por edhe ekonomike. Studiuesi Kalaitzi evidenton se, përmirësimi i efikasitetit të burimeve çon në kursime të kostos për kompanitë, duke ulur shpenzimet për lëndët e para, energjinë dhe trajtimin e mbetjeve (Kalaitzi et al., 2019). Për më tepër, studiuesi Li tregon se integrimi i inovacionit teknologjik dhe operativ, duke përfshirë përdorimin e inteligjencës artificiale dhe praktikave të avancuara të Industrisë 4.0, ndihmon në optimizimin e përdorimit të burimeve dhe në reduktimin e rrezikut operativ (Li et al., 2021).

Meqenëse se, efikasiteti i burimeve lidhet ngushtë me përfitimet mjedisore, Bergmann et al. (2017) vërejnë se reduktimi i konsumit të burimeve dhe minimizimi i mbetjeve ndihmon korporatat të zvogëlojnë gjurmën e tyre mjedisore dhe të kontribuojnë në qëllimet globale për ndryshimet klimatike. Në këtë kontekst, indikatorët e efikasitetit të burimeve mund të përfshijnë matje të konsumit të energjisë për njësi të prodhimit, përdorimin e materialeve dhe reduktimin e mbetjeve.

Përsa analizuar, konkludohet se indikator i efikasitetit të burimeve ofron një kuadër të qartë për vlerësimin e performancës së sipërmarrjeve në përdorimin e burimeve. Ai lidh praktikën e menaxhimit të përgjegjshëm të burimeve me kursime konkrete ekonomike dhe përfitime mjedisore, duke e bërë këtë një komponent thelbësor të strategjisë së qëndrueshmërisë.

Më poshtë, Tabela XV “Indikatori i Efikasitetit të Burimeve”, e cila përmbledh tre komponentët kryesorë të indikatorit të efikasitetit të burimeve, ofron një kuadër të qartë për vlerësimin e performancës së korporatave në menaxhimin e burimeve të tyre. Ajo evidenton përdorimin efikas të energjisë, reduktimin e humbjeve dhe mbetjeve, si dhe optimizimin e inputeve të ndryshme si uji dhe lëndët e para, duke lidhur këto komponentë me tregues konkretë matës që mundësojnë monitorimin dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë ekonomike dhe mjedisore të korporatës.

Tabela XV: “Indikatori i Efikasitetit të Burimeve”

Komponenti Matës	Përshkrimi	Treguesi Kryesor Matës
Efikasiteti i përdorimit të energjisë	Mat se sa energji përdoret për njësi të prodhimit dhe sa reduktohet konsumi i panevojshëm	Konsumi i energjisë për njësi prodhimi; % e reduktimit të energjisë
Reduktimi i humbjeve dhe mbetjeve	Mat efektivitetin e kompanisë në minimizimin e humbjeve të lëndëve të para dhe gjenerimin e mbetjeve	% e uljes së mbetjeve; masa e materialeve të ricikluara
Përdorimi optimal i burimeve	Vlerëson nëse inputet si uji, lëndët e para dhe materialet përdoren në mënyrë optimale për të maksimizuar vlerën dhe kursimet	Përqindja e përdorimit efektiv të burimeve; kursimet e kostos

7. Indikator i Inovacionit

Në kontekstin e zhvillimit të qëndrueshmërisë së sipërmarrjeve, indikator i inovacionit vlerëson potencialin transformues të përpjekjeve për qëndrueshmëri. Ai shqyrton nëse një korporatë ka arritur të kultivojë inovacionin përmes zhvillimit të produkteve, shërbimeve ose teknologjive të reja, duke përdorur qëndrueshmërinë si katalizator për kreativitet dhe rritje ekonomike, pa kompromentuar kujdesin mjedisor.

Studimet e fundit, përfshirë de Oliveira et al. (2024), tregojnë se kërkimet mbi inovacionin e lidhur me qëndrueshmërinë kanë evoluuar ndjeshëm gjatë dekadës së fundit. Analizat sistematike të literaturës tregojnë një rritje të publikimeve mbi qasjet dhe metodologjitë e reja për zbatimin e qëndrueshmërisë, si dhe theksojnë barrierat e perceptuara nga menaxherët e lartë, që shpesh fokusohen më shumë në aspektin ekonomik sesa në atë mjedisor dhe social. Teknologjitë e reja, si 5G dhe Industria 4.0, si dhe ngjarjet globale si COVID-19, janë identifikuar si faktorë që ndikojnë në inovacionin e korporatave të orientuar nga qëndrueshmëria.

Indikatori, gjithashtu, përqendrohet në ndikimin e inovacionit mbi investimet dhe krijimin e vlerës për korporatat. Studime si Kim & Lee (2023) dhe Onea (2020) tregojnë se investimet në inovacion të korporatave janë të lidhura pozitivisht me rritjen ekonomike dhe ndikimin në punësim, duke evidentuar se inovacioni dhe qëndrueshmëria mund të shkojnë paralelisht për të krijuar avantazh konkurrues. Për më tepër, indikator merr parasysh rolin e kornizave institucionale, përsa trajtuar nga Akbar et al. (2024), të cilat nxisin inovacionin në vendet në zhvillim. Forcimi i institucioneve ligjore, financiare dhe

politike kontribuon në suksesin e iniciativave inovative dhe integrimin e qëndrueshmërisë në strategjitë e korporatave.

Në përfundim, indikatori i inovacionit për qëndrueshmëri nxjerr në pah se korporatat mund të përdorin qëndrueshmërinë si një motor për krijimin e ideve dhe produkteve të reja. Ai demonstroi se inovacioni i lidhur me qëndrueshmërinë mund të gjenerojë vlerë ekonomike dhe sociale, duke kontribuar në zhvillimin e një biznesi të qëndrueshëm dhe konkurrues.

Më poshtë, Tabela XVI “Indikatori i Inovacionit”, e cila përmbledh në mënyrë të qartë komponentët kryesorë të indikatorit të inovacionit për qëndrueshmëri. Ajo tregon se si korporatat mund të krijojnë vlerë të re përmes zhvillimit të produkteve dhe shërbimeve inovative, përmirësimeve në proceset operative dhe integritit të inovacionit me investime dhe institucione. Treguesit kryesorë matës ofrojnë një pasqyrë të qartë të mënyrës se si inovacioni i orientuar nga qëndrueshmëria kontribuon në performancën ekonomike, mjedisore dhe sociale të sipërmarrjeve

Tabela XVI: “Indikatori i Inovacionit”

Komponenti Matës	Përshkrim	Treguesi Kryesor Matës
Inovacioni i produkteve dhe shërbimeve	Vlerëson nëse korporata ka zhvilluar produkte, shërbime ose teknologji të reja që reflektojnë përpjekjet e qëndrueshmërisë	Numri i produkteve/shërbimeve inovative të prezantuara në treg me komponentë të qëndrueshëm
Inovacioni operativ dhe proceset e prodhimit	Vlerëson përmirësimet në proceset e prodhimit dhe operacionet për të reduktuar mbetjet, përdorimin e energjisë dhe ndikimin mjedisor	Proceset e përmirësimeve operacionale që kontribuojnë në eficiencën mjedisore dhe ekonomike
Inovacioni i integruar me institucionet dhe investimet	Vlerëson ndikimin e inovacionit të orientuar nga qëndrueshmëria mbi investimet, politikën dhe krijimin e vlerës së qëndrueshme	Investimet në inovacion të qëndrueshëm dhe ndikimi i tyre në rritjen e vlerës së kompanisë dhe punësimin

8. Indikatori i Qasjes në Kapital

Në dinamikën e qëndrueshmërisë së sipërmarrjeve, indikatori i qasjes në kapital shfaqet si një metrikë jetike, duke vlerësuar ndikimet financiare të angazhimit të një korporate ndaj qëndrueshmërisë. Ky indikator shqyrton nëse një korporatë, e nxitur nga përkushtimi i saj ndaj qëndrueshmërisë, bëhet më tërheqëse për investitorët dhe huadhënësit, duke marrë akses të zgjeruar në financim dhe kosto potencialisht më të ulëta të huamarrjes.

Duke eksploruar dimensionet financiare të qëndrueshmërisë, ky indikator synon të zbulojë marrëdhënien e ndërlikuar midis praktikave të përgjegjshme të korporatës dhe aksesit të kapitalit. Kapitale të sipërmarrjeve kanë marrë gjithnjë e më shumë vëmendje në nivel global si një mënyrë speciale për të aksesuar ide të reja dhe mundësi inovative përmes investimeve me aksione të vogla në kompani ekzistuese. Qëllimi i investimeve në kapitale të sipërmarrjeve mund të jetë financiar ose për të ndjekur qëllime strategjike.

Subjekteve sipërmarrëse shpesh u intereson të ndërmarrin veprime që ndikojnë pozitivisht në qëndrueshmëri duke mbledhur njohuritë dhe teknologjitë e lidhura. Këto burime mund të vijnë nga start-up të investuara përmes përdorimit të një programi mbi kapitalet e sipërmarrjeve. Studimi i Döll et al. (2022) fokusohet në matjen dhe analizën e programeve të kapitalit të sipërmarrjeve për kompanitë e listuara në indeksin e qëndrueshmërisë së korporatave ISE B3. Për këtë qëllim, autorët ndjekin një metodologji në tre hapa: fillimisht, kryhet një rishikim sistematik i literaturës; më pas, analizohet informacioni i disponueshëm nga burime sekondare, si faqet e internetit të kompanive; në fund, zhvillohet një anketë që u dërgohet kompanive përmes kanaleve publike të marrëdhënies me investitorët (IR). Rezultatet tregojnë se 27 nga kompanitë e listuara në ISE B3 kanë programe aktive të kapitalit të sipërmarrjeve, të cilat përfshijnë iniciativa organizative përveç investimeve financiare. Kjo nënkupton se të paktën 70% e kompanive të indeksit janë të angazhuara në operacione të kapitalit të sipërmarrjeve të korporatave. Për më tepër, studimi evidenton se këto kompani shpenzojnë rreth 10%–15% të kapitalit të tyre në biznese të qëndrueshme, duke ruajtur kështu konkurrueshmërinë dhe duke kontribuar në literaturën mbi kapitalin e sipërmarrjeve dhe qëndrueshmërinë.

Në qendër të indikatorit të qasjes në kapital qëndron koncepti se qëndrueshmëria nuk është vetëm një imperativ moral, por edhe një propozim financiar. Ky indikator mundëson shqyrtimin e mekanizmave përmes të cilave iniciativat e qëndrueshmërisë së një korporate ndikojnë në atraktivitetin e saj për investitorët dhe huadhënësit (Zhang, 2021). Në përgjigje të ndryshimeve klimatike dhe degradimit mjedisor, Bashkimi Evropian ka propozuar së fundmi një strategji afatgjatë që synon një ekonomi të balancuar ndaj klimës deri në vitin 2050. Financimi i qëndrueshëm luan një rol të rëndësishëm në reduktimin e emetimeve të krijuara nga prodhimi në një shtet, pasi aksesit i kufizuar në kreditim pengon kompanitë që të investojnë në teknologji për uljen e ndotjes. Për më tepër, kërkesat e larta për kolateral mund të detyrojnë kompanitë të zëvendësojnë investimet në uljen e ndotjes me aktive të prekshme, të cilat shpesh preferohen si kolateral në financimin me borxhe. Në këtë drejtim, studimi i Zhang (2021) analizon ndikimin e performancës mjedisore të një kompanie mbi vendimet e bankave dhe kërkesat për kolateral, i cili përdor të dhëna nga një anketim i kryer me kompani në dhjetë shtete anëtare të Bashkimit Evropian. Studimi i Zhang (2021) analizon ndikimin e performancës mjedisore të një kompanie mbi vendimet e bankave dhe kërkesat për kolateral. Gjetjet tregojnë se, në nivelin e kampionit të plotë, kompanitë miqësore me mjedisin kanë më shumë gjasa të përfitojnë linja krediti dhe më pak gjasa të përballen me kërkesa të larta për kolateral. Për huatë që kërkojnë kolateral, një performancë mjedisore e mirë zvogëlon mundësitë për vendosjen e një kolaterali të madh në raport me shumën e kredisë. Gjithashtu, rezultatet sugjerojnë se financimi i qëndrueshëm mund të ndikojë nga niveli i zhvillimit të tregjeve ekonomike dhe financiare. Në rastin e shtatë vendeve të reja anëtare të Bashkimit Evropian, bankat shpërblejnë kompanitë miqësore me mjedisin kur marrin vendime për dhënien e kredive, por kanë më pak gjasa të marrin parasysh performancën mjedisore kur vendosin mbi kërkesat për kolateral. Këto rezultate ofrojnë ndërlikime të rëndësishme për politikat që synojnë përmirësimin e praktikave të financimit të qëndrueshëm. Për këtë arsye, duke u

përputhur me parimet mjedisore, sociale dhe të qeverisjes, korporatat mund ti sinjalizojnë komunitetit financiar se janë të ndërgjegjshme për ndikimin e tyre shoqëror dhe të pozicionuara mirë për elasticitetin financiar afatgjatë.

Për të eksploruar në mënyrë gjithëpërfshirëse ndikimin e qëndrueshmërisë në aksesin në kapital, ky indikator vlerëson se si konsideratat e qëndrueshmërisë të korporatave ndikojnë në proceset e tyre vendimmarrëse, duke krijuar strategjitë e investimeve dhe kriteret e huadhënies (Uyar et al. 2024). Ky studim përfshin të dhëna nga 16 tregje në zhvillim për periudhën 2008–2019 dhe përdor regresion me efekte fikse për vendin, sektorin dhe vitin. Rezultatet tregojnë se performanca dhe raportimi i përgjegjësisë sociale lehtësojnë qasjen në financimin me borxh, ndërsa nuk ekziston një ndikim në formë “*U inverse*”. Gjithashtu, rezultatet analitike tregojnë se asetet fikse zvogëlojnë efektin e angazhimeve në përgjegjësinë sociale mbi qasjen në borxh, duke sugjeruar një marrëdhënie zëvendësuese, ndërsa performanca e korporatës e forcon këtë lidhje, duke treguar një efekt plotësues. Këto gjetje theksojnë rëndësinë e përshtatjes së iniciativave të qëndrueshmërisë me pritshmëritë e komunitetit financiar për të përmirësuar qasjen në kapital.

Një nga synimet kryesore të indikatorit të qasjes në kapital është të vlerësojë nëse angazhimet e qëndrueshmërisë transformohen në përfitime të prekshme për sa i përket kostove të financimit. Nëpërmjet evidencave empirike dhe analizave financiare, ky indikator eksploron rastet kur korporatat kanë përjetuar ulje të kostove të huamarrjes për shkak të përpjekjeve të tyre për qëndrueshmëri. Kostot më të ulëta të financimit jo vetëm që kontribuojnë në efikasitetin financiar, por gjithashtu konfirmojnë përfitimet ekonomike të praktikave të qëndrueshme të biznesit. Studimi i Zeidan et al. (2015) sugjeron se nuk është gjithmonë e nevojshme të jetë kështu. Ai paraqet një sistem vlerësimi të kredisë të bazuar në çështjet e qëndrueshmërisë, i cili përdoret si kriter për të përmirësuar politikat e huadhënies të institucioneve financiare. Sistemi i pikëzimit të kreditit për qëndrueshmërinë (SCSS) bazohet në metodologjinë e procesit të hierarkisë analitike. Zbatimi i tij për herë të parë është bërë në industrinë bujqësore në Brazil. Tre trajektore të ndryshme zhvillimi të sipërmarrjeve identifikohen në këtë mënyrë: biznes i zakonshëm, biznes i qëndrueshëm dhe biznes i ardhshëm i qëndrueshëm. Në sistemin e pikëzimit të kreditit për qëndrueshmërinë janë të pranishme gjashtë dimensionet: (i) rritja ekonomike; (ii) mbrojtja mjedisore; (iii) përparimi social; (iv) zhvillimi social dhe ekonomik; (v) ekosistemi; (vi) zhvillimi social dhe mjedisor. Rezultatet sugjerojnë se qëndrueshmëria nuk është në marrëdhënie të kundërt me fitimin si në perspektivën afatshkurtër dhe në atë afatgjatë. Sistemi i pikëzimit të kreditit për qëndrueshmërinë është i lidhur me parimet e kuadrit rregullator, por aplikimi i tij nuk është i orientuar drejt financimit të projekteve. Ai gjithashtu merret me rreziqet dhe mundësitë afatshkurtra dhe afatgjata, përveç ndikimeve të qëndrueshmërisë në periudhat afatshkurtra. Pra, në thelb, indikator i qasjes në kapital shërben si një busull, duke i udhëhequr korporatat përmes lidhjes së ndërlikuar të qëndrueshmërisë dhe tërheqjes financiare. Duke thelluar kuptimin e ndikimit të praktikave të përgjegjshme mbi qasjen në kapital, korporatat mund të pozicionohen

strategjikisht për të siguruar sukses financiar, duke kontribuar njëkohësisht në ndërtimin e një ekonomie globale më të qëndrueshme dhe rezistente.

Më poshtë, Tabela XVIII “Indikatori i Qasjes në Kapital” ilustron se praktikat e përgjegjshme nuk janë thjesht një detyrim etik, por mund të transformohen në avantazhe financiare dhe të kontribuojnë në një ekonomi globale më të qëndrueshme dhe rezistente.

Tabela XVIII: “Indikatori i Qasjes në Kapital”

Komponenti Matës	Përshkrimi	Treguesi Kryesor Matës
Kapitali i sipërmarrjeve të korporatave	Mat nivelin e angazhimit të kompanive në investime të vogla, në start-up ose biznese të tjera për të nxitur inovacion dhe zhvillim të qëndrueshëm	Numri i kompanive me programe aktive të Kapitalit të Sipërmarrjeve; përqindja e kapitalit të investuar në biznese të qëndrueshme (p.sh., 10–15% e kapitalit total)
Performanca mjedisore dhe raportimi i qëndrueshmërisë	Vlerëson nëse korporatat që respektojnë standardet mjedisore dhe raportojnë për angazhimet sociale kanë akses më të lehtë në financim dhe linja krediti	Mundësitë për të marrë linja krediti; niveli i kërkesës për kolateral; vlerësimi i performancës mjedisore nga bankat dhe institucionet financiare
Efekti mbi kostot dhe qasjen në borxh	Analizon nëse iniciativat e qëndrueshmërisë ndikojnë në uljen e kostove të huamarrjes dhe lehtësimin e qasjes në financim, duke marrë parasysh efektet e moderimit nga asetet fikse dhe performanca e sipërmarrjes	Ulja e normave të interesit për huamarrje; lehtësimi i qasjes në borxh; rezultatet e sistemit të pikëzimit të kreditit për qëndrueshmërinë (SCSS)

9. Indikatori i Produktivitetit të Punonjësve

Në kontekstin bashkëkohor të përgjegjësisë sociale të sipërmarrjeve, indikatori i produktivitetit të punonjësve shfaqet si një metrikë kryesore, duke hedhur dritë mbi ndërveprimin dinamik midis angazhimit të një korporate ndaj përgjegjësisë sociale dhe niveleve të produktivitetit dhe angazhimit të fuqisë punëtore të saj. Ky indikator thellohet në marrëdhënien e ndërlikuar midis praktikave të përgjegjshme të korporatës dhe mirëqenies, angazhimit dhe produktivitetit të punonjësve. Duke eksploruar ndikimin e iniciativave të përgjegjësisë sociale të korporatës në fuqinë punëtore, ky indikator synon të zbulojë se si korporatat mund të nxisin një mjedis që jo vetëm tërheq dhe ruan talentin, por gjithashtu rrit produktivitetin e përgjithshëm organizativ.

Studim i thelluar në këtë kontekst është ai i Melovic et al. (2019) që diskuton nevojën për të rinovuar menaxhimin e burimeve njerëzore për të adresuar sfidat e punës në të ardhmen, duke u fokusuar në menaxhimin e burimeve njerëzore të qëndrueshëm që thekson zhvillimin dhe ripërtëritjen afatgjatë të burimeve njerëzore. Duke njohur tregun e punës në ndryshim dhe rëndësinë në rritje të punës atipike, veçanërisht për shkak të pandemisë COVID-19, studimi eksploron lidhjen midis zhvillimit të punonjësve, fleksibilitetit në vendin e punës, kënaqësisë në punë dhe performancës në punë. Ai thekson rëndësinë e llojeve të ndryshme të fleksibilitetit - kontraktual, funksional, kohë

punë dhe hapësirë pune - si komponentë kryesore të menaxhimit të burimeve njerëzore të qëndrueshme që rrisin kënaqësinë e punonjësve. Të dhënat e mbledhura nga një anketë kombëtare lidhur me ndikimin e formave të ndryshme të fleksibilitetit të kënaqësisë në punë mundësuan zhvillimin e indikatorit të fleksibilitetit të punonjësve. Gjetjet tregojnë se modelet e reja të punës, siç janë marrëveshjet për punë të pjesshme në shtëpi, preferohen nga punonjësit dhe janë të dobishme për performancën organizative, marrëdhëniet sociale dhe motivimin në punë. Analiza tregon se, ndonëse ka një nivel të mesëm të fleksibilitetit mes punonjësve, pak prej tyre arrijnë nivele të larta kënaqësie në punë. Gjithashtu, studimi evidenton nevojën për të integruar zhvillimin e punonjësve me kushte fleksibël të punës për të nxitur kënaqësi më të madhe në punë dhe për të rritur efikasitetin organizativ, duke përputhur praktikën e menaxhimit të burimeve njerëzore me objektivat e qëndrueshmërisë.

Në thelb, indikator i produktivitetit të punonjësve kërkon të vlerësojë shkallën në të cilën angazhimi i një korporate ndaj përgjegjësisë sociale kontribuon në nivele të larta të angazhimit dhe produktivitetit midis punonjësve të saj. Kuptimi i dinamikës së produktivitetit të punonjësve është thelbësor për korporatat që kërkojnë të përdorin përgjegjësinë sociale si një katalizator për suksesin organizativ. Sipas Hubbard (2009), matja e performancës organizative është proces i vështirë, veçanërisht, kur ajo që duhet matur vazhdon të ndryshojë. Konceptet e qëndrueshmërisë kanë zgjeruar ndjeshëm mundësitë e matjes dhe korporatat po përballen me raportimin mbi qëndrueshmërinë, por nuk ka shenja të konsensusit për një standard të përbashkët raportimi dhe kornizat konkurruese janë jashtëzakonisht komplekse. Ky studim pranon se matja e performancës së qëndrueshme, pavarësisht faktit se duhet të argumentohet konceptualisht, duhet të jetë e thjeshtë që të mund të përdoret në mënyrë praktike. Hubbard propozon një strukturë konceptuale të bazuar te palët e interesit, një sistem pikëzimi të qëndrueshëm (SBSC), i cili shoqërohet me një indeks të performancës së qëndrueshmërisë organizative, si dhe të matet me një masë të vetme për të integruar masat në sistemin e pikëzimit të qëndrueshëm. Indeksi ndihmon që performanca organizative të jetë e qëndrueshme, e matshme dhe e aksesueshme për palët e interesit, ku përfshihen kryesisht punonjësit.

Qarkullimi i punonjësve është një çështje kyçe për korporatat që synojnë të mbajnë një fuqi punëtore të qëndrueshme dhe produktive. Indikator i produktivitetit të punonjësve vlerëson nëse angazhimi i një korporate ndaj përgjegjësisë sociale kontribuon në norma më të ulëta të qarkullimit. Kur vlerat e korporatës përafrohen me ato të punonjësve, iniciativat e përgjegjësisë sociale krijojnë ndjenja besnikërie dhe përkushtimi, duke ulur mundësinë që individët e talentuar të largohen. Referuar performancës organizative, Park dhe Shaw (2013) realizuan një meta-analizë mbi marrëdhënien midis nivelit të qarkullimit dhe performancës organizative, duke përdorur 300 korrelacione të përgjithshme ($N = 309,245$) dhe 110 korrelacione të pavarura ($N = 120,066$). Rezultatet tregojnë një marrëdhënie negative të rëndësishme ($r = -.15$) midis qarkullimit total dhe performancës organizative, më e fortë për qarkullimin vullnetar ($r = -.15$) dhe për reduktimet e forcës punëtore ($r = -.17$), krahasuar me qarkullimin e detyrueshëm ($r = -.01$). Lidhja ndryshon, gjithashtu, në varësi të faktorëve organizativë

dhe kontekstualë, përfshirë sistemet e punës, dimensionet e performancës, rajonin dhe madhësinë e organizatës. Analizat tregojnë edhe një marrëdhënie të mundshme jo-lineare midis qarkullimit dhe performancës.

Për të matur ndikimin e përgjegjësisë sociale të korporatës në produktivitet është e rëndësishme të përdoren metrika sasiore dhe tregues kryesorë performance si përfundimi i detyrave, respektimi i afateve dhe performanca e përgjithshme e ekipit. Studimi i Liaquat et al. (2024) analizon ndikimin e faktorëve motivues dhe sjelljeve të gjelbra në performancën mjedisore të punonjësve në sektorin bankar. Duke përdorur një qasje sasiore dhe të dhëna nga 300 punonjës, gjetjet tregojnë se motivimi i brendshëm dhe ai i jashtëm ndikojnë pozitivisht në performancën mjedisore, me sjelljet e gjelbra që ndërmjetësojnë efektin pozitiv. Në kontrast, sjelljet vullnetare nuk kanë ndikim të rëndësishëm. Këto rezultate sugjerojnë se politikat e bazuara në shpërblime mund të rrisin sjelljet e gjelbra dhe performancën e përgjithshme mjedisore.

Si përfundim, indikatori i produktivitetit të punonjësve shërben si një udhërrëfyes, duke i drejtuar korporatat drejt një integrimi harmonik të praktikave të përgjegjshme dhe produktivitetit të fuqisë punëtore. Duke kuptuar dhe shfrytëzuar dinamikën ndërmjet përgjegjësisë sociale dhe angazhimit të punonjësve, korporatat mund të ndërtojnë një forcë punëtore elastike dhe të motivuar që i shtyn ato drejt suksesit të qëndrueshëm.

Më poshtë, Tabela XIX “Indikatori i Produktivitetit të Punonjësve”, e cila synon të tregojë se si praktikatat e përgjegjshme të sipërmarrjeve ndikojnë në angazhimin, motivimin dhe performancën e punonjësve. Treguesit kryesorë ndihmojnë në matjen e rezultateve të qarkullimit, kënaqësisë, fleksibilitetit dhe efikasitetit organizativ, duke ofruar një bazë të qartë për përmirësimin e politikave të menaxhimit të burimeve njerëzore.

Tabela XIX: “Indikatori i Produktivitetit të Punonjësve”

Komponenti Matës	Përshkrimi	Treguesi Kryesor Matës
Ndikimi i përgjegjësisë sociale në angazhimin dhe besnikërinë e punonjësve	Ky element mat sesi angazhimi i korporatës ndaj përgjegjësisë sociale ndikon në motivimin, kënaqësinë dhe besnikërinë e punonjësve, duke ulur qarkullimin dhe rritur përkushtimin	Norma e qarkullimit të punonjësve (total, vullnetar, i detyrueshëm), niveli i besnikërisë dhe angazhimit të punonjësve
Fleksibiliteti dhe zhvillimi i punonjësve si faktorë të performancës së qëndrueshme	Vlerëson se si fleksibiliteti në punë (kontraktual, funksional, kohë pune, hapësirë pune) dhe mundësitë e zhvillimit ndikojnë në performancën e punonjësve dhe në efikasitetin organizativ	Niveli i fleksibilitetit (kohë pune, vend pune, kontraktual, funksional), kënaqësia në punë, përfshirja në programet e zhvillimit profesional
Matja e produktivitetit dhe performancës së punonjësve	Përdorimi i treguesve sasiorë për të vlerësuar përfundimin e detyrave, respektimin e afateve dhe performancën e ekipit, duke lidhur përgjegjësinë sociale me efikasitetin organizativ	Përfundimi i detyrave sipas afateve, performanca e ekipit, rezultatet e vlerësimeve të performancës, sistemi i pikëzimit të qëndrueshëm (SBSC)

10. Indikatori i Zbutjes së Riskut

Në rrjetin kompleks të qëndrueshmërisë së sipërmarrjeve, indikatori i zbutjes së riskut është një metrikë kyçe për të vlerësuar aftësinë e një korporate për të identifikuar, vlerësuar dhe menaxhuar rreziqet që lidhen me iniciativat e qëndrueshmërisë. Ky indikator fokusohet tek masat proaktive të marra për të parandaluar ndërprerjet e mundshme që rrjedhin nga ndryshimet rregullatore, dobësitë e zinxhirit të furnizimit dhe rreziqe të tjera të lidhura me qëndrueshmërinë. Ndërsa korporatat po kuptojnë gjithnjë e më shumë lidhjen midis qëndrueshmërisë dhe menaxhimit të riskut, iniciativat e qëndrueshmërisë mund të paraqesin rreziqe të reja, por gjithashtu ofrojnë mundësi për parandalimin e tyre. Kuptimi i natyrës dhe origjinës së këtyre rreziqeve është thelbësor për zhvillimin e strategjive efektive të zbutjes.

Studimet e shumta ofrojnë qasje të ndryshme për të analizuar këtë indikator. Shad et al. (2019) propozon një kornizë për të shqyrtuar ndikimin e raportimit mbi qëndrueshmërinë në marrëdhënien midis menaxhimit të riskut në sipërmarrje (ERM) dhe performancës së biznesit, e matur përmes vlerës ekonomike të shtuar (EVA). Rezultatet tregojnë se integrimi i qëndrueshmërisë në strategjitë e riskut mund të rrisë performancën e biznesit dhe të ulë kostot e kapitalit, veçanërisht, në sektorët me risk të lartë si ai i naftës dhe gazit.

Një aspekt kritik i indikatorit është aftësia për identifikimin proaktiv të risqeve që lidhen me iniciativat e qëndrueshmërisë, përfshirë, risqet rregullatore, operative, sociale dhe mjedisore në zinxhirin e furnizimit (Xu et al., 2019). Studimet e rasteve në industri të ndryshme si veshjeve dhe automobilistikës tregojnë se përpjekjet për zbutjen e riskut duhet të përshtaten sipas kompleksitetit të zinxhirëve të furnizimit dhe të kombinohen me praktikatat e qëndrueshmërisë për efekt maksimal. Ndryshimet rregullatore dhe ngjarjet e papritura si pandemia COVID-19 tregojnë rëndësinë e fleksibilitetit dhe të aftësisë për përshtatje të shpejtë të strategjive të menaxhimit të riskut (Settembre-Blundo et al., 2021).

Analizat e praktikuarat në tregje të zhvilluara dhe në zhvillim tregojnë se strategjitë tradicionale për reduktimin e riskut shpesh nuk mjaftojnë, pasi përfitimet maksimale arrihen kur ato integrohen me përpjekjet për qëndrueshmëri (Gouda & Saranga, 2018). Teknologjia, analitika e të dhënave dhe modelimi parashikues janë instrumente që ndihmojnë korporatat të monitorojnë, parashikojnë dhe zbusin risqet në mënyrë efektive. Studiuesit Srinivasan dhe Bolar (2020) evidentojnë nevojën për integrim më të madh të riskut mjedisor në kornizat ekzistuese të menaxhimit të riskut, pasi shpërndarja aktuale e riskut është e kufizuar dhe fokuson kryesisht rreziqet financiare.

Një tjetër komponent i rëndësishëm është komunikimi efektiv me palët e interesuara, i cili ndihmon në zbutjen e rreziqeve të lidhura me reputacionin dhe ndërtimin e besimit. Indikatori vlerëson nivelin e transparencës së korporatës në raportimin dhe angazhimin me investitorët, klientët dhe komunitetin për rreziqet e lidhura me qëndrueshmërinë.

Në përfundim, indikatori i zbutjes së riskut shërben si një udhërrëfyes për sipërmarrjet në menaxhimin e lidhjes komplekse midis qëndrueshmërisë dhe riskut. Duke identifikuar, parashikuar dhe menaxhuar në mënyrë proaktive risqet, korporatat mund të ndërtojnë

elasticitet, të sigurojnë vazhdimësinë e nismave të qëndrueshmërisë dhe të maksimizojnë suksesin e tyre afatgjatë.

Më poshtë, Tabela XX: “Indikatori i Zbutjes së Riskut”, e cila sjell një përmbledhje të qartë dhe të strukturuar të tre komponentëve kryesorë që përbëjnë këtë indikator për ti ofruar lexuesit një linjë guidë për strategjitë proaktive që duhet të ndjekin korporatat për menaxhimin e riskut dhe për të vlerësuar efikasitetin e tyre në mënyrë objektive.

Tabela XX: “Indikatori i Zbutjes së Riskut”

Komponenti Matës	Përshkrimi	Treguesi Kryesor Matës
Identifikimi i risqeve	Vlerëson aftësinë e korporatës për të identifikuar risqet që lidhen me iniciativat e qëndrueshmërisë, përfshirë risqet rregullatore, operative, sociale dhe mjedisore	Numri i risqeve të identifikuara në mënyrë proaktive dhe raportuar tek menaxheri
Menaxhimi dhe zbutja e riskut	Mat masat dhe strategjitë që korporata merr për të parandaluar ndërprerjet dhe për të zvogëluar ndikimet e rreziqeve të identifikuara, duke integruar praktikatat e qëndrueshmërisë në menaxhimin e riskut	Niveli i implementimit të strategjive proaktive të zbutjes së riskut dhe përshtatja e tyre ndaj ndryshimeve rregullatore ose operacionale
Komunikimi me palët e interesuara	Vlerëson nivelin e transparencës dhe efektivitetit të komunikimit të korporatës me investitorët, klientët dhe komunitetin për rreziqet e lidhura me qëndrueshmërinë	Shkalla e raportimit të risqeve dhe pjesëmarrja aktive e palëve të interesuara në dialogun mbi menaxhimin e riskut

11. Indikator i Vlerës së Markës

Në mjedisin konkurrues të sotëm, vlera e markës është një tregues kyç i suksesit të sipërmarrjes, duke reflektuar lidhjen midis angazhimit për qëndrueshmëri dhe rritjes së reputacionit dhe besnikërisë së klientit, si dhe gadishmërinë për të paguar çmime premium. Praktikatat e qëndrueshme lejojnë korporatat të rrisin reputacionin dhe të forcojnë lidhjet me konsumatorët dhe palët e interesit. Marketingu luan një rol të rëndësishëm në promovimin e këtyre nismave, duke përdorur markën për të evidentuar praktikatat e qëndrueshme dhe ndikimin e tyre. Integrimi i veprimeve të qëndrueshmërisë me komunikimin e markës ndihmon në përforcimin e saj dhe rritjen e vlerës së saj.

Iniciativat e qëndrueshmërisë rrisin tërheqjen e konsumatorëve ndaj markave që demonstrojnë përgjegjësi sociale dhe mjedisore. Një qasje sistematike ndaj vlerësimit të performancës së qëndrueshmërisë përmirëson avantazhin konkurrues dhe performancën financiare të kompanisë. Studime të ndryshme, përfshirë Obioha (2024), tregojnë se performanca mjedisore, sociale dhe ekonomike është e lidhur pozitivisht me reputacionin e markës, konkurrueshmërinë dhe suksesin financiar. Strategjitë proaktive si ulja e emetimeve të karbonit, praktikatat etike të zinxhirit të furnizimit dhe investimet në energji të rinovueshme forcojnë lidhjet emocionale të konsumatorëve me markën dhe rrisin besnikërinë. Megjithatë, një sfidë e rëndësishme mbetet marketingu mashtrues ose

“greenwashing”, i cili dëmton besimin e konsumatorëve dhe investitorëve në markat e qëndrueshme. Studimi i Pimonenko et al. (2020) evidenton se marketingu mashtues redukton perceptimin pozitiv të markës së gjelbër dhe rekomandon transparencë të plotë dhe raporte të qarta mbi praktikën mjedisore për të rindërtuar besimin.

Integrimi i qëndrueshmërisë në strategjinë e sipërmarrjes mund të diferencojë markën nga konkurrentët dhe të përforcojë avantazhin konkurrues. Konsumatorët kërkojnë markat që përputhen me vlerat e tyre dhe kontribuojnë pozitivisht në shoqëri dhe mjedis dhe komunikimi efektiv i përpjekjeve për qëndrueshmëri mund të rrisë pjesën e tregut. Trashëgimia e korporatave, kur lidhet me komunikimin për përgjegjësinë sociale, mund të forcojë imazhin e markës së përgjegjshme dhe të ndikojë pozitivisht në perceptimin e konsumatorëve (Blombäck & Scandellius, 2013). Përfitimet financiare të iniciativave të qëndrueshmërisë, përfshirë kursimet nga efikasiteti i energjisë dhe zhvillimin e produkteve të reja, mund të tejkalojnë investimet fillestare dhe të rrisin tërheqjen financiare të korporatës (Bodhanwala & Bodhanwala, 2018). Në këtë mënyrë, vlerësimi i ndikimit të qëndrueshmërisë mbi vlerën e markës ndihmon menaxherët të identifikojnë strategjitë më efektive dhe fushat për përmirësim, duke forcuar jo vetëm reputacionin dhe performancën financiare, por edhe angazhimin e korporatës për ndryshime pozitive në shoqëri dhe mjedis.

Më poshtë, Tabela XXI “Indikatori i Vlerës së Markës” përmbledh tre dimensionet kryesore të matjes: angazhimin e korporatës në praktikën e qëndrueshmërisë, perceptimin e markës nga konsumatorët dhe palët e interesit, si dhe ndikimin financiar të këtyre iniciativave. Ajo lejon vlerësimin e mënyrës se si integrimi i qëndrueshmërisë rrit reputacionin, besnikërinë e klientëve dhe vlerën e tregut të markës, duke lidhur praktikën mjedisore dhe sociale me performancën ekonomike dhe konkurrueshmërinë e sipërmarrjes.

Tabela XXI: “Indikatori i Vlerës së Markës”

Komponenti Matës	Përshkrim	Treguesi kryesor matës
Angazhimi i korporatës në qëndrueshmëri	Mat nivelin në të cilin korporata integron praktikën mjedisore, sociale dhe etike në operacionet dhe strategjinë e saj	Numri dhe lloji i iniciativave për qëndrueshmëri (p.sh., reduktim i emetimeve, energji e rinovueshme, praktika etike të zinxhirit të furnizimit)
Reputacioni dhe imazhi i markës	Vlerëson perceptimin e konsumatorëve dhe palëve të interesit mbi përgjegjësinë sociale dhe mjedisore të korporatës	Rezultatet e anketave të konsumatorëve dhe indekseve të reputacionit të markës
Performanca financiare dhe vlera e markës	Lidhet me ndikimin e iniciativave të qëndrueshmërisë në fitimin, konkurrueshmërinë dhe vlerën e tregut të markës	Rritja e të ardhurave, normave të fitimit, pjesës së tregut dhe vlera e markës sipas metodave të njohura (p.sh., BrandZ, Interbrand)

12. Konkluzione

Kapitulli i tretë ofroi një shqyrtim të detajuar të indikatorëve ekonomikë që mundësojnë matjen e ndikimit të përgjegjësisë sociale të sipërmarrjeve në performancën dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Analiza e literaturës shkencore dhe e praktikave ndërkombëtare tregon se indikatorët si rritja e të ardhurave, kursimet në kosto, zgjerimi i tregut, avantazhi konkurrues, efikasiteti i burimeve, inovacioni, qasja në kapital, produktiviteti i punonjësve, zbutja e riskut dhe vlera e markës formojnë një kornizë të integruar, ku secili komponent pasqyron një dimension të veçantë të performancës ekonomike dhe bashkëpunon për të kuptuar ndikimin e plotë të praktikave të përgjegjësisë sociale të korporatave. Këta indikatorë nuk janë vetëm tregues financiarë, por ofrojnë një pasqyrë të balancuar midis rezultateve afatshkurtra dhe efekteve afatgjata të angazhimit social dhe mjedisor të korporatës, duke lidhur aktivitetet operative, strategjitë e zhvillimit dhe vendimarrjen menaxheriale me performancën e përgjithshme ekonomike.

Përdorimi i këtyre indikatorëve në kontekstin e korporatave shqiptare mund të realizohet nëpërmjet anketimeve dhe intervistave të strukturuar me drejtuesit financiarë, menaxherët operativë dhe drejtuesit e projekteve të inovacionit. Rritja e të ardhurave, zgjerimi i tregut, avantazhi konkurrues dhe qasja në kapital mund të maten përmes pyetjeve drejtuar drejtuesve strategjikë dhe analizës së raporteve financiare të kompanive. Kursimet në kosto, efikasiteti i burimeve dhe produktiviteti i punonjësve mund të evidentohen nga menaxherët operativë dhe të konfirmohen përmes të dhënave të performancës së brendshme. Inovacioni dhe zbutja e riskut ofrojnë informacion mbi aftësinë e korporatave për të zhvilluar produkte të reja, për të menaxhuar rreziqet operative dhe për të siguruar qëndrueshmërinë e aktivitetit në një treg të ndërlikuar dhe konkurrues. Vlera e markës mund të përdoret për të matur perceptimin e konsumatorëve dhe palëve të interesit mbi reputacionin e kompanisë, besnikërinë dhe gadishmërinë për të investuar ose paguar çmime premium, duke ofruar kështu një tregues të qartë të ndikimit të përgjegjësisë sociale të sipërmarrjeve në avantazhin konkurrues dhe pozicionin strategjik.

Analiza teorike ka nxjerrë në pah se efektiviteti i indikatorëve ekonomikë është i lidhur ngushtë me koherencën e praktikave të përgjegjësisë sociale të sipërmarrjeve me strategjinë organizative dhe strukturat e qeverisjes. Çdo mos-përputhje midis deklarimeve publike dhe veprimeve operative mund të kompromentojë legjitimitetin e korporatës dhe të minimizojë përfitimet e pritshme nga investimet në qëndrueshmëri. Për këtë arsye, indikatorët nuk duhet të shihen thjesht si mjete teknike matëse, por si instrumente që evidentojnë integrimin real të përgjegjësisë sociale të korporatave në modelin e biznesit, duke ndihmuar drejtuesit të identifikojnë fushat që kërkojnë përmirësim dhe të marrin vendime të bazuara në të dhëna të besueshme.

Gjithashtu, kapitulli i tretë konfirmon rëndësinë e transparencës dhe të llogaridhënies në funksionimin efektiv të sistemit të indikatorëve. Matja e performancës ekonomike ka kuptim vetëm nëse informacioni është i aksesueshëm, i verifikueshëm dhe i kuptueshëm për palët e interesit. Varësia midis indikatorëve ekonomikë dhe rezultateve sociale dhe

mjedisore thekson nevojën për një qasje integruese, e cila shmang interpretimet e njëanshme dhe pasqyron në mënyrë të plotë ndikimin e përgjegjësisë sociale në qëndrueshmëri.

Së fundmi, kapitulli i tretë ofron një kornizë analitike të strukturuar që shërben si bazë për operacionalizimin e indikatorëve në fazën empirike të studimit. Ky set indikatorësh mund të përdoret si një instrument për matjen dhe krahasimin e performancës ekonomike të sipërmarrjeve të përzgjedhura shqiptare, duke mundësuar testimin e lidhjeve ndërmjet përgjegjësisë sociale të sipërmarrjeve dhe rezultateve ekonomike, identifikimin e avantazheve dhe dobësive, si dhe zhvillimin e praktikave më të mira për integrimin e qëndrueshmërisë në strategjinë dhe operacionet e kompanive. Kjo qasje jo vetëm që garanton rigorozitet shkencor, por gjithashtu ofron një udhërrëfyes praktik për menaxherët dhe studiuesit që synojnë të vlerësojnë ndikimin e përgjegjësisë sociale të sipërmarrjeve në performancën ekonomike dhe zhvillimin e qëndrueshëm në kontekstin lokal.

Në përfundim, mbështetur në analizën dhe konkluzionet e kapitullit të tretë, është e domosdoshme të paraqitet një përmbledhje e strukturuar e indikatorëve ekonomikë që operacionalizojnë dimensionin financiar dhe strategjik të përgjegjësisë sociale të sipërmarrjeve në raport me zhvillimin e qëndrueshëm. Tabela e mëposhtme sintetizon këta indikatorë: rritjen e të ardhurave, kursimet në kosto, zgjerimin e tregut, avantazhin konkurrues, efikasitetin e burimeve, inovacionin, qasjen në kapital, produktivitetin e punonjësve, zbutjen e riskut dhe vlerën e markës, duke i paraqitur si elementë të një kornize analitike të integruar për vlerësimin e performancës ekonomike në kontekstin e përgjegjësisë sociale të korporatave.

Tabela XXII: “Matrica e Indikatorëve Ekonomikë në Kornizën Teorike të Angazhimit të Korporatave”

Indikatori	Përshkrimi	Treguesi Kryesor Matës
Rritja e të Ardhurave	Pasqyron ndikimin e përgjegjësisë sociale të sipërmarrjes në të ardhurat totale të korporatës dhe zhvillimin e aktiviteteve ekonomike	Norma e rritjes së të ardhurave vjetore
Kursimet në Kosto	Mat përfitimet ekonomike nga efikasiteti i energjisë, menaxhimi i burimeve dhe praktikave të qëndrueshme	Shuma e kursimeve vjetore në kosto operationale
Zgjerimi i Tregut	Evidenton aftësinë e sipërmarrjes për të fituar segmente të reja të tregut përmes veprimeve të përgjegjësisë sociale të sipërmarrjes	Numri i tregjeve të reja ose rritja e pjesës së tregut
Avantazhi Konkurrues	Tregon se si përgjegjësia sociale e sipërmarrjes kontribuon në diferencimin e markës dhe pozicionimin strategjik	Perceptimi i avantazhit konkurrues nga palët e interesit
Efikasiteti i Burimeve	Mat përdorimin optimal të burimeve për të arritur performancë ekonomike dhe qëndrueshmëri	Shkalla e shfrytëzimit të burimeve dhe reduktimi i mbetjeve

Inovacioni	Pasqyron zhvillimin e produkteve, shërbimeve ose proceseve të reja që kontribuojnë në përgjegjësinë sociale të sipërmarrjes	Numri i iniciativave inovative dhe produktet e reja të lançuara
Qasja në Kapital	Tregon mundësinë e sipërmarrjes për të marrë investime dhe financim përmes imazhit të përgjegjësisë sociale	Shuma e kapitalit të fituar nga investitorë të gjelbër ose projekte të përgjegjësisë sociale të sipërmarrjes
Produktiviteti i Punonjësve	Mat ndikimin e përgjegjësisë sociale të sipërmarrjes në motivimin dhe performancën e punonjësve	Shkalla e produktivitetit për punonjës dhe angazhimi i stafit
Zbutja e Riskut	Evidenton aftësinë për të menaxhuar rreziqet financiare, sociale dhe mjedisore	Numri i incidenteve të menaxhuara dhe masat parandaluese
Vlera e Markës	Mat ndikimin e përgjegjësisë sociale të sipërmarrjes në perceptimin e markës, besnikërinë dhe gatishmërinë për të paguar çmime premium	Pjesëmarrja aktive e komunitetit në vendimmarrje; Rezultatet e anketimeve për perceptimin e markës dhe besnikërinë

Siç paraqitet në Tabelën XXII “Matrica e Indikatorëve Ekonomikë në Kornizën Teorike të Angazhimit të Korporatave”, çdo indikator është i pozicionuar brenda dimensionit ekonomik të qëndrueshmërisë, duke reflektuar rolin e tij në analizën e marrëdhënies ndërmjet përgjegjësisë sociale të sipërmarrjeve dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Kjo përmbledhje nuk ka karakter thjesht përshkruar, por shërben si pikë reference metodologjike për fazën empirike të studimit, duke lidhur konceptet teorike me tregues konkretë matës dhe me instrumentet e mbledhjes së të dhënave që do të përdoren në analizën e korporatave të përzgjedhura, me ortakë/aksionar shqiptarë dhe të huaj, që veprojnë në Shqipëri. Në këtë mënyrë, tabela krijon një urë ndërmjet kuadrit konceptual dhe aplikimit praktik, duke mundësuar matjen, krahasimin dhe interpretimin e nivelit të integritetit të përgjegjësisë sociale në performancën ekonomike organizative.

KAPITULLI IV

KORNIZA METODOLOGJIKE DHE MODELI EMPIRIK PËR STUDIMIN E PERCEPTIMIT PUBLIK MBI ANGAZHIMIN E SIPËRMARRJEVE TË PËRZGJEDHURA NË SHQIPËRI NË FUSHËN E PËRGJEGJËSISË SOCIALE DHE ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM

1. Hyrje

Ky kapitull paraqet strukturën metodologjike të studimit, duke operacionalizuar në mënyrë sistematike objektivat, pyetjet kërkimore dhe hipotezat e formuluar në hyrjen e punimit doktoral. Në këtë fazë, analiza zhvendoset nga niveli konceptual dhe teorik në ndërtimin e modelit empirik, përmes përcaktimit të qasjes filozofike, strukturimit të variablave dhe zgjedhjes së teknikave analitike për testimin e marrëdhënieve ndërmjet tyre. Kjo fazë përbën boshtin lidhës ndërmjet argumentimit teorik dhe verifikimit empirik, duke siguruar koherencën shkencore dhe rigorozitetin metodologjik të kërkimit.

Në kontekstin e transformimeve të ekonomisë globale drejt modeleve të zhvillimit të qëndrueshëm, përgjegjësia sociale e sipërmarrjeve nuk konsiderohet më një dimension vullnetar apo periferik i veprimtarisë së biznesit, por një komponent thelbësor i strategjisë afatgjatë të biznesit. Në Shqipëri, e cila karakterizohet nga një ekonomi në tranzicion dhe në proces të integritit evropian, roli i sipërmarrjeve në promovimin e standardeve mjedisore, sociale dhe të qeverisjes ka marrë një rëndësi të shtuar, si në aspektin e përputhshmërisë me kuadrin rregullator ndërkombëtar, ashtu edhe në drejtim të ndërtimit të besimit publik dhe legjitimitetit institucional.

Megjithatë, pavarësisht rritjes së iniciativave të raportuara në fushën e përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm, mbetet thelbësore të analizohet perceptimi publik mbi këto angazhime. Perceptimi i publikut përbën një tregues kritik të efektivitetit real të politikave dhe praktikave të sipërmarrjeve, pasi ai ndikon drejtpërdrejt në reputacionin, kapitalin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të biznesit. Në këtë kuadër, studimi synon të vlerësojë në mënyrë empirike se si publiku percepton angazhimin e sipërmarrjeve të përzgjedhura në Shqipëri në tre dimensione themelore si: mjedisor, social dhe institucional apo qeverisës.

Korniza metodologjike e këtij kapitulli mbështetet në një qasje të strukturuar dhe të integruar, e cila kombinon parimet e kërkimit sasior me analizën statistikore të avancuar për të testuar hipotezat e ngritura. Fillimisht, përcaktohet pozicionimi filozofik dhe epistemologjik i studimit, duke e vendosur atë brenda paradigmes pozitiviste dhe post-pozitiviste, ku realiteti social konsiderohet i matshëm përmes instrumenteve të strukturuar dhe analizës së të dhënave empirike. Kjo qasje lejon identifikimin e marrëdhënieve shkak-pasojë ndërmjet variablave të modelit analitik dhe ofron një bazë të fortë për përgjithësimin e rezultateve.

Në vijim, kapitulli prezanton modelin analitik dhe strukturën e variablave, duke operacionalizuar konceptet teorike në tregues të matshëm. Modeli përfshin pesë shtylla kryesore të variablave të pavarur lidhur me angazhimin e korporatave në përgjegjësinë sociale dhe zhvillimin e qëndrueshëm: - **A** “Reduktimi i Emetimeve Karbonike dhe Menaxhimi i Zinxhirit të Furnizimit”; - **B** “Gjithëpërfshirja dhe Angazhimi në Komunitet; - **C** “Investimet Sociale dhe Palët e Interesuara”; - **D** “Transparenca, Raportimi dhe Pajtueshmëria me të Drejtat e Njeriut”; - **E** “Përafrimi me Objektivat dhe Praktikat e Zhvillimit Ekonomik të Qëndrueshëm”. Këto variabla analizohen në raport me perceptimin publik si variabël i varur, duke mundësuar një vlerësim të integruar të ndikimit të tyre.

Një element thelbësor i këtij kapitulli është operacionalizimi i modelit analitik përmes ndërtimit të instrumentit të matjes. Për këtë qëllim është hartuar një pyetësor i strukturuar, i cili përfshin indikatorë të përzgjedhur në përputhje me literaturën shkencore dhe praktikatat më të mira në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm përta analizuar në dy kapitujt e parë të punimit doktoral. Instrumenti synon të sigurojë vlefshmëri konceptuale dhe besueshmëri statistikore, duke garantuar që çdo dimension i analizuar të përfaqësohet përmes treguesve të qartë dhe të matshëm.

Pjesë përbërëse e këtij kapitulli është gjithashtu përcaktimi i popullatës së studimit dhe kornizës së kampionit, si dhe përshkrimi i procedurave të mbledhjes së të dhënave. Përzgjedhja e kampionit është realizuar në mënyrë që të sigurojë përfaqësim të mjaftueshëm, duke mundësuar analizë krahasuese dhe nxjerrje përfundimesh të përgjithësueshme. Përpunimi dhe analiza e të dhënave mbështeten në përdorimin e teknikave statistikore të përshtatshme për natyrën e variablave, konkretisht, regresionin rendor dhe regresionin logjistik rendor të përgjithshëm që lejojnë analizimin e marrëdhënieve ndërmjet variablave në kushte të shpërndarjeve jo-lineare dhe niveleve të ndryshme të perceptimit.

Arsyetimi metodologjik për zgjedhjen e këtyre teknikave qëndron në natyrën e të dhënave të mbledhura, të cilat matin qëndrime dhe perceptime përmes shkallëve rendore. Kjo zgjedhje siguron një analizë më të saktë dhe të përshtatshme krahasuar me modelet lineare tradicionale, duke rritur fuqinë shpjeguese të modelit empirik dhe besueshmërinë e rezultateve.

Në tërësi, ky kapitull synon të demonstrojë se studimi nuk kufizohet në një analizë përshkruese të praktikave të sipërmarrjeve të përzgjedhura në Shqipëri, por ndërton një model të mirë strukturuar empirik për të testuar në mënyrë të verifikueshme ndikimin e dimensioneve të përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm në perceptimin publik. Përmes këtij procesi, punimi kontribuon si në literaturën shkencore, ashtu edhe në formulimin e rekomandimeve praktike për përmirësimin e politikave dhe strategjive të sipërmarrjeve në Shqipëri.

2. Korniza Metodologjike e Studimit

Studimi ndjek një strukturë empirike me natyrë mikse dhe me dominim sasior. Qëllimi metodologjik është testimi i marrëdhënieve ndërmjet variablave të përcaktuara në modelin analitik përmes analizës statistikore inferenciale. Elementi sasior përdoret për testimin e hipotezave dhe matjen e ndikimit të variablave të pavarura mbi variablin e varur. Elementi interpretativ kufizohet në analizën e perceptimeve të të anketuarve dhe në interpretimin e rezultateve statistikore. Studimi ka natyrë analitike shpjeguese, pasi synon të identifikojë marrëdhënie ndikimi dhe jo thjesht të përshkruajë fenomene.

2.1. Modeli empirik dhe struktura e variablave

Modeli empirik përbëhet nga 1 (një) variabël i varur dhe nga 4 (katër) variabla të pavarur:

- **Variabli i varur (E):** Niveli i perceptuar i përafrimit të praktikave të korporatave të përzgjedhura në Shqipëri me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm përmes integritetit të praktikave të qëndrueshmërisë.
- **Variablat e pavarura:**
 - A – Reduktimi i Emetimeve Karbonike dhe Menaxhimi i Zinxhirit të Furnizimit.
 - B – Gjithëpërfshirja dhe Angazhimi në Komunitet.
 - C – Investimet Sociale dhe Menaxhimi i Palëve të Interesuara.
 - D – Transparenca, Raportimi dhe Respektimi i të Drejtave të Njeriut.

Secili variabël operacionalizohet përmes indikatorëve të matshëm të ndërtuar mbi bazën e kornizës teorike të ndërtuar dhe analizuar në kapitullin e dytë dhe në kapitullin e tretë

2.2. Operacionalizimi i modelit analitik dhe instrumenti i mbledhjes së të dhënave

Të dhënat janë mbledhur përmes një ankete “Aneksi A” të strukturuar dhe elektronike që përbën instrumentin e mbledhjes së të dhënave. Anketa mundëson mbledhjen e vlerësimeve mbi angazhimin e sipërmarrjeve në përgjegjësinë sociale dhe zhvillimin e qëndrueshëm, që bazohet në 5 (pesë) shtylla ku ndërthuren 10 (dhjetë) tipologji indikatorësh. Instrumenti “Anketa elektronike - Aneksi A” përbëhet nga seksionet kryesore:

- **Seksioni I.** Ky seksion përmban të dhëna demografike dhe karakteristika të përgjithshme të të anketuarve, duke përfshirë moshën e tyre, marrëdhënien me sipërmarrjen, kualifikimet arsimore përkatëse si dhe sektorin, vendndodhjen, origjinën dhe statusin e sipërmarrjes private apo publike, etj.
- ☐ **Seksioni II.** Ky seksion përmban pohime të strukturuar sipas pesë shtyllave “A - B - C - D - E” që përbën thelbin e anketës. Ai eksploron perceptimin publik në 5 (pesë)

shtylla “A – B – C - D – E” lidhur me angazhimin e sipërmarrjeve në përgjegjësinë sociale dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Çdo shtyllë e anketës përmban 8 (tetë) elementë si vijon:

A. Reduktimi i Emetimeve Karbonike dhe Menaxhimi i Zinxhirit të Furnizimit:

A1. Subjekti sipërmarrës ka implementuar strategjinë me "objektiv neto zero", me qëllim reduktimin e emetimeve karbonike, sikurse nxit sjelljen e qëndrueshme brenda saj si përdorimi i transportit publik ose puna nga shtëpia?

A2. Subjekti sipërmarrës përdor burimet e rinovueshme të energjisë diellore, eolike dhe hidroelektrike në proceset e saj të brendshme në mënyrë që të kontribuojë në mbrojtjen e mjedisit?

A3. Subjekti sipërmarrës diskuton vazhdimisht me punonjësit dhe drejtuesit mbi nevojën e ndërmarrjes së iniciativave që reduktojnë emetimin karbonik dhe përmirësojnë efikasitetin energjetik në proceset e prodhimit dhe në logjistikë?

A4. Subjekti sipërmarrës operon në sinergji me furnitorët dhe klientët lidhur me mundësitë e reduktimit të emetimeve karbonike përgjatë zinxhirit të furnizimit?

A5. Subjekti sipërmarrës promovon praktikat kërkimore mbi zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve të qëndrueshme si dhe përdor inteligjencën artificiale (AI) dhe pajisje specifike (IoT) për të monitoruar dhe optimizuar emetimet në kohë reale?

A6. Subjekti sipërmarrës angazhon palët e interesuara si punonjësit, komunitetin, investitorët, partnerët, organizatat jo-qeveritare, konsumatorët, etj. në përpjekje për të rritur qëndrueshmërinë e zinxhirit të saj të furnizimit?

A7. Subjekti sipërmarrës zbaton parimet e ekonomisë qarkulluese si riciklimi ose rikuperimi i burimeve në proceset e saj të brendshme si dhe në zinxhirin e furnizimit?

A8. Subjekti sipërmarrës trajton me përgjegjësi rastet e mospërputhjes me standardet sociale ose mjedisore në proceset e saj të brendshme si dhe në zinxhirin e furnizimit?

B. Gjithëpërfshirja dhe Angazhimi në Komunitet:

B1. Menaxhimi i diversitetit social përputhet me misionin dhe vlerat e subjektit sipërmarrës?

B2. Subjekti sipërmarrës siguron përfaqësim të larmishëm në rekrutimin e personelit të saj?

B3. Subjekti sipërmarrës nxit një kulturë gjithëpërfshirëse në vendin e punës në mënyrë që punonjësit të ndihen të vlerësuar dhe të respektuar pavarësisht prejardhjes së tyre?

B4. Subjekti sipërmarrës bashkëpunon me organizata të ndryshme, shkolla profesionale dhe universitete për të nxitur përfshirjen dhe përmirësimin e diversitetit në komunitet, duke mbështetur grupe të ndryshme dhe organizata promovuese që punojnë për barazi dhe përfaqësim të drejtë?

B5. Subjekti sipërmarrës ka prioritet adresimin e çështjeve sociale dhe mjedisore në komunitetin ku operon?

B6. Subjekti sipërmarrës bashkëpunon me palët e interesuara në kontekstin lokal si dhe me drejtuesit e komunitetit për zhvillimin e planeve që synojnë të mbështesin grupet e nënpërfaqësuar ose të marginalizuara?

B7. Subjekti sipërmarrës aspiron të vlerësojë kënaqësinë dhe angazhimin e punonjësve në programet komunitare?

B8. Subjekti sipërmarrës planifikon të përdorë inovacionin si dhe të shtojë angazhimin me komunitetin në të ardhmen për të përcjellë më mirë zërin dhe nevojat e komunitetit?

C. Investimet Sociale dhe Palët e Interesuara:

C1. Investimet që lidhen me aktivitetet sociale janë pjesë integrale e strategjisë së përgjithshme të subjektit sipërmarrës?

C2. Investimet e subjektit sipërmarrës në kontekstin social synojnë të trajtojnë kryesisht çështjet e arsimit, shëndetësisë, mjedisore, inovacionit dhe ato të zbutjes së varfërisë?

C3. Subjekti sipërmarrës ka ndërmarrë iniciativë për të eksploruar fusha në zhvillim si obligacionet e gjelbra dhe mikrofinancat?

C4. Subjekti sipërmarrës angazhon palët e interesuara si punonjësit, komunitetin, investitorët, partnerët, organizatat jo-qeveritare, konsumatorët, etj., në iniciativat e saj lidhur me aktivitetet sociale?

C5. Subjekti sipërmarrës ka përcaktuar rolet e palëve të lidhura si klientë, furnizues dhe konsumatorë në drejtimin e praktikave sociale dhe të qëndrueshme të biznesit?

C6. Punonjësit e subjektit sipërmarrës dhe komuniteti ku ajo bën pjesë kanë mundësi të japin kontribut në zhvillimin e strategjisë sociale dhe të qëndrueshme?

C7. Subjekti sipërmarrës ka vendosur kërkesa specifike sa i takon furnitorëve në lidhje me praktikën e punës, qëndrueshmërinë mjedisore dhe sjelljen etike?

C8. Komunitetet lokale luajnë një rol aktiv në krijimin e programeve të përgjegjësisë sociale të subjektit sipërmarrës?

D. Transparenca, Raportimi dhe Pajtueshmëria me të Drejtat e Njeriut:

D1. Subjekti sipërmarrës bën publik informacionin në lidhje me investimet, mjedisin dhe përgjegjësinë e saj sociale: subjekti sipërmarrës trajton informacione të ndjeshme ose negative në raportimin lidhur me përgjegjësinë e tij sociale, identifikon përparimin e bërë për qëllimet sociale dhe mjedisore, diskuton historitë e suksesit si dhe krahason praktikën e transparencës kundrejt standardeve globale ose specifike të industrisë?

D2. Subjekti sipërmarrës siguron që raportet e tij të transparencës të jenë të aksesueshme dhe të kuptueshme për të gjithë palët e interesuara si aksionerët, punonjësit, komunitetin, qeverisjen vendore e qendrore, etj.?

D3. Kanale të ndryshme komunikimi përdoren për të ofruar përditësime mbi aktivitetet e lidhura me përgjegjësinë sociale të subjektit sipërmarrës dhe praktikën e zhvillimit të qëndrueshëm si media sociale, postera, faqe web, etj.?

D4. Subjekti sipërmarrës përdor shërbimet teknologjike si analizat e të dhënave ose blockchain për të rritur transparencën e raportimit?

D5. Kornizat ndërkombëtare drejojnë praktikën e subjektit sipërmarrës në respektim të të drejtave të njeriut (p.sh., Parimet Udhëzuese të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut, Konventat e Zyrës Ndërkombëtare të Punës, etj.)?

D6. Subjekti sipërmarrës konsultohet dhe bashkëpunon me organizata të ndryshme ose ekspertë të fushës për të përmirësuar respektimin e të drejtave të njeriut dhe për të shmangur veprimet e tij që mund të shkaktojnë dëm për komunitetet lokale ose punonjësit?

D7. Subjekti sipërmarrës garanton që mekanizmat e ankimimit të jenë në dispozicion për individët e prekur me qëllim që të raportohen rastet e shkeljes së të drejtave të njeriut?

D8. Subjekti sipërmarrës trajton me prioritetet kontradiktat ndërmjet synimeve të biznesit dhe detyrimeve ndaj të drejtave të njeriut?

E. Përafrimi me Objektivat dhe Praktikën e Zhvillimit Ekonomik të Qëndrueshëm:

E1. Subjekti sipërmarrës bashkëpunon me qeverinë, organizatat jo-qeveritare ose biznese të tjera për të avancuar lidhur me Objektivat e Përbashkëta të Zhvillimit të Qëndrueshëm?

E2. Subjekti sipërmarrës rrit ndërgjegjësimin lidhur me objektivat e përbashkëta të zhvillimit të qëndrueshëm midis punonjësve, klientëve dhe furnitorëve?

E3. Subjekti sipërmarrës ndërmerr veprime për të avancuar lidhur me çështjen e barazisë gjinore sa i takon menaxhimin të fuqisë punëtore?

E4. Subjekti sipërmarrës siguron që partneritetet e formuara lidhur me objektivat e përbashkëta të zhvillimit të qëndrueshëm të jenë reciprokisht të dobishme dhe me ndikim sikurse kërkon të balancojë prioritetet globale me nismat e saj lokale?

E5. Subjekti sipërmarrës identifikon dhe vendos prioritetet në fushat e zhvillimit social, mjedisor dhe ekonomik?

E6. Subjekti sipërmarrës trajton konfliktet midis qëllimeve të fitimit dhe objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe përgjegjësisë sociale?

E7. Subjekti sipërmarrës mbështet qasje dhe teknologji inovative për të avancuar lidhur me zhvillimin e qëndrueshëm dhe përgjegjësinë sociale?

E8. Subjekti sipërmarrës vetë angazhohet për auditim të jashtëm sa i takon iniciativave lidhur me zhvillimin e qëndrueshëm dhe përgjegjësinë sociale në kuadër të transparencës dhe llogaridhënies?

Seicili pohim për çdo shtyllë matet përmes shkallës Likert me pesë nivele “1–5”, ku shkalla 1 (një) përfaqëson nivelin më të ulët të pajtueshmërisë dhe shkalla 5 (pesë) nivelin më të lartë. Për shkak të natyrës rendore të të dhënave, analiza inferenciale mbështetet në modele regresioni rendor dhe logjistik rendor të përgjithshëm.

2.3. Strategjia e analizës statistikore

Analiza e të dhënave realizohet në disa faza:

1. Statistika përshkruese për shpërndarjen e kampionit dhe përgjigjeve.
2. Testimi i qëndrueshmërisë së brendshme të instrumentit si koeficienti i besueshmërisë.
3. Vlerësimi i modelit përmes regresionit rendor.
4. Testimi i hipotezës me nivel domethënieje 5% dhe interval besimi 95%.

Modeli synon të vlerësojë nëse variablat e pavarur “A”, “B”, “C” dhe “D” ushtrojnë një ndikim statistikisht domethënës mbi variablin e varur “E”, çka do të trajtohet më tej në mënyrë të detajuar në nënçështjen e hipotezave të studimit.

2.4. Hipoteza e studimit

Në këtë studim hipotezat janë formuluar për të testuar ndikimin e pesë dimensioneve kryesore të angazhimit të subjektit sipërmarrës mbi perceptimin publik të përafrimit të sipërmarrjeve të përzgjedhura në Shqipëri me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm. Për këtë qëllim, përdoret modeli i regresionit rendor në të cilin variablat e pavarur përfaqësojnë dimensionet e angazhimit të sipërmarrjeve, ndërsa variabli i varur mat perceptimin publik mbi përafrimin me objektivat e qëndrueshmërisë. Hipotezat e mëposhtme synojnë të vlerësojnë nëse secili dimension ka ndikim pozitiv dhe statistikisht të rëndësishëm në perceptimin publik.

Hipoteza 0 (H0):

- Në modelin e regresionit rendor, koeficientët e variablave të pavarur që përfaqësojnë dimensionin mjedisor, shoqëror, institucional dhe ekonomik nuk janë statistikisht të rëndësishëm ($\beta_1 = \beta_2 = \beta_3 = \beta_4 = 0$), çka nënkupton se këto dimensione nuk ushtrojnë ndikim domethënës në perceptimin mbi përafrimin e sipërmarrjeve të përzgjedhura në Shqipëri me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Hipotezat alternative (H1-H4):

- **H1:** Koeficienti i variablit (β_1), i cili përfaqëson angazhimin e sipërmarrjeve në reduktimin e emetimeve të karbonit dhe në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit, është pozitiv dhe statistikisht i rëndësishëm në modelin e regresionit rendor, duke treguar ndikim domethënës në perceptimin publik mbi përafrimin e sipërmarrjeve me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.
- **H2:** Koeficienti i variablit (β_2), i cili përfaqëson gjithëpërfshirjen dhe angazhimin e sipërmarrjeve në komunitet, është pozitiv dhe statistikisht i rëndësishëm në modelin e regresionit rendor, duke treguar ndikim domethënës në perceptimin publik mbi përafrimin e sipërmarrjeve me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

- **H3:** Koeficienti i variablit (β_3), i cili përfaqëson investimet sociale dhe angazhimin e sipërmarrjeve me palët e interesuara, është pozitiv dhe statistikisht i rëndësishëm në modelin e regresionit rendor, duke treguar ndikim domethënës në perceptimin publik mbi përafrimin e sipërmarrjeve me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.
- **H4:** Koeficienti i variablit (β_4), i cili përfaqëson transparencën, raportimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut është pozitiv dhe statistikisht i rëndësishëm në modelin e regresionit rendor, duke treguar ndikim domethënës në perceptimin publik mbi përafrimin e sipërmarrjeve me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Hipoteza qendrore e studimit synon të vlerësojë nëse këto pesë dimensionet ndikojnë në perceptimin publik mbi përafrimin e sipërmarrjeve me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe integrimin e praktikave të qëndrueshmërisë. Konkretisht, shqyrtohet ndikimi i dimensioneve të mëposhtme:

- A. Reduktimi i Emetimeve të Karbonit dhe Menaxhimi i Zinxhirit të Furnizimit.
- B. Përfshirja dhe Angazhimi në Komunitet.
- C. Investimet Sociale dhe Palët e Interesit.
- D. Transparenca, Raportimi dhe Pajtueshmëria me të Drejtat e Njeriut.

Më tej, ndikimi i secilës shtyllë vlerësohet mbi **variablin e varur “E”**, i cili mat nivelin e perceptuar të përafrimit të sipërmarrjeve me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, duke mundësuar testimin e efektit pozitiv dhe statistikisht të rëndësishëm të secilit dimension në perceptimin publik.

Hipoteza qendrore e studimit paraqitet si vijon:

$$H_0: E_{(1-8)it} = \beta_0 + \beta_1 A_{(1-8)it} + \beta_2 B_{(1-8)it} + \beta_3 C_{(1-8)it} + \beta_4 D_{(1-8)it} + \mu_{it}.$$




Figura I: Diagramë e Analizës së Efektit Vlerësues midis Fokus-Grupeve




Figura II: Diagramë e Qasjes Statistike të Studimit që përfshin Fokus Grupet

3. Popullata e Studimit dhe Korniza e Kampionit

Popullata e këtij studimi përbëhet nga të gjitha shoqëritë tregtare të mëdha dhe të mesme që operojnë në Shqipëri dhe që plotësojnë kriteret e përcaktuara në Ligjin nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”²⁹ sipas të cilit, për t’u konsideruar biznes i madh ose i mesëm subjekti duhet të tejkalojë të paktën dy nga tre kriteret e mëposhtme: 1. Totali i aktiveve - 750 milionë lekë; 2. Qarkullimi vjetor - 1,500 milionë lekë; 3. Numri mesatar i punonjësve gjatë vitit - 250 punonjës.

Korniza e kampionit u ndërtua duke identifikuar subjekte sipërmarrëse nga sektori i prodhimit, shërbimeve, tregtisë dhe ndërtimit, të cilat kishin selinë e tyre ligjore në qytete të ndryshme të Shqipërisë, përfshirë kryeqytetin Tiranën, si dhe qytetet Elbasanin, Fierin, Vlorën, Lushnjën, Shkodrën dhe Korçën. Përveç shoqërive tregtare me ortakë/aksionarë shqiptarë, në kampion u përfshinë edhe shoqëri tregtare me ortakë/aksionarë me origjinë të huaj nga shtetet si Turqia, Holanda, Ishujt Kajman, Sllovenia, Zvicra, Austria, Qiproja, Serbia, Hungaria, Franca, Italia, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Koreja e Jugut dhe Libani. Që të gjitha shoqëritë tregtare rezultojnë të jenë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe të kenë selinë e tyre ligjore në Shqipëri.

Për të mbledhur të dhënat empirike u kontaktuan 120 (njëqind e njëzet) individë të lidhur me këto sipërmarrje, përfshirë drejtues, menaxherë dhe punonjës, të cilët mund të jepnin vlerësime mbi angazhimin e sipërmarrjeve në përgjegjësinë sociale dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Përzgjedhja e individëve u bë duke ndjekur një *qasje të përzier*, me elementë të rastësisë brenda kornizës së disponueshme dhe duke siguruar përfaqësim nga sektorë dhe pozicione të ndryshme, me qëllim të shmangies së mbivendosjes së vlerësimeve dhe sigurimit të një variacioni të mjaftueshëm të perceptimeve.

Madhësia e kampionit u përcaktua duke balancuar kapacitetin mbledhës të të dhënave, heterogjenitetin e sektorëve dhe qyteteve të përfshira, si dhe mundësinë e kryerjes së analizave statistikore për 40 elementët përbërës të modelit studimor. Në këtë mënyrë, kampioni siguron një mbulim të konsiderueshëm të popullatës dhe premisat për të nxjerrë vlerësime të besueshme mbi perceptimin e publikut dhe palëve të interesuara.

3.1. Mbledhja e të dhënave të studimit dhe karakteristikat e kampionit

Për të mbledhur të dhënat empirike, ky studim përdori dy teknika:

1. Anketimin elektronik; 2. Fokus-grupet.

Anketimi elektronik u shpërnda përgjatë një periudhe dy-mujore, nga 31 tetor 2024 deri më 31 dhjetor 2024, duke përdorur adresat zyrtare të postës elektronike të individëve të përzgjedhur brenda kampionit. Nga një total prej 120 (njëqind e njëzet) individësh të kontaktuar, **92 (nëntëdhjetë e dy)** dhanë përgjigjet e tyre, duke siguruar të dhëna mbi perceptimin e angazhimit të sipërmarrjeve në përgjegjësinë sociale dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

²⁹ Fletore Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, nr. 79, datë 30.05.2018. Për më shumë: <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2018/05/10/25>

Anketimi përfshiu **pjesëmarrës nga kategori të ndryshme profesionale**: drejtues korporatash (15), punonjës (27), klientë (17), furnitorë (28) dhe partnerë (5). Kategoria e partnerëve përfshinte ekspertë të politikave ekonomike, akademikë, ekspertë kontabël, vlerësues ndërkombëtar projektsh dhe menaxherë të organizatave jo-qeveritare. Këto grupe u përdorën gjithashtu për të organizuar **pesë fokus-grupe thelbësore**, të cilat thelluan analizën cilësore të perceptimeve mbi angazhimin e korporatave.

Karakteristikat demografike të pjesëmarrësve reflektojnë diversitetin e kampionit.

Lidhur me moshën rezultoi se pjesëmarrësit u grupuan si në vijim:

- a. 29.65% nga 18–25 vjeç.
- b. 23.59% nga 26–34 vjeç.
- c. 31.52% nga 35–44 vjeç.
- d. 15.21% nga 45–54 vjeç.
- e. 0.02% nga 55–64 vjeç.
- f. 0.01% mbi 65 vjeç.

Për kualifikimet arsimore rezultoi se:

- a. 28.26% ishin të diplomuar me Diplomë Bachelor.
- b. 19.56% ishin të diplomuar me Diplomë Master Profesional.
- c. 46.74% ishin të diplomuar me Diplomë Master i Shkencave.
- d. 3.26% ishin të diplomuar në ciklin e tretë të studimeve “Doktoratë”.
- e. 2.18% ishin të promovuar në nivel akademik me titullin “Profesor” ose “Profesor i Asociuar”.

Ky strukturim i kampionit dhe përdorimi i dy metodave të mbledhjes së të dhënave krijojnë një bazë të qëndrueshme për analizimin e perceptimeve të publikut dhe palëve të interesuara, duke siguruar një kombinim të të dhënave **sasiore dhe cilësore** që mbështesin hipotezat e studimit.




Figura III: Diagramë e Shpërndarjes së Pjesëmarrësve sipas Moshës dhe Nivelit të Arsimit

Burimi: Llogaritje të autores

Anketa përdor shkallën e vlerësimit Likert që varion nga 1 (një) në 5 (pesë) me përshkrimin si në vijim: 1 = nuk jam plotësisht dakord (SD); 2 = nuk jam dakord (D); 3 = i pavendosur (U); 4 = dakord (A); 5 = jam plotësisht dakord (SA). Kështu, të anketuarit dhanë vlerësimet e tyre për 40 (dyzet) elementë kërkimorë të grupuar në 5 (pesë) shtyllat e studimit. Të dhënat u analizuan duke përdorur programin statistikor SPSS 20 (SPSS Inc., Chicago, IL).

3.2. Analiza e të dhënave

Në lidhje me të gjithë elementet e studimit, fillimisht, bëjmë vlerësimet e efektit për secilin fokus grup (drejtues korporatash, punonjës, klientë, furnitorë dhe partnerë), duke përdorur analizën e madhësisë së efektit. Kjo e fundit bëhet e mundur duke vlerësuar madhësinë e efektit (d) të Cohen³⁰ në intervalin e besimit 95% (Maher et al., 2013). Analiza e madhësisë së efektit ndihmon për të kuptuar se cili është perceptimi publik i qasjes së korporatave ndaj përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm, edhe nga këndvështrimi i secilit fokus grup.

Ndërsa për të vlerësuar hipotezën e kërkimit: $H_0: E_{(1-8)it} = \beta_0 + \beta_1 A_{(1-8)it} + \beta_2 B_{(1-8)it} + \beta_3 C_{(1-8)it} + \beta_4 D_{(1-8)it} + \mu_{it}$, në intervalin e besimit 95%, përdoren testet e Shapiro-Wilk (1968)³¹ dhe Kolmogorov-Smirnov³². Nëpërmjet rezultateve të testeve identifikohet shpërndarja e të dhënave të studimit, pasi kjo e fundit luan rol vendimtar në gjetjen e formës funksionale statistikore të përshtatshme për vlerësim.

Prërdhimisht, për të vlerësuar nëse: Reduktimi i Emetimeve të Karbonit dhe Menaxhimi i Zinxhirit të Furnizimit **(A)**, Përfshirja dhe Angazhimi i Komunitetit **(B)**, Investimet Sociale dhe Palët e Interesit **(C)**, si dhe Transparenca, Raportimi dhe Pajtuëshmëria me të Drejtat e Njeriut **(D)** ndikojnë në përafrimin e korporatës me Objektivat dhe Praktikën e Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik **(E)**, përdoret analiza e regresionit rendor dhe ajo e regresionit logistik rendor të përgjithshëm.

Regresioni rendor është i përshtatshëm kur variabli i varur është i natyrës rendore dhe lejon modelimin e probabilitetit të përkatësisë në kategori më të larta të rezultatit (Agresti, 2010; Hosmer, Lemeshow & Sturdivant, 2013). Në rastet kur supozimi i proporcionalitetit të shanseve kërkon verifikim ose relaksim aplikohet regresioni logjistik rendor i përgjithshëm i cili mundëson vlerësim më fleksibël të marrëdhënieve ndërmjet variablave (Williams, 2006; Long & Freese, 2014).

³⁰ Llogaritja e madhësisë së efektit d të Cohen = $d(M1-M2) / (s1^2+s2^2)^{1/2}$. Madhësia mesatare e efektit konsiderohet e vogël (≥ 0.2), e mesme ($0.2 < X < 0.8$) dhe e madhe (≥ 0.8).

³¹ Testi Shapiro-Wilk, i propozuar nga Samuel Shapiro dhe Martin Wilk në vitin 1968, është një metodë statistikore që përdoret për të vlerësuar normalitetin e një grupi të dhënash. Ky test është shumë popullor për shkak të efikasitetit të tij dhe përshtatshmërisë për mostra të vogla dhe të mesme si në rastin konkret.

³² Testi Kolmogorov-Smirnov (K-S) përdoret shpesh në statistika për të vlerësuar nëse një grup të dhënash përputhet me një shpërndarje teorike. Pra, krahasohet shpërndarja empirike e të dhënave me atë teorike (normale në këtë rast). Një nga avantazhet e këtij testi është aspekti jo parametrik që do të thotë se nuk ka nevojë për supozime specifike mbi shpërndarjen e të dhënave, çka e bën atë të përshtatshëm për një gamë të gjerë aplikacionesh.

Së pari, analiza e regresionit rendor aplikohet për të kuptuar marrëdhënien midis variablave të pavarur (**A, B, C dhe D**) dhe variablit të varur rendor (**E**). Kjo qasje modelon probabilitetet e kategorive të ndryshme të rezultatit rendor (**E**), duke ofruar vlerësime mbi mënyrën se si variablat e pavarur (**A, B, C dhe D**) ndikojnë në mundësitë për t'u alokuar në kategori më të larta ose më të ulëta. Për të konfirmuar sjelljen e të dhënave sipas formës funksionale të regresionit rendor përdorim Testin e Linjave Paralele³³ (Erkan & Yildiz, 2014).

Në përputhje me rezultatet e gjeneruara më lart kryhet analiza e regresionit logjistik rendor të përgjithshëm. Kjo metodë është një trajtë e specializuar e regresionit rendor dhe funksionon sipas supozimit proporcional. Ky i fundit vlen kur marrëdhënia midis çdo çifti të kategorive të rezultateve (variabli i pavaruar kundrejt variablit të varur) mbetet e qëndrueshme. Ai vlerëson shanset e përkatësisë në një kategori më të lartë krahasuar me të gjitha kategoritë më të ulëta të kombinuara, duke ofruar vlerësime të vlefshme. Këtu na vjen në ndihmë Testi Omnibus³⁴ (Doornik & Hansen, 2008). Ky test ndihmon në të kuptuarit nëse ndonjë grup i veçantë vlerësimi ose kombinim grupesh ka një ndikim të rëndësishëm mbi një faktor të caktuar.

Duke përdorur si regresionin rendor ashtu edhe atë logjistik rendor të përgjithshëm, analiza merr në konsideratë supozime të ndryshme dhe siguron një vlerësim të plotë të hipotezës kërkimore të studimit. Gjithashtu, kjo qasje e dyfishtë rrit gjithëpërfshirjen dhe besueshmërinë e gjetjeve duke përshtatur kërkesat e ndryshme të modelimit dhe forcuar analizën e përgjithshmenë të të dhënave studimore. Për të kuptuar më tej vlerësimet e regresionit logjistik rendor të përgjithshëm analizojmë për secilën nga shtyllat e hipotezës matricën e korrelacioneve Spearman-it³⁵.

Procedura statistikore e mësipërme përdoret edhe për vlerësimin e perceptimit publik në përgjithësi si dhe për secilin fokus grup në lidhje me angazhimin e sipërmarrjeve në përgjegjësinë sociale dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Kështu, marrim përkatësisht perceptimin e drejtuesve, partnerëve, klientëve, furnitorëve dhe punonjësve si palë të lidhura me sipërmarrjet.

Të dhënat e mbledhura për secilin element të shtyllave (**A/B/C/D dhe E, nga 1 në 8**) vlerësohen duke përdorur vlerësime mesatare dhe rrumbullakosen në numrin e plotë më të afërt. Ky transformim mundësohet pasi e thjeshton interpretimin, veçanërisht, për

³³ Testi i linjave paralele është një metodë statistikore që përdoret për të vlerësuar vlefshmërinë e një testi matës duke krahasuar rezultatet e tij me ato të një testi referencë (ose testi standard). Konkretisht, ky test ndihmon për të kuptuar qëndrueshmërinë e parametrave të vlerësuar në kategoritë e përgjigjeve për e variablin e varur.

³⁴ Testi Omnibus është një metodë statistikore e përdorur për të kryer testime hipotezash. Në kontekstin e regresionit të shumëfishtë, testi Omnibus ndihmon në vlerësimin nëse variablat e pavarur së bashku kontribuojnë në parashikimin e variablit të varur.

³⁵ Korrelacioni Spearman është një masë statistike që përdoret për të vlerësuar forcën dhe drejtimin e marrëdhënies monotone midis dy variablave. Gjithashtu, ai mund të përdoret për të krahasuar variablat brenda grupeve. Ky korrelacion mat marrëdhëniet monotone që do të thotë se ndihmon në identifikimin e situatave ku një variabël rritet ndërsa tjetri gjithashtu rritet (ose zvogëlohet), përveç marrëdhënieve lineare (multikolinearitetin). Ai është veçanërisht i dobishëm kur variablat janë të renditur (si në rastin konkret) ose kur shprehen në forma të tjera që nuk janë numerike por që mund të renditen.

përdoruesit që mund të kenë vështirësi në interpretimin e vlerave të shkallës Likert, si ato në një shkallë 5-pikëshe.

3.3. Arsyetimi metodologjik për përzgjedhjen e regresionit rendor dhe regresionit logjistik rendor të përgjithshëm

Qëllimi kryesor i analizës empirike në këtë studim është vlerësimi i ndikimit të katër dimensioneve të përgjegjësisë dhe qëndrueshmërisë së sipërmarrjeve të përzgjedhura në Shqipëri: - Reduktimi i Emetimeve të Karbonit dhe Menaxhimi i Zinxhirit të Furnizimit **(A)**, Përfshirja dhe Angazhimi i Komunitetit **(B)**, Investimet Sociale dhe Palët e Interesit **(C)**, si dhe Transparenca, Raportimi dhe Pajtueshmëria me të Drejtat e Njeriut **(D)** - mbi nivelin e përafrimit të sipërmarrjeve me Objektivat dhe Praktikrat e Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik **(E)**.

Struktura e modelit kërkimor përcaktohet nga natyra e variablit të varur. Variabli **(E)** është operacionalizuar përmes një shkalle vlerësimi të tipit Likert, e cila përfaqëson kategori të renditura (p.sh., nivel shumë i ulët deri në nivel shumë i lartë përafrimi). Këto kategori kanë rend, por nuk garantojnë distanca të barabarta midis tyre. Për këtë arsye, trajtimi i tyre si variabël i vazhdueshëm do të implikonte supozime të forta mbi linearitetin dhe intervalet e barabarta të cilat nuk mund të justifikohen metodologjikisht në kontekstin e këtij studimi.

Në analizat ku variabli i varur është i natyrës rendore, regresioni linear klasik nuk është i përshtatshëm për shkak të shkeljes së supozimeve themelore mbi shpërndarjen normale të gabimit, homoskedasticitetin dhe linearitetin e marrëdhënieve. Në vend të kësaj kërkohet një teknikë që ruan rendin e kategorive dhe modelon probabilitetin e përkatësisë në kategori më të larta ose më të ulëta të rezultatit. Në këtë kontekst, regresioni rendor përfaqëson një zgjedhje metodologjike koherente.

Regresioni rendor lejon modelimin e funksionit kumulativ të probabilitetit që një njësi (në këtë rast një sipërmarrje) të pozicionohet në një kategori të caktuar ose më të lartë të variablit të varur, në varësi të ndryshimeve në variablat e pavarur. Kjo qasje është veçanërisht e përshtatshme për analiza të bazuara në të dhëna anketimi, ku perceptimet, praktikrat ose nivelet e angazhimit maten nëpërmjet shkallëve të strukturuar rendore.

Për më tepër, struktura teorike e modelit të këtij studimi sugjeron se ndikimi i katër dimensioneve të qëndrueshmërisë mund të rrisë probabilitetin që një korporatë të kalojë nga nivele më të ulëta në nivele më të larta të përafrimit me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik. Pikërisht ky lloj tranzicioni ndërmjet niveleve rendore është objekti i drejtpërdrejtë i modelimit përmes regresionit logjistik rendor.

Një nga supozimet themelore të modelit të regresionit logjistik rendor është proporcionaliteti i shanseve (*proportional odds assumption*), sipas të cilit raporti i shanseve midis kategorive të ndryshme të variablit të varur mbetet konstant përgjatë pragjeve të modelit. Në terma praktikë kjo do të thotë se ndikimi i një variabli të pavarur mbi kalimin nga kategori më të ulëta në më të larta është i njëjtë pavarësisht nga pika e ndarjes ndërmjet kategorive.

Megjithatë, në analiza empirike që përfshijnë struktura komplekse si përgjegjësia sociale e sipërmarrjeve dhe zhvillimi i qëndrueshëm, ky supozim nuk është gjithmonë i garantuar. Ndikimi, për shembull, i transparencës dhe raportimit mund të jetë më i fortë në dallimin ndërmjet niveleve të ulëta dhe mesatare, por më i moderuar në dallimin ndërmjet niveleve të mesme dhe shumë të larta të përafrimit. Për këtë arsye, verifikimi i supozimit të proporcionalitetit përbën një hap të domosdoshëm metodologjik.

Në kuadër të këtij studimi u aplikua Testi i Linjave Paralele për të vlerësuar nëse modeli standard i regresionit logjistik rendor përmbushte këtë supozim. Në rastet kur rezultatet e testit sinjalizuan devijime potenciale nga proporcionaliteti i shanseve u konsiderua përdorimi i regresionit logjistik rendor të përgjithshëm.

Regresioni logjistik rendor i përgjithshëm ofron një strukturë më fleksibël modelimi, duke lejuar që koeficientët e variablave të pavarur të ndryshojnë përgjatë pragjeve të ndryshme të variablit të varur. Kjo qasje redukton rrezikun e specifikimit të gabuar të modelit dhe mundëson kapjen e efekteve heterogjene të dimensioneve të qëndrueshmërisë mbi nivele të ndryshme të përafrimit me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.

Zgjedhja për të aplikuar si regresionin rendor standard ashtu edhe variantin e përgjithshëm nuk është thjesht një zgjerim teknik, por një masë për të garantuar qëndrueshmërinë e rezultateve. Krahësimi i modeleve lejon vlerësimin nëse përfundimet empirike mbeten të qëndrueshme nën specifikime alternative dhe nëse marrëdhëniet e identifikuar janë të ndjeshme ndaj strukturës së supozimeve statistikore.

Nga perspektiva epistemologjike, kjo qasje i shërben forcimit të vlefshmërisë së brendshme të studimit. Duke përdorur modele të përshtatura me natyrën rendore të të dhënave dhe duke testuar në mënyrë eksplicite supozimet e tyre shmanget rreziku i mbivlerësimit të efekteve ose interpretimeve të pasakta të lidhjeve shkakësore.

Në përfundim, përzgjedhja e regresionit rendor dhe regresionit logjistik rendor të përgjithshëm në këtë studim është rezultat i një procesi arsyetimi metodologjik të bazuar në: (i) natyrën rendore të variablit të varur; (ii) strukturën konceptuale të modelit kërkimor; (iii) nevojën për modelim të mundshëm të kalimit ndërmjet niveleve të zhvillimit të qëndrueshëm; (iv) verifikimin dhe, nëse është e nevojshme, konfirmimin e supozimit të proporcionalitetit të shanseve; (v) sigurimin e qëndrueshmërisë së rezultateve empirike.

Kjo qasje metodologjike garanton që analiza statistikore të jetë e përshtatur me karakteristikat e të dhënave, koherente me literaturën bashkëkohore të modelimit të variablave rendorë dhe e aftë të prodhojë përfundime të besueshme për testimin e hipotezave të studimit.

4. Konkluzione

Në përfundim, ky kapitull ka ndërtuar në mënyrë të strukturuar dhe të argumentuar strukturën metodologjike të studimit, duke siguruar lidhjen logjike ndërmjet kornizës teorike dhe analizës empirike. Përmes përcaktimit të qasjes filozofike brenda paradigmes pozitiviste dhe post-pozitiviste, studimi pozicionohet qartë në një traditë kërkimore që

synon matjen, testimin dhe verifikimin e marrëdhënieve ndërmjet variablave. Modeli empirik i ndërtuar operacionalizon dimensionet kryesore të përgjegjësisë sociale të sipërmarrjeve në tregues të matshëm, duke i vendosur ato në raport të drejtpërdrejtë me perceptimin publik mbi përafrimin me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Përzgjedhja e regresionit rendor dhe regresionit logjistik rendor të përgjithshëm justifikohet nga natyra rendore e të dhënave dhe nga nevoja për një analizë statistikore të përshtatshme dhe të besueshme. Procedurat e testimit të normalitetit, verifikimi i supozimeve të modelit dhe përdorimi i analizave plotësuese si madhësia e efektit dhe korrelacioni Spearman-it rrisin rigorozitetin metodologjik dhe forcojnë vlefshmërinë e gjetjeve. Gjithashtu, kombinimi i anketimit elektronik me fokus-grupet kontribuon në një qasje më gjithëpërfshirëse, duke integruar dimensionin sasior me elementë interpretues.

Korniza e kampionit dhe përfshirja e grupeve të ndryshme të interesit – drejtues, punonjës, klientë, furnitorë dhe partnerë – krijojnë premisat për një analizë të thelluar krahasuese të perceptimeve duke rritur potencialin shpjegues të modelit. Në këtë mënyrë, kapitulli demonstroi se studimi mbështetet mbi një strukturë metodologjike koherente, të argumentuar dhe statistikisht të justifikuar, e cila mundëson testimin e hipotezave kërkimore dhe krijon kushtet për nxjerrjen e përfundimeve të besueshme mbi ndikimin e dimensioneve të përgjegjësisë sociale në perceptimin publik në kontekstin shqiptar.

KAPITULLI V

REZULTATET E STUDIMIT PËR VLERËSIMIN E PERCEPTIMIT PUBLIK MBI ANGAZHIMIN E SIPËRMARRJEVE TË PËRZGJEDHURA NË SHQIPËRI NË FUSHËN E PËRGJEGJËSISË SOCIALE DHE ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM

1. Hyrje

Analiza empirike e të dhënave të mbledhura në kuadër të këtij studimi synon të verifikojë në mënyrë sistematike marrëdhënien ndërmjet dimensioneve të përgjegjësisë sociale të sipërmarrjes dhe nivelit të përafrimit të saj me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm. Në përputhje me kornizën konceptuale të ndërtuar në kapitujt pararendës dhe me modelin metodologjik të operacionalizuar në këtë kapitull, rezultatet paraqiten fillimisht në mënyrë përshkruese për të ofruar një panoramë të përgjithshme të perceptimeve të palëve të interesit, të cilat më pas analizohen në mënyrë inferenciale përmes modeleve statistikore të përzgjedhura.

Qasja e zbatuar në këtë kapitull synon të ndërthurë interpretimin statistikor me analizën konceptuale, duke shmangur një paraqitje thjesht numerike të të dhënave. Rezultatet nuk trajtohen si tregues të izoluar, por si elementë të ndërlidhur brenda një strukture analitike që pasqyron kompleksitetin e ndërveprimit ndërmjet dimensioneve mjedisore, sociale dhe të qeverisjes së sipërmarrjeve. Në këtë mënyrë, analiza empirike shërben jo vetëm për testimin e hipotezave, por edhe për të vlerësuar koherencën ndërmjet deklarimeve strategjike të sipërmarrjeve dhe perceptimit të aktorëve të lidhur me to.

Ky kapitull paraqet rezultatet e përgjithshme të studimit, duke u fokusuar në nivelin e pjesëmarrjes në anketim, në njohjen e planeve strategjike të përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe në vlerësimin mesatar të elementëve të përfshirë në pesë shtyllat analitike të modelit (A, B, C, D, E). Këto rezultate ofrojnë një bazë fillestare për të kuptuar se në cilat dimensionë perceptimi publik është më i konsoliduar dhe në cilat fusha ekziston pasiguri ose natyrë e dyfishtë.

Interpretimi i të dhënave përshkruese lejon identifikimin e tendencave kryesore në qasjen e sipërmarrjeve të përzgjedhura në Shqipëri ndaj përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Në veçanti, diferencat në vlerësimet mes shtyllave mjedisore, sociale dhe të transparencës ofrojnë tregues mbi fushat ku angazhimi perceptohet si më i strukturuar dhe ato ku kërkohet thellim institucional. Këto gjetje paraprake përbëjnë një pikënisje të rëndësishme për analizën e mëtejshme të madhësisë së efektit dhe të modeleve të regresionit, të cilat synojnë të identifikojnë ndikimin relativ të secilit dimension mbi përafrimin e përgjithshëm me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.

Në vijim të këtij kapitulli rezultatet do të analizohen në mënyrë të diferencuar sipas fokus-grupeve të përfshira në studim, me qëllim evidentimin e dallimeve potenciale në perceptim ndërmjet drejtuesve, punonjësve, klientëve, furnitorëve dhe partnerëve. Kjo

qasje shumë-dimensionale rrit thellësinë analitike të studimit dhe kontribuon në një interpretim më të plotë të marrëdhënieve të testuara.

Në këtë kuptim, trajtimi i çështjes së rezultateve nuk kufizohet në raportimin e gjetjeve empirike, por shërben si fazë kritike e integritetit ndërmjet modelit teorik dhe evidencës empirike, duke mundësuar verifikimin e hipotezave kërkimore dhe nxjerrjen e rezultateve të rëndësishme për praktikën e sipërmarrjeve dhe politikëbërjen në kontekstin shqiptar.

2. Rezultatet kërkimore dhe diskutime

Ky nënseksion paraqet dhe analizon në mënyrë të integruar gjetjet empirike të studimit, duke i vendosur ato në raport të drejtpërdrejtë me objektivat, pyetjet kërkimore dhe hipotezat e trajtuara në këtë kapitull. Në këtë nënseksion, të dhënat e mbledhura përpunohen fillimisht në nivel përshkrues për të evidentuar tendencat kryesore dhe perceptimet dominuese të palëve të interesit dhe në vazhdim të dhënat analizohen në nivel inferencial përmes modeleve statistikore të përshtatshme, me qëllim testimin e marrëdhënieve ndërmjet variablave të pavarur dhe variablit të varur. Diskutimi i rezultateve nuk kufizohet në interpretimin numerik të tyre, por synon të vlerësojë koherencën ndërmjet kornizës teorike dhe evidencës empirike, duke nxjerrë konkluzione për praktikën e sipërmarrjeve dhe për thellimin e mëtejshëm të kërkimit në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.

2.1. Rezultate të përgjithshme të studimit

Të dhënat e mbledhura nga studimi dëshmojnë se vetëm 77% e personave të lidhur me sipërmarrjet që veprojnë në vend e të kontaktuar nëpërmjet postës elektronike për këtë studim morën pjesë në anketim. Në 57.6% të rasteve, të anketuarit deklaruan se nuk ishin në dijeni të ndonjë plani strategjik të zbatuar nga sipërmarrja në vlerësim në lidhje me përgjegjësinë sociale dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Ndërsa, përsa i takon vlerësimit të elementeve të studimit vihet re se vetëm për 22.5% të elementeve të studimit të anketuarit janë të pavendosur, ndërsa në 77.5% të elementëve të mbetur të studimit të anketuarit pohojnë se qasja e sipërmarrjeve në vend mbështetet mbi parimet e përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

2.2. Paraqitja statistike e të dhënave

Analiza empirike realizohet në dy faza: Fillimisht, paraqitet analiza statistike përshkruese e variablave, pra, e indikatorëve të agreguar në dimensione, e cila vijon me analizën inferenciale përmes regresionit rendor për të testuar ndërlidhjet midis tyre. Në fazën përshkruese, indikatorët janë agreguar në pesë dimensionet e modelit kërkimor: **(A)** Reduktimi i emetimeve të karbonit dhe menaxhimi i zinxhirit të furnizimit; **(B)** Përfshirja dhe angazhimi i komunitetit; **(C)** Investimet sociale dhe palët e interesuara; **(D)**

Transparenca, raportimi dhe pajtueshmëria me të drejtat e njeriut; **(E)** Përafrimi me praktikatat e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.

Rezultatet tregojnë se:

- **Dimensioni (A)** paraqet vlerësim mesatar më të moderuar krahasuar me dimensionet e tjera, duke reflektuar një qëndrim relativisht neutral të të anketuarve mbi zbatimin e strategjive “net zero”, integrimin e teknologjive për monitorimin e emetimeve dhe zbatimin e parimeve të ekonomisë qarkulluese.
- **Dimensioni (C)**, në mënyrë të ngjashme, shfaq vlerësime më të përmbajtura në elementët që lidhen me inovacionin financiar dhe përfshirjen aktive të komunitetit në programet sociale.
- **Dimensionet (B), (D)** dhe **(E)** paraqesin vlerësime mesatare më të larta, duke treguar një perceptim më pozitiv mbi politikatat e diversitetit dhe gjithëpërfshirjes, praktikatat e raportimit dhe transparencës, si dhe përafrimin strategjik të sipërmarrjeve me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm. Kjo sugjeron se në perceptimin publik, aspektet sociale dhe të qeverisjes janë më të konsoliduara sesa komponenti mjedisor dhe ai i inovacionit të thelluar financiar.
- **Analiza krahasuese sipas grupmoshave** evidenton dallime të dukshme në perceptim. Grupmosha 18–25 vjeç paraqet një vlerësim relativisht pozitiv në të gjitha dimensionet. Grupmoshat 26–34 dhe 45–54 shfaqin vlerësim më të moderuar në dimensionin **(A)**, por më pozitiv në dimensionet e tjera. Ndërkohë, grupmosha 35–44 rezulton më skeptike, me vlerësime më të ulëta në të gjitha dimensionet, çka sugjeron një qëndrim më kritik ndaj praktikave të përgjegjësisë sociale të sipërmarrjeve. Variacioni më i theksuar konstatohet në grupin mbi 65 vjeç, ku perceptimi është pozitiv për dimensionet mjedisore dhe sociale, por dukshëm më kritik për aspektet e transparencës dhe përafrimit strategjik. Këto rezultate përshkruese ofrojnë një panoramë të përgjithshme të perceptimit publik, por nuk japin evidencë mbi fuqinë e ndërlidhjes midis dimensioneve.

Tabela XXIII: Analiza Krahasuese sipas Grup Moshave

Dimensioni	Mesatarja	Interpretimi
A (A1; A3-A8)	3	Qëndrim i pavendosur
B	4	Dakordësi e lartë
C (C3; C8)	3	Perceptim mesatar
D	4	Dakordësi e lartë
E	4	Perceptim pozitiv

2.3. Analiza e ndërlidhjeve përmes regresionit rendor

Për të testuar ndikimin e dimensioneve **(A)**, **(B)**, **(C)** dhe **(D)** mbi variablin e varur **(E)** (përafrimi me praktikatat e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik), u aplikua regresioni rendor dhe regresioni logistik rendor i përgjithshëm. Modeli analizon probabilitetin që një rritje në vlerësimin e praktikave mjedisore, sociale dhe të transparencës të shoqërohet me

rritje të mundësive për një nivel më të lartë të përafrimit strategjik me zhvillimin e qëndrueshëm.

Rezultatet tregojnë se dimensionet që lidhen me përfshirjen sociale dhe transparencën paraqesin ndikim më të fortë në shpjegimin e variablit (E), duke sugjeruar se perceptimi mbi angazhimin social dhe raportimin e përgjegjshëm luajnë rol thelbësor në vlerësimin e përgjithshëm të qëndrueshmërisë së sipërmarrjeve. Dimensioni i investimeve sociale paraqet ndikim të moderuar, ndërsa dimensionin mjedisor rezultojnë me efekt relativisht më të kufizuar, në përputhje me rezultatet përshkruese.

Analiza e madhësisë së efektit konfirmon se, ndonëse disa rezultate janë statistikisht të rëndësishme, fuqia e ndikimit ndryshon ndërmjet dimensioneve, duke treguar se jo të gjithë komponentët kontribuojnë në mënyrë të barabartë në perceptimin e përgjithshëm mbi zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.

2.4. Analiza e perceptimit publik dhe interpretimi i rezultateve

Analiza e të dhënave të mbledhura nga anketa tregon se perceptimi publik mbi qasjet e sipërmarrjeve në lidhje me përgjegjësinë sociale dhe zhvillimin e qëndrueshëm ndryshon në varësi të dimensioneve të studiuara:

- Elementet që lidhen me dimensionet (A1) dhe (A3-A8), si dhe elementët e investimeve sociale dhe angazhimit të palëve të interesuara (C3) dhe C8) janë vlerësuar mesatarisht me 3, duke reflektuar një qëndrim më të rezervuar të të anketuarve. Në të kundërt, dimensionet që lidhen me përfshirjen dhe angazhimin në komunitet (B), transparencën dhe respektimin e të drejtave të njeriut (D), si dhe përafrimin me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm (E) rezultojnë me mesatare 4, duke treguar një nivel më të lartë dakordësie.
- Analiza krahasuese sipas grupmoshave tregon dallime të dukshme në perceptimin e dimensioneve të studimit : - Grupmosha 18–25 vjeç i vlerëson të gjitha dimensionet mesatarisht me 4; - Grupmoshat 26–34 dhe 45–54 vjeç paraqesin një qasje më selektive, duke vlerësuar dimensionin (A) me 3 ndërsa dimensionet e tjera me 4; - Grupmosha 35–44 vjeç rezultojnë më skeptik, me vlerësim mesatar 3 për të gjitha dimensionet; - Grupmoshat 55–64 vjeç dhe mbi 65 vjeç shfaqin tendencë më pozitive në shumicën e dimensioneve, me përjashtim të dimensioneve (D) dhe (E) tek grupi mbi 65 vjeç, ku perceptimi paraqitet relativisht më i ulët.

2.5. Analiza e madhësisë së efektit sipas fokus grupeve

Tabela 3 paraqet analizën e madhësisë së efektit kundrejt personave të lidhur me sipërmarrjet që operojnë në vend apo fokus grupeve. Vlerësimi i madhësisë së efektit për secilin fokus grup është bërë i mundur kundrejt fokus grupit “Drejtues”. Kështu, nëse i referohemi 4 (katër) vlerësimeve të fokus grupeve (Tabela 3) vërehen dallimet statistikisht të rëndësishme në intervalin e besimit 95% për vlerësimet e dhëna nga:

- Drejtuesit kundrejt klientëve: **A1**- Korporata ka implementuar strategjinë me "objektiv neto zero" me qëllim reduktimin e emetimeve karbonike sikurse nxit sjelljen e qëndrueshme brenda saj si përdorimi i transportit publik ose puna nga shtëpia? Cohen`s d vlerësohet 0.016 dhe efekti është i vogël;
- Klientët kundrejt drejtuesve dhe punonjësit kundrejt drejtuesve: **C7**- Sipërmarrja ka vendosur kërkesa specifike sa i takon furnitorëve në lidhje me praktikën e punës, qëndrueshmërinë mjedisore e sjelljen etike? Cohen`s d vlerësohet 1.216 dhe 1.111, respektivisht, efekti është i madh në të dyja rastet;
- Klientët kundrejt drejtuesve dhe punonjësit kundrejt drejtuesve: **C8**- Komunitetet lokale luajnë një rol aktiv në krijimin e programeve të përgjegjësisë sociale të sipërmarrjes? Cohen`s d vlerësohet 1.106 dhe 0.881, respektivisht, efekti është i madh në të dyja rastet;
- Drejtuesit kundrejt klientëve: **D8**- Sipërmarrja trajton me prioritetet kontradiktat ndërmjet synimeve të biznesit dhe detyrimeve ndaj të drejtave të njeriut? Cohen`s d vlerësohet 1.094 dhe efekti është i madh.

Pjesa tjetër e rezultateve të analizës së madhësisë së efektit (Tabela XXV) ndër 5 fokus grupet e studimit tregon se nuk kemi diferenca statistikisht të rëndësishme në intervalin e besimit 95% për vlerësimet e dhëna.

Tabela XXIV: Krahësimi i vlerësimeve të elementeve studimore sipas fokus grupeve

	Drejtorë vs Partnerë (Cohen`s d)	Drejtorë vs Furnitorë (Cohen`s d)	Drejtorë vs Klientë (Cohen`s d)	Drejtorë vs Punonjës (Cohen`s d)
A1	0.733	-0.081	0.016*	0.578
A2	0.067	0.002	-0.18	0.504
A3	1.267	0.876	-0.063	0.615
A4	-0.193	0.658	-0.329	0.496
A5	0.4	-0.014	-0.565	0.385
A6	1.067	-0.033	-0.122	0.319
A7	0.4	-0.171	-0.306	0.363
A8	1.133	-0.002	0.063	0.533
B1	1	-0.021	0.388	-0.089
B2	1.067	0.024	0.078	-0.407
B3	1.333	0.133	0.133	-0.163
B4	1.2	0.371	0.153	-0.163
B5	0.467	-0.355	-0.063	-0.348
B6	0.133	-0.095	-0.314	-0.37
B7	0.6	-0.364	-0.165	-0.141
B8	0.8	-0.164	0.212	-0.015
C1	0.933	0.176	-0.114	-0.096
C2	0.6	-0.064	-0.129	-0.081

C3	0.933	-0.06	-0.431	0.185
C4	1	-0.293	-0.518	-0.289
C5	0.533	-0.51	-0.808	-0.681
C6	0.4	-0.443	-0.918	-0.652
C7	-0.333	-0.726	-1.216*	-1.111*
C8	-0.4	-0.793	-1.106*	-0.881*
D1	0.4	-0.043	0.012	-0.215
D2	0.667	0.024	-0.392	-0.259
D3	0.4	-0.386	-0.482	-0.933
D4	-0.133	-0.376	-0.439	-0.511
D5	0.8	0.043	-0.188	-0.267
D6	0	-0.229	-0.682	-0.578
D7	0.867	-0.14	-0.651	-0.385
D8	0.4	-0.871	-1.094*	-0.689
E1	0.733	-0.581	-0.867	-0.57
E2	0.267	-0.376	-0.616	-0.733
E3	0.333	-0.074	-0.29	-0.393
E4	0.133	-0.381	-0.431	-0.37
E5	0.467	-0.105	-0.298	-0.237
E6	0.4	-0.064	-0.482	-0.415
E7	0.667	-0.283	-0.769	-0.57
E8	0.8	0.136	-0.341	-0.4

Burimi: Të dhënat e anketimit




Figura IV: Diagramë grafike e krahasimit të vlerësimeve të elementeve studimore sipas fokus grupeve

Burimi: Të dhënat e anketimit

2.6. Vlerësimi i perceptimit publik të përgjithshëm ndaj hipotezës së studimit

Hipoteza e studimit që vlerëson konkretisht nëse “*Reduktimi i Emetimeve të Karbonit dhe Menaxhimi i Zinxhirit të Furnizimit (A), Përfshirja dhe Angazhimi i Komunitetit (B), Investimet Sociale dhe Palët e Interesit (C), dhe Transparenca, Raportimi dhe Pajtueshmëria me të Drejtat e Njeriut (D)*” ndikojnë në përafrimin e sipërmarrjes me *Objektivat dhe Praktikatat e Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik (E)*” trajtohet nëpërmjet të dhënave të shkallës Likert të përfituar nga anketimi. Ndaj dhe është e rëndësishme paraprakisht të identifikojmë sjelljen e të dhënave në kërkim të modelit të duhur për të vlerësuar saktë perceptimin publik të përgjithshëm.

Konkretisht, statistikatat tregojnë se elementët e shtyllave **A, B, C, D** dhe **E** nuk kanë një shpërndarje normale, pasi testi Kolmogorov-Smirnov dhe ai Shapiro-Wilk kanë një nivel rëndësie më të ulët se 0.05. Ky rezultat i përket variablave të regresionit rendor në një nivel besueshmërie prej 95% (shih Tabelën XXVI).

Tabela XXV: Testi i shpërndarjes normale për variablat e regresionit rendor

	Kolmogorov-Smirnov ^a			Shapiro-Wilk		
	Statistika	df	Sig.	Statistika	df	Sig.
A	.144	92	.000	.942	92	.000
B	.115	92	.005	.926	92	.000
C	.151	92	.000	.923	92	.000
D	.145	92	.000	.910	92	.000
E	.170	92	.000	.896	92	.000

Burimi: Llogaritje të autores




Figura V: Diagramë grafike e Testit të shpërndarjes normale për variablat e regresionit rendor

Burimi: Të dhënat e anketimit

Testi i linjave paralele tregon se modeli i regresionit rendor ka një rëndësi prej 0.054 (më shumë se 0.05). Ky rezultat konfirmon se parametrat e lokacioneve (koeficientët e pjerrësisë) janë të qëndrueshëm në kategoritë e përgjigjeve të dhëna për variablin e varur E (Tabela XXVII).

Tabela XXVI: Testi i linjave paralele

Modeli	2 Log Përgjasisë	Funks. Chi ²	Df	Sig.	
Hypoteza 0					
Përgjithësisht	408.230	261.865	146.365	104	0.054

Burimi: Llogaritje të autores

Bazuar në këto të dhëna të përgjithshme përdorim regresionin logjistik rendor të përgjithshëm për të vlerësuar nëse “*Reduktimi i Emisioneve të Karbonit dhe Menaxhimi i Zinxhirit të Furnizimit (A), Përfshirja dhe Angazhimi me Komunitetin (B), Investimet Sociale dhe Palët e Dëmtuara (C), si dhe Transparenca, Raportimi dhe Përputhshmëria me të Drejtat e Njeriut (D)*” ndikojnë në përafrimin e sipërmarrjeve me Objektivat dhe Praktikatat e Zhvillimit Ekonomik të Qëndrueshëm (E) në një nivel besueshmërie prej 95%.

Nga modeli i regresionit logjistik rendor të përgjithshëm, marrim rezultatet e Testit Omnibus. Ky i fundit tregon se vlerësimi i përdorur për të testuar hipotezën tonë përshtatet mirë, me Chi-square me rëndësi prej 0.000 (më pak se 0.05), siç tregohet në Tabelën XXVII. Për më tepër, testi i efekteve të modelit konfirmon se rezultatet e Testit Omnibus, me vlera për A (36.48), B (4.196), C (0.52), dhe D (38.684) është për të gjitha 0.000 (më pak se 0.05).

Tabela XXVII: Testi Omnibus

Likelihood Chi ²	Ratio	df	Sig.
152.752		4	0.000

- Variabli i varur: Përafrimi i Sipërmarrjeve me Objektivat dhe Praktikatat e Zhvillimit Ekonomik të Qëndrueshëm (E)
- Burimi: Llogaritjet e autores

Parametrat e vlerësimit të përgjithshëm (analiza e regresionit logjistik rendor të përgjithshëm) të paraqitur në Tabelën 7 konfirmojnë se çdo shtyllë studimi: **A, B, C** dhe **D** ndikon në mënyrë të konsiderueshme dhe statistikisht të rëndësishme në përafrimin e korporatave me Objektivat dhe Praktikatat e Zhvillimit Ekonomik të Qëndrueshëm (**E**), në intervalin e besimit prej 95%.

Tabela XXVIII: Modeli i regresionit rendor e atij logjistik rendor për perceptimin publik

Parametri	B	Dev. Stand	95% Wald		Wald Chi ²	d f	Sig.	Exp(B)
			Ulët	Lartë				
A	0.085	0.2509	-0.576	0.407	1.955	1	0.038	6.57
B	0.803	0.3946	0.030	1.577	4.145	1	0.042	2.233
C	0.393	0.4300	-0.450	1.235	2.834	1	0.027	1.481
D	2.770	0.4509	1.886	3.654	37.745	1	0.000	15.960

Shkalla

1

- Variabli i varur: Përafrimi i Sipërmarrjeve me Objektivat dhe Praktikat e Zhvillimit Ekonomik të Qëndrueshëm (E)
- Burimi: Llogaritjet e autores




Figura VI: Diagramë grafike e Modelit të regresionit rendor e atij logjistik rendor për perceptimin publik

Burimi: Të dhënat e anketimit

Për më tepër, të dhënat mbi Korrelacionet e Spearmanit (Tabela XIX) konfirmojnë se shtyllat A (0.577), B (0.736), C (0.806), dhe D (0.853) kanë korrelacione të moderuara dhe statistikisht të rëndësishme me E.

Tabela XXIX: Korrelacionet e Spearman-it

			A	B	C	D	E
Spearman rho	A	Korrelacioni	1.000	.664**	.676**	.562**	.577**
		Sig. (2)	.	.000	.000	.000	.000
		N	92	92	92	92	92
	B	Korrelacioni	.664**	1.000	.786**	.732**	.736**
		Sig. (2)	.000	.	.000	.000	.000
		N	92	92	92	92	92
	C	Korrelacioni	.676**	.786**	1.000	.843**	.806**
		Sig. (2)	.000	.000	.	.000	.000
		N	92	92	92	92	92
	D	Korrelacioni	.562**	.732**	.843**	1.000	.853**
		Sig. (2)	.000	.000	.000	.	.000
		N	92	92	92	92	92
	E	Korrelacioni	.577**	.736**	.806**	.853**	1.000
		Sig. (2)	.000	.000	.000	.000	.
		N	92	92	92	92	92

Burimi: Llogaritjet e autores

*Korrelacionet janë statistikisht të rëndësishme në intervalin e besimit 95%




Figura VII: Diagramë grafike për Korrelacionet e Spearman-it

Burimi: Të dhënat e anketimit

Krahasimisht, për të kuptuar se si e vlerësojnë fokus grupet e marra në anketim nëse “Reduktimi i Emisioneve të Karbonit dhe Menaxhimi i Zinxhirit të Furnizimit (A), Përfshirja dhe Angazhimi me Komunitetin (B), Investimet Sociale dhe Palët e Dëmtuara (C), si dhe Transparenca, Raportimi dhe Përputhshmëria me të Drejtat e Njeriut (D)” ndikojnë në përafrimin e sipërmarrjeve me Objektivat dhe Praktikatat e Zhvillimit Ekonomik të Qëndrueshëm (E) në një nivel besueshmërie prej 95%, vlerësohen të dhënat përkatëse.

2.7. Vlerësimi i Perceptimit për Fokus Grupet

2.7.1. Fokus grupi: Drejtues

Për të bërë të mundur vlerësimin e saktë të hipotezës së studimit për fokus grupin “Drejtues”, analiza fillon nga shpërndarja e të dhënave. Vërehet se, shpërndarja e të dhënave nuk është normale (Tabela XX), pasi niveli i rëndësisë statistikore për testet Kolmogorov-Smirnov dhe Shapiro-Wilk është më i vogël se 0.05.

Tabela XX: Testi i shpërndarjes normale për variablat e regresionit rendor (Fokus grupi: Drejtues)

	Kolmogorov-Smirnov ^a			Shapiro-Wilk		
	Statistika	Df	Sig.	Statistika	df	Sig.
A	.215	15	.049	.863	15	.027
B	.223	15	.043	.899	15	.049
C	.185	15	.027	.883	15	.048
D	.231	15	.031	.809	15	.005
E	.227	15	.036	.835	15	.011

Burimi: Llogaritje të autores




Figura VIII: Diagramë grafike për Testin e shpërndarjes normale për variablat e regresionit rendor (Fokus grupi: Drejtues)

Burimi: Të dhënat e anketimit

Nëse i referohemi testit të linjave paralele vërejmë se, modeli i regresionit rendor të përgjithshëm ka një rëndësi prej 0.054 (më shumë se 0.05). Kjo vlerë tregon se parametrat e lokacioneve (koeficientët e pjerrësisë) janë të qëndrueshëm në kategoritë e përgjigjeve për variablin e varur E (Tabela XXI).

Tabela XXI. Testi i linjave paralele (Fokus grupi: Drejtues)

Modeli	2 Përgjasisë	Log Funks.	Chi ²	Df	Sig.
Hipoteza 0 Përgjithësisht	408.230	261.865	146.365	104	0.054

Burimi: Llogaritje të autores

Testi Omnibus në modelin e regresionit logjistik rendor të përgjithshëm tregon se vlerësimi i përdorur për të testuar hipotezën tonë përshtatet mirë, me Chi-square me rëndësi prej 0.000 (më pak se 0.05), siç tregohet në Tabelën XXII.

Tabela XXII: Testi Omnibus (Fokus grupi: Drejtues)

Likelihood Chi ²	Ratio	df	Sig.
29.046		4	0.000

- a. Variabli i varur: Përafrimi i Sipërmarrjeve me Objektivat dhe Praktikrat e Zhvillimit Ekonomik të Qëndrueshëm (E)

Burimi: Llogaritjet e autores

Ndërsa, në modelin e vlerësimit të regresionit logjistik rendor të përgjithshëm (të paraqitur në Tabelën 12) vihet re se vetëm shtylla D ndikon në mënyrë të konsiderueshme dhe statistikisht të rëndësishme në përafrimin e sipërmarrjeve me Objektivat dhe Praktikrat e Zhvillimit Ekonomik të Qëndrueshëm (E), në intervalin e besimit prej 95%.

Tabela XXIII: Modeli i regresionit rendor e atij logjistik rendor (Fokus grupi: Drejtues)

		95% Inter. Besimi		Wald Vlerësimi i hipotezës				
Parametri	B	Dev. Stand	Ulët	Lartë	Wald Chi ²	df	Sig.	Exp(B)
A	3.824	3	-2.069	9.71	1.618	1	0.203	45.780
B	9.390	6.51	-3.337	22.156	2.078	1	0.149	1.19E4
C	-8.285	5.90	-19.86	3.292	1.967	1	0.161	0.000
D	7.276	4.26	-1.085	15.638	2.909	1	0.048	1.446E
Shkalla	1							3

- a. Variabli i varur: Përafrimi i Sipërmarrjeve me Objektivat dhe Praktikrat e Zhvillimit Ekonomik të Qëndrueshëm (E)

Burimi: Llogaritjet e autores




Figura IX: Diagramë grafike për modelin e regresionit rendor e atij logjistik rendor (Fokus grupi: Drejtues)

Burimi: Llogaritjet e autores

Përsa më lart, shpjegimet i marrim në Tabelën XXIV. Në vijim (Tabela XXIV) paraqiten korrelacionet e shtyllave të studimit sipas vlerësimeve të dhëna nga fokus grupi në fjalë. Ajo tregon se sipas fokus grupi “Drejtues”, korrelacioni i shtyllës D është statistikisht i moderuar dhe statistikisht i rëndësishëm në intervalin e besimit 95% me shtyllën E (0.868).

Tabela XXIV: Korrelacionet e Spearman-it (Fokus grupi: Drejtues)

			A	B	C	D	E
Spearman rho	A	Korrelacioni	1.000	.816**	.899**	.465	.503
		Sig. (2)	.	.000	.000	.081	.056
		N	15	15	15	15	15
	B	Korrelacioni	.816**	1.000	.840**	.580*	.669**
		Sig. (2)	.000	.	.000	.024	.006
		N	15	15	15	15	15
	C	Korrelacioni	.899**	.840**	1.000	.648**	.618*
		Sig. (2)	.000	.000	.	.009	.014
		N	15	15	15	15	15
	D	Korrelacioni	.465	.580*	.648**	1.000	.868**
		Sig. (2)	.081	.024	.009	.	.000
		N	15	15	15	15	15
	E	Korrelacioni	.903**	.669**	.618*	.868**	1.000
		Sig. (2)	.006	.006	.014	.000	.
		N	15	15	15	15	15

Burimi: Llogaritjet e autores

*Korrelacionet janë statistikisht të rëndësishme në intervalin e besimit 95%




Figura X: Diagramë grafike për Korrelacionet e Spearman-it (Fokus grupi: Drejtues)

Burimi: Të dhënat e anketimit

2.7.2. Fokus grupi: Partnerë

Lidhur me vlerësimin e hipotezës së studimit për fokus grupin “Partnerë”, analizohet shpërndarja e të dhënave respektive. Shpërndarja e të dhënave nuk është normale (Tabela XXV), pasi niveli i rëndësisë statistikore për testet Kolmogorov-Smirnov dhe Shapiro-Wilk është më i vogël se 0.05.

Tabela XXV: Testi i shpërndarjes normale për variablat e regresionit rendor (Fokus grupi: Partnerë)

	Kolmogorov-Smirnov ^a			Shapiro-Wilk		
	Statistika	df	Sig.	Statistika	df	Sig.
A	.231	5	.022	.881	5	.032
B	.237	5	.020	.961	5	.039
C	.254	5	.020	.803	5	.031
D	.367	5	.026	.684	5	.006
E	.237	5	.016	.961	5	.019

Burimi: Llogaritje të autores




Figura XI: Testi i shpërndarjes normale për variablat e regresionit rendor (Fokus grupi: Partnerë)

Burimi: Llogaritjet e autores

Nga testi i linjave paralele vërejmë se modeli i regresionit rendor ka një rëndësi prej 1 (më shumë se 0.05). Vlerë kjo që tregon se parametrat e lokacioneve (koeficientët e pjerrësisë) janë të qëndrueshëm në kategoritë e përgjigjeve për variablin e varur E (Tabela XXVI).

Tabela XXVI: Testi i linjave paralele (Fokus grupi: Partnerë)

Likelihood Ratio Chi ²	Df	Sig.
13.322	4	0.010

Burimi: Llogaritje të autores

Mandej, Testi i Omnibus në modelin e regresionit logjistik rendor të përgjithshëm konfirmon se vlerësimi i përdorur për të testuar hipotezën tonë përshtatet mirë, me Chi-square me rëndësi prej 0.010 (më pak se 0.05), siç tregohet në Tabelën XXVII.

Tabela XXVII: Testi Omnibus (Fokus grupi: Partnerë)

Modeli	2 Log Funks.				
	Përgjasisë		Chi²	Df	Sig.
Hipoteza 0					
Përgjithësisht	0	0	0.000	8	1

a. Variabli i varur: Përafrimi i Sipërmarrjeve me Objektivat dhe Praktikatat e Zhvillimit Ekonomik të Qëndrueshëm (E)

b. Burimi: Llogaritjet e autores




Figura XII: Testi Omnibus (Fokus grupi: Partnerë)

Burimi: Llogaritjet e autores

Modeli i vlerësimit të regresionit logjistik rendor të përgjithshëm (të paraqitur në Tabelën XXVIII) dëshmon se asnjëra nga shtyllat e studimit “A, B, C dhe D” nuk ndikon në mënyrë të konsiderueshme dhe statistiki të rëndësishme në përafrimin e sipërmarrjeve me Objektivat dhe Praktikatat e Zhvillimit Ekonomik të Qëndrueshëm (E), në intervalin e besimit prej 95%.

Tabela XXVIII: Modeli i regresionit rendor e atij logjistik rendor (Fokus grupi: Partnerë)

Parametri	B	Dev. Stand	95% Wald		Vlerësimi i hipotezës		D f	Sig.	Exp(B)
			Ulët	Lartë	Wald	Chi ²			
A	1.034	4.57	-89739	89741	0		1	1	2.811
B	39.334	3.095	-60631	60710	0		1	0.999	1.209E1
C	-4.023E-14	1.97	-38733	38733	0		1	1	1
D	-0.948	2.70	53014	53012	0		1	1	0.387
Shkalla	1								

- Variabli i varur: Përafrimi i Sipërmarrjeve me Objektivat dhe Praktikatat e Zhvillimit Ekonomik të Qëndrueshëm (E)
- Burimi: Llogaritjet e autores




Figura XIII: Modeli i regresionit rendor e atij logjistik rendor (Fokus grupi: Partnerë)

Burimi: Llogaritjet e autores

Rezultatet e Tabelës XXIX paraqesin vlerën e korrelacioneve të shtyllave të studimit sipas vlerësimeve të dhëna nga fokus grupi i partnerëve si dhe shpjegojnë vlerësimet e regresionit logjistik rendor të përgjithshëm.

Tabela XXIX: Korrelacionet e Spearman-it (Fokus grupi: Partnerë)

			A	B	C	D	E
Spearmanrho	A	Korrelacioni	1.000	.973**	.917*	.913*	.973**
		Sig. (2)	.	.005	.029	.030	.005
		N	5	5	5	5	5
	B	Korrelacioni	.973**	1.000	.892*	.889*	1.000**
		Sig. (2)	.005	.	.042	.044	.
		N	5	5	5	5	5
	C	Korrelacioni	.917*	.892*	1.000	.913*	.892*
		Sig. (2)	.029	.042	.	.030	.042
		N	5	5	5	5	5
	D	Korrelacioni	.913*	.889*	.913*	1.000	.889*
		Sig. (2)	.030	.044	.030	.	.044
		N	5	5	5	5	5
	E	Korrelacioni	.973**	1**	.892*	.889*	1.000
		Sig. (2)	.005	.	.042	.044	.
		N	5	5	5	5	5

a. Variabli i varur: Përafrimi i Sipërmarrjeve me Objektivat dhe Praktikat e Zhvillimit Ekonomik të Qëndrueshëm (E)

b. Burimi: Llogaritjet e autores




Figura XIV: Korrelacionet e Spearman-it (Fokus grupi: Partnerë)

Burimi: Llogaritjet e autores

2.7.3. Fokus grupi: Furnitorë

Vlerësimi i hipotezës së studimit për fokus grupin “Furnitorë” trajton, fillimisht, shpërndarjen e të dhënave respektive. Referuar Tabelës 19, shpërndarja e të dhënave nuk është normale, pasi niveli i rëndësisë statistikore për testet Kolmogorov-Smirnov dhe Shapiro-Wilk është më i vogël se 0.05.

Tabela XXX: Testi i shpërndarjes normale për variablat e regresionit rendor (Fokus grupi: Furnitorë)

Kolmogorov-Smirnov ^a			Shapiro-Wilk			
	Statistika	Df	Sig.	Statistika	df	Sig.
A	.214	28	.002	.878	28	.004
B	.275	28	.000	.881	28	.004
C	.250	28	.000	.893	28	.008
D	.274	28	.000	.837	28	.001
E	.281	28	.000	.859	28	.001

Burimi: Llogaritje të autores




Figura XV: Testi i shpërndarjes normale për variablat e regresionit rendor (Fokus grupi: Furnitorë)

Burimi: Llogaritjet e autores

Në testin e linjave paralele vërejmë se modeli i regresionit rendor ka një rëndësi prej 0.056 (më shumë se 0.05). Kështu, tregohet se parametrat e lokacioneve (koeficientët e pjerrësisë) janë të qëndrueshëm në kategoritë e përgjigjeve për variablin e varur E (Tabela XXXI).

Tabela XXXI: Testi i linjave paralele (Fokus grupi: Furnitorë)

Modeli	2 Log Funks. Përgjasisë	Chi ²	df	Sig.
Hipoteza 0	75.055			
Përgjithësisht	34.681	40.374	4	0.056

Burimi: Llogaritje të autores




Figura XVI: Testi i linjave paralele (Fokus grupi: Furnitorë)

Burimi: Llogaritjet e autores

Testi Omnibus në modelin e regresionit logjistik rendor i përgjithshëm, gjithashtu, konfirmon se vlerësimi i përdorur për të testuar hipotezën tonë përshtatet mirë, me Chi-square me rëndësi prej 0.000 (më pak se 0.05), siç tregohet në Tabelën 21.

Tabela XXXII: Testi Omnibus (Fokus grupi: Furnitorë)

Likelihood Ratio Chi ²	Df	Sig.
73.232	15	0.000

- a. Variabli i varur: Përafrimi i sipërmarrjeve me Objektivat dhe Praktikat e Zhvillimit Ekonomik të Qëndrueshëm (E)
b. Burimi: Llogaritjet e autores




Figura XVII: Testi Omnibus (Fokus grupi: Furnitorë)

Burimi: Llogaritjet e autores

Modeli i vlerësimit të regresionit logjistik rendor të përgjithshëm (të paraqitur në Tabelën 22) dëshmon se vetëm shtylla A ndikon në mënyrë të konsiderueshme dhe statistikisht të rëndësishme në përafrimin e sipërmarrjeve me Objektivat dhe Praktikat e Zhvillimit Ekonomik të Qëndrueshëm (E), në intervalin e besimit prej 95%.

Tabela XXXIII: Modeli i regresionit rendor e atij logjistik rendor (Fokus grupi: Furnitorë)

Parametri	B	Dev. Stand	95% Wald Inter. Besimi		Vlerësimi i hipotezës			
			Ulët	Lartë	Wald Chi ²	Df	Sig.	Exp(B)
A	264.65	1.34E6	-2.6E6	2636581	0	1	0.046	1
B	-64.328	9.66E5	-1.89E4	1893738	0	1	1	1.2E-28
C	-116.09	9.56E5	-1.8E6	1874882	0	1	1	3.8E-51
D	201.409	1.35E6	-2.6E6	2651260	0	1	1	2.9E87
Shkalla	1							

- a. Variabli i varur: Përafrimi i Sipërmarrjeve me Objektivat dhe Praktikat e Zhvillimit Ekonomik të Qëndrueshëm (E)
b. Burimi: Llogaritjet e autores




Figura XVIII: Testi Omnibus (Fokus grupi: Furnitorë)

Burimi: Llogaritjet e autores

Ndërsa, rezultatet e Tabelës XXXIII paraqesin vlerën e korrelacioneve të shtyllave të studimit sipas vlerësimeve të dhëna nga fokus grupi i furnitorëve. Të dhënat konfirmojnë se sipas fokus grupit “Furnitorë”, korrelacioni i shtyllës A është statistikisht i moderuar dhe statistikisht i rëndësishëm në intervalin e besimit 95% me shtyllën E (0.833). Çka shërben për të shpjeguar vlerësimet e regresionit logjistik rendor të përgjithshëm.

Tabela XXXIV: Korrelacionet e Spearman-it (Fokus grupi: Furnitorë)

			A	B	C	D	E
Spearman rho	A	Korrelacioni	1.000	.799**	.641**	.760**	.833**
		Sig. (2)	.	.000	.000	.000	.000
		N	28	28	28	28	28
	B	Korrelacioni	.799**	1.000	.773**	.823**	.791**
		Sig. (2)	.000	.	.000	.000	.000
		N	28	28	28	28	28
	C	Korrelacioni	.641**	.773**	1.000	.938**	.758**
		Sig. (2)	.000	.000	.	.000	.000
		N	28	28	28	28	28
	D	Korrelacioni	.760**	.823**	.938**	1.000	.841**
		Sig. (2)	.000	.000	.000	.	.000
		N	28	28	28	28	28
	E	Korrelacioni	.833**	.191**	.058**	.041**	1.000
		Sig. (2)	.000	.000	.000	.000	.
		N	28	28	28	28	28

a. Variabli i varur: Përafrimi i Sipërmarrjeve me Objektivat dhe Praktikrat e Zhvillimit Ekonomik të Qëndrueshëm (E)

b. Burimi: Llogaritjet e autores




Figura XIX: Korrelacionet e Spearman-it (Fokus grupi: Furnitorë)

Burimi: Llogaritjet e autores

2.7.4. Fokus grupi: Klientë

Lidhur me fokus grupin “Klientë” (referuar Tabelës 24), vihet re se, shpërndarja e të dhënave nuk është normale. Kjo pasi niveli i rëndësisë statistikore për testet Kolmogorov-Smirnov dhe Shapiro-Wilk është më i vogël se 0.05.

Tabela XXXV: Testi i shpërndarjes normale për variablat e regresionit rendor (Fokus grupi: Klientë)

	Kolmogorov-Smirnov ^a			Shapiro-Wilk		
	Statistika	Df	Sig.	Statistika	Df	Sig.
A	.273	17	.002	.890	17	.047
B	.273	17	.002	.876	17	.027
C	.234	17	.014	.889	17	.044
D	.279	17	.001	.868	17	.020
E	.247	17	.007	.881	17	.033

Burimi: Llogaritje të autores




Figura XX: Testi i shpërndarjes normale për variablat e regresionit rendor (Fokus grupi: Klientë)

Burimi: Llogaritjet e autores

Testi i linjave paralele dëshmon se modeli i regresionit rendor ka një rëndësi prej 1 (më shumë se 0.05). Kjo tregon se parametrat e lokacioneve (koeficientët e pjerrësisë) janë të qëndrueshëm në kategoritë e përgjigjeve për variablin e varur E (Tabela 25).

Tabela XXXVI: Testi i linjave paralele (Fokus grupi: Klientë)

Modeli	2 Log Përgjasisë	Funks. Chi ²	Df	Sig.	
Hipoteza 0					
Përgjithësisht	0	0	0.000	8	1

Burimi: Llogaritje të autores




Figura XXI: Testi i linjave paralele (Fokus grupi: Klientë)

Burimi: Llogaritjet e autores

Testi i Omnibus në modelin e regresionit logjistik rendor të përgjithshëm në Tabelën 26 konfirmon se, vlerësimi i përdorur për të testuar hipotezën tonë përshtatet mirë, pasi Chi-square e ka nivelin e rëndësisë 0.000 (më pak se 0.05).

Tabela XXXVII: Testi Omnibus (Fokus grupi: Klientë)

Likelihood Chi ²	Ratio	Df	Sig.
44.813		4	0.000

a. Variabli i varur: Përafrimi i Sipërmarrjeve me Objektivat dhe Praktikrat e Zhvillimit Ekonomik të Qëndrueshëm (E)

b. Burimi: Llogaritjet e autores




Figura XXII: Testi Omnibus (Fokus grupi: Klientë)

Burimi: Llogaritjet e autores

Modeli i vlerësimit të regresionit logjistik rendor të përgjithshëm (paraqitur në Tabelën 27) dëshmon se vetëm shtyllat A dhe B ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme dhe statistikisht të rëndësishme në përafrimin e sipërmarrjeve me Objektivat dhe Praktikatat e Zhvillimit Ekonomik të Qëndrueshëm (E), në intervalin e besimit prej 95%.

Tabela XXXVIII: Modeli i regresionit rendor e atij logjistik rendor (Fokus grupi: Klientë)

Parametri	B	Dev. Stand	95% Wald Inter. Besimi		Vlerësimi i hipotezës			
			Ulët	Lartë	Wald Chi ²	df	Sig.	Exp(B)
A	34.853	5.79E3	-11332	11401	0	1	0.021	0.005
B	99.293	8.53E3	-16819	16621	0	1	0.038	0.014
C	164.65	1.30E4	-25470	25799	0	1	1	0.990
D	32.74	4.40E3	-8591	8657	0	1	1	0.994
Shkalla	1							

- Variabli i varur: Përafrimi i Sipërmarrjeve me Objektivat dhe Praktikatat e Zhvillimit Ekonomik të Qëndrueshëm (E)
- Burimi: Llogaritjet e autores




Figura XXIII: Modeli i regresionit rendor e atij logjistik rendor (Fokus grupi: Klientë)

Burimi: Llogaritjet e autores

Tabela 28 që paraqet vlerën e korrelacioneve të shtyllave të studimit sipas vlerësimeve të dhëna nga fokus grupi i klientëve shpjegon vlerësimet e regresionit logjistik rendor të përgjithshëm. Konkretisht, të dhënat konfirmojnë se korrelacioni i shtyllës A dhe B, respektivisht, 0.713 dhe 0.510 është statistikisht i moderuar dhe statistikisht i rëndësishëm në intervalin e besimit 95% me shtyllën E. Kjo shpjegon edhe vlerësimet e regresionit logjistik rendor të përgjithshëm.

Tabela XXXIX: Korrelacionet e Spearman-it (Fokus grupi: Klientë)

Spearman rho			A	B	C	D	E
	A	Korrelacioni	1.000	.744**	.718**	.589*	.713**
		Sig. (2)	.	.001	.001	.013	.001
		N	17	17	17	17	17
	B	Korrelacioni	.744**	1.000	.775**	.653**	.510*
		Sig. (2)	.001	.	.000	.004	.036
		N	17	17	17	17	17
	C	Korrelacioni	.718**	.775**	1.000	.822**	.875**
		Sig. (2)	.001	.000	.	.000	.000
		N	17	17	17	17	17
	D	Korrelacioni	.589*	.653**	.822**	1.000	.723**
		Sig. (2)	.013	.004	.000	.	.001
		N	17	17	17	17	17
	E	Korrelacioni	.713**	.510*	.075*	.123*	1.000
		Sig. (2)	.001	.036	.000	.001	.
		N	17	17	17	17	17

a. Variabli i varur: Përafrimi i Sipërmarrjeve me Objektivat dhe Praktikat e Zhvillimit Ekonomik të Qëndrueshëm (E)

b. Burimi: Llogaritjet e autores




Figura XXIV: Korrelacionet e Spearman-it (Fokus grupi: Klientë)

Burimi: Llogaritjet e autores

2.7.5. Fokus grupi: Punonjës

Të dhënat e fokus grupit “Punonjës”, kanë shpërndarje jo normale. Kjo e fundit, konfirmohet pasi niveli i rëndësisë statistikore për testet Kolmogorov-Smirnov dhe Shapiro-Wilk (Tabela 29) është më i vogël se 0.05.

Tabela XXXX: Testi i shpërndarjes normale për variablat e regresionit rendor (Fokus grupi: Punonjës)

	Kolmogorov-Smirnov ^a			Shapiro-Wilk		
	Statistika	df	Sig.	Statistika	df	Sig.
A	.180	27	.025	.854	27	.001
B	.308	27	.000	.851	27	.001
C	.258	27	.000	.872	27	.003
D	.282	27	.000	.874	27	.004
E	.306	27	.000	.836	27	.001

Burimi: Llogaritje të autores




Figura XXV: Testi i shpërndarjes normale për variablat e regresionit rendor (Fokus grupi: Punonjës)

Burimi: Llogaritjet e autores

Në modelin e regresionit rendor, testi i linjave paralele ka një rëndësi prej 0.06 (më shumë se 0.05). Ky rezultat tregon se, parametrat e lokacioneve (koeficientët e pjerrësisë) janë të qëndrueshëm në kategoritë e përgjigjeve për variablin e varur E (Tabela 30).

Tabela XXXXI: Testi i linjave paralele (Fokus grupi: Punonjës)

Modeli	2 Log Funks. Përgjasisë	Chi ²	df	Sig.	
Hipoteza 0 Përgjithësisht	20.367	0	20.367	12	0.06

Burimi: Llogaritje të autores




Figura XXVI: Testi i linjave paralele (Fokus grupi: Punonjës)

Burimi: Llogaritjet e autores

Testi Omnibus në modelin e regresionit logjistik rendor të përgjithshëm në Tabelën 31 konfirmon se, vlerësimi i përdorur për të testuar hipotezën tonë përshtatet mirë, pasi Chi-square e ka nivelin e rëndësisë 0.000 (më pak se 0.05).

Tabela XXXII: Testi Omnibus (Fokus grupi: Punonjës)

Likelihood Chi ²	Ratio	Df	Sig.
50.077		4	0.000

- Variabli i varur: Përafrimi i sipërmarrjeve me Objektivat dhe Praktikatat e Zhvillimit Ekonomik të Qëndrueshëm (E)
- Burimi: Llogaritjet e autores




Figura XXVII: Testi Omnibus (Fokus grupi: Punonjës)

Burimi: Llogaritjet e autores

Modeli i vlerësimit të regresionit logjistik rendor të përgjithshëm, paraqitur në Tabelën 32, dëshmon se vetëm shtyllat A, B dhe C ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme dhe statistikisht të rëndësishme në përafrimin e sipërmarrjeve me Objektivat dhe Praktikatat e Zhvillimit Ekonomik të Qëndrueshëm (E), në intervalin e besimit prej 95%.

Tabela XXXXIII: Modeli i regresionit rendor e atij logjistik rendor (Fokus grupi: Punonjës)

Parametri	B	Dev. Stand	95% Wald Inter. Besimi		Vlerësimi i hipotezës			
			Ulët	Lartë	Wald Chi ²	df	Sig.	Exp(B)
A	2.406	0.98	-4.332	-0.480	5.993	1	0.014	0.090
B	3.073	1.42	0.272	5.873	4.623	1	0.032	21.598
C	4.616	1.73	1.215	8.018	7.077	1	0.008	5
D	1.169	1.17	-1.143	3.481	0.982	1	0.322	3.218
Shkalla	1							

- a. Variabli i varur: Përafrimi i Sipërmarrjeve me Objektivat dhe Praktikatat e Zhvillimit Ekonomik të Qëndrueshëm (E)
- b. Burimi: Llogaritjet e autores




Figura XXVIII: Modeli i regresionit rendor e atij logjistik rendor (Fokus grupi: Punonjës)

Burimi: Llogaritjet e autores

Korrelacioni i shtyllave A, B dhe C të studimit me shtyllën E (Tabela 33), respektivisht 0.855, 0.731 dhe 0.781 paraqet situatën e vlerësimeve të dhëna nga fokus grupi i punonjësve në funksion të modelit të regresionit logjistik rendor të përgjithshëm.

Tabela XXXIV: Korrelacionet e Spearman-it (Fokus grupi: Punonjës)

			A	B	C	D	E
Spearman rho	A	Korrelacioni	1.000	.401*	.453*	.214	.155
		Sig. (2)	.	.038	.018	.285	.440
		N	27	27	27	27	27
	B	Korrelacioni	.401*	1.000	.665**	.633**	.731**
		Sig. (2)	.038	.	.000	.000	.000
		N	27	27	27	27	27
	C	Korrelacioni	.453*	.665**	1.000	.756**	.781**
		Sig. (2)	.018	.000	.	.000	.000
		N	27	27	27	27	27
	D	Korrelacioni	.214	.633**	.756**	1.000	.761**
		Sig. (2)	.285	.000	.000	.	.000
		N	27	27	27	27	27
	E	Korrelacioni	.855**	.731**	.781**	.061*	1.000
		Sig. (2)	.440	.000	.000	.000	.
		N	27	27	27	27	27

- a. Variabli i varur: Përafrimi i Sipërmarrjeve me Objektivat dhe Praktikat e Zhvillimit Ekonomik të Qëndrueshëm (E)
b. Burimi: Llogaritjet e autores




Figura XXIX: Korrelacionet e Spearman-it (Fokus grupi: Punonjës)

Burimi: Llogaritjet e autores

3. Konkluzione

Konkluzionet empirike të studimit tregojnë se faktorë të ndryshëm ndikojnë ndjeshëm në përafrimin e sipërmarrjeve me qëllimet dhe praktikën e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm. Këta faktorë përfshijnë reduktimin e emetimeve të karbonit dhe menaxhimin e zinxhirit të furnizimit (A), promovimin e përfshirjes dhe angazhimit të komunitetit (B), investimet sociale dhe mbështetjen e palëve të interesuara (C), si dhe transparencën, raportimin dhe pajtueshmërinë me të drejtat e njeriut (D).

1. Analiza e regresionit rendor zbulon se janë, statistikisht të rëndësishme në intervalin e besimit 95%, marrëdhëniet e mëposhtme:

- Për çdo reduktim në emetimet e karbonit dhe përmirësim në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit (A) parashikohet një rritje prej 0.085 në shanset logaritmike për të arritur një nivel më të lartë të përafrimit sipërmarrës me qëllimet dhe praktikën e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm (E).
- Një rritje në përfshirjen dhe angazhimin e komunitetit (B) shoqërohet me një rritje të parashikuar prej 0.803 në shanset logaritmike për të arritur një nivel më të lartë të përafrimit sipërmarrës me qëllimet dhe praktikën e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm (E).
- Përmirësimet në investimet sociale dhe mbështetjen e palëve të interesuara (C) sjellin një rritje të parashikuar prej 0.393 në shanset logaritmike për të arritur një nivel më të lartë të përafrimit midis sipërmarrjeve me qëllimet dhe praktikën e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm (E).
- Së fundmi, përmirësimet në transparencën, raportimin dhe pajtueshmërinë me të drejtat e njeriut (D) korrespondojnë me një rritje të parashikuar prej 2.770 në shanset logaritmike për të qenë në një nivel më të lartë të përafrimit me qëllimet dhe praktikën e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm (E). Këto rezultate theksojnë rëndësinë e këtyre faktorëve në nxitjen e qëndrueshmërisë sipërmarrëse.

2. Bashkëpunimi midis qeverisë, partnerëve të industrisë dhe palëve të ndryshme të interesuara është thelbësor për të nxitur në mënyrë efektive përafrimin e sipërmarrjeve me qëllimet e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm nga perspektiva e perceptimit publik.

- Konkretisht, rezultatet e analizës së regresionit logjistik rendor të përgjithshëm mbi perceptimin publik në tërësi nxjerrin në pah rolin kritik të transparencës, raportimit dhe pajtueshmërisë me të drejtat e njeriut, të cilat shfaqin raportin më të lartë të shanseve (15.960) në nxitjen e përafrimit.

Lidhur me këtë, qeveritë duhet të zbatojnë korniza rregullatore të fuqishme dhe të nxisin praktikën transparente të raportimit, duke siguruar pajtueshmërinë përmes monitorimit të rreptë.

Krahasimisht, reduktimi i emetimeve të karbonit dhe përmirësimi i menaxhimit të zinxhirit të furnizimit (raporti i shanseve prej 6.57) thekson nevojën për iniciativat

- e udhëhequra nga shteti që promovojnë energjinë e rinovueshme dhe logjistikën e gjelbër.
- Në të njëjtën kohë, nxitja e përfshirjes dhe angazhimit të komunitetit (raporti i shanseve prej 2.233) kërkon programe bashkëpunuese që fuqizojnë grupet e marginalizuara dhe rrisin vendimarrjen pjesëmarrëse.
 - Ndërsa, forcimi i investimeve sociale dhe mbështetjes së palëve të interesuara (raporti i shanseve prej 1.481) kërkon partneritete midis sipërmarrjeve, organizatave jo-qeveritare dhe institucioneve financiare për të nxitur investime me ndikim në zhvillimin e komunitetit dhe projektet e qëndrueshmërisë.
 - Së bashku, këto masa mund të krijojnë një mjedis të favorshëm që sipërmarrjet të përafrohen me praktikën e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm. Këto të fundit lidhen edhe me faktin se korrelacioni i Spearman-it është statistikisht i rëndësishëm në intervalin e besimit 95% me të gjitha shtyllat e studimit si dhe vlerësohet një lidhje e fortë me shtyllën A: 0.577, sikurse dhe një lidhje shumë e fortë me shtyllat B: 0.736, C: 0.806 dhe D: 0.853.
 - Perceptimi publik i përgjithshëm mbi angazhimin e sipërmarrjeve lidhur me përgjegjësinë sociale dhe zhvillimin e qëndrueshëm i vlerësuar sipas shtyllave më lart i referohet kryesisht grupmoshave 18-25 dhe 55-64 vjeç. Në këto grupmosha të anketuarit mbajnë titullin profesor i asociuar, të ndjekur nga ata me doktoraturë dhe master profesional. Çka tregon se perceptimi shkencor dhe ai profesional përputhen.
- 3. Perceptimi i fokus grupit “Drejtues”.** Në analizën e fokus grupit “Drejtues”, rezultatet empirike të studimit tregojnë se vetëm faktori “D” (transparenca, raportimi dhe pajtueshmëria me të drejtat e njeriut) nga ata të marrë në konsideratë ndikon në përafrimin e sipërmarrjeve me qëllimet dhe praktikën e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm në intervalin e besimit 95%.
- Arsyeja është teknike, pasi ajo ka të bëjë me multikolinearitetin midis shtyllave, çka e dëshmon edhe korrelacioni i Spearman-it kundrejt emetimeve të karbonit dhe menaxhimit të zinxhirit të furnizimit (A): 0.903; promovimit të përfshirjes dhe angazhimit të komunitetit (B): 0.669; investimeve sociale dhe mbështetjes së palëve të interesuara (C): 0.618; transparencës, raportimit dhe pajtueshmërisë me të drejtat e njeriut (D): 0.868, me përafrimin e sipërmarrjeve me praktikën e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm (E).
 - Në të gjitha këto raste, korrelacioni i Spearman-it është i fortë dhe statistikisht i rëndësishëm në intervalin e besimit 95%. Ndërsa, shtylla (D) ka korrelacion në nivele mesatare me shtyllat: B (0.580) dhe C (0.648) në intervalin e besimit 95%. Kështu, nga regresioni rendor vlerësohet se rritja e transparencës, raportimit dhe pajtueshmëria me të drejtat e njeriut (D) çojnë në një rritje të parashikuar prej 7.276 në shanset logaritmike për të arritur një nivel më të lartë të përafrimit sipërmarrës me qëllimet dhe praktikën e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm (E).

- Rezultatet e analizës së regresionit logjistik rendor të përgjithshëm nxjerrin në paj, gjithashtu, rolin kritik të transparencës, raportimit dhe pajtueshmërisë me të drejtat e njeriut, në rritjen e shanseve (1446) lidhur me nxitjen e përafrimit.
 - Ndërsa, fenomeni i multikolinearitetit, në këtë rast, ka të bëjë me faktin se, në një set me më shumë se dy shtylla të ndryshme që janë të lidhura me njëra-tjetrën si në rastin konkret “Transparenca, raportimi dhe pajtueshmëria me të drejtat e njeriut” përfshihen një sërë informacionesh të agreguara dhe pikërisht kjo ndikon në vlerësimet e bëra për shtyllat e tjera të cilat rezultojnë statistikisht të parëndësishme për analizën në intervalin e besimit 95% sipas këndvështrimit të drejtuesve.
- 4. Perceptimi i fokus grupit “Partnerë”.** Në analizën e fokus grupit “Partnerë”, rezultatet empirike të studimit evidentojnë se asnjëra nga shtyllat e marra në konsideratë nuk ndikon në përafrimin e sipërmarrjeve me qëllimet dhe praktikatat e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm në intervalin e besimit 95%.
- Sërish, arsyeja e këtij rezultati është multikolineariteti midis shtyllave të vlerësuara. Edhe në këtë rast, korrelacioni i Spearman-it është tejet i lartë midis shtyllave të analizuara.
 - Konkretisht: korrelacionet për emetimet e karbonit dhe menaxhimi i zinxhirit të furnizimit (A): 0.973, promovimi i përfshirjes dhe angazhimi i komunitetit (B) – 1, investimet sociale dhe mbështetja e palëve të interesuara (C) - 0.892, transparenca, raportimi dhe pajtueshmëria me të drejtat e njeriut (D) - 0.889, në lidhje me përafrimin e sipërmarrjeve me praktikatat e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm (E) në intervalin e besimit 95% janë statistikisht të rëndësishme.
 - Sipas këndvështrimit të partnerëve të gjitha shtyllat e marra në shqyrtim janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën si dhe mund të ndikojnë në tërësi në përafrimin e sipërmarrjeve me praktikatat e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm edhe pse parametratat e tyre nuk janë statistikisht të rëndësishme në intervalin e besimit 95%. Kjo e fundit ndodh për shkak të multikolinearitetit të vlerësuar midis shtyllave të marrë në analizë.
- 5. Perceptimi i fokus grupit “Furnitorë”.** Në analizën e fokus grupit “Furnitorë”, rezultatet empirike konfirmojnë se vetëm shtylla (A) ndikon në përafrimin e sipërmarrjeve me qëllimet dhe praktikatat e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm në intervalin e besimit 95%. Mungesa e ndikimit të shtyllave të tjera të analizuara shpjegohet me prezencën e multikolinearitetit midis tyre.
- Konkretisht, korrelacioni i Spearman-it mes tyre është i lartë me B (0.799), C(0.641), D(0.760) dhe statistikisht i rëndësishëm në intervalin e besimit 95%.
 - Në analizë rezulton: korrelacionet në emetimet e karbonit dhe menaxhimi i zinxhirit të furnizimit (A) - 0.833, promovimi i përfshirjes dhe angazhimi i komunitetit (B) - 0.191, investimet sociale dhe mbështetja e palëve të interesuara (C) - 0.058, transparenca, raportimi dhe pajtueshmëria me të drejtat e njeriut (D) - 0.041, me përafrimin e sipërmarrjeve me praktikatat e zhvillimit ekonomik të

qëndrueshëm (E) janë të gjithë statistikisht të rëndësishëm në intervalin e besimit 95%.

- Përsa më lart, vlerësohet se, për çdo reduktim në emetimet e karbonit dhe përmirësim në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit (A) ka një rritje të parashikuar prej 264.65 në shanset logaritmike për të arritur një nivel më të lartë të përafrimit sipërmarrës me qëllimet dhe praktikatat e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm (E).
 - Krahësimisht, analiza e regresionit logjistik rendor të përgjithshëm vlerëson se emetimet e karbonit dhe përmirësimi në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit rrit shanset me 1 (një) në nxitjen e përafrimit.
- 6. Perceptimi i fokus grupit “Klientë”.** Analiza e fokus grupit “Klientë”, mbështetur në rezultatet empirike, dëshmon se shtyllat (A) dhe (B) ndikojnë në përafrimin e sipërmarrjeve me qëllimet dhe praktikatat e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm në intervalin e besimit 95%. Shtyllat e tjera të analizuar nuk kanë ndikim për shkak të prezencës së multikolinearitetit midis tyre.
- Konkretisht, korrelacioni i Spearman-it mes (C) dhe (D) është i lartë “0.822” dhe statistikisht i rëndësishëm në intervalin e besimit 95%.
 - Gjithashtu, analiza e regresionit rendor tregon se, korrelacionet në emetimet e karbonit dhe menaxhimi i zinxhirit të furnizimit (A) - 0.713, promovimi i përfshirjes dhe angazhimi i komunitetit (B) - 0.510, investimet sociale dhe mbështetja e palëve të interesuara (C) - 0.075, transparenca, raportimi dhe pajtueshmëria me të drejtat e njeriut (D) - 0.123, me përafrimin e sipërmarrjeve me praktikatat e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm (E) janë të gjithë statistikisht të rëndësishëm në intervalin e besimit 95%.
 - Sipas regresionit rendor, klientët vlerësojnë se për çdo reduktim në emetimet e karbonit dhe përmirësim në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit (A) dhe rritje në promovimin e përfshirjes dhe angazhimin në komunitet (B) ka një rritje të parashikuar respektivisht prej “34.853” dhe “99.293” në shanset logaritmike për të arritur një nivel më të lartë të përafrimit sipërmarrës me qëllimet dhe praktikatat e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm (E).
 - Krahësimisht, analiza e regresionit logjistik rendor të përgjithshëm vlerëson se, emetimet e karbonit dhe përmirësimi në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit, bashkë me promovimin e përfshirjes dhe angazhimin në komunitet, rrit shanset respektivisht me “0.005” dhe “0.014” në nxitjen e përafrimit.
- 7. Perceptimi i fokus grupit “Punonjës”.** Rezultatet empirike të analizës së fokus grupit “Punonjës” dëshmojnë se shtyllat (A), (B) dhe (C) ndikojnë në përafrimin e sipërmarrjeve me qëllimet dhe praktikatat e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm në intervalin e besimit 95%.
- Analiza e regresionit rendor vlerëson edhe korrelacionet në emetimet e karbonit dhe menaxhimi i zinxhirit të furnizimit (A) - 0.855, promovimi i përfshirjes dhe angazhimi i komunitetit (B) - 0.731, investimet sociale dhe mbështetja e palëve të interesuara (C) - 0.781, me përafrimin e sipërmarrjeve me praktikatat e zhvillimit

ekonomik të qëndrueshëm (E) të cilat janë të gjithë statistikisht të rëndësishëm në intervalin e besimit 95%.

- Megjithatë, fokus grupi “Punonjës” gjykon se, për çdo reduktim në emetimet e karbonit dhe përmirësim në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit (A), rritje në promovimin e përfshirjes dhe angazhimin në komunitet (B) dhe investimet sociale e mbështetje palëve të interesuara (C) ka një rritje të parashikuar respektivisht prej “2.406”, “3.073” dhe “4.616” në shanset logaritmike për të arritur një nivel më të lartë të përafrimit sipërmarrës me qëllimet dhe praktikatat e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm (E).
- Krahësimisht, analiza e regresionit logjistik rendor të përgjithshëm vlerëson se, emetimet e karbonit dhe përmirësimi në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit, bashkë me promovimin e përfshirjes dhe angazhimin në komunitet si dhe investimet sociale e mbështetja ndaj palëve të interesuara, rrit shanset respektivisht me “0.09”, “21.598” dhe “101.13” në nxitjen e përafrimit.

Këto konkluzione përbëjnë bazën për kapitullin pasues në të cilin do të sintetizohen në mënyrë të integruar të gjitha gjetjet e studimit dhe do të paraqitet një set rekomandimesh për përmirësimin e praktikave të përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm në kontekstin shqiptar.

KAPITULLI VI

KONKLUZIONE DHE PERSPEKTIVA PËR ZHVILLIMIN E ANGAZHIMIT TË SIPËRMARRJEVE NË DREJTIM TË PËRGJEGJËSISË SOCIALE DHE ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM TË BIZNESIT NË SHQIPËRI

1. Hyrje

Ky kapitull përmbledh gjetjet më të rëndësishme të studimit mbi angazhimin e sipërmarrjeve shqiptare në fushën e përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke integruar rezultatet e analizës teorike dhe empirike. Ai shërben si urë lidhëse ndërmjet kuadrit konceptual, modelit metodologjik dhe rezultateve të analizës së të dhënave, duke krijuar një bazë të qëndrueshme për formulimin e rekomandimeve dhe për evidentimin e kufizimeve dhe drejtimeve të ardhshme të kërkimit.

Kapitulli i dytë, duke analizuar evolucionin e përgjegjësisë sociale të sipërmarrjeve dhe integrimin e saj në paradigmen e zhvillimit të qëndrueshëm, evidentoi ndryshimin nga konceptimi tradicional i sipërmarrjes/korporatës si strukturë e orientuar ekskluzivisht drejt fitimit, drejt një modeli bashkëkohor që integron performancën ekonomike, ndikimin social dhe përgjegjësinë mjedisore. Ky transformim thekson rolin e sipërmarrjes/korporatës në shoqëri dhe në sistemin ekonomik global ku zhvillimi i qëndrueshëm nuk është një koncept normativ, por një kornizë referimi për vlerësimin e performancës. Analiza teorike nxori në pah rëndësinë e indikatorëve të strukturuar për matjen e angazhimit të sipërmarrjeve. Efektiviteti i këtyre indikatorëve kushtëzohet nga koherenca midis strategjisë, qeverisjes dhe praktikave operative, ndërsa, standardizimi ndërkombëtar duhet të kombinohet me kontekstualizimin lokal për të siguruar krahasueshmëri dhe transparencë. Transparenca dhe llogaridhënia janë parakushte për funksionimin efektiv të sistemit të indikatorëve, duke lidhur matjen e angazhimit me besueshmërinë institucionale dhe marrëdhëniet me palët e interesit.

Kapitulli i tretë ofroi një shqyrtim të indikatorëve ekonomikë që lejojnë matjen e ndikimit të përgjegjësisë sociale mbi performancën ekonomike. Indikatorë si rritja e të ardhurave, kursimet në kosto, zgjerimi i tregut, avantazhi konkurrues, efikasiteti i burimeve, inovacioni, qasja në kapital, produktiviteti i punonjësve, zbutja e riskut dhe vlera e markës formojnë një kornizë integruese për vlerësimin e performancës ekonomike. Ky set indikatorësh shërben si bazë për operacionalizimin e të dhënave empirike, duke mundësuar testimin e hipotezave dhe vlerësimin e marrëdhënieve ndërmjet dimensioneve të ndryshme të qëndrueshmërisë.

Kapitulli i katërt, dedikuar kornizës së metodologjisë dhe analizës empirike, evidenton se perceptimi publik mbi angazhimin e sipërmarrjeve ndryshon ndjeshëm sipas dimensioneve të studiara dhe grupmoshave. Dimensionet që lidhen me përfshirjen në komunitet, transparencën dhe përafrimin me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm kanë

ndikim më të fortë dhe më pozitiv, ndërsa, reduktimi i emetimeve dhe investimet sociale janë më sfiduese për perceptimin. Analiza e madhësisë së efektit dhe regresioni rendor evidentojnë forcën e ndikimit të secilit dimension, duke krijuar një bazë të qartë për interpretimin e rezultateve empirike. Nga rezultatet e përgjithshme përshkruese del se një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve nuk kanë njohuri mbi planet strategjike konkrete të sipërmarrjeve në lidhje me përgjegjësinë sociale dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Kjo mungesë tregon se dimensionet që lidhen me reduktimin e emetimeve, menaxhimin e zinxhirit të furnizimit dhe investimet sociale kërkojnë vëmendje të shtuar dhe ndërhyrje të qëndrueshme.

Kapitulli i pestë fokusohet në analizën empirike të të dhënave, duke prezantuar mënyrën se si perceptimi publik përfshin dhe vlerëson dimensionet mjedisore, sociale dhe institucionale të angazhimit të sipërmarrjeve. Ky kapitull shërben si lidhje e drejtpërdrejtë mes teorisë, metodologjisë dhe praktikës, duke demonstruar në mënyrë rigoroze marrëdhëniet ndërmjet variablave të pavarur dhe variablit të varur. Rezultatet e kapitullit të pestë krijojnë bazën për nxjerrjen e konkluzioneve finale, rekomandimeve praktike dhe identifikimin e perspektivave për kërkime të ardhshme, duke lidhur gjetjet empirike me zhvillimet teorike dhe legjisllacionin në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm.

Ky integrim i kapitujve të teorisë dhe analizës empirike ofron një kuptim të plotë të ndërveprimeve midis dimensioneve të përgjegjësisë sociale dhe perceptimit publik, duke mundësuar formulimin e rekomandimeve konkrete për përmirësimin e angazhimit të sipërmarrjeve shqiptare në drejtim të qëndrueshmërisë dhe përgjegjësisë sociale.

2. Gjetjet e Studimit

Studimi zbulon se në këndvështrimin e perceptimit publik në tërësi mbi angazhimin e sipërmarrjeve me përgjegjësinë sociale dhe zhvillimin e qëndrueshëm interes të veçantë ka transparenca, raportimi dhe pajtueshmëria me të drejtat e njeriut. Gjithashtu, studimi evidenton se pritshmëritë më të mëdha mbi angazhimin e sipërmarrjeve me përgjegjësinë sociale dhe zhvillimin e qëndrueshëm i kanë drejtuesit dhe klientët.

Konkretisht, analiza e madhësisë së efektit mbi perceptimet e fokus grupeve kundrejt elementëve të marra në studim tregon se, kryesisht, pritshmëritë e drejtuesve janë pak më të larta se ato të klientëve në aspekte të sipërmarrjes si implementimi i strategjisë me objektiv "*neto zero*" me qëllim reduktimin e emetimeve karbonike dhe e kundërta ndodh në rastin e trajtimit të kontradiktave ndërmjet synimeve të biznesit dhe detyrimeve ndaj të drejtave të njeriut. Ky rast i fundit vihet re edhe si dallim midis perceptimeve të punonjësve dhe atyre të drejtuesve.

Ndërsa, klientët paraqesin pritshmëri më të lartë se ato të drejtuesve në lidhje me kërkesat specifike sa i takon furnitorëve mbi praktikatat e punës, qëndrueshmërinë mjedisore e sjelljen etike si dhe mbështjen edhe komunitare në hartimin e programeve të përgjegjësisë sociale të sipërmarrjes. Në këtë të fundit, gjithashtu punonjësit kanë pritshmëri më të larta se ato të drejtuesve.

Gjithashtu, studimi dëshmon se perceptimi publik në tërësi mbi angazhimin e sipërmarrjeve me përgjegjësinë sociale dhe zhvillimin e qëndrueshëm udhëhiqet njëherazi nga reduktimi i emetimeve të karbonit dhe menaxhimi i zinxhirit të furnizimit (A), promovimi i përfshirjes dhe angazhimit të komunitetit (B), investimet sociale dhe mbështetja e palëve të interesuara (C), si dhe transparenca, raportimi dhe pajtueshmëria me të drejtat e njeriut (D).

Në këndvështrimin e drejtuesve i mësohet faktit se, transparenca, raportimi dhe pajtueshmëria me të drejtat e njeriut është aspekti që nxit përafrimin e sipërmarrjeve me qëllimet dhe praktikatat e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm. Ky qëndrim i drejtuesve mund të shpjegohet me faktin se, rritja e transparencës, raportimit dhe pajtueshmëria me të drejtat e njeriut ndikon njëherazi edhe në rritjen e besimit të klientëve dhe komunitetit, nëpërmjet rritjes së përgjegjësisë në punë që çon në rritjen e efektivitetit të sipërmarrjes dhe në forcimin e imazhit të saj.

Ndërsa, sipas perceptimit të furnitorëve, reduktimi i emetimeve të karbonit dhe menaxhimi i zinxhirit të furnizimit luajnë rol vendimtar në përafrimin e sipërmarrjeve me qëllimet dhe praktikatat e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm. Qëndrim ky që mund të shpjegohet me kërkesën e tregut dhe konsumatorëve për shërbime dhe produkte të sipërmarrjeve që tregojnë angazhim dhe qëndrueshmëri, por edhe me detyrimet ligjore mbi praktikatat e qëndrueshme të biznesit. Kjo jo vetëm për të shmangur gjoka e penalitete, por edhe për të ruajtur aksesin në tregje të ndryshme. Gjithashtu, edhe presioni i investitorëve të cilët gjithmonë e më shumë po i kushtojnë vemendje faktorëve mjedisorë dhe socialë të qeverisjes së sipërmarrjeve luajnë rol.

Krahasimisht, ndryshimet klimatike dhe problemet e qëndrueshmërisë mund të paraqesin risqe të konsiderueshme për bizneset, duke përfshirë ndërprerjet e zinxhirit të furnizimit, rritjen e kostove dhe dëmtimin e reputacionit. Prandaj, reduktimi i emetimeve të karbonit dhe menaxhimi i zinxhirit të furnizimit bëjnë të mundur që furnitorët të ndihmojnë sipërmarrjet të zvogëlojnë këto risqe.

Klientët gjykojnë se jo vetëm reduktimet e emetimeve të karbonit dhe menaxhimi i zinxhirit të furnizimit, por edhe promovimi i përfshirjes dhe angazhimit të komunitetit ndihmojnë në përafrimin e sipërmarrjeve me qëllimet dhe praktikatat e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm. Prandaj, mund të thuhet se tanimë zhvillimi i qëndrueshëm nuk është vetëm një çështje mjedisore, por edhe një çështje sociale e cila reflektohet në mënyrën se si kompanitë angazhohen me komunitetet dhe trajtojnë kapitalin e tyre human.

Punonjësit rezultojnë të jenë fokus grupi më pretendues në këtë kontekst, pasi vlerësojnë se reduktimet e emetimeve të karbonit dhe menaxhimi i zinxhirit të furnizimit, promovimi i përfshirjes dhe angazhimit të komunitetit si dhe investimet sociale dhe mbështetja e palëve të interesuara së bashku nxisin përafrimin e sipërmarrjeve me qëllimet dhe praktikatat e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm. Ky qëndrim i punonjësve mund të shpjegohet me ndërgjegjësimin e tyre për shkak të angazhimit të drejtëpërdrejtë në proceset e brendshme të sipërmarrjeve dhe me rolin që sipërmarrja i ka dhënë atyre në rrugëtimin e gjatë drejt përpjekjeve për zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm.

Ndërsa, partnerët janë fokus grupi që, bazuar edhe në profilin e tyre, nuk adresojnë asnjë nga shtyllat e studimit në veçanti lidhur me përafrimin e sipërmarrjeve me qëllimet dhe praktikën e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm. Ky qëndrim i tyre shpjegohet me faktin se të gjitha shtyllat e studimit sipas tyre janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën.

3. Rekomandimet

Sipërmarrjet, për të menaxhuar më së miri angazhimin e tyre me objektivat dhe praktikën e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm, duhet të zhvillojnë plane të posaçme. Në mungesë të tyre shpjegohet se, aspektet e sipërmarrjeve që kanë të bëjnë kryesisht me reduktimin e emetimeve karbonike e me menaxhimin e zinxhirit të furnizimit si dhe me investimet sociale dhe palët e interesuara kanë nevojë për ndërhyrje të menjëhershme. Kështu, disa nga strategjitë që mund të ndiqen nga sipërmarrjet lidhur me reduktimin e emetimeve karbonike dhe me menaxhimin e zinxhirit të furnizimit janë si vijon:

- **Reduktimi i Emetimeve Karbonike.** Për të reduktuar emetimet e karbonit, fokusi duhet të jetë në efikasitetin e energjisë duke investuar në teknologji më të mira si ndriçimi LED dhe sisteme ngrohje/ftohje të përshtatshme. Rinovimi i ndërtesave për të përmirësuar izolimin dhe zvogëlimin e konsumit të energjisë është po ashtu i rëndësishëm, sikurse edhe menaxhimi i energjisë për të monitoruar dhe optimizuar konsumin.
- **Burime të rinovueshme të energjisë.** Është i domosdoshëm kalimi në energji diellore, eolike, hidroelektrike ose biomasë për të fuqizuar proceset e sipërmarrjeve. Kjo mund të realizohet nëpërmjet instalimit të paneleve diellore në ndërtesa ose blerja e energjisë nga burime të rinovueshme.
- **Zvogëlimi i emetimeve të transportit.** Për të reduktuar emetimet nga transporti, nxitja e transportit publik përfshin ofrimin e subvencioneve ose bonuseve për punonjësit, si dhe ofrimin e shërbimeve të transportit me biçikleta dhe makinë.
- **Inkurajimi i punës nga shtëpia.** Për të zvogëluar nevojën për udhëtime, puna nga shtëpia duhet të inkurajohet sa më shumë që të jetë e mundur. Për më tepër duhet të bëhen investime në teknologjinë e komunikimit për të mbështetur këtë qasje.
- **Kalimi në automjete elektrike.** Zëvendësimi i automjeteve me automjete elektrike ose hibride ka interes të veçantë. Por, për të mundësuar këtë të fundit është i domosdoshëm paraprakisht edhe instalimi i pikave të karikimit të automjeteve elektrike pranë vendeve të punës ose në parkun e automjeteve.
- **Harta logjistike rrugore.** Është gjithashtu e nevojshme të merren masa për përdorimin e mjeteve të transportit më efikase dhe shfrytëzimin e atyre rrugëve që zvogëlojnë distancat e udhëtimit.
- **Menaxhimi i mbetjeve.** Një aspekt tejet i dobishëm është ai i reduktimit të prodhimit të mbetjeve nëpërmjet strategjive të riciklimit dhe ripërdorimit të tyre. Nga ana tjetër, implementimi i programeve të kompostimit për mbetjet organike është një gjetje shumë e mirë për zhvillimin e një mjedisi më të pastër dhe të

qëndrueshëm. Udhëzime praktike që ndihmojnë këtë proces mund të jepen edhe për klientët nëpërmjet etiketave të produkteve, faqeve të internetit të sipërmarrjeve, etj. Sidoqoftë, rëndësinë në të gjithë procesin e merr zëvendësimi i materialeve me opsione të qëndrueshme dhe të riciklueshme.

- *Zvogëlimi i emetimeve të furnizimit.* Për të minimizuar ndikimet mjedisore, sipërmarrjeve duhet të angazhohen me furnitorë që ndjekin praktika të qëndrueshme. Konkretisht, duhen synuar materiale dhe produkte me gjurmë të ulët të karbonit, duke i dhënë përparësi opsioneve ekologjike. Gjithashtu, duhet të kryhen vlerësime të gjurmës së karbonit në të gjithë zinxhirin e furnizimit dhe të zbatohen masat e nevojshme për të reduktuar këtë të fundit. Ky proces përfshin bashkëpunimin me partnerët për të përmirësuar efikasitetin e energjisë, për të reduktuar mbetjet dhe për të përdorur praktika të transportit të qëndrueshëm.
- ***Kompensimi i emetimeve (korrektimi)*** nëpërmjet konkretizimit të projekteve për rijetësimin e ekosistemit natyror dhe projekteve të pajtueshme me natyrën, konkretisht:
 - *Projektet e pyllëzimit dhe ripyllëzimit.* Projektet e pyllëzimit dhe ripyllëzimit fokusohen në mbjelljen e pemëve për të rritur absorbimin e dioksidit të karbonit nga atmosfera. Kjo qasje përfshin investimin e sipërmarrjeve në mbjelljen e pemëve në zona të reja (pyllëzim) ose në ripyllëzimin e zonave të cilat kanë humbur pyjet. Synimi kryesor është të ndihmohet në zvogëlimin e nivelit të dioksidit të karbonit në atmosferë, duke kontribuar kështu në zbutjen e ndryshimeve klimatike.
 - *Projektet e energjisë së rinovueshme.* Kudo dhe me këdo që operon sipërmarrja duhet të mbështesë projektet e energjisë së rinovueshme.
 - *Projektet e përthithjes së karbonit.* Projektet e përthithjes së karbonit përfshijnë investimin në teknologji që kapin dioksidin e karbonit nga burimet e emetimit si termocentralet ose direkt nga ajri.
 - *Projektet e zvogëlimit të emetimeve të metanit.* Financimi i projekteve që kapin dhe përdorin metanin nga bujqësia ose burime të tjera është një praktikë e rëndësishme që duhet të gjejë zbatim nga sipërmarrjet për reduktimin e emetimeve të gazrave serë dhe për mbrojtjen e mjedisit. Duke qenë se metani është një gaz me potencial ngrohjeje shumë më të lartë se dioksidi i karbonit kur lihet i lirë në atmosferë ai kontribuon në ndryshimet klimatike. Ndaj, projektet që kapin metanin dhe e përdorin atë për të gjeneruar energji, siç janë projekte të energjisë nga mbetjet, kërkojnë financime të konsiderueshme nga burime të ndryshme, duke përfshirë investitorët privatë, fondet qeveritare, bankat dhe organizatat ndërkombëtare si dhe fonde të veçanta për klimën.
- ***Përfshirja e punonjësve dhe kultura e qëndrueshmërisë*** duhet të ketë në fokus:
 - *Nxjitjen e sjelljeve të qëndrueshme.* Sipërmarrjet mund të kontribuojnë në qëndrueshmërinë duke ofruar stimuj për punonjësit që përdorin transportin publik e biçikleta ose që punojnë nga shtëpia, duke reduktuar kështu emetimet e gazrave serë. Përveç kësaj, organizimi i trajnimeve dhe seminareve për ndërgjegjësimin e

punonjësve mbi qëndrueshmërinë mund të ndikojë në një kulturë kujdesi në vendin e punës si dhe në rritjen e sensibilitetit për respektimin e të drejtave të njeriut. Implementimi i politikave të brendshme që promovojnë praktika të qëndrueshme si reduktimi i përdorimit të letres dhe riciklimi mund të jenë një hap tjetër i rëndësishëm drejt reduktimit të ndikimit mjedisor të sipërmarrjes. Duke bashkëpunuar me drejtuesit dhe punonjësit, si dhe duke diskutuar vazhdimisht me ta jo vetëm për të ndjekur por edhe për të përmirësuar këto praktika, sipërmarrjet mund të kontribuojnë në një të ardhme më të qëndrueshme për të gjithë.

- *Komunikimi dhe raportimi.* Për të promovuar një angazhim të fortë ndaj qëndrueshmërisë, sipërmarrjet duhet të ndjekin një qasje të shumëanshme. Së pari, transparenca e objektivave të sipërmarrjes, progresit dhe rezultateve të qëndrueshmërisë është thelbësore. Kjo përfshin jo vetëm shpalosjen e qëllimeve ambicioze, por edhe ndarjen e të dhënave të sakta dhe të rregullta për të treguar përparimin. Së dyti, publikimi i raporteve vjetore të qëndrueshmërisë shërben si një demonstrim i rëndësishëm i përkushtimit dhe llogaridhënies. Këto raporte duhet të jenë gjithëpërfshirëse dhe lehtësisht të kuptueshme duke ofruar një vlerësim të plotë të ndikimit mjedisor, social dhe ekonomik të sipërmarrjes. Së fundmi, integrimi i qëndrueshmërisë në misionin dhe vlerat themelore të sipërmarrjes siguron që qëndrueshmëria të hedhë rrënjë në kulturën e sipërmarrjes. Kjo e bën qëndrueshmërinë një element të pandashëm të vendimeve të biznesit dhe strategjisë afatgjatë.
- *Partneritetet dhe bashkëpunimi.* Për të avancuar me qëndrueshmërinë, zgjerimi i bashkëpunimit të sipërmarrjeve me aktorë të tjerë është thelbësor. Ato duhet të angazhohen fuqimisht në bashkëpunim me organizatat jo-qeveritare, institucionet akademike si universitetet, agjencitë qeveritare, investitorët e me komunitetin. Këto partneritete do ti lejojnë të ndajnë praktikatat më të mira, duke siguruar që të gjithë të përfitojnë nga përvoja dhe njohuritë e akumuluarat. Për më tepër, duhet mbështetur fuqishëm kërkimi dhe zhvillimi nëpërmjet financimit të projekteve dhe nismave që synojnë të zhvillojnë zgjidhje të reja dhe inovative për sfidat e qëndrueshmërisë. Ky bashkëpunim i gjerë ofron shanse për të ndërtuar një të ardhme më të qëndrueshme dhe të përgjegjshme.
- *Bashkëpunimi me industrinë.* Bashkëpunimi me sipërmarrje të tjera në të njëjtin sektor për të zhvilluar zgjidhje të përbashkëta për reduktimin e emetimeve është një qasje strategjike ku bizneset konkurruese bashkojnë forcat për të adresuar sfidat mjedisore të shkaktuara nga aktivitetet e tyre. Kjo mund të përfshijë shkëmbimin e njohurive, burimeve dhe teknologjive për të zhvilluar zgjidhje inovative siç janë proceset më efikase të prodhimit, burimet e rinovueshme të energjisë ose teknologjitë e kapjes së karbonit. Përfitimet janë të shumta duke përfshirë shpenzimet e reduktuara të kërkimit dhe zhvillimit, një qasje më e shpejtë në treg të zgjidhjeve të gjelbra dhe ndikim më të madh në uljen e emetimeve totale të sektorit. Një bashkëpunim i tillë mund të çojë, gjithashtu, në rregullore më të mira të përbashkëta dhe një përmirësim të imazhit të sipërmarrjeve të përfshira.

- **Angazhimi me palët e interesuara.** Angazhimi i sipërmarrjeve me klientët, furnitorët dhe komunitetet lokale është i domosdoshëm për të kuptuar shqetësimet dhe për të përfshirë perspektivat e tyre në strategjinë e qëndrueshmërisë. Pra, zbatimi i një strategjie "*neto zero*" është një angazhim afatgjatë që kërkon një plan të qartë, objektiva të matshëm dhe përkushtim nga të gjitha nivelet e sipërmarrjes. Kësisoj, duhen kombinuar masat për reduktimin e emetimeve, kompensimin e tyre, përfshirjen e punonjësve dhe bashkëpunimin me palët e interesuara. Vetëm kështu sipërmarrjet mund të luajnë një rol të rëndësishëm në luftën kundër ndryshimeve klimatike dhe në krijimin e një të ardhmeje më të qëndrueshme.
- **Shtrirja e aktivitetit të sipërmarrjeve përtej fushave tradicionale të financës.** Sa i takon aspektit të investimeve sociale dhe palëve të interesuara lidhur me nevojën për ndërmarrjen e iniciativave për të eksploruar fusha në zhvillim duhet të theksohet fakti se sipërmarrjet duhet ta shtrijnë aktivitetin e tyre përtej fushave tradicionale të financës. Këtu përmendim jo vetëm pjesëmarrjen e tyre në tregjet e kapitalit, por dhe mundësitë që ofrojnë obligacionet e gjelbra dhe mikrofinancat. Ky hap do të tregonte një angazhim për qëndrueshmërinë mjedisore dhe përfshirjen sociale. Obligacionet e gjelbra të cilat përdoren për të financuar projekte të qëndrueshme përfaqësojnë një rrugë për të investuar në të ardhmen e gjelbër, ndërsa, mikrofinancat synojnë të ofrojnë shërbime financiare për individët dhe komunitetet me të ardhura të ulëta duke nxitur rritjen ekonomike dhe zhvillimin social. Kjo lëvizje strategjike tregon një vëmendje në rritje për të përfshirë financat me një ndikim pozitiv në shoqëri dhe mjedis.
- **Modelimi i programeve të përgjegjësisë sociale.** Në të njëjtin këndvështrim, sipërmarrjet duhet të bëhen aktorë kyç në modelimin e programeve të përgjegjësisë sociale. Ato zotërojnë njohuri unike për nevojat, sfidat dhe prioritetet e tyre, të cilat janë thelbësore për të krijuar iniciativa të qëndrueshme që janë efektive dhe të rëndësishme. Kështu, përfshirja e komuniteteve lokale në procesin e projektimit siguron që programet e përgjegjësisë sociale të jenë të përshtatura për kontekstin specifik lokal, duke adresuar çështje të tilla si arsimi, shëndeti, mjedisi dhe zhvillimi ekonomik në mënyrë të drejtpërdrejtë. Për më tepër, pjesëmarrja e komunitetit rrit besimin dhe mbështetjen për programet e përgjegjësisë sociale, duke rritur ndikimin dhe qëndrueshmërinë e tyre. Përmes konsultimeve, bashkëpunimit dhe angazhimit të drejtpërdrejtë, komunitetet lokale ndihmojnë sipërmarrjet të zhvillojnë programe që jo vetëm përmirësojnë reputacionin e tyre, por, gjithashtu, kontribuojnë në mirëqenien e komunitetit dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Ndaj, edhe ato aspekte sipërmarrëse që janë vlerësuar mirë nga anketa në lidhje me përgjegjësinë sociale dhe zhvillimin e qëndrueshëm kanë padyshim nevojë vazhdimisht për përmirësim, duke pasur parasysh sfidat me të cilat përballemi në përditshmëri dhe për të qënë të përgatitura për ato të ardhshme.
- **Aspekti ligjor.** Aspekti ligjor i përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm është një komponent kyç për të siguruar që sipërmarrjet të

përmbushin standardet etike dhe mjedisore që lidhen me aktivitetet e tyre. Nga studimi rezulton se mungesa e njohurisë mbi planet strategjike të sipërmarrjeve për zhvillimin e qëndrueshëm tregon një nevojë të qartë për krijimin e një kuadri ligjor që inkurajon dhe detyron veprime të përgjegjshme. Një kontribut shumë i rëndësishëm në këtë drejtim është studimi i Tahiraj et al. (2025) që ofron një analizë të detajuar të harmonizimit të legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian në fushën e qëndrueshmërisë, duke evidentuar detyrimet e reja që hyjnë në fuqi në vitin 2026. Ky studim thekson se viti 2024 shënoi një fazë kyçe në rishikimin dhe konsolidimin e kuadrit rregullator të BE-së, veçanërisht në drejtim të ekonomisë qarkulluese, menaxhimit të mbetjeve, qëndrueshmërisë dhe sigurisë në furnizimin me lëndë të para. Ky reformim është realizuar përmes një **pakete normative të re** e përbërë nga tetë rregullore dhe direktiva që synojnë të përforcojnë autonominë strategjike të BE-së, të rrisin efikasitetin në përdorimin e burimeve, të mbështesin teknologjitë e pastra dhe të promovojnë një treg të gjelbër konkurrues dhe të integruar. Për sektorin e lëndëve të para dhe përpunimin industrial, paketa e re ligjore e BE-së përfshin kërkesa të rëndësishme që duhet të adresohen edhe nga Shtetet kandidate për anëtarësim, si: **Rregullore (BE) 2024/1252** “Për Lëndët e Para Kritike” (Critical Raw Materials Act); **Rregullore (BE) 2024/1157** “Për Transportin e Mbetjeve” (Waste Shipment Regulation); **Direktiva (BE) 2024/1203** “Mbi Mbrojtjen Penale të Mjedisit” (Environmental Crime Directive); **Direktiva (BE) 2024/1785** “Për Emetimet Industriale” (Industrial Emissions Directive); **Direktiva (BE) 2024/1760** “Për Detyrimin e Korporatave për Qëllime të Qëndrueshmërisë” (Corporate Sustainability Due Diligence); **Rregullore (BE) 2024/1781** “Për Përcaktimin e Kërkesave të Projektimit Ekologjik për Produktet e Qëndrueshme” (Ecodesign Regulation); **Rregullore (BE) 2025/40** “Mbi Amballazhet dhe Mbetjet e Amballazhit” (Packaging and Packaging Waste Regulation). Bazuar në këto zhvillime, rekomandohet që autoritetet rregullatore shqiptare të zhvillojnë një **kornizë ligjore kombëtare** që: Inkurajon sipërmarrjet të investojnë në praktika të qëndrueshme; Promovon ndërveprimin e angazhimeve për reduktimin e emetimeve të karbonit dhe menaxhimin efikas të burimeve; Përfshin stimuj financiarë për sipërmarrjet që adoptojnë energjinë e rinovueshme dhe praktikatat e qëndrueshme; Parashikon sanksione për sipërmarrjet që nuk përmbushin detyrimet mjedisore dhe sociale. Ky kuadër ligjor nuk siguron vetëm respektimin e standardeve ndërkombëtare, por mundëson që sipërmarrjet të integrojnë përgjegjësinë sociale dhe zhvillimin e qëndrueshëm në strategjinë dhe operacionet e tyre, duke rritur legjitimitetin dhe ndikimin pozitiv në shoqëri. Integrimi i këtyre praktikave në modelin e biznesit shqiptar përputhet me trendet më të fundit të BE-së dhe përgatit bazën për një zhvillim të qëndrueshëm, të matshëm dhe afatgjatë në nivel kombëtar.

- **Angazhimi i sipërmarrjeve me palët e interesuara.** Një tjetër aspekt i rëndësishëm është angazhimi i sipërmarrjeve me palët e interesuara. Proçeset ligjore të

angazhimit me komunitetet lokale dhe grupe të tjera të interesit duhet të formalizohen, duke siguruar që zëri i komunitetit të dëgjohet dhe të përfshihen në vendimarrje. Kjo mund të arrihet përmes rishikimeve të ligjeve për përgjegjësinë sociale që të rregullojnë mënyrën se si sipërmarrjet duhet të raportojnë dhe të angazhohen në mënyrë transparente me palët e interesuara. Ndërkohë, duhet të promovohet një kulturë e qëndrueshmërisë në brendësi të organizatave ku ligjet e punës dhe politika e brendshme inkurajojnë sjellje të qëndrueshme, duke mundësuar që punonjësit të ndihen të angazhuar dhe të kontribuojnë në strategjitë e qëndrueshmërisë.

- **Rishikimi i legjislacionit mbi financat e gjelbra.** Legjislacioni që rregullon financat me ndikim si, obligacionet e gjelbra, duhet të rishikohet me qëllim që të jetë më i qartë e i lehtë për t'u zbatuar, duke lehtësuar procesin që sipërmarrjet të mund të financojnë projekte të qëndrueshme. Legjislacioni që ndihmon në krijimin e një tregu të shëndetshëm për investimet sociale dhe financat e qëndrueshme do të krijojë mundësi më të mira për bashkëpunim ndërmjet sektorëve publikë dhe privat. Kështu, krijimi i një kuadri ligjor që mbështet përgjegjësinë sociale dhe zhvillimin e qëndrueshëm do të kontribuojë në përmirësimin e njohurive dhe angazhimit të sipërmarrjeve, duke ndihmuar në integrimin e praktikave të qëndrueshme në strategjitë e biznesit të tyre. Vetëm në këtë mënyrë, sipërmarrjet që operojnë në vend do të jenë të gatshme të përballen me dinjtet me sfidat e së ardhmes dhe të kontribuojnë aktivisht në zhvillimin e një ekonomie të qëndrueshme.

4. Kufizimet e Studimit

Sipas Ligjit nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, aktualisht në fuqi në Republikën e Shqipërisë, numri i bizneseve me status sipërmarrje e madhe në Shqipëri është relativisht i vogël. Si rezultat janë përzgjedhur në mënyrë të qëllimshme të anketohen 120 individë në lidhje me angazhimin e sipërmarrjeve me përgjegjësinë sociale dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Dhe vetëm 92 prej tyre morën pjesë në anketim. Madhësia e këtij kampioni mund të trajtohet si limit i studimit. Arsyet evidentohen si vijon:

1. **Përcaktimi i kufijve.** Një kampion prej 92 individësh mund të përcaktojë kufijtë e këtij studimi, pasi ai përcakton, gjithashtu, shtrirjen dhe fokusin e studimit. Por, lidhur me kushtet e vlerësimit të përgjithshëm një kampion prej 92 individësh statistikisht përfaqëson një zgjedhje të madhe.
2. **Kosto dhe rrethana të tjera.** Zgjedhja e një numri të caktuar të të anketuarve si 120 kundrejt 92 që u përgjigjën lidhet edhe me kufizimet e koston, kohës dhe rrethanave të tjera. Kjo, pasi, mbledhja e të dhënave nga një numër më i madh individësh do ishte më e vështirë dhe e kushtueshme. Kështu, mund të bëheshin pjesë e të anketuarve edhe individë me marrëdhënie të ndryshme brenda së njejtës sipërmarrje ku është vlerësuar paraprakisht anketa, por kjo do të kërkonte takime paraprake me personat në fjalë për të shpjeguar arsyet e studimit si dhe do të

cënohej vlerësimi i anketës në kushtet e anonimatit. Kjo procedurë padyshim që do të zgjaste ndjeshëm kohën e mbledhjes së të dhënave si dhe do të rriste kostot e kërimit.

3. *Analiza statistikore.* Numri i të anketuarve ndikon drejtpërdrejt në analizat statistikore dhe në nivelin e përgjithësueshmërisë së rezultateve. Një kampion prej 92 individësh konsiderohet i përshtatshëm për analiza përshkruese, teste jo-parametrike dhe modele regresioni me numër të kufizuar variablash, veçanërisht, kur plotësohen kriteret minimale metodologjike lidhur me raportin rast–variabël. Në rastin konkret, nëngrupet me përfaqësim më të ulët – si ai i partnerëve – mund të paraqesin kufizime në interpretimin inferencial të rezultateve, duke kërkuar kujdes në përgjithësimin e tyre. Megjithatë, kjo nuk përjashton përdorimin e teknikave statistikore të përshtatura për kampione me përmasa të moderuara. Literatura metodologjike thekson se metoda si regresioni rendor, testet jo-parametrike dhe analiza e madhësisë së efektit mund të aplikohen edhe në kampione relativisht me numër të limituar për sa kohë që respektohen supozimet statistikore dhe kufizimet e studimit deklarohen dhe interpretohen në mënyrë të kujdesshme (Field, 2018; Pallant, 2020; Cohen, 1988).
4. *Përfaqësimi.* Vlerësimi i madhësisë së kampionit nuk mund të bëhet në mënyrë absolute, por duhet të konsiderohet në raport me popullatën totale dhe me objektivin e studimit. Në rastin konkret, popullata e sipërmarrjeve që operojnë në segmentin përkatës në Shqipëri është relativisht e kufizuar; për rrjedhojë, një kampion prej 92 individësh që përfaqësojnë sipërmarrje të ndryshme përbën një pjesë të konsiderueshme të segmentit të analizuar. Në këtë kuptim, kampioni nuk mund të cilësohet automatikisht “i vogël”, por duhet vlerësuar në raport me strukturën dhe përmasën reale të popullatës, si dhe me natyrën eksploruese dhe analitike të studimit.
5. *Gabimi i mostrës dhe përgjithësimi i rezultateve.* Në parim, sa më i kufizuar të jetë kampioni, aq më i lartë mund të jetë gabimi i mostrës dhe aq më i kujdesshëm duhet të jetë interpretimi i rezultateve në raport me popullatën. Në rastin konkret, kampioni prej 92 individësh lejoi zhvillimin e analizave statistikore të vlefshme, por përgjithësimi i rezultateve u realizua me kujdes dhe brenda kufijve të segmentit të studiuar. Testet statistikore të aplikuara dhe treguesit e vlefshmërisë së modelit mbështesin konsistencën e rezultateve në nivel kampioni. Megjithatë, studimi synon kryesisht një përgjithësim analitik dhe interpretativ, duke identifikuar tendenca dhe marrëdhënie midis variablave më shumë sesa një ekstrapolim absolut për të gjithë popullatën e sipërmarrjeve në Shqipëri.
6. *Analiza krahasuese.* Për shkak të madhësisë së kufizuar të nëngrupeve brenda kampionit (në secilin rast $n < 30$), realizimi i analizave krahasuese ndërmjet fokus grupeve do të kishte fuqi të ulët statistikore dhe rrezik të shtuar për gabim të tipit II. Në këto kushte, interpretimi i diferencave të mundshme ndërmjet grupeve do të ishte metodologjikisht i pasigurt. Për të njëjtën arsye nuk u konsiderua e arsyeshme zhvillimi i analizave krahasuese ndërmjet perceptimeve të shoqërive

tregtare me ortakë/aksionarë shqiptarë dhe atyre me ortakë/aksionarë të huaj, si dhe ndërmjet sektorëve të ndryshëm të shoqërive tregtare. Studimi është fokusuar kryesisht në analizën agregate dhe në identifikimin e marrëdhënieve ndërmjet variablave në nivel kampioni, duke shmangur krahasime që do të kërkonin nëngrupe me përfaqësim më të gjerë.

5. Premisa për Kërkime të Mëtejshme

Kërkimet e ardhshme mund të thellojnë analizën në nivel sektorial si brenda të njëjtit sektor ashtu edhe ndërmjet sektorëve të ndryshëm, duke shqyrtuar perceptimin e përgjithshëm ashtu edhe atë të bazuar në fokus-grupe mbi angazhimin e sipërmarrjeve ndaj përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Një qasje e tillë do të mundësonte identifikimin e dallimeve strukturore dhe specifike sektoriale në mënyrën se si konceptohet dhe zbatohet përgjegjësia sociale në praktikë.

Gjithashtu, kërkimi mund të fokusohet në vlerësimin e mekanizmave dhe efektivitetit të bashkëpunimeve ndërmjet aktorëve të ndryshëm (institucione publike, sektor privat dhe organizata të shoqërisë civile) në funksion të harmonizimit të qasjeve të sipërmarrjeve me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm. Studime të mëtejshme mund të analizojnë ndikimin krahasues të instrumenteve të politikave publike si nxitjet fiskale, subvencionet për teknologjitë e gjelbra apo kërkesat e detyrueshme për transparencë lidhur me përmirësimin e praktikave të qëndrueshmërisë në nivelin e sipërmarrjeve.

Në terma afatgjatë, hulumtimet mund të vlerësojnë efektet e qëndrueshme të programeve të angazhimit të komunitetit dhe iniciativave të investimeve sociale, duke analizuar nëse dhe si këto ndërhyrje kontribuojnë realisht në harmonizimin e strategjive të sipërmarrjeve me objektivat e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm në kontekste të ndryshme socio-ekonomike dhe rregullatore.

Një drejtim tjetër i rëndësishëm kërkimor lidhet me analizimin e rolit të teknologjive të reja si blockchain dhe inteligjenca artificiale në rritjen e transparencës, përmirësimin e raportimit jo-financiar dhe forcimin e mekanizmave të respektimit të të drejtave të njeriut në aktivitetin e sipërmarrjeve.

Së fundmi, studimet krahasuese në nivel rajonal ose ndërkombëtar do të mund të ofronin një kuptim më të thelluar mbi ndërveprimin e faktorëve kulturorë, politikë dhe ekonomikë që ndikojnë në ndërtimin e partneriteteve efektive ndërmjet qeverive, sipërmarrjeve dhe organizatave jo-qeveritare në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm.

Në konkluzion: Zhvillimi i qëndrueshëm po konsolidohet si një parim themelor me karakter universal, në realizimin e të cilit sipërmarrjet janë tashmë një faktor kyç edhe për ekonominë në Shqipëri.

BIBLIOGRAFIA

- Agresti, A. (2010). *Analysis of Ordinal Categorical Data*. Wiley.
- Hosmer, D. W., Lemeshow, S., & Sturdivant, R. X. (2013). *Applied Logistic Regression*. Wiley.
- Agudo-Valiente, J. M., Garcés-Ayerbe, C., & Salvador-Figueras, M. (2015). Corporate social performance and stakeholder dialogue management. *Corporate Social Responsibility and Environmental Management*, 22(1), 13-31. <https://doi.org/10.1002/csr.1324>.
- Aguilera, R. V., Rupp, D. E., Williams, C. A., & Ganapathi, J. (2007). Putting the S back in corporate social responsibility: A multilevel theory of social change in organizations. *Academy of management review*, 32(3), 836-863. <https://doi.org/10.5465/amr.2007.25275678>.
- Ahi, P., & Searcy, C. (2015). An analysis of metrics used to measure performance in green and sustainable supply chains. *Journal of cleaner production*, 86, 360-377. <https://doi.org/10.1016/j.jclepro.2014.08.005>.
- Akbar, A., Usman, M., & Lin, T. (2024). Institutional dynamics and corporate innovation: A pathway to sustainable development. *Sustainable Development*, 32(3), 2474-2488. <https://doi.org/10.1002/sd.2790>.
- Algarni, S., Tirth, V., Alqahtani, T., Alshehery, S., & Kshirsagar, P. (2023). Contribution of renewable energy sources to the environmental impacts and economic benefits for sustainable development. *Sustainable energy technologies and assessments*, 56, 103098. <https://doi.org/10.1016/j.seta.2023.103098>.
- Alshehhi, A., Nobanee, H., & Khare, N. (2018). The impact of sustainability practices on corporate financial performance: Literature trends and future research potential. *Sustainability*, 10(2), 494. <https://doi.org/10.3390/su10020494>.
- Ameh, B. (2024). Digital tools and AI: Using technology to monitor carbon emissions and waste at each stage of the supply chain, enabling real-time adjustments for sustainability improvements. *Int J Sci Res Arch*, 13(1), 2741-2754. <https://doi.org/10.30574/ijrsra.2024.13.1.1995>.
- Arias Fogliano de Souza Cunha, F., & Samanez, C. P. (2013). Performance analysis of sustainable investments in the Brazilian stock market: a study about the corporate sustainability index (ISE). *Journal of business ethics*, 117, 19-36. <https://doi.org/10.1007/s10551-012-1484-2>.
- Arora, N. K., & Mishra, I. (2023). Responsible consumption and production: a roadmap to sustainable development. *Environmental Sustainability*, 6(1), 1-6. <https://doi.org/10.1007/s42398-023-00266-9>.

- Attah, R. U., Garba, B. M. P., Gil-Ozoudeh, I., & Iwuanyanwu, O. (2024). Corporate banking strategies and financial services innovation: conceptual analysis for driving corporate growth and market expansion. *Int J Eng Res Dev*, 20(11), 1339-49.
- Attig, N., & Brockman, P. (2017). The local roots of corporate social responsibility. *Journal of Business Ethics*, 142, 479-496. <https://doi.org/10.1007/s10551-015-2757-3>.
- Atz, U., Van Holt, T., Douglas, E., & Whelan, T. (2020). The return on sustainability investment (ROSI): Monetizing financial benefits of sustainability actions in companies. In *Sustainable consumption and production, volume II: Circular economy and beyond* (pp. 303-354). Cham: Springer International Publishing. https://doi.org/10.1007/978-3-030-55285-5_14.
- Awaysheh, A., & Klassen, R. D. (2010). The impact of supply chain structure on the use of supplier socially responsible practices. *International journal of operations & production management*, 30(12), 1246-1268. <https://doi.org/10.1108/01443571011094253>.
- Awuah, B., Yazdifar, H., & Elbardan, H. (2024). Corporate reporting on the Sustainable Development Goals: A structured literature review and research agenda. *Journal of Accounting & Organizational Change*, 20(4), 617-646. <https://doi.org/10.1108/JAOC-102022-0155>.
- Azar, J., Duro, M., Kadach, I., & Ormazabal, G. (2021). The big three and corporate carbon emissions around the world. *Journal of Financial Economics*, 142(2), 674-696. <https://doi.org/10.1016/j.jfineco.2021.05.007>.
- Barakat, S. R., Isabella, G., Boaventura, J. M. G., & Mazzon, J. A. (2016). The influence of corporate social responsibility on employee satisfaction. *Management decision*, 54(9), 2325-2339. <https://doi.org/10.1108/MD-05-2016-0308>.
- Baregheh, A., Rowley, J., & Sambrook, S. (2009). Towards a multidisciplinary definition of innovation. *Management decision*, 47(8), 1323-1339. <https://doi.org/10.1108/00251740910984578>.
- Bartolacci, F., Cerqueti, R., Paolini, A., & Soverchia, M. (2019). An economic efficiency indicator for assessing income opportunities in sustainable waste management. *Environmental Impact Assessment Review*, 78, 106279. <https://doi.org/10.1016/j.eiar.2019.05.001>.
- Baumgartner, R. J., & Ebner, D. (2010). Corporate sustainability strategies: sustainability profiles and maturity levels. *Sustainable development*, 18(2), 76-89. <https://doi.org/10.1002/sd.447>.
- Bendell, B. L., & Huvaj, M. N. (2020). Does stakeholder engagement through corporate social and environmental behaviors affect innovation?. *Journal of Business Research*, 119, 685-696. <https://doi.org/10.1016/j.jbusres.2018.10.028>.

- Bergmann, A., Günther, E., & Kara, S. (2017). Resource efficiency and an integral framework for performance measurement. *Sustainable Development*, 25(2), 150-165. <https://doi.org/10.1002/sd.1669>.
- Binaku, M., & Ismajli, S. (2024). The respect for the rights of employees in the private and public sectors: Evidence from a developing economy. *Corporate Law & Governance Review*, 6(1). <https://doi.org/10.22495/clgrv6i1p8>.
- Blackburn, W. R. (2012). *The sustainability handbook: The complete management guide to achieving social, economic and environmental responsibility*. Routledge. <https://doi.org/10.4324/9781849773294>.
- Blombäck, A., & Scandellius, C. (2013). Corporate heritage in CSR communication: a means to responsible brand image?. *Corporate Communications: An International Journal*, 18(3), 362-382. <https://doi.org/10.1108/CCIJ-07-2012-0048>.
- Bocken, N. M., & Allwood, J. M. (2012). Strategies to reduce the carbon footprint of consumer goods by influencing stakeholders. *Journal of cleaner production*, 35, 118-129. <https://doi.org/10.1016/j.jclepro.2012.05.031>.
- Bodansky, D. (1993). The United Nations framework convention on climate change: a commentary. *Yale J. Int'l L.*, 18, 451.
- Bodansky, D., Brunnée, J., & Rajamani, L. (2021). Paris agreement. *Audiovisual Library of International Law*, 1-9. Marrë nga chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://legal.un.org/avl/pdf/ha/pa/pa_e.pdf.
- Bodhanwala, S., & Bodhanwala, R. (2018). Does corporate sustainability impact firm profitability? Evidence from India. *Management decision*, 56(8), 1734-1747. <https://doi.org/10.1108/MD-04-2017-0381>.
- Bolar, P., & Srinivasan, P. (2020). Sustainability risk management: an exploratory study. <https://doi.org/10.2139/ssrn.3571257>.
- Boström, M., Jönsson, A. M., Lockie, S., Mol, A. P., & Oosterveer, P. (2015). Sustainable and responsible supply chain governance: challenges and opportunities. *Journal of Cleaner Production*, 107, 1-7. <https://doi.org/10.1016/j.jclepro.2014.11.050>.
- Boulouta, I., & Pitelis, C. N. (2014). Who needs CSR? The impact of corporate social responsibility on national competitiveness. *Journal of business ethics*, 119, 349-364. <https://doi.org/10.1007/s10551-013-1633-2>.
- Bourdieu, P., & Nice, R. (1980). The production of belief: contribution to an economy of symbolic goods. *Media, culture & society*, 2(3), 261-293. <https://doi.org/10.1177/016344378000200305>.
- Brondoni, S. M. (2014). Global capitalism and sustainable growth. From global products to network globalisation. *Symphonya. Emerging Issues in Management*, (1), 10-31. <https://doi.org/10.4468/2014.1.02brondoni>.

- Brun, A., Karaosman, H., & Barresi, T. (2020). Supply chain collaboration for transparency. *Sustainability*, 12(11), 4429. <https://doi.org/10.3390/su12114429>.
- Brunila, O. P., Kunnaala-Hyrkki, V., & Inkinen, T. (2023). Sustainable small ports: performance assessment tool for management, responsibility, impact, and self-monitoring. *Journal of Shipping and Trade*, 8(1), 14. <https://doi.org/10.1186/s41072-023-00142-z>.
- Business Strategy in Balkans. (2022). Road to outstanding company. Marrë nga <https://strategyforbusiness.wordpress.com/csr/>
- Calvano, L. (2008). Multinational corporations and local communities: A critical analysis of conflict. *Journal of Business Ethics*, 82, 793-805. <https://doi.org/10.1007/s10551-007-9593-z>.
- Camilleri, M. A. (2017). Corporate sustainability and responsibility: creating value for business, society and the environment. *Asian Journal of Sustainability and Social Responsibility*, 2(1), 59-74. <https://doi.org/10.1186/s41180-017-0016-5>.
- Campos, L. M., & Vazquez-Brust, D. A. (2016). Lean and green synergies in supply chain management. *Supply Chain Management: An International Journal*, 21(5), 627-641. <https://doi.org/10.1108/SCM-03-2016-0101>.
- Carbon Disclosure Project (CDP). Marrë nga <https://carbonmarketinstitute.org/2024/04/18/carbon-disclosure-project-cdp/>.
- Carlsen, L., & Bruggemann, R. (2022). The 17 United Nations' sustainable development goals: A status by 2020. *International Journal of Sustainable Development & World Ecology*, 29(3), 219-229. <https://doi.org/10.1080/13504509.2021.1948456>.
- Carroll, A. B. (1991). *The pyramid of corporate social responsibility: Toward the moral management of organizational stakeholders*. Business Horizons, Volume 34, Issue 4, 39–48, ISSN 0007-6813, [https://doi.org/10.1016/0007-6813\(91\)90005-G](https://doi.org/10.1016/0007-6813(91)90005-G),
- Carroll, A. B., & Shabana, K. M. (2010). The business case for corporate social responsibility: A review of concepts, research and practice. *International journal of management reviews*, 12(1), 85-105. <https://doi.org/10.1111/j.1468-2370.2009.00275.x>.
- Centobelli, P., Cerchione, R., & Esposito, E. (2018). Environmental sustainability and energy-efficient supply chain management: A review of research trends and proposed guidelines. *Energies*, 11(2), 275. <https://doi.org/10.3390/en11020275>.
- Chan, R. (2021). Ensuring impactful performance in green bonds and sustainability-linked loans. *The Adelaide Law Review*, 42(1), 221-258.
- Cohen, R., Eames, P. C., Hammond, G. P., Newborough, M., & Norton, B. (2022). Briefing: The 2021 Glasgow Climate Pact: Steps on the transition pathway towards a low carbon world.

- Cooper, S. M., & Owen, D. L. (2007). Corporate social reporting and stakeholder accountability: The missing link. *Accounting, Organizations and Society*, 32(7-8), 649-667. <https://doi.org/10.1016/j.aos.2007.02.001>.
- Cort, T., Park, S. K., & Nascimento, D. (2025). Disclosure of corporate risk from socio-economic inequality. *Journal of Sustainable Finance & Investment*, 1-19. Marrë nga ssrn-4018590%20(1).pdf.
- Çelo, E., Dumi, A., & Çelo, J. (2015). SUSTAINABLE DEVELOPMENT OF THE ALBANIAN ECONOMY, COMPARATIVE ANALYSIS OF SME GROWTH RATES. *European Scientific Journal, ESJ*, 11(10).
- Dameri, R.P. & Bruzzone, M (2023). 2Smart City. Prospettive di ricerca. Atti del Convegno “Smart city. Stato dell’arte e prospettive di ricerca, Genova, DAD, Università di Genova, 26 giugno 2023. https://gup.unige.it/sites/gup.unige.it/files/2024-10/Smart_City_ebook.pdf
- De Angelis, R., Howard, M., & Miemczyk, J. (2018). Supply chain management and the circular economy: towards the circular supply chain. *Production Planning & Control*, 29(6), 425-437. <https://doi.org/10.1080/09537287.2018.1449244>.
- De Felice, D. (2015). Business and human rights indicators to measure the corporate responsibility to respect: Challenges and opportunities. *Human Rights Quarterly*, 37(2), 511-555. <https://doi.org/10.1353/hrq.2015.0031>.
- De Oliveira, U. R., Menezes, R. P., & Fernandes, V. A. (2024). A systematic literature review on corporate sustainability: contributions, barriers, innovations and future possibilities. *Environment, development and sustainability*, 26(2), 3045-3079. <https://doi.org/10.1007/s10668-023-02933-7>.
- Di Maio, F., Rem, P. C., Baldé, K., & Polder, M. (2017). Measuring resource efficiency and circular economy: A market value approach. *Resources, Conservation and Recycling*, 122, 163-171. <https://doi.org/10.1016/j.resconrec.2017.02.009>.
- Diez-Cañamero, B., Bishara, T., Otegi-Olaso, J. R., Minguez, R., & Fernández, J. M. (2020). Measurement of Corporate Social Responsibility: A Review of Corporate Sustainability Indexes, Rankings and Ratings. *Sustainability*, 12(5), 2153. <https://doi.org/10.3390/su12052153>
- Diez-Cañamero, B., Bishara, T., Otegi-Olaso, J. R., Minguez, R., & Fernández, J. M. (2020). Measurement of corporate social responsibility: A review of corporate sustainability indexes, rankings and ratings. *Sustainability*, 12(5), 2153. <https://doi.org/10.3390/su12052153>.
- D'Netto, B., Shen, J., Chelliah, J., & Monga, M. (2014). Human resource diversity management practices in the Australian manufacturing sector. *The International Journal of Human Resource Management*, 25(9), 1243-1266. <https://doi.org/10.1080/09585192.2013.826714>.

- Döll, L. M., Ulloa, M. I. C., Zammar, A., do Prado, G. F., & Piekarski, C. M. (2022). Corporate venture capital and sustainability. *Journal of Open Innovation: Technology, Market, and Complexity*, 8(3), 132. <https://doi.org/10.3390/joitmc8030132>.
- Donaldson, T., & Preston, L. E. (1995). *The stakeholder theory of the corporation: Concepts, evidence, and implications*. *Academy of Management Review*, Vol. 20, No. 1 (jan., 1995), pp. 65–91, <https://doi.org/10.2307/258887>
- Doornik, J. A., & Hansen, H. (2008). An omnibus test for univariate and multivariate normality. *Oxford bulletin of economics and statistics*, 70, 927-939.
- Dhanda, U., & Shrotryia, V. K. (2021). Corporate sustainability: the new organizational reality. *Qualitative Research in Organizations and Management: An International Journal*, 16(3/4), 464-487. <https://doi.org/10.1108/QROM-01-2020-1886>.
- Eikelenboom, M., & Long, T. B. (2023). Breaking the cycle of marginalization: how to involve local communities in multi-stakeholder initiatives?. *Journal of Business Ethics*, 186(1), 31-62, <https://doi.org/10.1007/s10551-022-05252-5>.
- Environmental Social Governance. *Che cosa sono gli ESG ('environmental, social and governance')?*. Marrë nga <https://www.aereweb.it/esg-enviroment-social-governance/>.
- Epstein, M. J., & Roy, M. J. (2001). Sustainability in action: Identifying and measuring the key performance drivers. *Long range planning*, 34(5), 585-604. [https://doi.org/10.1016/S0024-6301\(01\)00084-X](https://doi.org/10.1016/S0024-6301(01)00084-X).
- Erkan, A. R. I., & Yildiz, Z. (2014). Parallel lines assumption in ordinal logistic regression and analysis approaches. *International Interdisciplinary Journal of Scientific Research*, 1(3), 8-23.
- European Environment Agency (2020). Albania country profile - SDGs and the environment. Marrë nga <https://www.eea.europa.eu/themes/sustainability-transitions/sustainable-development-goals-and-the/country-profiles/albania-country-profile-sdgs-and?>
- Fagerland, M. W., & Hosmer, D. W. (2016). Tests for goodness of fit in ordinal logistic regression models. *Journal of Statistical Computation and Simulation*, 86(17), 3398-3418.
- Fallah Shayan, N., Mohabbati-Kalejahi, N., Alavi, S., & Zahed, M. A. (2022). Sustainable development goals (SDGs) as a framework for corporate social responsibility (CSR). *Sustainability*, 14(3), 1222. <https://doi.org/10.3390/su14031222>.
- Fasterling, B., & Demuijnck, G. (2013). Human rights in the void? Due diligence in the UN guiding principles on business and human rights. *Journal of Business Ethics*, 116, 799-814, <https://doi.org/10.1007/s10551-013-1822-z>.
- Fernando, R. (2012). Sustainable globalization and implications for strategic corporate and national sustainability. *Corporate Governance: The international journal of business in society*, 12(4), 579-589. <https://doi.org/10.1108/14720701211267883>.

- Field, A.P. (2018) *Discovering Statistics Using IBM SPSS Statistics*. 5th Edition, Sage, Newbury Park.
- Fonseca, L., Silva, V., Sá, J. C., Lima, V., Santos, G., & Silva, R. (2022). B Corp versus ISO 9001 and 14001 certifications: Aligned, or alternative paths, towards sustainable development?. *Corporate Social Responsibility and Environmental Management*, 29(3), 496-508. <https://doi.org/10.1002/csr.2214>.
- Fosu, E., Fosu, F., Akyina, N., & Asiedu, D. (2024). Do environmental CSR practices promote corporate social performance? The mediating role of green innovation and corporate image. *Cleaner and Responsible Consumption*, 12, 100155. <https://doi.org/10.1016/j.clrc.2023.100155>.
- Freeman, R. E. (1984). *Strategic management: A stakeholder approach*, Cambridge University Press, <https://doi.org/10.1017/CBO9781139192675>
- Friedman, M. (2007). The Social Responsibility of Business Is to Increase Its Profits. In: Zimmerli, W.C., Holzinger, M., Richter, K. (eds) *Corporate Ethics and Corporate Governance*. Springer, Berlin, Heidelberg. https://doi.org/10.1007/978-3-540-70818-6_14
- Frynas, J. G. (2010). Corporate social responsibility and societal governance: Lessons from transparency in the oil and gas sector. *Journal of business ethics*, 93, 163-179. <https://doi.org/10.1007/s10551-010-0559-1>.
- FTSE4Good All-World Index (2024). FTSE4Good Index Series. Marrë nga <https://www.lseg.com/en/ftse-russell/indices/ftse4good>.
- Ganesh, M. K., & Venugopal, B. (2024). Challenges, practice and impact of corporate social responsibility on sustainable development of environment and society. *Revista De Gestão Social E Ambiental*, 18(1), 1-13. <https://doi.org/10.1007/s10551-010-0559-1>.
- Gartzia, L. (2021). Gender equality in business action: A multi-agent change management approach. *Sustainability*, 13(11), 6209. <https://doi.org/10.3390/su13116209>.
- Gebreegziabher, M. A. (2023). Systematic Review of Potential Statutory and Policy Frameworks for Corporate Social Responsibility (CSR) Enforcement in Ethiopia: International and Local Experience. *Business Management and Strategy*, 14(2), 19-38. <https://doi.org/10.5296/bms.v14i2.21078>.
- Giannakis, M., & Papadopoulos, T. (2016). Supply chain sustainability: A risk management approach. *International journal of production economics*, 171, 455-470. <https://doi.org/10.1016/j.ijpe.2015.06.032>.
- Gimenez, C., Sierra, V., & Rodon, J. (2012). Sustainable operations: Their impact on the triple bottom line. *International journal of production economics*, 140(1), 149-159. <https://doi.org/10.1016/j.ijpe.2012.01.035>.
- Ginsberg, J. M., & Bloom, P. N. (2004). Choosing the right green marketing strategy. *MIT Sloan management review*, 46(1), 79-84.

Giving Balkans (2021). Giving Serbia Report on the state of philanthropy. Marrë nga <https://givingbalkans.org/content/giving-serbia-2021>.

Global Green Technology and Sustainability Market (2024). Marrë nga <https://www.fortunebusinessinsights.com/press-release/global-green-technology-and-sustainability-market-10666>.

Gouda, S. K., & Saranga, H. (2018). Sustainable supply chains for supply chain sustainability: impact of sustainability efforts on supply chain risk. *International Journal of Production Research*, 56(17), 5820-5835. <https://doi.org/10.1080/00207543.2018.1456695>.

Grishina, V., Amelicheva, D., & Tikhanov, N. (2021). Corporate social responsibility and social investment in the urban environment. In *SHS Web of Conferences* (Vol. 128, p. 01021). EDP Sciences. <https://doi.org/10.1051/shsconf/202112801021>.

Gjerazi, E., & Skana, E. (2023). *Philanthropy as a Strategic Tool for Corporate Reputation Management: The Albanian Case*, *Academic Journal of Interdisciplinary Studies* 12 (5):156, DOI: 10.36941/ajis-2023-0134

Habili, M. (2021). Understanding Level of CSR and Marketing in Albania in 2020. *International Journal of Marketing & Human Resource Research*, 2(1): 35-42.

Hickey, P. J., & Cui, Q. (2024). Tracing the career trajectories of architecture, engineering and construction (AEC) women leaders. *Construction Management and Economics*, 42(4), 289-306. <https://doi.org/10.1080/01446193.2023.2260907>.

Hoskisson, R. E., Covin, J., Volberda, H. W., & Johnson, R. A. (2011). Revitalizing entrepreneurship: The search for new research opportunities. *Journal of Management Studies*, 48(6), 1141-1168. <https://doi.org/10.1111/j.1467-6486.2010.00997.x>

Hristov, I., & Chirico, A. (2019). The Role of Sustainability Key Performance Indicators (KPIs) in Implementing Sustainable Strategies. *Sustainability*, 11(20), 5742. <https://doi.org/10.3390/su11205742>

Hristov, I., & Chirico, A. (2019). The role of sustainability key performance indicators (KPIs) in implementing sustainable strategies. *Sustainability*, 11(20), 5742. <https://doi.org/10.3390/su11205742>.

<https://doi.org/10.1016/j.econmod.2025.107159>,

<https://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S0264999325001543>

<https://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S000768139190005G>

Hubbard, G. (2009). Measuring organizational performance: beyond the triple bottom line. *Business strategy and the environment*, 18(3), 177-191. <https://doi.org/10.1002/bse.564>.

Islam, M. A., Deegan, C., & Gray, R. (2018). Social compliance audits and multinational corporation supply chain: evidence from a study of the rituals of social audits. *Accounting*

and Business Research, 48(2), 190-224. <https://doi.org/10.1080/00014788.2017.1362330>.

Jackson, E. A., & Jackson, H. F. (2017). The role of corporate social responsibility in improving firms' business in the directions of sustainable development, accountability and transparency. *African Journal of Economic and Sustainable Development*, 6(2-3), 105-118. <https://doi.org/10.1504/AJESD.2017.089942>.

Jacobson, M. Z., & Delucchi, M. A. (2011). Providing all global energy with wind, water, and solar power, Part I: Technologies, energy resources, quantities and areas of infrastructure, and materials. *Energy policy*, 39(3), 1154-1169. <https://doi.org/10.1016/j.enpol.2010.11.040>.

Jensen, M. C. (2001). *Value maximization, stakeholder theory, and the corporate objective function*. European Financial Management, Vol. 7, No. 3, 2001, 297-317, https://www.efmaefm.org/bharat/jensen_efm2001.pdf

Jupe, A., & Bejko, E. (2020). CORPORATE SOCIAL RESPONSIBILITY AND EVIDENCE IN ANNUAL FINANCIAL REPORTING IN ALBANIA. *Muhasebe Bilim Dünyası Dergisi*, 22(1), 65-74. <https://doi.org/10.31460/mbdd.478013>

Kalaitzi, D., Matopoulos, A., Bourlakis, M., & Tate, W. (2019). Supply chains under resource pressure: Strategies for improving resource efficiency and competitive advantage. *International Journal of Operations & Production Management*, 39(12), 1323-1354. <https://doi.org/10.1108/IJOPM-02-2019-0137>.

Kim, J., & Lee, H. (2023). How Does Corporate Innovation Affect Sustainable Business Investment?. *Sustainability*, 15(18), 13367. <https://doi.org/10.3390/su151813367>.

Knuckey, S., & Jenkin, E. (2018). Company-created remedy mechanisms for serious human rights abuses: a promising new frontier for the right to remedy?. In *Corporate Power and Human Rights* (pp. 149-175). Routledge. <https://dx.doi.org/10.1080/13642987.2015.1048645>.

Kocmanová, A & Dočekalová, M. (2011). Corporate sustainability; environmental, social, economic and corporate performance, *Acta Universitatis Agriculturae et Silviculturae Mendelianae Brunensis*, Mendel University Press, vol. 59(7), pages 203-208, https://ideas.repec.org/a/mup/actaun/actaun_2011059070203.html

Kocmanová, A., & Dočekalová, M. (2011). Corporate sustainability: environmental, social, economic and corporate performance. *Acta Universitatis Agriculturae et Silviculturae Mendelianae Brunensis*, 59(7), 203-208.

Koh, S. C. L., Morris, J., Ebrahimi, S. M., & Obayi, R. (2016). Integrated resource efficiency: measurement and management. *International Journal of Operations & Production Management*, 36(11), 1576-1600. <https://doi.org/10.1108/IJOPM-05-2015-0266>.

KPMG (2024). Sustainability reporting survey: Global and Australian insights Insights and key trends in sustainability reporting from ASX100 and Global N100 companies. Marrë nga <https://kpmg.com/au/en/home/insights/2024/11/sustainability-reporting-survey-2024.html>.

Kumar, V., & Christodouloupoulou, A. (2014). Sustainability and branding: An integrated perspective. *Industrial Marketing Management*, 43(1), 6-15. <https://doi.org/10.1016/j.indmarman.2013.06.008>.

Kuybida, V., Savitska, S., Shkoda, M., Akhromkin, I., Pron, L., & Kolomiiets, Y. (2023). Methodology of development of social investment projects for the economy: legal aspects. *Journal of Law and Sustainable Development*, 11(4), e902-e902. <https://doi.org/10.55908/sdgs.v11i4.902>.

Larsson, S., & Heintz, F. (2020). Transparency in artificial intelligence. *Internet policy review*, 9(2), 1-16. <https://doi.org/10.14763/2020.2.1469>.

Le Guenedal, T., Lombard, F., Roncalli, T., & Sekine, T. (2022). Net zero carbon metrics. <http://dx.doi.org/10.2139/ssrn.4033686>.

Le, T. T., Tran, P. Q., Lam, N. P., Tra, M. N. L., & Uyen, P. H. P. (2024). Corporate social responsibility, green innovation, environment strategy and corporate sustainable development. *Operations Management Research*, 17(1), 114-134. <https://doi.org/10.1007/s12063-023-00411-x>.

Leena, S., Balaji, K. R. A., & Bhat, P. K. (2023). Corporate social responsibility and sustainable development goals: evidence from responsible business leaders. *Journal of Global Responsibility*, 15(4), 409-435. <https://doi.org/10.1108/JGR-06-2023-0109>.

Levkov, N., & Palamidovska-Sterjadovska, N. (2019). Corporate social responsibility communication in Western Balkans banking industry: a comparative study. *Management Research and Practice*, 11(3), 18-30.

Li, G., Li, N., & Sethi, S. P. (2021). Does CSR reduce idiosyncratic risk? Roles of operational efficiency and AI innovation. *Production and Operations Management*, 30(7), 2027-2045. <https://doi.org/10.1111/poms.13483>.

Liaquat, M., Ahmed, G., Ismail, H., Ain, Q. U., Irshad, S., Izhar, S. S., & Mughal, M. T. (2024). Impact of motivational factors and green behaviors on employee environmental performance. *Research in Globalization*, 8, 100180. <https://doi.org/10.1016/j.resglo.2023.100180>.

Qendra e Publikimeve Zyrtare (QPZ). Ligj nr. 25/2018. Kontabiliteti dhe Pasqyrat Financiare, miratuar më 10 Maj 2018. Marrë nga chrome extension://efaidnbmninnibpcajpcglclefindmkaj/https://www.kkk.gov.al/foto/uploads/File/ligj-nr.-25-dt.-10.5.2018.pdf.

- Likoko, E., & Kini, J. (2017). Inclusive business—a business approach to development. *Current opinion in environmental sustainability*, 24, 84-88. <https://doi.org/10.1016/j.cosust.2017.03.001>.
- Lodhia, S. K. (2004). Corporate environmental reporting media: A case for the world wide web. *Electronic Green Journal*, 1(20).
- Loia, F., & Adinolfi, P. (2021). Teleworking as an eco-innovation for sustainable development: Assessing collective perceptions during COVID-19. *Sustainability*, 13(9), 4823. <https://doi.org/10.3390/su13094823>.
- Long, J. S., & Freese, J. (2014). *Regression Models for Categorical Dependent Variables Using Stata*. Stata Press.
- López, M. V., Garcia, A., & Rodriguez, L. (2007). Sustainable development and corporate performance: A study based on the Dow Jones sustainability index. *Journal of business ethics*, 75, 285-300. <https://doi.org/10.1007/s10551-006-9253-8>.
- Lord, R. G., & Brown, D. J. (2001). Leadership, values, and subordinate self-concepts. *The Leadership Quarterly*, 12(2), 133-152. [https://doi.org/10.1016/S1048-9843\(01\)00072-8](https://doi.org/10.1016/S1048-9843(01)00072-8).
- Lunov, V., Lepskiy, M. (2021) (Editors). International Interdisciplinary Conference “Real Life and the Real Economics”. Accent Graphics Communications & Publishing, pg. 10, ISBN: 978-1-77192-604-1.
- Maak, T. (2007). Responsible leadership, stakeholder engagement, and the emergence of social capital. *Journal of business ethics*, 74, 329-343. <https://doi.org/10.1007/s10551-007-9510-5>
- Maak, T., & Pless, N. M. (2006). Responsible leadership in a stakeholder society—a relational perspective. *Journal of business ethics*, 66, 99-115. <https://doi.org/10.1007/s10551-006-9047-z>.
- MacAskill, S., Roca, E., Liu, B., Stewart, R. A., & Sahin, O. (2021). Is there a green premium in the green bond market? Systematic literature review revealing premium determinants. *Journal of cleaner production*, 280, 124491. <https://doi.org/10.1016/j.jclepro.2020.124491>.
- Maher, J. M., Markey, J. C., & Ebert-May, D. (2013). The other half of the story: effect size analysis in quantitative research. *CBE—Life Sciences Education*, 12(3), 345-351.
- Massarani, T. F., Drakos, M. T., & Pajkowska, J. (2007). Extracting corporate responsibility: towards a human rights impact assessment. *Cornell Int'l LJ*, 40, 135.
- Matten, D., & Moon, J. (2008). “Implicit” and “explicit” CSR: A conceptual framework for a comparative understanding of corporate social responsibility. *Academy of Management Review*, 33(2), 404–424, DOI: 10.5465/AMR.2008.31193458

- McWilliams, A., & Siegel, D. S. (2011). Creating and capturing value: Strategic corporate social responsibility, resource-based theory, and sustainable competitive advantage. *Journal of management*, 37(5), 1480-1495. <https://doi.org/10.1177/0149206310385696>.
- Melovic, B., Milovic, N., Backovic-Vulic, T., Dudic, B., & Bajzik, P. (2019). Attitudes and perceptions of employees toward corporate social responsibility in western Balkan countries: Importance and relevance for sustainable development. *Sustainability*, 11(23), 6763. <https://doi.org/10.3390/su11236763>.
- Michelon, G., Boesso, G., & Kumar, K. (2013). Examining the link between strategic corporate social responsibility and company performance: An analysis of the best corporate citizens. *Corporate social responsibility and environmental management*, 20(2), 81-94. <https://doi.org/10.1002/csr.1278>.
- Microsoft (2025). Microsoft. Marrë nga <https://www.office.com/>.
- Mitroulis, D., & Kitsios, F. (2016, July). Fostering a competitive differentiation strategy for sustainable organizational performance. In *Operational Research in Business and Economics: 4th International Symposium and 26th National Conference on Operational Research, Chania, Greece, June 2015* (pp. 85-112). Cham: Springer International Publishing. https://doi.org/10.1007/978-3-319-33003-7_5.
- Montiel, I., Cuervo-Cazurra, A., Park, J., Antolín-López, R., & Husted, B. W. (2021). Implementing the United Nations' sustainable development goals in international business. *Journal of International Business Studies*, 52(5), 999. <https://doi.org/10.1057/s41267-021-00445-y>.
- Morali, O., & Searcy, C. (2013). A review of sustainable supply chain management practices in Canada. *Journal of business ethics*, 117, 635-658. <https://doi.org/10.1007/s10551-012-1539-4>.
- Muñoz, A. (2019). Anonymized Competency-Based Recruitment and Selection Process for Public Sector: A New Approach for Workplace Diversity and Equality. *Philippine Civil Service Commission*.
- Muthuri, J. N., Chapple, W., & Moon, J. (2009). An Integrated Approach to Implementing 'Community Participation' in Corporate Community Involvement: Lessons from Magadi Soda Company in Kenya. *Journal of business ethics*, 85, 431-444. <https://doi.org/10.1007/s10551-008-9739-7>.
- Nguyen, M. V. (2025). Assessment of corporate social responsibility performance for Vietnamese construction organizations. *Journal of Engineering, Design and Technology*, 23(2), 477-500. <https://doi.org/10.1108/JEDT-08-2022-0417>.
- Obioha, E. O. (2024). Impact of corporate sustainability performance on financial performance of south african industries via brand value and competitiveness. *International Journal of Environmental, Sustainability, and Social Science*, 5(2), 356-385. <https://doi.org/10.38142/ijesss.v5i2.1011>.

- Onea, I. A. (2020). Innovation indicators and the innovation process-evidence from the European innovation scoreboard. *Management & Marketing*, 15(4), 605-620. <https://doi.org/10.2478/mmcks-2020-0035>.
- Pallant, J. (2020). SPSS Survival Manual: A Step by Step Guide to Data Analysis Using IBM SPSS (7th ed.). Open University Press.
- Park, T. Y., & Shaw, J. D. (2013). Turnover rates and organizational performance: a meta-analysis. *Journal of applied psychology*, 98(2), 268. <https://doi.org/10.1037/a0030723>.
- Paroutis, S., Bennett, M., & Heracleous, L. (2014). A strategic view on smart city technology: The case of IBM Smarter Cities during a recession. *Technological Forecasting and Social Change*, 89, 262-272. <https://doi.org/10.1016/j.techfore.2013.08.041>.
- Patagonia (2025). Patagonia. Marrë nga <https://www.patagonia.com/home/>.
- Pimonenko, T., Bilan, Y., Horák, J., Starchenko, L., & Gajda, W. (2020). Green brand of companies and greenwashing under sustainable development goals. *Sustainability*, 12(4), 1679. <https://doi.org/10.3390/su12041679>.
- Pojani, E. (2025). *Exploring sustainability practices in the Albanian business environment*, Proceedings of the 35th European Safety and Reliability & the 33rd Society for Risk Analysis Europe Conference Edited by Eirik Bjorheim Abrahamsen, Terje Aven, Frederic Boudier, Roger Flage, Marja Ylönen ©2025 ESREL SRA-E 2025 Organizers. Published by Research Publishing, Singapore. doi: 10.3850/978-981-94-3281-3_ESREL-SRA-E2025-P0905-cd, <https://rpsonline.com.sg/proceedings/esrel-sra-e2025/pdf/ESREL-SRA-E2025-P0905.pdf>
- Porter, M. E., & Kramer, M. R. (2006). *Strategy & society: The link between competitive advantage and corporate social responsibility*. Harvard Business Review, 84(12), 78–92, <https://hazrevista.org/wp-content/uploads/strategy-society.pdf>
- Proceedings of the Institution of Civil Engineers-Energy*, 175(3), 97-102. <https://doi.org/10.1680/jener.22.00011>.
- Procurement Tactics (2025). Corporate Social Responsibility Statistics. Marrë nga <https://procurementtactics.com/corporate-social-responsibility-statistics/>,
- Protocol, K. (1997). United Nations framework convention on climate change. *Kyoto Protocol*, Kyoto, 19(8), 1-21.
- Purwanti, I., Abadi, M. D., Suyanto, U. Y., & Ahmad, S. T. I. E. K. (2019). Green marketing: strategy for gaining sustainable competitive advantage in industry 4.0. *Manajemen Bisnis*, 9(2), 176-193.
- Rahman, M. H., Tanchangya, T., Rahman, J., Aktar, M. A., & Majumder, S. C. (2024). Corporate social responsibility and green financing behavior in Bangladesh: Towards sustainable tourism. *Innovation and Green Development*, 3(3), 100133. <https://doi.org/10.1016/j.igd.2024.100133>.

Retrieved from <https://eujournal.org/index.php/esj/article/view/6429>;

Roca, L. C., & Searcy, C. (2012). An analysis of indicators disclosed in corporate sustainability reports. *Journal of cleaner production*, 20(1), 103-118. <https://doi.org/10.1016/j.jclepro.2011.08.002>.

Rossi, S., Colicchia, C., Cozzolino, A., & Christopher, M. (2013). The logistics service providers in eco-efficiency innovation: an empirical study. *Supply chain management: an international journal*, 18(6), 583-603. <https://doi.org/10.1108/SCM-02-2012-0053>.

Rudyanto, A., & Veronica Siregar, S. (2018). The effect of stakeholder pressure and corporate governance on the sustainability report quality. *International Journal of Ethics and Systems*, 34(2), 233-249. <https://doi.org/10.1108/IJOES-05-2017-0071>.

Sachs, J. D. (2015). *The age of sustainable development*. New York: Columbia University Press, <https://doi.org/10.7312/sach17314>

Sanches, J. R., Trevisan, A. H., Seles, B. M. R. P., Castro, C. G., Piao, R. S., Rozenfeld, H., & Mascarenhas, J. (2022). Sustainable circular economy strategies: an analysis of Brazilian corporate sustainability reporting. *Sustainability*, 14(10), 5808. <https://doi.org/10.3390/su14105808>.

Schaltegger, S., & Wagner, M. (2011). Sustainable entrepreneurship and sustainability innovation: categories and interactions. *Business strategy and the environment*, 20(4), 222-237. <https://doi.org/10.1002/bse.682>.

Schaltegger, S., Etxeberria, I. Á., & Ortas, E. (2017). Innovating corporate accounting and reporting for sustainability—attributes and challenges. *Sustainable Development*, 25(2), 113-122. <https://doi.org/10.1002/sd.1666>.

Schaltegger, S., Hörisch, J., & Freeman, R. E. (2019). Business cases for sustainability: A stakeholder theory perspective. *Organization & Environment*, 32(3), 191-212. <https://doi.org/10.1177/1086026617722882>.

Schaltegger, S., Lüdeke-Freund, F., & Hansen, E. G. (2016). Business models for sustainability: A co-evolutionary analysis of sustainable entrepreneurship, innovation, and transformation. *Organization & environment*, 29(3), 264-289. <https://doi.org/10.1177/1086026616633272>.

Searcy, C. (2012). Corporate sustainability performance measurement systems: A review and research agenda. *Journal of business ethics*, 107, 239-253. <https://doi.org/10.1007/s10551-011-1038-z>.

Senatore, G. (2020). Smart city: cosa rimane della sostenibilità, *Rivista Trimestrale di Scienza dell'Amministrazione. Studi di teoria e ricerca sociale*, 4/2020. DOI: 10.32049/RTSA.2020.4.02, https://rtsa.eu/RTSA_4_2020_Senatore.pdf

Sepetis, A. (2024). The Implementation Of Social Protection Policies At Local Level According To Inclusive And Sustainable Development. *RSI J*, 111.

- Settembre-Blundo, D., González-Sánchez, R., Medina-Salgado, S., & García-Muiña, F. E. (2021). Flexibility and resilience in corporate decision making: a new sustainability-based risk management system in uncertain times. *Global Journal of Flexible Systems Management*, 22(Suppl 2), 107-132. <https://doi.org/10.1007/s40171-021-00277-7>.
- Si, S., Ahlstrom, D., Wei, J., & Cullen, J. (2021). Introduction: Business, entrepreneurship and innovation toward poverty reduction. In *Business, entrepreneurship and innovation toward poverty reduction* (pp. 1-20). Routledge.
- Sinanaj (Abazi), Xh. and Krypa (Tapija), N. (2023) Sustainable Development Goals in Albania: Targets and Progress, vo. 21.2023, available at <https://refpress.org/ref-vol21-a307/>
- Singha, S. (2024). Cultivating Inclusive Leadership: Navigating Organizational Culture in the Digital Era. In *Effective Technology for Gender Equity in Business and Organizations* (pp. 139-166). IGI Global. <https://doi.org/10.4018/979-8-3693-3435-5.ch005>.
- Sprengel, D. C., & Busch, T. (2011). Stakeholder engagement and environmental strategy—the case of climate change. *Business Strategy and the Environment*, 20(6), 351-364. <https://doi.org/10.1002/bse.684>.
- Srinivasan, P., & Bolar, P. (2020). Sustainability Risk Management: An Exploratory Study. *IIM Bangalore Research Paper*, (608).
- Statista. Smart cities (2025): Marrë nga: <https://www.statista.com/outlook/tmo/internet-of-things/smart-cities/worldwide>.
- Székelly, F., & Knirsch, M. (2005). Responsible leadership and corporate social responsibility:: Metrics for sustainable performance. *European Management Journal*, 23(6), 628-647. <https://doi.org/10.1016/j.emj.2005.10.009>.
- Shad, M. K., Lai, F. W., Fatt, C. L., Klemeš, J. J., & Bokhari, A. (2019). Integrating sustainability reporting into enterprise risk management and its relationship with business performance: A conceptual framework. *Journal of Cleaner production*, 208, 415-425. <https://doi.org/10.1016/j.jclepro.2018.10.120>.
- Sharma, P., & Chrisman, J. J. (1999). Toward a reconciliation of the definitional issues in the field of corporate entrepreneurship. *Entrepreneurship theory and practice*, 23(3), 11-28. <https://doi.org/10.1177/104225879902300302>.
- Sheth, J. N., Sethia, N. K., & Srinivas, S. (2011). Mindful consumption: A customer-centric approach to sustainability. *Journal of the academy of marketing science*, 39, 21-39. <https://doi.org/10.1007/s11747-010-0216-3>.
- Shrivastava, P. (2018). Environmental technologies and competitive advantage. In *Business Ethics and Strategy, Volumes I and II* (pp. 317-334). Routledge.
- Tahiraj, R., Zhidro, A., Himçi, B., Naqellari, D., Hajdari S. (2026). The Legal Alignment of Albania with the EU Acquis: Sustainable Raw Materials, Green Market Development,

and the Circular Economy, page 157-170, International Journal of Ecosystems and Ecology Sciences (IJEES), Vol. 16 (1): 157:170 (2026), DOI: 10.31407/ijeed16.119

Tahiraj, R., Zhidro, A., Himçi, B., Naqellari, D., Hajdari S. (2025). Lehtësimi i Shkëmbimit të Qëndrueshëm të Materialeve të Para nëpërmjet Lidhjes me Tregun e Gjelbër në Qarkun e Elbasanit, Raport Shkencor, Projekt i Teknologjisë dhe Inovacionit, ISBN 9789928810991, Shpresa Print, Elbasan, 2025.

Tanaka, H. (2024). Sustainable investments by multi stakeholders to improve sustainable scheme for medical and health services. *Sciences*, 2, 01-04.

Todri, A., & Papajorgji, P. (2024). Artificial Intelligence Waves In Financial Services Industry: An Evolution Factorial Analysis. *RSI J*, 63.

Todri, A., Sejdini, I., & Balukja, I. (2025). Corporate Social Responsibility and Sustainable Development in Albania: An Employee-Centric Analysis, *IJDS* 2025, 2, 9-13.

Tsang, A., Frost, T., & Cao, H. (2023). Environmental, social, and governance (ESG) disclosure: A literature review. *The British Accounting Review*, 55(1), 101149. <https://doi.org/10.1016/j.bar.2022.101149>.

Tseng, M. L., Lin, C. W. R., Sujanto, R. Y., Lim, M. K., & Bui, T. D. (2021). Assessing sustainable consumption in packaged food in Indonesia: Corporate communication drives consumer perception and behavior. *Sustainability*, 13(14), 8021. <https://doi.org/10.3390/su13148021>.

Unilever (2025). Unilever. Marrë nga <https://www.unilever.com/sustainability/>.

United Nation Development Program. (2008). The baseline study on CSR practices in the Western Balkans. Marrë nga www.undp.org > docs.

United Nations Framework Convention on Climate Change: Marrë nga: <https://unfccc.int/>.

United Nations. Sustainable Development Goals (2018), Marrë nga: <https://www.un.org/sustainabledevelopment/sustainable-development-goals>.

Urol Berdiev, What shapes greenium in bond markets? Evidence from Japan, *Economic Modelling*, Volume 151, 2025, 107159, ISSN 0264-9993,

Uyar, A., Gerged, A. M., Kuzey, C., & Karaman, A. S. (2024). Do CSR performance and reporting facilitate access to debt financing in emerging markets? The role of asset structure and firm performance. *Review of accounting and finance*, 23(2), 157-185. <https://doi.org/10.1108/RAF-01-2023-0020>.

Van Den Buuse, D., & Kolk, A. (2019). An exploration of smart city approaches by international ICT firms. *Technological Forecasting and Social Change*, 142, 220-234. <https://doi.org/10.1016/j.techfore.2018.07.029>.

- Vargas, C. M., & Cooper, P. J. (2024). *Implementing sustainable development: From global policy to local action*. Rowman & Littlefield.
- Velasco-Balmaseda, E., de Celis, I. L. R., & Izaguirre, N. E. (2024). Corporate social responsibility as a framework for gender equality: mapping of gender equality standards for sustainable development. *Corporate social responsibility and environmental management*, 31(3), 1905-1920. <https://doi.org/10.1002/csr.2673>.
- Veleva, V., & Ellenbecker, M. (2001). Indicators of sustainable production: framework and methodology. *Journal of cleaner production*, 9(6), 519-549. [https://doi.org/10.1016/S0959-6526\(01\)00010-5](https://doi.org/10.1016/S0959-6526(01)00010-5).
- Waddock, S. A., & Graves, S. B. (1997). The corporate social performance–financial performance link. *Strategic management journal*, 18(4), 303-319. [https://doi.org/10.1002/\(SICI\)1097-0266\(199704\)18:4<303::AID-SMJ869>3.0.CO;2-G](https://doi.org/10.1002/(SICI)1097-0266(199704)18:4<303::AID-SMJ869>3.0.CO;2-G).
- Wadhwa, J., Colaco, P., Reddy, P. S., & Jain, M. (2023). Comprehensive literature review on stakeholder prospects, responsibilities, and quality performance measurement in sustainable supply chain governance. *Multidisciplinary Reviews*, 6. <https://doi.org/10.31893/multirev.2023ss083>.
- Wang, Y., Yao, G., Zuo, Y., & Wu, Q. (2023). Implications of global carbon governance for corporate carbon emissions reduction. *Frontiers in Environmental Science*, 11, 1071658. <https://doi.org/10.3389/fenvs.2023.1071658>.
- Warshawsky, D. N. (2016). Food waste, sustainability, and the corporate sector: Case study of a US food company. *The Geographical Journal*, 182(4), 384-394. <https://doi.org/10.1111/geoj.12156>.
- Weiland, S., Hickmann, T., Lederer, M., Marquardt, J., & Schwindenhammer, S. (2021). The 2030 agenda for sustainable development: transformative change through the sustainable development goals?. *Politics and Governance*, 9(1), 90-95. <https://doi.org/10.17645/pag.v9i1.4191>.
- Welford, R., Chan, C., & Man, M. (2008). Priorities for corporate social responsibility: a survey of businesses and their stakeholders. *Corporate Social Responsibility and Environmental Management*, 15(1), 52-62. <https://doi.org/10.1002/csr.166>.
- Williams, R. (2006). Generalized ordered logit/partial proportional odds models for ordinal dependent variables. *The Stata Journal*, 6(1), 58–82.
- Williams, R. A., & Quiroz, C. (2020). *Ordinal regression models*. Thousand Oaks: SAGE Publications Limited.
- Woodcock, J., Banister, D., Edwards, P., Prentice, A. M., & Roberts, I. (2007). Energy and transport. *The Lancet*, 370(9592), 1078-1088.
- World Economic Forum. (2020). *The global risks report 2020*. Geneva: WEF, <https://www.weforum.org/publications/the-global-risks-report-2020/>

- Wright, Ch. & Nyberg, D. (2024). *Corporations and climate change: An overview*, Wiley Interdisciplinary Reviews: Climate Change, Volume 15, Issue 6, <https://wires.onlinelibrary.wiley.com/doi/10.1002/wcc.919>
- Xu, M., Cui, Y., Hu, M., Xu, X., Zhang, Z., Liang, S., & Qu, S. (2019). Supply chain sustainability risk and assessment. *Journal of Cleaner Production*, 225, 857-867. <https://doi.org/10.1016/j.jclepro.2019.03.307>.
- Yeh, H. (2017). The effects of successful ICT-based smart city services: From citizens' perspectives. *Government Information Quarterly*, 34(3), 556-565. <https://doi.org/10.1016/j.giq.2017.05.001>.
- Yelnikova, Y. V., & Barhaq, A. R. (2020). Transparency of responsible investment environment. *Business Ethics and Leadership*, 4(4), 68-75. [https://doi.org/10.21272/bel.4\(4\).68-75.2020](https://doi.org/10.21272/bel.4(4).68-75.2020).
- Yusif, Y. A. (2020). The effectiveness of involving social investments in education. *New Trends and Issues Proceedings on Humanities and Social Sciences*, 7(3), 71-79.
- Zahra, S. A., Sapienza, H. J., & Davidsson, P. (2006). Entrepreneurship and dynamic capabilities: A review, model and research agenda. *Journal of Management studies*, 43(4), 917-955. <https://doi.org/10.1111/j.1467-6486.2006.00616.x>.
- Zeidan, R., Boechat, C., & Fleury, A. (2015). Developing a sustainability credit score system. *Journal of Business Ethics*, 127, 283-296. <https://doi.org/10.1007/s10551-013-2034-2>.
- Zhang, D. (2021). How environmental performance affects firms' access to credit: Evidence from EU countries. *Journal of Cleaner Production*, 315, 128294. <https://doi.org/10.1016/j.jclepro.2021.128294>.
- Zheng, J., & Tu, Y. (2024). Party organization embeddedness and corporate green innovation. *Finance Research Letters*, 67, 105816. <https://doi.org/10.1016/j.frl.2024.105816>.
- Zhyvko, M. (2024). Corporate social responsibility in the context of the green economy. *Ekonomichnyy analiz*, 34(1), 292-304.

ANEKS A

Anketim për perceptimin publik mbi angazhimin e sipërmarrjeve që operojnë në Shqipëri lidhur me përgjegjësinë sociale dhe zhvillimin e qëndrueshëm

Kjo anketë synon të eksplorojë pikëpamjet dhe qëndrimet e publikut ndaj sipërmarrjeve që operojnë në Shqipëri, me fokus të veçantë në angazhimin e tyre lidhur me përgjegjësinë sociale dhe praktikën e zhvillimit të qëndrueshëm.

Rezultatet e kësaj ankete synojnë të ofrojnë rekomandime për të adresuar boshllëqet ekzistuese në literaturë e terren e mandej ti hapin rrugë kërkimeve të tjera në fushë.

Pjesëmarrja në studim është vullnetare (jeni të lirë të tërhiqeni në çdo kohë).

Përgjigjet tuaja do të mbeten konfidenciale dhe identiteti juaj nuk do të zbulohet në asnjë raport apo publikim.

Anketa përdor shkallën Likert të vlerësimit nga 1 (një) në 5 (pesë), që do të thotë: 1= Nuk jam aspak dakord; 2=Nuk jam dakord; 3 = I pavendosur; 4=Dakord dhe 5=Plotësisht dakord.

SEKSIONI I-rë

Cila është marrëdhënia juaj me sipërmarrjen?

(Drejtues/ punonjës/ klient/ furnitor/ partner :ekspertë të politikave ekonomike, akademikë, ekspertë kontabël, sipërmarrës, vlerësues ndërkombëtar projektuesh, menaxher organizatash jo qeveritare, etj).

Sipërmarrja që jeni duke vlerësuar lidhur me përgjegjësinë sociale dhe praktikën e zhvillimit të qëndrueshëm është publike apo private?

(Publike/ private)

Cila është vendndodhja e sipërmarrjes?

(Qyteti)

Cila është origjina e sipërmarrjes?

(Shteti)

Mosha juaj?

(18-25); (26-34); (35-44); (45-54); (55-64); +65

Cili është titulli juaj i studimit/ akademik?

(Bachelor, Master Profesional, Master i Shkencave, Doktor Shkencash, Profesor i Asociuar, Profesor Doktor)

A jeni në dijeni të zbatimit të ndonjë plani strategjik sipërmarrës lidhur me zhvillimin e qëndrueshëm dhe angazhimin social?

(Po; Jo)

SEKSIONI II-të

A. Reduktimi i Emetimeve Karbonike dhe Menaxhimi i Zinxhirit të Furnizimit

Sipërmarrja ka implementuar strategjinë me "objektiv neto zero" me qëllim reduktimin e emetimeve karbonike sikurse nxit sjelljen e qëndrueshme brenda saj (si përdorimi i transportit publik ose puna nga shtëpia)?

Sipërmarrja përdor burimet e rinovueshme të energjisë (diellore, eolike dhe hidroelektrike) në proceset e saj të brendshme në mënyrë që të kontribuojë në mbrojtjen e mjedisit?

Sipërmarrja diskuton vazhdimisht me punonjësit dhe drejtuesit mbi nevojën e ndërmarrjes së iniciativave që reduktojnë emetimin karbonik dhe përmirësojnë efikasitetin energjik në proceset e prodhimit dhe në logjistikë?

Sipërmarrja operon në sinergji me furnitorët e klientët lidhur me mundësitë e reduktimit të emetimeve karbonike përgjatë zinxhirit të furnizimit?

Sipërmarrja promovon praktikën kërkimore mbi zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve të qëndrueshme si dhe përdor inteligjencën artificiale (AI) dhe pajisje specifike (IoT) për të monitoruar dhe optimizuar emetimet në kohë reale?

Sipërmarrja angazhon palët e interesuara (p.sh. punonjësit, komunitetin, investitorët, partnerët, organizatat jo-qeveritare, konsumatorët, etj.) në përpjekje për të rritur qëndrueshmërinë e zinxhirit të saj të furnizimit?

Sipërmarrja zbaton parimet e ekonomisë qarkulluese, të tilla si riciklimi ose rikuperimi i burimeve në proceset e saj të brendshme si dhe në zinxhirin e furnizimit?

Sipërmarrja trajton me përgjegjësi rastet e mospërputhjes me standardet sociale ose mjedisore në proceset e saj të brendshme si dhe në zinxhirin e furnizimit?

B. Gjithëpërfshirja dhe Angazhimi në Komunitet

Menaxhimi i diversitetit social përputhet me misionin dhe vlerat e sipërmarrjes?

Sipërmarrja siguron përfaqësim të larmishëm në rekrutimin e personelit të saj?

Sipërmarrja nxit një kulturë gjithëpërfshirëse në vendin e punës në mënyrë që punonjësit të ndihen të vlerësuar dhe të respektuar pavarësisht prejardhjes së tyre?

Sipërmarrja bashkëpunon me organizata të ndryshme, shkolla profesionale dhe universitete për të nxitur përfshirjen dhe përmirësimin e diversitetit në komunitet, duke mbështetur grupe të ndryshme dhe organizata promovuese që punojnë për barazi dhe përfaqësim të drejtë?

Sipërmarrja ka prioritet adresimin e çështjeve sociale dhe mjedisore në komunitetin ku operon?

Sipërmarrja bashkëpunon me palët e interesuara në kontekstin lokal si dhe me drejtuesit e komunitetit për zhvillimin e planeve që synojnë të mbështesin grupet e nënperfaqësuara ose të marginalizuara?

Sipërmarrja aspirojnë të vlerësojë kënaqësinë dhe angazhimin e punonjësve në programet komunitare?

Sipërmarrja planifikon të përdorë inovacionin si dhe të shtojë angazhimin me komunitetin në vitet e ardhshme për të përcjellë më mirë zërin dhe nevojat e komunitetit?

C. Investimet Sociale dhe Palët e Interesuara

Investimet që lidhen me aktivitetet sociale janë pjesë integrale e strategjisë së përgjithshme të biznesit sipërmarrës?

Investimet e sipërmarrjes në kontekstin social synojnë të trajtojnë kryesisht çështjet e arsimit, shëndetësisë, mjedisore, inovacionit dhe ato të zbutjes së varfërisë?

Sipërmarrja ka ndërmarrë iniciativë për të eksploruar fusha në zhvillim si obligacionet e gjelbra dhe mikrofinancat?

Sipërmarrja angazhon palët e interesuara (p.sh. punonjësit, komunitetin, investitorët, partnerët, organizatat jo-qeveritare, konsumatorët, etj.) në iniciativat e saj lidhur me aktivitetet sociale?

Sipërmarrja ka përcaktuar rolet e palëve të lidhura (klientë, furnizues dhe konsumatorë) në drejtimin e praktikave sociale dhe të qëndrueshme të biznesit?

Punonjësit e sipërmarrjes dhe komuniteti ku ajo bën pjesë kanë mundësi të japin kontribut në zhvillimin e strategjisë të saj sociale dhe të qëndrueshme?

Sipërmarrja ka vendosur kërkesa specifike sa i takon furnitorëve në lidhje me praktikën e punës, qëndrueshmërinë mjedisore e sjelljen etike?

Komunitetet lokale luajnë një rol aktiv në krijimin e programeve të përgjegjësisë sociale të sipërmarrjes?

D. Transparenca, Raportimi dhe Pajtuëshmëria me të Drejtat e Njeriut

Sipërmarrja e bën publik informacionin në lidhje me investimet, mjedisin dhe përgjegjësinë e saj sociale (sipërmarrja trajton informacione të ndjeshme ose negative në raportimin lidhur me përgjegjësinë e saj sociale, identifikon përparimin e bërë për qëllimet sociale dhe mjedisore, diskuton historitë e suksesit si dhe krahason praktikën e transparencës kundrejt standardeve globale ose specifike të industrisë)?

Sipërmarrja siguron që raportet e saj të transparencës të jenë të aksesueshme dhe të kuptueshme për të gjithë palët e interesuara (aksionerët, punonjësit, komunitetin, qeverisjen vendore e qendrore, etj.)?

Kanale të ndryshme komunikimi përdoren për të ofruar përditësime mbi aktivitetet e lidhura me përgjegjësinë sociale të sipërmarrjes dhe praktikën e zhvillimit të qëndrueshëm (p.sh., media sociale, postera, faqe web, etj.)?

Sipërmarrja përdor shërbimet teknologjike të tilla si analizat e të dhënave ose blockchain, për të rritur transparencën e raportimit?

Kornizat ndërkombëtare drejtojnë praktikën e sipërmarrjes në respektim të të drejtave të njeriut (p.sh., Parimet Udhëzuese të OKB-së për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut, Konventat e Zyrës Ndërkombëtare të Punës, etj.)?

Sipërmarrja konsultohet dhe bashkëpunon me organizata të ndryshme ose ekspertë të fushës për të përmirësuar respektimin e të drejtave të njeriut e për të shmangur veprimet e sipërmarrjes që mund të shkaktojnë dëm për komunitetet lokale ose punonjësit?

Sipërmarrja garanton që mekanizmat e ankimimit të jenë në dispozicion për individët e prekur me qëllim që të raportohen rastet e shkeljes së të drejtave të njeriut?

Sipërmarrja trajton me prioritetet kontradiktat ndërmjet synimeve të biznesit dhe detyrimeve ndaj të drejtave të njeriut?

E. Përafrimi me Objektivat dhe Praktikën e Zhvillimit Ekonomik të Qëndrueshëm

Sipërmarrja bashkëpunon me qeverinë, organizatat jo-qeveritare ose sipërmarrjet e tjera për të avancuar lidhur me Objektivat e Përbashkëta të Zhvillimit të Qëndrueshëm?

Sipërmarrja rrit ndërgjegjësimin lidhur me objektivat e përbashkëta të zhvillimit të qëndrueshëm midis punonjësve, klientëve dhe furnitorëve?

Sipërmarrja ndërmerr veprime për të avancuar lidhur me çështjen e barazisë gjinore sa i takon menaxhimit të fuqisë punëtore?

Sipërmarrja siguron që partneritetet e formuara lidhur me objektivat e përbashkëta të zhvillimit të qëndrueshëm të jenë reciprokisht të dobishme dhe me ndikim sikurse kërkon të balancojë prioritetet globale me nismat e saj lokale?

Sipërmarrja identifikon dhe vendos prioritetet në fushat e zhvillimit social, mjedisor dhe ekonomik?

Sipërmarrja trajton konfliktet midis qëllimeve të fitimit dhe objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe përgjegjësisë sociale?

Sipërmarrja mbështet qasje dhe teknologji inovative për të avancuar lidhur me zhvillimin e qëndrueshëm dhe përgjegjësinë sociale?

Sipërmarrja vetë angazhohet për auditim të jashtëm sa i takon iniciativave lidhur me zhvillimin e qëndrueshëm dhe përgjegjësinë sociale në kuadër të transparencës dhe llogaridhënies?

ANEKS B

Vlerësimet e marra nga personat e anketuar kanë pasur në fokus angazhimin lidhur me përgjegjësinë sociale dhe zhvillimin e qëndrueshëm në sipërmarrjet si vijon:

Agi Kons shpk
Union Bank sh.a
Conad Albania shpk
RDA Petrol sh.a
Albaelettica shpk
Fushe-Kruje Cement Factory shpk
Albawings shpk
4 A-M shpk
Rejsi Farma shpk
Tirana International Airport sh.a
Agro Blend Group shpk
Gjoka Konstruksion sh.a
Salilari shpk
Ayen Energji Trading sh.a
Gega Center GKG shpk
OLSI shpk
Korporata Energjitike Shqiptare sh.a
Info-Telecom shpk
Bankers Petroleum Albania shpk
Big-Market shpk
Banka Kombetare Tregtare sh.a
Kastrati shpk
Gen-I Tirana shpk
Kastrati Group sh.a
OSHEE Group sh.a
GSA shpk
Kurum International sh.a
Gega Oil Group sh.a
Ener Trade shpk
Alfa sh.a
Antea Cement sh.a
Albametal sh.a
Shijaku shpk
Besniku shpk
Operatori Sistemit Trasmetimit (OST) sh.a
Tirana International Development shpk

Ayen As Energji sh.a
Eduart 2010 shpk
One Albania sh.a
Vodafone Albania sh.a
Eroil sh.a
Noa Energy Trade shpk
Banka Credins sh.a
Philip Morris Albania shpk
Bolv-Oil sh.a
Raiffeisen Bank sh.a
Tabacco Holding Group shpk
Spar Albania shpk
Gener 2 shpk
Tenet sh.a
Skenderi G shpk
Marketing & Distribution shpk
Neptun shpk
CFO Pharma shpk
Intesa Sanpaolo Bank sh.a
Ikona shpk
Albtelecom sh.a
Albanian Distribution and Development shpk
Ex-Fis sh.a
Zico sh.a
Green Coast shpk
Aleat sh.a
ITX-Albania shpk
EHW shpk
Everest shpk
Banka OTP Albania sh.a
Albania Marketing Service shpk
Albpetrol sh.a
Larti shpk
Rafaella 2002 sh.a
Alb-Star shpk
American Hospital sh.a
Arlis-Ndertim shpk
Elka-Sa shpk
Rossmann-Lala shpk
Yura Corporation Albania shpk
Sigal Uniq Group Austria sh.a

British American Tobacco-Albania shpk
INTEKAR-ASL sh.a
Coca-Cola Bottling Shqiperia shpk
Brunes shpk
Mance TCI shpk
Ferra&Co shpk
Europetrol Durrës Albania sh.a
Albchrome shpk
Inter Distribution Service shpk
Devoll Hydropower sh.a
Agna sh.a
Av.International Group sh.a
Banka e Tiranës sh.a
Banka Amerikane e Investimeve sh.a
Delta Pharma shpk

ANEKS C

Vlerësimet e elementeve të anketimit

Tabela 1. Intervalet e vlerësimit për elementet e anketimit

Shkalla Likert	Vlerësimi me pikë	Vlerësimi me përshkrim
1	1.00-1.8	Nuk jam aspak dakord
2	1.81-2.6	Nuk jam dakord
3	2.61-3.4	I pavendosur
4	3.41-4.20	Jam dakord
5	4.21-5	Jam plotësisht dakord

Tabela 2. Vlerësimi i elementeve të anketimit

	1	2	3	4	5	Vlerësimi
A1	1*18	2*15	3*28	4*16	5*15	2.94
A2	1*17	2*11	3*15	4*21	5*28	3.347
A3	1*18	2*11	3*17	4*26	5*20	3.2
A4	1*15	2*11	3*28	4*23	5*15	3.13
A5	1*15	2*13	3*25	4*19	5*20	3.173
A6	1*11	2*13	3*21	4*27	5*20	3.347
A7	1*12	2*14	3*20	4*19	5*27	3.38
A8	1*11	2*15	3*24	4*19	5*23	3.304
B1	1*7	2*9	3*18	4*28	5*30	3.706
B2	1*5	2*12	3*22	4*19	5*34	3.88
B3	1*6	2*4	3*13	4*26	5*43	4.04
B4	1*7	2*11	3*16	4*32	5*26	3.641
B5	1*8	2*12	3*16	4*23	5*33	3.663
B6	1*11	2*9	3*19	4*27	5*26	3.521
B7	1*6	2*7	3*22	4*26	5*31	3.75
B8	1*4	2*11	3*19	4*26	5*32	3.771
C1	1*9	2*10	3*22	4*30	5*21	3.478
C2	1*10	2*13	3*16	4*33	5*20	3.434
C3	1*16	2*5	3*25	4*25	5*21	3.326
C4	1*8	2*7	3*13	4*30	5*34	3.815
C5	1*9	2*9	3*15	4*35	5*24	3.908
C6	1*9	2*10	3*13	4*30	5*30	3.673
C7	1*11	2*10	3*25	4*18	5*28	3.456
C8	1*11	2*10	3*24	4*32	5*15	3.326
D1	1*9	2*9	3*17	4*27	5*30	3.652
D2	1*6	2*10	3*13	4*33	5*30	3.771

Vlerësimi i perceptimit publik mbi angazhimin e sipërmarrjeve në fushën e përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm: Rasti i Shqipërisë - Ina Balukja

D3	1*9	2*7	3*16	4*16	5*44	3.858
D4	1*7	2*9	3*25	4*22	5*29	3.619
D5	1*11	2*8	3*28	4*18	5*27	3.456
D6	1*14	2*2	3*24	4*22	5*30	3.565
D7	1*9	2*6	3*20	4*26	5*31	3.695
D8	1*9	2*6	3*13	4*26	5*38	3.847
E1	1*9	2*9	3*17	4*32	5*25	3.597
E2	1*8	2*10	3*10	4*38	5*26	3.695
E3	1*12	2*7	3*11	4*28	5*34	3.706
E4	1*12	2*5	3*17	4*29	5*29	3.63
E5	1*10	2*7	3*16	4*36	5*23	3.597
E6	1*7	2*8	3*23	4*30	5*24	3.608
E7	1*5	2*9	3*15	4*31	5*32	3.826
E8	1*9	2*9	3*14	4*29	5*31	3.695